



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 24, 28 DHE 29 DHJETOR 2021**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 24, 28. I 29. DECEMBRA 2021. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2021**

Rendi i ditës

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-096 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Programit - Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit,
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-100 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian, në njërën anë, dhe Kosovës, në anën tjetër, për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit Horizon Europe - Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin,
8. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-105 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa kreative (2021-2027),
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-055 për dizajnin industrial,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-059 për patentat,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut,

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor,
21. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
22. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
23. Propozimi i dy (2) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese,
24. Zgjedhja e dy (2) drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, “NP KOSTT”,
25. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave,
26. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtëritshme,
27. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-021 për tregti me jashtë,
28. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-099 për borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore,
29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
31. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-079 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-85 për peshkatari dhe akuakulturë,
32. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/5 për farërat,
33. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-085 për bujqësi organike,
34. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-082 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve,
35. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat,
36. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-084 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-53 për gjuetinë,
37. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-085 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/13 për materialin fidanor,
38. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-086 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-114 për pasurimin e miellit,
39. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-087 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 04/L-040 për rregullimin e tokës,
40. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-111 për bletari,
41. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-089 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/10 për plehurat artificiale,

42. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-090 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-10 për përkujdesjen ndaj kafshëve,
43. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/21 për veterinarinë,
44. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-029 për Inspektoratin Bujqësor,
45. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-093 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve,
46. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-094 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 02/L-9 për ujitjen e tokave bujqësore,
47. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-095 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve,
48. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
49. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-064 për tokën ndërtimore,
50. Debat parlamentar në lidhje me krizën energjetike në Kosovë.

Dnevni red

1. Izjave van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja,
3. Usvajane zapisnika sa vanredne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-098 o ratifikaciji Memoranduma o razumevanju između Ambasade Sjedinjenih Američkih Država, Priština, Kosovo, i Ministarstva obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacija Republike Kosovo za Fulbrajtove programe akademске razmene,
5. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-097 o ratifikaciji Sporazuma između Republike Kosovo i Republike Severne Makedonije o statusu pripadnika Bezbednosne snage Republike Kosovo i Vojske Republike Severne Makedonije tokom njihovog privremenog boravka na teritoriji relevantnih država,
6. Razmatranje Nacrta Zakona 08/L-096 o ratifikaciji Sporazuma između Republike Kosova i Međunarodne Asocijacije za Razvoj u vezi finansiranja Programa-olakšavanje i omogućavanje mogućnosti za osiguranje vode,
7. Razmatranje Nacrta zakona nr. 08/L-100 o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Evropske unije i Kosova, za učešće Kosova u programu Unije Horizont Evropa - Okvir programa za istraživanje i inovacije,
8. Razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-105 o ratifikaciji Sporazuma o učešću Kosova u programu Evropske unije Kreativna Evropa (2021-2027),
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-012 o komorama arhitekata i inženjera u oblasti građevinarstva,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-053 o topografijama poluprovodnika,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-055 o industrijskom dizajnu,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-059 o patentima,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-037 o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-76 o reproduktivnom zdravlju,
14. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-038 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-192 o transplantaciji tkiva i ćelija,
15. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-039 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-024 za hitnu medicinsku pomoć,
16. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-040 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-156 o kontroli pušenja,
17. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08 / L-041 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-023 o zaštiti dojenja,
18. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-044 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-110 o prekidu trudnoće,
19. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-045 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-042 o krvi i sastojcima krvi,

20. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-051 o izmenama i dopunama Zakona br. 2004/38 o pravima i odgovornostima stanovnika Kosova u zdravstvenom sistemu.
21. Izbor direktora Agencije za borbu protiv korupcije,
22. Izbor članova Sudskog saveta Kosova,
11. Predlog dva (2.) kandidata za sudije u Ustavnom sudu,
12. Izbor dva (2.) direktora Borda Javnog preduzeća operater sistema, prenosa i tržišta, “JP KOSTT” ,
13. Izbor tri (3) člana Nezavisne komisije za medije,
14. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-018 o prometu naftnih derivata i obnovljivih goriva,
15. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-021 o spoljnoj trgovini,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-099 o državnom dugu i državnim garancijama,
17. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-077 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-127 o poljoprivrednoj registraciji,
18. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-078 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-041 o proizvodnji, sakupljanju, preradi i prometu duvana,
19. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-079 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L- 85 o za ribarstvu i akvakulturi,
20. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-080 o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/5 o semenima,
21. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-081 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-085 o organskoj poljoprivredi,
22. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-082 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-120 o zaštiti bilja,
23. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-083 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-8 o vinima,
24. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-084 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-53 o lovu,
25. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-085 o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/13 o materijalu sadnica,
26. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-086 o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-114 o obogaćivanju brašna,
27. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-087 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-040 o uređenju zemljišta,
28. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-088 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-111 o pčelarstvu,
29. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-089 o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/10 o veštačkim đubrivima,
30. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-090 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L- 10 o zbrinjavanju životinja,

31. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-091 o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/21 o veterinarstvu,
32. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-092 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-029 o poljoprivrednoj inspekciji,
33. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-093 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-042 o proizvodima za zaštitu bilja,
34. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-094 o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-9 o navodnjavanju poljoprivrednih zemljišta,
35. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-095 o izmeni i dopuni Zakona br.2003/9 o zemljoradničkim zadrugama,
36. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-052 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/1-010 o kosovskoj agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
37. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-064 o građevinskom zemljištu,
38. Parlamentarna rasprava o energetskej krizi na Kosovu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, nëse mund të uleni nëpër vendet tuaja, sepse po e fillojmë këtë seancë plenare!

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

I nderuar ministër,

Po i hapim punimet e kësaj seance plenare, rendin e ditës e kemi përgatitur në mbledhjen e Kryesisë, të cilën e kemi mbajtur më 21 dhjetor.

Ju lus edhe një herë që t'i respektojmë masat, të cilat na i ka rekomanduar Instituti i Shëndetit Publik, masat të cilat i aplikojmë në luftimin e pandemisë COVID-19, prandaj përdorimi i maskave, si dhe mbajtja e distancës janë të nevojshme.

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Fjalën në emër të Lëvizjes Vetëvendosje e ka nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë,

Edhe ky vit që po e lëmë pas që nga dita e parë pothuajse pandemia e ka dominuar jetën e gjithsecilit prej nesh.

Të gjithëve na është dashur të përshtatemi me një jetë, përvojë sa e çuditshme shpeshherë edhe çorientuese. Në të njëjtën kohë ky vit ishte plot shpresë me politikat qeveritare në shërbim të qytetarëve, me kursim të parasë publike, me llogaridhënie, me investime dhe përkrahje për shpresat më të nevojshme në shoqërinë tonë. Një vit që institucionet shtetërore qëndruan më pranë qytetarëve. Një vështrim për historinë tonë jo të largët, të kohëve të trazuara duhet të na shërbejë si një frymëzim. Pas një dhune shkatërrimi dhe humbjeje që ne përjetuam me vite, ne gjetëm forcën, kurajën që jetën ta bëjmë më të sigurt e më të mirë për gjeneratat që do të vijnë. Dhe, më e rëndësishmja ne kemi mësuar se çfarëdo që na hedh jeta, sado e vështirë apo e dhimbshme të jetë, ka gjithmonë dritë në fund të tunelit. Gjatë këtij viti që po e lëmë pas ishim ne që siguroam dozat e para të vaksinës Pfizer dhe sot kemi shkallën më të lartë të vaksinimit të popullatës në rajon. Me këtë rast, dua ta falënderoj ish-ministrin e Shëndetësisë, zotin Arben Vitia, për angazhimin dhe punën e tij që e ka bërë në këtë drejtim, por në të njëjtën kohë edhe gjithë ata që na ndihmuan nga organizatat ndërkombëtare, domethënë në ndihmesën tonë rreth luftës së pandemisë.

Gjithashtu, ishim ne që filluam mbështetjen për lehonat dhe shtesat për fëmijë, dhe jo vetëm që po fuqizojmë rolin e gruas, por po ndihmojmë edhe në krijimin e kushteve elementare për mirëqenien e fëmijëve. Ishim ne që po ndihmojmë bizneset në shtimin e kapaciteteve të tyre prodhuese, duke nxitur një dinamikë më të shtuar të aktivitetit ekonomik në vend. Kosova këtë vit ka shkallën më të lartë të zhvillimit ekonomik në rajon. Politika e subvencionimit dhe granteve për bizneset dhe qytetarët po vazhdon ende. Republika e Kosovës po shndërrohet në një partner serioz që ofron siguri, zhvillim dhe paqe në rajon dhe më gjerë. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ne po e godasim krimin pa dallim etnie dhe jemi në rrugë të mirë në miratimin e bazës ligjore edhe për konfiskim të pasurisë së pajustificueshme.

E lajme të mira në këtë vit kishim për të gjithë të rinjtë e të rejtat që do të zhvillojnë studimet në arsimin e lartë, ku për herë të parë Qeveria ua mundësoi që ato t'i bëjnë pa pagesë. Sigurisht që janë bërë dhe do të bëhen edhe shumë punë të tjera të mira në vitet pasuese. Të mos harrojmë dhe të jemi vigjilentë se për shkak të variantit Omikron dhe sfidave me marrjen e vaksinës shtesë, ne duhet të mobilizohemi në respektimin e masave në bindjen e qytetarëve në marrjen e vaksinës. Në këtë ditë feste të datës 24 dhjetor për besimtarët katolikë, trajtimi i problemeve të mëdha kërkon që njerëzit të punojnë së bashku. Vitin 2021 le ta kujtojmë për atë që kemi arritur, por të mos vetëmjaftohemi, sepse qytetarët kanë pritje me vite të tëra për një qeverisje të drejtë, për sundim të ligjit dhe për llogaridhënie. Për fund, dhe një herë dua t'i uroj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për festat e fundvitit, gjithashtu edhe deputetët dhe stafin e Kuvendit. Uroj që do të arrini të festoni me familjarët tuaj, por në të njëjtën kohë, lutem që të gjithë të ruajnë shëndetin e tyre, të ruajnë shëndetin e njëri-tjetrit, të respektojnë masat që i kemi dhe po shpresoj që vitin 2022 ta fillojmë me më pak raste...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, urdhëro, regjia, zgjatja fjalën nënkryetares!

SARANDA BOGUJEVCI: Dhe, shpresoj që domethënë sfidat që i kemi pasur me COVID 19 veç të fillojnë dhe të eliminohen. Çdo të mirë dhe shihemi më 2022! Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Tash, fjalën e ka në emër të Partisë Demokratike deputeti Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë,

Jeni dëshmitarë, tashmë kemi hyrë në një fazë të krizës së thellë energjetike. Kjo krizë është si pasojë e shumë faktorëve, atyre globalë dhe atyre lokalë. Pasojat janë jashtëzakonisht të mëdha në të gjitha sferat ekonomike, sociale të vendit, humbjet financiare të shtetit janë qindra

milionëshe dhe ajo çka është ende më e rëndë, ne si Kosovë e dimë vetëm që kemi hyrë në krizë, por nuk kemi asnjë të dhënë, asnjë parametër, asnjë informacion se kur dhe si do të dalim nga kjo krizë, cilat dhe sa do të jenë pasojat ekonomike financiare, si dhe sa do të përballojnë qytetarët këtë situatë në periudhën më të vështirë të dimrit. Edhe për situatë të tilla, shoqëria njerëzore e kulturuar dhe e modernizuar ka paraparë skenarët, Kosova ka Kushtetutë dhe legjislacion të qartë dhe shumë fleksibil për këto situatë krizash, përgjegjësi kryesor është Qeveria e Kosovës, me gjithë sektorët dhe dikasteret që mbulojnë këtë sektor të energjisë. Po a i ka kryer detyrat dhe obligimet Qeveria karshi kësaj krize? E themi me përgjegjësi të plotë, jo! Mungesa totale e një planifikimi për një situatë të tillë përkundër paralajmërimeve të hershme, mungesa mobilizuese, organizuese ndërinstucionale, paaftësia e skajshme vendimmarrëse e kësaj qeverie, orientimi i tërë kapacitetit qeveritar drejt identifikimit të zbulimit dhe të ashtuquajturve “fajtorë historikë” parti e qeveri të kaluara, procese e individë të caktuar.

Për të ardhur në përfundim final qeveritar që fajtorë janë qytetarët, të cilët po kërkojnë shërbim dhe ngrohje gjatë stinës së dimrit. Kulmi i injorancës dhe i papërgjegjësisë institucionale është ky konstatim. Në tërë këtë proces krize e gjer më sot kemi një mostransparencë dhe joseriozitet të veprimeve dhe komunikimeve qeveritare, e në anën tjetër, e ballafaquar me realitetin në rend të popullizmit dhe të retorikës politike, e cila nuk zgjati shumë, po ballafaqohet me sfidën që tashmë duhet të marrë veprime. Duhet të marrë veprimet e para, ndau 20 milionë euro KEK-ut pa asnjë bazë ligjore. Pra, ato që duhet të kalojnë nga KEK-u te KEDS-i dhe KESCO. Qeveria ndau edhe 20 milionë të tjera KOSTIT, mjete këto në emër të dividitës, të cilat u munduan të kamuflohen po ashtu me një retorikë populiste tash e gjashtë muaj, të cilat e dinë dhe kanë një destinacion të saktë, destinimin e mbulimit të humbjeve në pjesën veriore, por që Qeveria nuk donte dhe nuk do ta marrë përsipër në mënyrë populiste këtë problem.

Importet janë rritur si asnjëherë më parë në 15 vjetët e fundit, përkundër shtimit të kapaciteteve gjeneruese nga energjia alternative që ka filluar këtë vit. Qytetarët po i nënshtrohen një diskriminimi të skajshëm duke qëndruar në terr me orë të tëra. Kjo situatë ka dy kuptime: diskriminimi po ndodh jo në tërë territorin e vendit, sepse në pjesën veriore, përjashtoj lagjet e banuara me shqiptarë, nuk ka reduktime dhe nuk ka ndalje të rrymës. Asnjë reagim nga Qeveria për këtë situatë diskriminuese në pjesë të caktuara të vendit. Dhe, natyrshëm vijmë deri te pyetjet: cilët janë hapat që parasheh Qeveria përveç reduktimeve? Çfarë praktike po ndjek kjo qeveri? Cilat janë modelet e zgjidhjes së kësaj krize, së paku të marra nga shtetet e tjera përreth? Nëse nuk ka ide, së paku të konsultohet dhe të marrë modelet e shteteve përreth.

Ku janë rekomandimet e grupit të Task Forcës për energjinë që u proklamua shumë që kanë themeluar një grup task force, veprimet e të cilës nuk po i shohim, asnjë rezultat praktik. Dhe, në fund të këtij diskutimi, si përfundim për shkak të paaftësisë dhe neglizhencës qeveritare, i themi kryeministrit që urgjentisht duhet të lirojë nga detyra një pjesë të kabinetit të tij që mbulojnë sektorin e energjisë, të shpallë gjendje emergjente të jashtëzakonshme, mbështetur në

legjislacionin në fuqi, të jetë transparent para opinionit dhe qytetarëve për transaksionet qeveritare që po ndërmerr, të ndërpresë urgjentisht gjuhën e komunikimit fyes me konsumatorët dhe qytetarët, të dalë përtej konceptit të VV-së dhe të formojë trupa profesionale për sektorin e energjisë për rrethana të jashtëzakonshme, të hartojë urgjentisht një plan veprimi afatshkurtër njëvjeçar, i cili do të përballojë sfidat që ka vendi dhe ekonomia jonë e përgjithshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Kryetar i Kuvendit!

Kryesi,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kosova ka filluar qeverisjen me një shumicë, pra qeverisje më të madhe ndonjëherë që nga paslufta, me subjektin politik Vetëvendosje që ka fituar mbi 50% të votave.

Me luftën ndaj të keqes, të cilën e ka trumbetuar përmbi një dekadë, çka i ka ndodhur Kosovës? E ka fituar qeverinë më të keqe ndonjëherë në historinë e vet. Një qeveri që është e paaftë në politikë të jashtme, një qeveri që ka vetëm dështime në politikë të jashtme. Qeveria e parë që ka mbërritur të krijojë mosbesim, pra mosbesim të skajshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qeveria e parë që ka mbërritur ta dorëzojë Kosovën në duart e disa zyrtarëve evropianë në çështjen më të rëndësishme të vetën, pra përballje me Serbinë. Një qeveri, e cila nuk ka ditur të udhëheqë në çështje të sigurisë, një qeveri që progresin pas dy dekadave në Veri të Kosovës ka mbërritur ta zbehë skajshëm. Po ashtu, një qeveri, e cila ka qenë vetëshkatërruese sa i përket energjisë në Kosovë, qeveri e cila ka penguar me çdo mjet e çdo mënyrë investimet në energji.

Së fundi, ajo që është një çështje mjaft e ndjeshme, jemi në prag të festave të fundvitit e të bashkimit familjar. Kjo qeveri diasporën tonë, pra ata që i kanë ndihmuar të vijë në pushtet, sot po i dënon në mënyrën më të keqe me pritje orë të tëra në kufi, por jo vetëm kaq. Kjo qeveri e mban në fuqi orën policore, nëse e marrim kohën të cilën mërgimtarët qëndrojnë në Kosovë, pra nëse janë dy javë dhe ua heq kohën e orës policore që s'kanë të drejtë qarkullimi, i bie që ata rrinë 1 javë e gjysmë në Kosovë. Imagjinoni Qeverinë e Kosovës, e cila edhe kohën sa qëndrojnë në vend ua vështirëson me orë policore. E lus ministrin e Shëndetësisë që ka ardhur prej Amerikës t'i tregojë kryeministrit të vet se ora policore nuk aplikohet në asnjë vend në botë që ka ndalesa për shkak të pandemisë, që ka kufizime për shkak të pandemisë. Gjenerali, ju lutem, cili vend tjetër në botë ka ndalim-qarkullimi edhe kur kanë lockdown Anglia, Gjermania e vendet të tjera, pra nuk kanë orë policore, nuk kanë ndalim qarkullimi.

A di dikush të na tregojë neve prej ekspertëve të Vetëvendosjes, pse ndalesa e qarkullimit nga mesnata deri në orën 05:00? Si ndihmohet, pra luftimi i pandemisë me këtë ndalesë qarkullimi,

veçanërisht nxitoni ta merrni këtë vendim para festave dhe për kohën sa janë diaspora në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu, nga PDK-ja!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Situata me pandeminë COVID19 në muajin e fundit në vendin tonë ka qenë me tendencë të rritjes, po ishte e qetë.

Mirëpo, rreziku për përkeqësim të situatës i paralajmëruar nga ekspertët shëndetësorë rezulton që të jetë prezent në ditët në vijim dhe kjo po shihet nga shtimi i numrit të rasteve. Situata më e rëndë në muajin e fundit ka qenë me gripin sezonal, dhe ka kohë që sistemi ynë shëndetësor ka kaluar vetëm në kujdes ndaj COVID-19 dhe janë anashkaluar sëmundjet e tjera, përjashtimisht rasteve urgjente. Për shkak të neglizhencës, mosvaksinimit dhe të keqmenaxhimit, situata me gripin sezonal në spitalet tona dhe në QKMF është alarmante. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, vetëm nga data 6 deri më 12 dhjetor janë shënuar 6 mijë raste të gripit sezonal. Numri i atyre me gripin sezonal tani e kalon 20 mijë raste.

Simptomat e gripit sezonal dhe të variantit të ri Omikron janë me simptomatologji të njëjtë, pra lodhje, dhimbje koke, dhimbje trupi, gërvishtje fyti dhe dilemat e shumë qytetarëve sot që po përballen me këto simptoma është se a janë me grip sezonal apo të infektuar me variantin Omikron. Dhe, rreziku i përhapjes së këtij varianti dhe shpejtësia e përhapjes së tij është e madhe. Këtë shqetësim e kam diskutuar edhe me ministrin e Shëndetësisë, i cili ka konfirmuar se edhe pas dy vjetëve të përballjes me pandeminë COVID-19 Kosova nuk ka arritur të rrisë kapacitetet identifikuese dhe testuese për variantin Omikron dhe variantin Delta. Dhe, kjo paraqet problem, sepse ende vazhdojnë testimet me tampon pa rritjen e nivelit të testimeve.

Kjo paaftësi po të rriten kapacitetet testuese identifikuese të varianteve të COVID-19, kanë ndikuar në përhapjen e virusit dhe sot spitalet tona dhe QKMF-të janë të mbushura me virusin sezonal apo variantin Omikron, i paidentifikuar deri më tani tek ne.

Të nderuar qeveritarë,

Sa herë që të deklaroheni për pandeminë, e para që do të duhej të bënit është t'u kërkonti falje qytetarëve për keqmenaxhimin, për katastrofën shëndetësore, të cilën e futët vendin tonë gjatë muajve të verës, ku për 3 muaj kemi pasur 1 mijë raste të vdekjes dhe të keni kujdes të shtoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro? Po, zoti Haxhiu, le ta përfundojë fjalimin!

BEKIM HAXHIU: Dhe, të shtohen kapacitetet e vaksinimit, të ketë një kujdes të veçantë sa i përket afatit të vaksinave të pranuar donacion dhe të blera nga Pfizer. Sipas deklaramit të ish-ministrit të Shëndetësisë, më 15 shtator në Kosovë kanë qenë 538 mijë doza të vaksinave të pranuar donacion nga SHBA-ja. Pastaj, kanë qenë 700 mijë doza të blera nga Pfizer, 94 mijë doza të pranuar nga EU, shumë doza nga Covax, 10 mijë nga Kroacia dhe, prej kësaj periudhe kohore e deri më sot janë administruar më pak se 600 mijë doza të vaksinave, kjo rezulton që në stok të jenë afro 900 mijë doza të vaksinave të pranuar në shtator. Sot jemi në fund të dhjetorit dhe nëse nuk ka një rritje të intensitetit të vaksinimit rrezikojmë që edhe këto doza të vaksinave të hidhen njësoj si ato të Aztra Zenec-as.

KRYETARI: Deputeti Vendenis Lahu nga Lëvizja Vetëvendosje.

VENDENIS LAHU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Më lejoni që nga kjo foltore sot t'ju adresohem shkurtazi rreth situatës epidemiologjike në vend, në vigjilje të festave të fundvitit dhe ardhjes së shumë njerëzve në Kosovë për këto festa.

Që prej valës së fundit me variantin Delta, të koronavirusit që përfshiu edhe Kosovën, sikurse shumë nga vendet më të zhvilluara, në vendin tonë prej asaj periudhe situata epidemiologjike vazhdon të jetë e qetë, e me vetëm pak raste të reja të koronavirusit. Momentalisht, sipas të dhënave të IKSHPK-së, janë vetëm 326 raste aktive, por nuk mund të themi se situata është e tillë edhe në rajon e botë, ku është paraqitur një variant i ri i koronavirusit, për të cilën kemi dëgjuar të gjithë, besoj, varianti Omikron.

Disa nga këto vende, në të cilat varianti Omikron është shndërruar në variant dominues, po përjetojnë një numër të madh të infektiveve në ditë, e disa prej këtyre vendeve edhe numrin më të madh të infektiveve në ditë prej fillimit të pandemisë. Ne deri më tani nuk kemi të raportuara raste me variantin Omikron, por kjo nuk do të thotë se ky variant nuk do të vijë te ne, edhe për shkak të rritjes së numrit të vizitave në Kosovë nga ata që jetojnë jashtë, por edhe duke pasur parasysh faktin se Omikron është variant disafish më i përhapur se Delta, me ç'rast si ilustrim në SHBA nga variant me prezencë të 1% të mostrave të testuara brenda dy javësh ka arritur të jetë variant dominues me prezencë me 70% të mostrave të testuara.

Këto të dhëna për kapacitetet infektuese të tij nuk duhet të na frikësojnë e të na bëjnë të jemi në panik, ashtu siç nuk duhet të na bëjë indiferent e të pakujdesshëm edhe fakti se ky variant, përkundër shkallës së madhe të transmisionit, sipas të dhënave të fundit, ka për 2/3 rrezik më të vogël për hospitalizim e vdekshmëri.

Të nderuar qytetarë, meqë jemi në vigjilje të festave të fundvitit, kohë kur rritet edhe numri i bashkatdhetarëve tanë që vijnë në Kosovë e ku shtohen takimet miqësore e familjare, është e rëndësishme të kujtojmë se virusi është ende mes nesh, prandaj ju bëj apel që të keni kujdes maksimal, të evitoni grumbullimet në vende me shumë njerëz e në ambiente të mbyllura, të përdorni maskën, të ruani distancën dhe higjienën. Të gjithë ju që ende nuk jeni vaksinuar dhe ju që kualifikoheni për dozën përforcuese, të vaksinoheni...

KRYETARI: Shtojani edhe pak deputetit Lahu që ta përfundojë fjalën.

VENDENIS LAHU: Të gjithë ju që nuk jeni vaksinuar deri më tani dhe të gjithë ju që kualifikoheni për dozën përforcuese, dozën e tretë, ju bëj apel që sa më parë të vaksinoheni, sepse vaksina është arma jonë më e fortë ndaj këtij virusi.

Të dashur qytetarë, mbrojeni veten, ruajeni shëndetin dhe gëzuar festat! Faleminderit!

KRYETARI: Nga LDK-ja, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ministra prezentë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në fillim të mandatit tim si ministër i Shëndetësisë u ballafaqova me një kërkesë të ndërprerjes së punimeve në Spitalin Pediatrik Kirurgjik, i financuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe nga ata që ishin duke e ndërtuar këtë spital. Kërkesa ishte që për nëntë muaj ishin ndërprerë punimet dhe arsyetimi i vetëm ishin punë inatesh politike, xhelozia me individë të caktuar, ku u prolongua ndërtimi i këtij spitali. Kjo u zhbllokua, ecën punët, spitali dukej se ishte drejt përfundimit.

Kolegë deputetë,

Diku katër muaj më parë e pamë mënyrën populiste të stilit që e ka kjo Qeveri, bashkë me presidenten, ministrin dhe shumë aktorë të tjerë nga pozita, duke bërë përrurimin e këtij spitali, duke mos folur asnjë fjalë për të kaluarën, së paku edhe duke mos falënderuar, pothuajse në mënyrë periferike edhe investuesit, ndërsa spitali sot akoma qëndron i mbyllur. Kjo papërgjegjësi i dëmton fëmijët tanë, i lejon ata që kanë qëllime të keqja që t'i referojnë këto raste për trajtim jashtë vendit dhe e dëmton shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, nëse ka momentum të kapjes së gjërave në mënyrë graduale, po kjo është më imediate krahas jo vetëm asaj që të gjithë po tentojmë, ose të gjithë po tentojnë luftimin e pandemisë, por edhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Mbyllja e këtij spitali apo qëndrimi i mbyllur i këtij spitali për arsye teknike është papërgjegjësi e madhe, është tepër papërgjegjësi dhe duhet të kërkohet përgjegjësi nga ata që e kanë këtë përgjegjësi, që ta funksionalizojnë këtë spital. Andaj, bëj thirrje nga këtu, që sa më shpejt, jo për arsye teknike, as financiare, sepse edhe kjo Qeveri prapë e ka rritur koston buxhetore për trajtim jashtë vendit, ndërsa i ka ulur shpenzimet në shërbime, në furnizime, por edhe në barna.

Kjo është tepër e papërgjegjshme, andaj një spital i tillë i ndërtohet me standardet më të mira ndërkombëtare, me kosto pothuajse mbi 22 milionë, për katër muaj dhe nuk kemi asnjë përgjigje se kur do të funksionalizohet. Kjo tregon keqmenaxhimin, por edhe papërgjegjësinë që të mbajnë veprime konkrete në shërbim të shëndetit të qytetarëve, sidomos të fëmijëve tanë që kanë nevoja të mëdha në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Kryetari i Grupit të AAK-së e ka fjalën, deputeti Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot dua të ngre një çështje që për vlerësimin tim është shumë e jashtëzakonshme dhe ajo lidhet me versionin e ri të Omikronit, i cili po depërton gjithandej botës, po depërton edhe në Evropë dhe, siç shihet, shtetet e ndryshme kanë marrë masa rigorozë ndaj këtij versionit të virusit dhe njëkohësisht pritet që një version i tillë të vijë edhe në Kosovë.

U fol edhe nga disa deputetë kjo çështje dhe kërkesa ime, ministri s'qenka këtu, është shumë e thjeshtë. Duke pasur parasysh që ne kemi parë tash e dhjetë muaj një Qeveri që reagon në probleme, pra nuk ka një situatë ku ndërton politika proaktive ndaj problemeve që dihen. Për shembull, rastin e fundit e kemi me energjinë. E kemi ditur që gjashtë muaj që do të kemi krizë dhe ka një reagim, nuk ka një politikë proaktive për t'u mbrojtur, apo për të pasur një strategji të veprimit në të gjitha temat.

Njësoj ka qenë edhe kur është trajtuar tema e dialogut. Ka gjithmonë reaktivitet, nuk ka proaktivitet. Kërkesa ime për ministrin e Shëndetësisë është që urgjentisht t'i marrë të gjitha të dhëna, fatmirësisht ka të dhëna të mjaftueshme në të gjitha platformat ndërkombëtare për këtë virus, pra për virusin Omicron, që të krijojë një strategji proaktive në raport me këtë virus, që siç po shihet është shumë më depërtues, shumë më vdekjeprurës dhe prek edhe moshat e reja. Nuk po ndalem në procesin e vaksinimit, as të menaxhimit të deritanishëm, por po ju kërktoj, duke qenë se politika juaj ka qenë reaktive në gjithçka, e vonshme në gjithçka, ju lutem që ta trajtoni këtë temë seriozisht dhe të keni një pozicion shumë proaktiv, në mënyrë që ta tejkalojmë edhe këtë situatë sa më mirë. Faleminderit!

2. Pyetjet parlamentare

Deputeti Bekim Haxhiu e ka një pyetje për ministrin Latifi, por ai nuk është i pranishëm në këtë seancë. A dëshironi ta bëni pyetjen, i nderuar deputet?

BEKIM HAXHIU: Pasi që ministri nuk është këtu, atëherë po e bartim për seancën e radhës.

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra, po ashtu e ka një pyetje për ministrin. Nuk janë të pranishëm asnjëri në seancë. Deputetja Ganimete Musliu e ka një pyetje për ministrin Liburn Aliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

I nderuar ministër Liburn Aliu,

Kam parashtruar një pyetje parlamentare, ka ardhur edhe në seancën e kaluar, por s'keni qenë këtu për të prezantuar.

Pyetja ime parlamentare ka të bëjë me prishjen e rrugës në Mazgit, në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, konkretisht në fshatin Mazgit. Ajo prishje është prej janarit dhe tani kemi hyrë në dimër, ose në fund të vitit, dhe ende është në gjendje të mjerueshme dhe çdo vazhdim i kësaj gjendjeje shkakton pasoja edhe më të mëdha.

Më intereson të di, si ministër dhe si ministri çka keni ndërmarrë që të riparohet dhe kur do të riparohet ajo rrugë, sepse është bërë pengesë e përditshme e shumë qytetarëve, duke pasur parasysh që frekuentimi në atë segment është i jashtëzakonshëm. Kur do të përfundojë rregullimi i kësaj rruge?

KRYETARI: Ministri Aliu e ka fjalën.

MINISTRI LIBURN ALIU: E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Çështja e rregullimit të rrugës në fshatin Mazgit është në procedurë të prokurimit, i cili është shpallur si projekt emergjent, me titull “Sanimi i rrëshqitjes në rrugën në hyrje të autostradës, nga rruga nacionale M2 në Mazgit, zona kadastrale Obiliq”.

Paraprakisht kemi qenë të detyruar të bëhet analiza gjeo-mekanike e shtresave tokësore dhe në bazë të analizave laboratorike, të hartohet projekti i hollësishëm për sanimin e gjendjes në këtë segment. Pra, bëhet fjalë për projekt që ka qenë pjesë e projektit të autostradës, pjesa e kyçjes, edhe çështja e rrënimit të asaj pjese ka kërkuar trajtim bukur të hollësishëm, edhe shkaktarin, edhe për t'i ditur arsyet pse ka ndodhur dhe cilat do të jenë masat konkrete, e që nënkupton se duhet bërë shqyrtim të duhur laboratorik për këtë punë.

Deri më tani është bërë përzgjedhja e operatorit ekonomik punëkryes nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe, në ndërkohë, për shkak të ankesës nga një operator ekonomik dhe meqenëse procesi i ankimimit merr kohë për shkak të procedurave ligjore, ministria si autoritet është e obliguar që të respektojë të gjitha këto procedura. Pra, presim që pas përfundimit të ankesave ta fillojë punën operatori ekonomik dhe varësisht prej motit, apo të reshurave atmosferike, të sanohet kjo pjesë e rrugës. Pra, kemi pasur ankesë në procedurën e prokurimit dhe kjo e ka zvarritur procedurën deri më tani, kurse tash jemi në pritje të përfundimit të saj.

KRYETARI: Deputete Musliu, a dëshironi ta bëni edhe një pyetje shtesë?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Po e bëj një pyetje shtesë. Mbase s'më shtini në ndonjë grup kriminel, se po kërkoj hollësi. Më intereson, vetëm pak sa për qytetarët, sa është afati i ankimimit? Po e kuptoj shumë drejt dhe qartë, ju falënderoj për të gjitha sqarimet që i dhatë!

Më intereson të di sa është faza, ose afati i ankimimit dhe kur përfundon, që pak a shumë ta kemi një orientim, se pas ankimimit, fillon puna. Unë e kuptoj plotësisht që reshjet atmosferike janë pengesë e madhe, po megjithatë më intereson vetëm ana ligjore, procesi i ankimimit kur përfundon, që qytetarët ta kenë pak a shumë një vëmendje rreth asaj që ne e diskutojmë sot dhe lehtësimet e qarkullimit në atë pikë.

MINISTRI LIBURN ALIU: Afatet në hollësi për çështjet e ankimimeve dhe sa janë ato, janë çështje, detaje të prokurimeve dhe autoriteteve të prokurimit, detaje të cilat unë nuk hyj e as nuk i di. Por, me aq sa di, është edhe autoriteti i OSHP-së, problemet që kanë ndodhur, pra mosfunksionimi i autoritetit të OSHP-së, i cili e ka zvarritur në këtë mënyrë këtë procedurë. Kur saktë, unë tash nuk mund të jap përgjigje menjëherë, po mbase mund të jap përgjigje pastaj për hollësitë. Përndryshe, është në proces dhe është bukur me urgjencë.

KRYETARI: Deputeti Pal Lekaj, nuk po e shoh që është këtu. Dalim te pyetjet që parashtrohen për herë të parë.

Një pyetje prej deputetit Haradinaj i është parashtruar kryeministrit, por kryeministri na ka lajmëruar se është në disa aktivitete të tjera, nuk ka mundur të marrë pjesë në seancë. Për këtë arsye i është kthyer përgjigja me shkrim, më ka lajmëruar zoti Haradinaj. E dëshironi fjalën?

RAMUSH HARADINAJ: Po, një përgjigje me shkrim, do ta lë këtë çështje kur të jetë kryeministri prezent. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Ariana Musliu-Shoshi e ka pyetjen për ministrin e Shëndetësisë, por ai nuk është këtu, zonja Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Zoti kryetar,

Pyetjen që doja ta adresoja ka të bëjë me mosnjohjen e certifikatës së vaksinimit për qytetarët tanë në shtetet e BE-së, si në Zvicër, Greqi, Gjermani dhe mendoj që është shumë e rëndësishme që ministri të jetë këtu dhe të japë përgjigje për qytetarët tanë që i kanë këto probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Hisen Berisha e ka pasur një pyetje për Arbërie Nagavcin, deputeti nuk qenka këtu, me sa po e shoh. Po ashtu edhe për ministren Haxhiu e ka pyetjen i njëjti deputet. Deputetja Arjeta Fejza ia shtron një pyetje ministrit Liburn Aliu, pastaj i kthehem zotit Berisha. E keni tërhequr pyetjen? Mirë!

Zoti Berisha, nëse jeni i gatshëm? Pyetjen zoti Berisha e ka për ministren.

HISEN BERISHA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Media,

Po, pyetja ime motivohet nga fakti se kur Kosova e pavarur u paraqit si një formulë e rrezikshme për atë që na mbante të okupuar, për shkak se u përkrah edhe nga Perëndimi dhe të gjithë. Atëherë, i gjithë rrjeti agjenturor armik e realizuan atë, që përmes flamurit të Shqipërisë, sepse kjo ishte pika jonë e dobët, u hodhën në kundërshtim të flamurit të Kosovës. Pikërisht këtë gjë, pikërisht këta, sepse ishte pika jonë e dobët, ngase identifikohet vetë historia jonë, si komb, si rrugëtim politik, si sakrificë, që kemi bërë për po atë flamur.

Kjo arsye pastaj krijon një terren të përshtatshëm për ta sfiduar flamurin e identitetit tonë shtetëror kosovar përmes flamurit kombëtar shqiptar. Me po të njëjtën formulë po luhet edhe me serbët dhe komunitetet e tjera në vendin tonë. Prandaj, dua të them se askush dhe askujt nuk ia mohon të drejtën në flamur kombëtar. Ne kemi luftuar dhe jemi çliruar me të, mirëpo edhe flamuri me të cilin ka luftuar Gjorgj Uashingtoni sot është në muze. Pra, ishte një kohë dhe rrethanë tjetër, tani është një realitet i ri.

Flamuri i Kosovës është i qytetarëve të Kosovës, prandaj unë e kam një pyetje: sa janë marrë masa për respektimin e simboleve shtetërore në institucionet qeverisëse të drejtësisë, agjenci shtetërore, institucione të arsimit, në komuna dhe në vetë institucionet e pushtetit lokal?

KRYETARI: Zoti Berisha, unë të thashë që pyetjen e ke për ministren e Arsimit, po në rregull, ti e paske lexuar pyetjen që është për ministren e Drejtësisë. Përgjigjet ministria tash.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar deputet Berisha,

Më lejoni t'ju njoftoj që Ministria e Drejtësisë s'e ka të përcaktuar përgjegjësinë e saj me Rregulloren 02/2021, prandaj kjo çështje nuk bie në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë.

Ju inkurajoj që ta lexoni Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore dhe aty i gjeni se kush janë përgjegjësitë dhe cilat janë veprimet që duhet të ndërmerren në raport me pyetjen që keni adresuar. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Berisha, a keni pyetje shtesë?

HISEN BERISHA: Po! Edhe pyetjen, edhe t'i tregoj ministres se mosrespektimi i simboleve shtetërore me automatizëm tregon mosrespekt ndaj shtetit dhe kjo e vë në veprim prokurorin do të duhej ta vinte në veprim, sepse mosrespektimin e kemi në institucione, ekspozita flamujsh dhe simbolesh kemi nëpër institucione, përjashtoj Zyrën e presidentit dhe të kryeministrit, që duhet përgëzuar për respektimin që i bën këtij simboli të shtetit. Prandaj, edhe kërkesa e pyetja ime ka qenë e adresuar në Ministrinë e Drejtësisë për moszbatimin e këtij ligji dhe mosveprim të prokurorit në këtë drejtim, se përndryshe, kur të vijë puna e arrestimin të policit, duhet ndërruar edhe diçka krejt tjetër.

KRYETARI: Zonja Haxhiu, nëse s'doni të përgjigjeni!? Ministria konsideron se ka dhënë përgjigjen e saj në pjesën e parë. Zoti Berisha, dëshironi t'ia bëni pyetjen po ashtu edhe ministres së Arsimit?

HISEN BERISHA: Gjatë lëvizjeve tona si deputetë jemi përballur me situata, me ankimime e paraqitje problemesh të ndryshme në zona të ndryshme. Ajo që më ka shqetësuar shumë ka qenë gjendja e shkollave nëpër zonat rurale, jo vetëm në aspektin infrastrukturor, sepse kjo është çështje edhe e mirëmbajtjes së tyre, por në aspektin e kuadrit, përfaqësimit arsimor dhe personave që japin mësim dhe e standardit në të cilin mbahet mësimi nëpër këto shkolla.

Një çështje tjetër që më ka shqetësuar është çështja e kurrikulave në lëndën e historisë. Unë dua ta them një frazë: "Një popull që nuk është patriot, nuk ka as përfaqësim dinjitoz". Kjo po reflekton si rezultat i një sistemi arsimor dekadent edhe në gjithë përfaqësimin tonë institucional dhe shtetëror. A keni menduar në ndryshimin e plan-programeve të mësimi të historisë, që ende mësohen me ato të kohës së komunizmit? Nëse i shihni librat e fëmijëve, besoj se të gjithë përballeni me këto, se të gjithë jeni prindër, në kontekst të kësaj, a keni ndonjë plan dhe kur do t'i ndryshoni kurrikulat? Mos na flisni për abetaren kombëtare, se e kemi parë se ka iniciativë.

Por, çka kam parë unë, një shtypshkronjë i mbledh dy-tre tituj akademikë atje, i fut, e shkruajnë një libër dhe ai e shet atë libër si libër mësimor. Mblidhen dy a tre të tjerë dhe e shkruajnë një, pra asnjëra s'ka harmonizim me politikat tona nacionale rreth arsimit, me theks në lëndën e historisë, ku vendosen dhe mbrohen vlerat tona nacionale dhe historike.

A ka ndonjë plan dhe kur do të fillohet ndryshimi i këtyre kurrikulave?

KRYETARI: Ministrja Nagavci e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Faleminderit deputeti Berisha për pyetjen!

Sa i përket punësimit në komuna, mendoj se duhet ta dini që është kompetencë e drejtorive komunale të arsimit. Ndërkaq, sa i përket çështjes së teksteve, ju informoj përgjithësisht se jemi në proces të hartimit të përfundimit të projektligjit të ri për tekstet mësimore dhe sivjet për herë të parë ne kemi filluar edhe zbatimin e mundësisë për zgjedhjen e teksteve alternative nga ana e mësimdhënësve dhe shkollave.

Sa i përket çështjes që ju adresuat, se akoma janë kurrikulat e kohës së komunizmit, nuk e di çfarë saktësisht keni menduar, por më lejoni t'ju informoj se që nga përfundimi i luftës në Republikën e Kosovës, në vendin tonë dy herë është intervenuar në ndryshimet e kurrikulës së arsimit parauniversitar dhe një herë është rishikuar kurrikula.

Më saktësisht, kurrikula ka ndryshuar në vitin 2001 dhe pastaj në vitin 2011, ndërsa në vitin 2016 është bërë rishikimi i kurrikulave. Pas hartimit të kurrikulës së re, kornizës së re kurrikulare, në vitin 2011, ka ndodhur edhe rishikimi, gjegjësisht ka vazhduar hartimi i programeve dhe kurrikulave lëndore për të gjitha lëndët e të gjitha klasat, përfshirë edhe lëndën e historisë. Këtë vit, në vitin 2021 pra, është përmbyllur i gjithë cikli i hartimit të të gjitha programeve dhe kurrikulave të reja për të gjitha klasat e arsimit parauniversitar dhe ato janë zyrtarisht në zbatim.

Kurrikulat në përgjithësi dhe sidomos kurrikulat e historisë, në veçanti, janë punuar nga grupe të profesionistëve, me përfshirje të profesorëve nga Fakulteti i Historisë së Universitetit të Prishtinës, nga Instituti i Historisë së Kosovës dhe mësimdhënës të shkollave nëntëvjeçare dhe ato të mesme të larta, të koordinuara në përgjithësi nga zyrtarët e MASHT-it.

Kurrikulat janë hartuar duke u mbështetur edhe në përvojën paraprake që ka ekzistuar në Kosovë dhe në përvojat bashkëkohore të vendeve të ndryshme perëndimore dhe ajo që është e rëndësishme të përmendet, është që për programet, kurrikulat në lëndën e historisë që nga fillimi i punës në këtë drejtim vazhdimisht ka pasur edhe shkëmbim të përvojave e konsultime të ndërsjella edhe me ekspertë e historianë nga Republika e Shqipërisë.

KRYETARI: Zoti Berisha, a dëshironi ta bëni edhe një pyetje shtesë?

HISEN BERISHA: Pyetja ime konsistonte në situatën në shkollat në zonat rurale, në kuadrat dhe në mësimbajtjen, në zëvendësimet e orëve. Unë kam parë situatë kur një mësues mban mësim në katër nivelet, në të parën deri në të katërtën. Kjo është një absurditet i llojit të vet, që ndodh nëpër shkollat tona, pikërisht në zonat rurale, ku edhe inspektimet, edhe kontrollet ndoshta janë më të dobëta.

Kurse, sa u përket kurrikulave të lëndës së historisë, unë kam fëmijë dhe unë kam parë në historinë e tyre nga tituj akademikë të paguar nga disa agjenci X, ku thuhet se dyndjet sllave erdhën në shekullin IV në territorin e Kosovës dhe Maqedonisë e Shqipërisë së sotme. Pra, ne jemi duke bërë një dëm të madh në të vërtetën historike në formimin e të rinjve tanë, vetë popullit tonë dhe vetëdijes sonë kombëtare. Shqetësimi është më i thellë, sesa këto politikat e ndërtimit të librave që e kam marrë vesh se si shkojnë përmes shtypshkronjave, ose ta zëmë atje...

KRYETARI: Ministrja e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: I nderuar deputet, po e përsëris edhe një herë.

Sipas Ligjit për arsimin, është kompetencë dhe përgjegjësi e drejtorive komunale të arsimit që të bëjnë punësimin e stafit dhe zëvendësimin e tyre. Në secilin rast të adresimit, apo ku kemi informata, po edhe sipas detyrës zyrtare, ne bëjmë inspektime të rregullta nëpër shkolla dhe i dorëzojmë raportet me rekomandime, por mbetet përgjegjësi e komunave punësimi i stafit.

Sa u përket teksteve shkollore dhe kurrikulave, edhe një herë e përsëris, ato janë punuar nga grupe të ekspertëve, përfshirë të gjithë personat që i përmenda, e që janë të punësuar në institucionet tona. Përtej kësaj, ne kemi filluar një cikël të diskutimeve për tekstet mësimore dhe ju inkurajoj juve dhe secilin që ka rekomandime që të na drejtohen me sugjerime konkrete, që do të shqyrtohen me shumë kujdes nga kolegët tanë në Ministrinë e Arsimit.

KRYETARI: Deputetja Fjolla Ujkani, po ashtu e ka një pyetje për ministren Nagavci.

FJOLLA UJKANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Jemi të vetëdijshëm për avancimin e përshpejtuar të teknologjisë informative në dy dekadat e fundit, ku po bëhet një transformim i madh në jetën tonë shoqërore. Në mënyrë proporcionale është rritur edhe interesimi i të rinjve tanë që të studiojnë shkencat kompjuterike dhe të vazhdojnë ta jetësojnë epokën e digjitalizimit.

Nga kjo perspektivë mund të themi që ka nevojë të futet në kurrikulë lënda e programimit për nxënësit e shkollave të mesme të larta.

E nderuar ministre, a do të mund të zbatohet përfshirja e lëndës së programimit në nivelin e mesëm të lartë, të paktën si lëndë zgjedhore?

KRYETARI: Ministrja Nagavci e ka fjalën.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: E nderuar deputete Ujkani, Faleminderit për pyetjen! Natyrisht se lënda e programimit sikurse edhe lëndët e tjera që paraqesin interes për nxënësit e shkollave të mesme të larta mund të përdoret apo të përfshihet si lëndë me zgjedhje. Kjo është e rregulluar me udhëzimin administrativ nr. 32 të vitit 2013 për organizimin e mësimit me zgjedhje, sipas së cilit, në rast se ka interesim nga nxënësit dhe paraqesin kërkesën për të organizuar një lëndë të tillë, shkolla e ofron si mundësi për nxënësit. Pra, mbetet që të zgjidhet si lëndë dhe pastaj të organizohet nga shkolla. Natyrisht për këtë duhet të ekzistojë edhe infrastruktura për të zbatuar këtë lëndë me zgjedhje, e që besoj që shumica e shkollave i plotësojnë kushtet në këtë drejtim.

KRYETARI: Deputete, a doni pyetje shtesë?

FJOLLA UJKANI: Pra, infrastruktura ligjore qenka. Pra, mbetet të jetë edhe vullneti nga nxënësit. Në të njëjtën kohë, a duhet koordinim ndërmjet drejtorive komunale dhe gjimnazeve apo shkollave teknike, apo duhet edhe leje nga Ministria e Arsimit? Sepse kuptohet që duhen edhe profesorë të profilizuar që ta ligjërojnë edhe lëndën e programimit. Sepse deri tash e kemi parë që profesorët që janë nëpër gjimnaze nuk janë edhe aq adekuat, dhe nuk e kanë të perfeksionuar lëndën e programit, sepse nuk është edhe diçka që mund të bëhet lehtë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministrja e ka fjalën për një përgjigje.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Atëherë, informata shtesë në lidhje me pyetjen. Po kjo është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 32 të vitit 2013, i cili është i publikuar edhe në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit edhe mund të shërbejë, edhe duhet të shërbejë si udhëzues për shkollat. Zakonisht në fund të vitit shkollor, shkollat ofrojnë mundësinë për nxënësit e tyre që të zgjedhin lëndët e caktuara me të cilat ata do t'i përdorin gjatë lëndës me zgjedhje në vitin e ardhshëm shkollor. Secila prej shkollave që merr një numër të konsiderueshëm të kërkesave ka obligim që të organizoj mësimin me zgjedhje sipas kërkesave të nxënësve. Natyrisht kjo duhet të bëhet në koordinim me drejtoritë komunale të arsimit, ku duhet të punësohet stafi në rast se nuk ka kuadro të tilla të kualifikuara në kuadër të shkollës dhe për këtë nuk nevojitet leje e veçantë nga Ministria e Arsimit.

Pra, zgjedhjet në kuadër të shkollave dhe u ofrohet ndihma nëse është e nevojshme nga drejtoritë komunale të arsimit.

KRYETARI: Deputeti Fitim Uka e ka një pyetje për ministrin Rifat Latifi. Ministri nuk është këtu. E bartni për seancën tjetër me siguri.

Po ashtu deputetët Nijazi Isaku, Salih Zyba dhe Halil Thaçi i kanë tërhequr pyetjet e tyre.

Tash deputeti Milazim Salihaj i ka dy pyetje për ministrin Liburn Aliu. Mund ta bëni pyetjen e parë, deputet.

MILAZIM SALIHAI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar media,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër,

Sezoni dimëror tanimë ka filluar dhe në disa rrugë magjistrale dhe regjionale të Kosovës paraqiten të ashtuquajtura pika të zeza në rrugë, terminologji kjo në kuadër të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve. D.m.th. aty ku akumulohet uji në shtresën qarkulluese, pra në asfalt, nga ujërat sipërfaqësorë, si reshjet e shiut, reshjet e borës dhe shkrirja e borës ku pastaj nga temperaturat e ulëta gjatë dimrit krijohen shtresa të akullit të cilat janë potencial për aksidente të trafikut me dëme materiale, e fatkeqësisht në disa raste edhe me fatalitet.

Pyetja: A do të ndërmerri masa që në kuadër të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve magjistrale dhe regjionale, nëpërmjet operatorëve ekonomikë, përkatësisht kompanive të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, të bëni identifikimin e të ashtuquajturave pika të zeza, eliminimin eventual të tyre dhe në pamundësi eliminimi momental, aty të bëni sinjalizimin e nevojshëm të këtyre pikave të zeza, të cilat paraqesin mjaft rrezik për sigurinë në komunikacionin rrugor.

KRYETARI: Ministri Aliu e ka fjalën.

MINISTRI LIBURN ALIU: I nderuar deputet, faleminderit për pyetjen!

Ministria e Mjedisit, e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e bën mirëmbajtjen verore dhe dimërore të autoudhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale të Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, e tërë hapësira territoriale e Republikës së Kosovës është e ndarë në shtatë regjione. Secili nga këto regjione është i mbuluar me operatorë ekonomikë të mirëmbajtjes gjatë gjithë vitit. Për mirëmbajtje ka kontrata, edhe për autoudhë dhe për rrugët nacionale dhe regjionale.

Të gjithë operatorët ekonomikë për mirëmbajtje e kanë të paraparë me kontratë edhe kujdestarinë 24-orëshe. Për sa i përket pikave të zeza, Ministria gjithmonë ka marrë masat e duhura për t'i eliminuar ato dhe jemi në, prapë çdo vit, sidomos në fazat kur vjen sezoni i dimrit, merremi me identifikimin dhe marrjen e masave për eliminimin e tyre. Në këtë aspekt, është bashkëpunuar edhe me Policinë e Kosovës, Departamentin e Trafikut, për t'i eliminuar këto pika.

Për sa i përket pyetjes për akumulimin e ujërave në shtresat qarkulluese nga reshjet e shiut dhe shkrirja e borës, menaxherët e rajoneve janë të obliguar që gjatë tërë kohës të bëjnë monitorimin e rrugës dhe në raste të tilla kur i identifikojnë ato, t'u japin urdhra kompanive që të eliminohen ato sa më shpejt. Në ndërkohë, para se të ndodhë eliminimi duhet të bëhet sinjalizimi edhe mandej dhe eliminimi i tyre të bëhet sipas standardeve teknike. Faleminderit!

KRYETARI: Z. Salihaj, a doni edhe një pyetje shtesë t'ia bëni ministrit? Mund ta bësh edhe pyetjen e dytë.

MILAZIM SALIHAI: Siç jeni në dijeni edhe ju i nderuar zoti ministër, projekti i filluar për zgjerimin e rrugës magjistrale M2, pjesa e Ferizajt dhe pastaj e ndërprerë, pas ankesave dhe kërkesave të bizneseve që e përshkojnë këtë pjesë të rrugës, të cilat biznese kërkojnë revidimin dhe ndryshimin e projekteve me qëllim të ndryshimit të parametrave projektues, me gjasë ngushtimin e gjerësisë së rrugës së projektuar, me të filluar të realizohen punimet në këtë projekt, operatori ekonomik, përkatësisht kontraktori, me qëllim të zgjerimit të rrugës ka realizuar një gjermim me gjatësi përafërsisht 100 m, gjerësi të përafërt 4 m dhe thellësi 1,20 m. Si pasojë e këtij gjermimi në thellësi, me prerje vertikale përgjatë rrugës së asfaltuar, vihet shiriti qarkullues, bëhet akumulimi i ujërave atmosferikë si nga reshjet e shiut ashtu edhe nga bora, të cilët dukshëm po e rrezikojnë trupin e tanishëm të rrugës së asfaltuar, me mundësi të rrëshqitjes të ndonjë pjese të shtresës qarkulluese. Por, edhe siç është tani, paraqet rrezik për pjesëmarrësit në komunikacion, e sidomos tani gjatë stinës së dimrit.

Pyetja: A do të ndërmerrni ndonjë veprim që kjo pjesë e rrugës së sigurohet nga dëmtimi eventual, pra nga rrëshqitja e ndonjë pjese të shiritit qarkullues, si dhe a do të bëni ndonjë intervenim apo sinjalizim pasi kjo pjesë e rrugës siç është tani, paraqet rrezik për pjesëmarrësit në komunikacion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministri Aliu përgjigjet.

MINISTRI LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Faleminderit prapë për pyetjen! Duhet të kemi parasysh se së pari kjo pjesë e rrugës është projekt i cili financohet nëpërmjet kredisë së BERZH-it dhe procedurat janë specifike. Por, sido që të jetë, pavarësisht këtyre procedurave, për shkak të situatës emergjente të mundshme, ne do të marrim veprimet e domosdoshme dhe këto punimet do të rifillojnë sapo të përmirësohen kushtet

atmosferike. Kompanisë mbikëqyrëse i janë dhënë instruksionet për aktivitetet në atë pjesë, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e trupit të rrugës dhe sigurinë në trafik. Në respektim të shqetësimit tuaj, dhe po ashtu të ankesave që i marrim në vazhdimësi nga qytetarët, duke pasur përvojën nga e kaluara për rrezikun në atë pjesë të segmentit, jemi shumë të vetëdijshëm dhe në komunikim të vazhdueshëm me mbikëqyrjen dhe me kompaninë sapo të rregullohen të kemi kushte më të mira atmosferike, do të vazhdojnë punimet në sigurimin e trupit të rrugës. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Salihaj, a dëshironi të bëni pyetje shtesë?

MILAZIM SALIHAI: Jo, e qartë është, faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Meqë kemi në propozim dy mocione, i presim edhe pak kryetarët e grupeve parlamentare derisa ta bëjnë marrëveshjen.

Morën pak kohë konsultimet, meqenëse tri mocione po propozohen tash nga grupet parlamentare. I thërrasim të gjithë deputetët që të vijnë në sallë. Seanca plenare po vazhdon dhe në rend të ditës do t'i kemi tri mocione shumë të rëndësishme që t'i votojmë.

Mocionin e parë e propozon Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje, kryetarja e grupit, Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Mocioni ynë procedural ka të bëjë me përfshirjen në agjendën e ditës së sotme, projektligje të cilat janë të gatshme, kanë kaluar procedurat dhe raportet për të cilat kanë ardhur në seancë, janë projektligjet në lexim të dytë.

Tri projektligje janë nga Komisioni për Ekonomi, tetë projektligje janë nga Komisioni për Shëndetësi, dhe një projektligj është nga Komisioni për Mjedis.

Nëse më lejoni, kryetar, në mocion procedural propozoj që një nga një të votohet përfshirja e këtyre projektligjeve për shqyrtim të dytë në seancën e ditës së sotme.

KRYETARI: A mund t'i lexoni projektligjet e sakta për të cilat po bëhet fjalë?

MIMOZA KUSARI-LILA: Projektligjet të cilat propozojmë që të përfshihen në lexim të dytë në seancën e ditës së sotme, janë: Projektligji nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve, Projektligji nr. 08/L-059 për patentat, Projektligji nr. 08/L-055 për dizajnin industrial.

Ndërsa, projektligjet nga Komisioni për Shëndetësi; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 068/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

Këto projektligje, për informatën tuaj dhe gjithë opinionit publik, janë projektligje të cilat kanë pasur harmonizimin me Ligjin për kundërvajtje, të cilat janë prezantuar dhe janë diskutuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës muaj më parë.

Përderisa nga Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, kemi shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 04/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

KRYETARI: Deklarohen edhe grupet e tjera tash. Në emër të grupit... A keni nevojë për konsultime shtesë, zoti Tahiri? Urdhëro! Kryetari i grupit, Abelard Tahiri e ka fjalën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Partia Demokratike e Kosovës nuk e mbështet këtë mocion procedural, dhe rrjedhimisht kërkojmë që të shkojmë në procedurë të rregullt, që Kryesia e Kuvendit t'i përcaktojë për seancën e radhës.

Kam kërkesë edhe nga deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që kanë nevojë edhe për disa sqarime edhe konsultime shtesë. Pastaj, pasi do t'i kemi, atëherë do t'i vendosim në Kryesi dhe do t'i vendosim në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoq që rendin e ditës e keni marrë dhe e keni lexuar. Rendi i ditës i miratuar në Kryesinë e Kuvendit, i ka hiç më pak se 38 pika të rendit të ditës, 38 pika të rendit të ditës.

Kryetarja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje sot propozon që t'i shtohen edhe 12 pika të tjera rendit të ditës së sotme, me urgjencë dhe pa asnjë lloj arsye në botë.

Veç po t'i përmend disa prej çështjeve që i kemi sot. E kemi ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, katër marrëveshje ndërkombëtare. E kemi votime për institucione të pavarura kushtetuese apo ligjore, votime me kuti që na i marrin nja 6-7 orë për të votuar me kuti.

Dhe, i kemi hiç më pak se sa 23 ligje që kanë të bëjnë me bujqësinë, dhe nja tri-katër ligje të tjera dhe po propozoni që t'ia shtoni edhe 12 ligje të tjera sot Kuvendit. Pse? Pse? Pse, sot? 50 pika të rendit të ditës të bëhen sot. Pse? Nuk po e kuptoj, pse?! Statistikë. Të plotësohet statistika vjetore, ja shiko, i bëmë ne 50 për një ditë? Çfarë është kjo?

Kurrë s'ka ndodhur në këtë Kuvend të kalohen 50 ligje, 60 ligje brenda dite. Ka ndodhur kur është shpallur pavarësia që të kalojnë 86 ligje për tri ditë, ka qenë gjendje e jashtëzakonshme e kemi kuptuar, por sot?

Në vend se të flasim për energjinë, ku njerëzit mërdhinë pa energjinë elektrike si rezultat të paaftësisë së Qeverisë që ta menaxhojë këtë situatë, ju propozimi që t'i fusni edhe 12 ligje të tjera që s'kanë lidhje me këtë punë, që s'kanë kurrfarë urgjence, që ajo fushë është e rregulluar me ligjet, me Kodin Penal, me Ligjin për kundërvajtje, janë ato fusha të rregulluara. Kurrfarë urgjence nuk kanë. Dhe, i fusim kot, sepse sot nuk ka shanse të kalohen 50 pika të rendit të ditës. Nuk ka shanse hiç, sepse kemi votime me kuti. I kemi tri votime me kuti, minimalisht nga tri orë, bëjnë nëntë orë votim me kuti.

Kur do t'i kalosh ligjet? I ke edhe 28 ligje të tjera dhe po do t'ia shtosh edhe 12 ligje. Pra, do ta bësh rendin e ditës me 50 pika, 50 pika, prej të cilave 40 aprovime të ligjeve. Pse? Të dilni dhe t'i thoni popullit, ne i votuam 50 ligje në qeverisjen tonë të dështuar të zotit Kurti. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk e mbështet këtë pikë. Ne diskutuam për gati 30 minuta që të hyjnë katër ligje dhe kjo nuk ndodhi.

E rrugës e mbarë do të ishte që në këtë lexim të dytë, të lexohet Ligji i pagave, i cili nuk u shty për këta dhjetë muaj, mirëpo nuk ndodhi. Ajo që ne kërkojmë është që debatin parlamentar që ne e kemi kërkuar për çështjet dhe për çështjen më të rëndësishme dhe më me urgjencë që është, gjendja energjetike në vend, kjo të trajtohet.

Për këtë u dakorduam që të mos hyjë në këtë seancë, ashtu si e pata kërkesën që të jetë menjëherë pika e parë, mirëpo që të diskutohet në seancën e 28 dhjetorit, pra të martën e ardhshme, si pikë e parë e rendit të ditës.

Për ne kjo është e rëndësishme, debati për energjinë, temat e tjera për të cilat nuk u dakorduam, nuk i mbështetim. Për katër ligje do t'i mbështetnim, mirëpo këto 12 ligje nuk i mbështetim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Edhe nga Grupi Multietnik, fjalën e ka kryetari i grupit, Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

Si grup parlamentar ne e mbështesim propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për mocionin procedural, pasi edhe nëpër komisione është përkrahur dhe besojmë që duhet të futet në rendin e ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Grupet e tjera parlamentare nuk e kanë kërkuar fjalën, kështu që mund ta hedhim në votim këtë mocion të propozuar nga Grupi i Vetëvendosjes.

Mirëpo, nga Sekretaria më thonë që këto duhet të votohen një nga një, nuk mund të hyjnë në pako të gjitha ligjet, por për secilin ligj që kanë kërkuar që të hyjë në rend të ditës, duhet të kemi votim të veçantë.

Mocion, mocion, zonja Bajrami, jo ligje. Mocion thashë. Të mos kesh gajle për atë punë. Mocionin e votojmë, por duhet që për secilin ligj veç e veç të votojmë që të futet në rend të ditës. Nuk mund të hyjmë në... Mirë! 105 deputetë janë pranishëm.

I dëgjuat ligjet të cilat janë propozuar në mocion. Votojmë për secilin ligj veç e veç që të hyjë në rend të ditës. Së pari që të futet në rend të ditës, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që me 72 vota për, 33 kundër dhe asnjë abstenim, futet në rend të ditës ky projektligj. Pra, të futet si pikë e 9-të, pas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe vazhdojmë kështu me radhë.

Projektligji i dytë i cili i propozuar në mocion, është shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-053 për topografite e gjysmëpërçuesve.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 30 kundër dhe asnjë abstenim, përfshihet ky projektligj në rendin e sotëm të ditës.

Pika tjetër: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-055 për dizajnin industrial.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 28 kundër dhe asnjë abstenim, përfshihet në rend të ditës edhe ky projektligj.

Projektligji tjetër: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-059 për patentat.

Kush është për përfshirjen e këtij projektligji në rendin e sotëm të ditës? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë me 72 vota për, asnjë abstenim dhe 30 vota kundër, është përfshirë në rendin e ditës edhe ky projektligj.

Tash do të votojmë për përfshirjen në rend të ditës të Shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-076 për shëndetin riprodhues.

Kush është për këtë projektligj që të përfshihet në rend të ditës? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 30 kundër dhe asnjë abstenim, ky projektligj përfshihet në rendin e ditës.

Tash po votojmë për Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave. Natyrisht, po votojmë që të përfshihet apo jo në rend të ditës ky shqyrtim i dytë.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 28 kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj që Kuvendi mori vendim që ky projektligj të përfshihet në rendin e sotëm të ditës.

Propozimi tjetër është që të përfshihet në rend të ditës në seancën e sotme Projektligji nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 29 vota kundër dhe asnjë abstenim, përfshihet në rend të ditës edhe ky projektligj.

Tash do të votojmë për Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

Kush është që ky projektligj të përfshihet në rendin e sotëm të ditës? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 27 kundër dhe asnjë abstenim, ky projektligj përfshihet në rendin e sotëm të ditës.

Tash e hedhim në votim përfshirjen në rend të ditës të Shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri. Kemi votuar për këtë projektligj.

Tash e kemi, më falni, Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 29 kundër dhe asnjë abstenim, ky projektligj përfshihet në rendin e ditës.

Megjithatë, nuk e kemi votuar Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit, kështu që e hedhim në votim edhe këtë për përfshirjen në rend të ditës. Pra, po flasim për përfshirjen në rend të ditës të Shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 28 kundër dhe asnjë abstenim, edhe ky projektligj përfshihet në rend të ditës.

Tash e kemi votimin për përfshirjen në rend të ditës të Shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që me 72 vota për, 29 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e përfshin në rend të ditës së seancës së sotme këtë projektligj.

Dhe, projektligji i fundit i propozuar është përfshirja në rend të ditës e Shqyrtimit të dytë të Projektligjit nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 72 vota për, 27 vota kundër dhe asnjë abstenim, edhe ky projektligj përfshihet në rendin e ditës së seancës së sotme plenare.

Tash, për të vazhduar me mocionet e tjera po ju kërkoj në 12:30, për një arsye shumë të thjeshtë që prej përgjegjësve teknikë të seancës dhe të Kuvendit më njoftojnë që duhet disa rregullime t'i bëjnë. Nuk janë duke punuar aktualisht as kartelat tuaja, as mikrofonat, as mikrofoni i foltores. Ka prishje! Nuk është për shkak të rrymës. Qëndroni në vendet tuaja, ju lutem! Kështu na thanë që ka nevojë për një ristartim të sistemit, nëse nuk ka nevojë, vazhdojmë. Numrat i kemi, unë jam për të vazhduar me siguri, kjo është vetëm nëse e kemi të detyrueshme patjetër.

Po, edhe mikrofoni im po bën, po më thanë që i foltores dhe i deputetëve nuk është duke bërë. Problemi teknik që e paskemi është që nuk varet tash prej meje a dua t'ju jap fjalën a jo, po secili mund ta merrni fjalën. Mirë, pra, me një mirëkuptim mund t'i vazhdojmë edhe mocionet. Atëherë, në bazë të asaj që unë ju them se cili e ka fjalën, mund ta merrni fjalën, por nuk është duke jua dhënë regjia fjalën, pra ky qenka defekti teknik.

Mocioni i dytë ka qenë i prezantuar prej Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri e ka fjalën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Siç jeni në dijeni, tashmë në rend të ditës e kemi edhe një pikë tepër të rëndësishme, zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe gjatë këtyre ditëve është deklaruar që njëri nga këta dy kandidatë ka konflikt interesi, pikërisht për faktin që është në rangun e zyrtarëve të lartë shtetërorë për pozitën që është duke e mbajtur aktualisht dhe, në anën tjetër, po ashtu mban pozitë drejtuese të një kompanie, të cilën ia ndalon ligji.

Pra, në këtë rast personi në fjalë do të duhej që kompetencat e tij në kompaninë tjetër private t'i transferojë te një person tjetër, duke qenë pronar, mirëpo jo drejtues i kësaj kompanie. Dhe, me këtë rast do të ishte e pakuptimtë që të ndodhë zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, e cila është përgjegjëse po ashtu për interpretimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit dhe pasi që ta zgjedhin, të kërkojmë nga agjencia në rast se drejtori i kësaj agjencie është në konflikt interesi apo jo.

Prandaj, unë ju kërkoj me mirëkuptim që ta largojmë nga rendi i ditës me mocion procedural këtë pikë dhe të kërkojmë nga Agjencia Kundër Korrupsionit pikërisht interpretim dhe pastaj, në

rast se do të jetë në rregull, ne s'kemi asgjë kundër, komisioni e ka bërë punën e vet, të sillet në Kuvend, të votohet, edhe ashtu e dini që një kohë të gjatë ky proces është shtyrë, është anuluar për shkak të kuotës gjinore e shumë çështje të tjera dhe do të ishte shumë e udhës që të mos biem në lajthitje siç kemi rënë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, që më vonë e ktheu Gjykata Kushtetuese. Andaj, ju kërkoj që të kërkojmë një interpretim nga Agjencia Kundër Korrupsion për konflikt të interesit në raport me njërin nga këta dy kandidatë. Dhe, nëse nuk ka, jemi shumë në rregull që të vazhdojmë me votimin.

Mirëpo, kjo paqartësi duhet qartësuar! Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat propozimin nga ana e PDK-së, që e bëri kryetari i këtij grupi për heqjen nga rendi të ditës të kësaj pike për votimin lidhur me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion. Tash, fjalën e ka Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes. Në emër të grupit, deputeti Adnan Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Si Grup Parlamentar nuk e mbështesim mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së. Konsiderojmë që duhet të vazhdojë seanca me procedimin e kësaj pike, ashtu siç ishte përfshirë në rend të ditës dhe siç ka vendosur Kryesia e Kuvendit.

Mendojmë që duhet ta dëgjojmë raportin dhe rekomandimin e Komisionit intervistues për këtë pozicion. Nuk duhet të paragjykojmë procesin e votimit nga ana e deputetëve për kandidatët, të cilët i ka rekomanduar komisioni, aq më tepër më duhet ta them që ky proces edhe si kryetar i Komisionit intervistues ka qenë një proces jashtëzakonisht transparent, në përfshirjen e ekspertëve të projektit britanik e që raportin e kanë mbështetur dhe nënshkruar secili anëtar i komisionit, pozitë-opozitë.

Në anën tjetër, duhet ta themi që Komisioni intervistues nuk e ka as autorizim dhe as përgjegjësi të verifikojë kriteret dhe kërkesat e tjera ligjore prej atyre që përcakton Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsion, kur bëhet fjalë për kandidatët ose për drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Ne kemi verifikuar dhe kemi përmbushur ato kritere që përcaktohen. Nuk është në mandatin ose në autorizimet tona të vlerësojmë ose të konstatojmë konfliktin e interesit. Palët e kanë pasur dhe e kanë mundësinë ose të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje.

Sidoqoftë, unë si deputet para së gjithash, por edhe si grup parlamentar jemi të interesuar që ky proces të jetë jashtëzakonisht në përputhje me ligjin dhe me procedurat, por në të njëjtën kohë, jemi të interesuar që agjencia të bëhet me drejtor sa më parë, sepse ka një kohë që është në vakum institucional, por edhe si deputet u interesova në rastin konkret një nga kandidatët, domethënë në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve ka qarkullimin zero për sa i përket këtij

biznesi, sikurse që e ka të deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, si agjencia që e ka tagrin dhe përgjegjësinë për ta luftuar konfliktin e interesit dhe nuk ka pasur ndonjë veprim le të themi në këtë drejtim.

Ne mendojmë që duhet të procedohet si pikë e rendit të ditës, pastaj deputetët me votën e tyre i japin kah ose epillog këtij procesi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, në emër të LDK-së, kryetari i grupit, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Me sa e kuptova, propozimi për shtyrje është derisa të eliminohet ose të sqarohet pretendimi për konflikt interesi. Vetë agjencia njëhën prej detyrave kryesore e ka parandalimin e konfliktit të interesit. Nuk po kuptoj çka ka të papërkrahshme këtu?

Nëse ekziston një pretendim ose një dilemë se ndonjëri nga kandidatët mund të jetë në konflikt interesi për shkak të pasjes së një biznesi ose diçka tjetër që u prezantua këtu, le t'i jepet kohë derisa të dalë nga konflikti i interesit, le të heqë dorë sipas ligjit nga drejtimi i kompanisë apo çka parashihet në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe në seancën e radhës mund të votohet.

Pra, mendoj se propozimi është i arsyeshëm dhe është i qëndrueshëm si i tillë. Për të kundërtën, dëshira për ta votuar me çdo kusht sot po më duket e paarsyeshme. Ka një pretendim prej një subjekti politik që njëri prej kandidatëve mund të jetë në konflikt interesi. Krejt ideja e agjencisë ku personi pritet të shkojë drejtor është parandalimi i konfliktit të interesit, t'i japim mundësi një javë njeriut që të shkojë i pastër, kushdo që të shkojë atje, pa probleme, pa pretendime, të mundësisë apo të rreziqeve të shkeljes së ligjit dhe kontestimit të vazhdueshëm të pozicionit të tij. Sepse, në një letër heq dorë prej konfliktit të interesit edhe zgjidhet kjo punë, vjen, votohet, po mendoj që është kërkesë e arsyeshme dhe ne si grup parlamentar e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Grupet e tjera nuk janë paraqitur për fjalë, kështu që mund ta hedhim në votim mocionin e propozuar nga PDK-ja.

Përgatituni për votim për mocionin e propozuar nga kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri. Vetëm duhet ta dimë saktë numrin e deputetëve, meqenëse duhet t'i kalkulojmë 2/3 e votave.

95 deputetë jemi, po hyjmë në proces të votimit për këtë pikë të propozuar nga Abelard Tahiri në formë të mocionit për ndryshimin e rendit të ditës.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 22 vota për, 58 vota kundër dhe asnjë abstenim, nuk kalon ky mocion i propozuar nga Grupi i PDK-së.

Kalojmë në mocionin tjetër, i propozuar prej Grupit të AAK-së. Kryetari i Grupit, Besnik Tahiri, e ka fjalën!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne si Grup Parlamentar e kemi thirrur debatin për krizën energjetike, menduam që ta vendosim këtë menjëherë pas marrëveshjeve ndërkombëtare, mirëpo pasi që u dakorduam paraprakisht që kjo të jetë pika e parë në vazhdimin e seancës të martën, të datës 28, vendosim që ta mbajmë debatin më 28 dhjetor. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë! Atëherë e kuptuat pra që mocioni i AAK-së ka të bëjë me propozimin që debati, të cilin ata e kanë propozuar, debati parlamentar të ndodhë ditën e martë dhe të jetë pikë e parë e rendit të ditës në vazhdimin e seancës.

Kush është për këtë mocion?

KRYETARI: Ju lutem, edhe një herë, meqenëse po e shoh që disa deputetë nuk e kanë të qartë. Po votojmë dhe ky është mocion pra, mocioni i propozuar nga AAK-ja, debatin që ata e kanë pasur si pikë të fundit të rendit të ditës për këtë seancë të sotme, të ndryshohet, meqenëse nuk e dimë se çfarë kohe do të jetë kur të mbahet ai debat si pikë e fundit e këtij rendi shumë të gjatë të ditës së seancës plenare. Për ta precizuar se, kur do të mbahet ky debat dhe meqenëse, gjithsesi e dimë që këtë seancë nuk mund ta përfundojmë sot, që të martën të vazhdojë ajo, e që pikë e parë e vazhdimin të së martës të jetë pika e debatit parlamentar të propozuar nga AAK-ja.

Kush është për këtë mocion? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që mocioni i propozuar nga Besnik Tahiri, me 79 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, është miratuar.

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së jashtëzakonshme

Të nderuar deputetë,

Nëse nuk keni vërejtje në procesverbalin e seancës, të cilën e kemi mbajtur më 17 dhjetor, konstatoj se është miratuar procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, që e mbajtëm më 17 dhjetor.

Tash po hyjmë në pikën e 4-t të rendit të ditës, që është:

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji, bashkë me amendamentin e propozuar.

E ftoj ministren e Arsimit, zonjën Arbërie Nagavci, që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

Po e shihni që jemi të detyruar që ta bëjmë një intervenim teknik, i cili na u propozua më herët. Pra, deputetët janë të lirë që mikrofonin ta ndezin sa herë që të duan por mikrofoni i foltores nuk po bën. Kështu që, propozoj dhjetë minuta pushim dhe të kthehemi në sallë pas këtij rregullimi.

* * *

KRYETARI: Ju paralajmërova që dhjetë minuta i merr kjo. E ftojme ministren Nagavci që ta paraqesë këtë marrëveshje.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore, po sjellim sot para jush Projektligjin për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik.

Republika e Kosovës është duke përfituruar nga programi Fulbright që nga viti 2012, fillimisht me marrëveshjen e arritur ndërmjet Ambasadës Amerikane dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, pasuar pastaj me memorandumin e mirëkuptimit në mes Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ambasadës Amerikane për periudhën 2016 - 2020.

Marrë për bazë rëndësinë e marrëveshjes, bashkëpunimin e shkëlqyer me Ambasadën Amerikane në implementimin e marrëveshjes ekzistuese si dhe mbështetur në nevojën e ngritjes së kapaciteteve hulumtuese dhe ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, MASHTI ka shprehur interesimin për realizimin e memorandumit të ri të mirëkuptimit, duke ndarë edhe mjete shtesë buxhetore, si dhe duke kërkuar avancimin e programit në Kosovë. Memorandumi i ri e përfshin periudhën 2021-2025, pra është në afat pesëvjeçar.

Programi Fulbright i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është një program i shkëmbimit akademik me reputacion të lartë dhe përmes këtij programi, studentëve, hulumtuesve të rinj dhe stafit akademik të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë u ofrohet mundësi e shkëmbimit në universitetet amerikane. Po ashtu hulumtues dhe profesionistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës vijnë në Kosovë dhe u ndihmojnë institucioneve të Kosovës, përfshirë institucionet akademike e kulturore dhe ato qeveritare, për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Deri më tani ky lloj bashkëpunimi është treguar shumë e dobishëm për institucionet dhe individët nga Kosova dhe realizimi i memorandumit të ri të mirëkuptimit mes palëve, bën të mundur që bashkëpunimi akademik të zgjerohet, duke shtuar ndjeshëm edhe numrin e përfituesve dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në vend.

Skemat në kuadër të programit Fulbright janë programi Fulbright për studentë të huaj në Shtetet e Bashkuara që ofrohet si mundësi qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke u ofruar bursa për studentët në nivel master, pastaj programi Fulbright për studiuese, profesorë të institucioneve të arsimit të lartë në studimet e postdoktoraturës dhe programi Fulbright për specialistët që përshin ekspertë nga një fushë e caktuar të cilët sipas nevojës vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe sjellin eksperiencën e tyre në institucionet e Republikës së Kosovës.

Skema e katërt në kuadër të këtij programi është për zhvillimin e stafit akademik, kryesisht stafit të ri akademik të cilët mund të përfitojnë përvojën dyvjeçare, me mbështetje për të zhvilluar kurrikula.

Skema e pestë ka të bëjë me programin Fulbright për studiuesit amerikanë, studiuesit hulumtuese nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët vijnë nga atje dhe sjellin përvojën e tyre dhe eksperiencën për tre deri në gjashtë muaj.

Në marrëveshjen ekzistuese, MASHTI ka duplikuar fondet për mbështetjen e programit, ku për një vit MASHTI do të financojë programin në vlerë prej 600 mijë euro. Kjo nënkupton edhe një mundësi apo një shtim të numrit të përfituesve në skemat për të cilat do të dakordohemi si ministri dhe që i konsiderojmë si të rëndësishme.

Duke pasur parasysh që kanë kaluar të gjitha procedurat formale dhe rëndësinë e marrëveshjes për të cilën veçse i parashtrova përfitimet që i kemi, ju ftoj të gjithëve për votimin dhe mbështetjen e kësaj marrëveshjeje. Ju faleminderit!

KRYETARI: E ftoj tash kryetarin e Komisionit për Arsim, deputetin Ardian Gola, që ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

Ia kaloni fjalën deputeti Gola, ju lutem!

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Arsimit, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të nenit 61 dhe 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor të këtij viti në cilësi të Komisionit Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright dhe ka vendosur që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright me amendamentin e propozuar si vijon:

Amendamenti 1. Pas nenit 3 të projektligjit, të shtohet edhe neni i ri me sa vijon: dokumentet e bashkëngjitura. Pjesë përbërëse e këtij ligji është edhe memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së SHBA-ve dhe MASHTI-t për programin e shkëmbimit akademik Fulbright.

Komisioni ka vlerësuar se Projektligji për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit në ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright, ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit të institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dy vendet, inkurajimin dhe përmirësimin e kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, edukatorëve dhe studentëve si dhe promovimin e projekteve të përbashkëta kërkimore.

Andaj, marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, Komisioni Funkcional i rekomandon Kuvendit miratimin e tij.

KRYETARI: Tash është radha e grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së, deputeti, kryetari i këtij grupi, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit i nderuar, kryetar!

Ne si grup parlamentar i kemi shqyrtuar këto marrëveshje. Në princip nuk jemi kundër marrëveshjeve, por meqenëse shumica qeverisëse nuk tregon vullnet bashkëpunimi dhe

mirëkuptimi me opozitën, mënyra sesi u sollët sot dhe si e imponuat agjendën e Kuvendit jashtë asaj si jemi marrë vesh në Kryesi, ne si grup parlamentar deklarohemi se për asnjërin nga marrëveshjet ndërkombëtare sot nuk do të votojmë. Dhe nëse vazhdohet me këtë sjellje dhe këtë ndikim me opozitën dhe sidomos me Lidhjen Demokratike të Kosovës, ne do të vazhdojmë të mos marrim pjesë në votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, deri në pikën ku, nëse vazhdoni kështu, do t'i votojmë kundër.

Pra, meqenëse ju keni shumicë qeverisëse, meqenëse me partnerin që sot u votua, e ndryshuat rendin e ditës, i bëni dy të tretat, është në diskrecionin e juaj që t'i votoni dhe t'i kaloni marrëveshjet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu nuk kemi çka spekulojmë. Këto marrëveshje nuk mund të votohen pa opozitën. Opozita është vendimtare për votimin e tyre. Fjalën e ka kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Si grup parlamentar opozitar në vazhdimësi kemi kërkuar që të kemi një konsensus parlamentar, pavarësisht që jemi opozitë, me mazhorancën në këtë rast, dhe sot për ne ky konsensus ishte i rëndësishëm. Ne si grup parlamentar kemi qenë në favor të votimit të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare, mirëpo meqenëse kemi një sjellje të mazhorancës në raport me opozitën, duke mos e marrë parasysh për asnjë moment kërkesat tona si pari opozitare. Atëherë, normalisht që edhe neve s'na mbetet gjë tjetër vetëm që t'ju them bashkë me partnerët e juaj qeveritarë me komunitetet joshumicë, ashtu siç i bëtë dy të tretat t'i fusni edhe disa pika të tjera, besoj që mund t'i bëni.

Mirëpo besoj që kjo qasje është qasje e cila nuk i kontribuon mbarëvajtjes së punës së këtij Kuvendi, rritjes së efikasitetit të këtij Kuvendi. Viti 2021 ka qenë vit ku kemi çaluar shumë në agjendën parlamentare, prandaj si duket qasja nuk po do të ndryshojë prej kësaj qeverie. Ne në vazhdimësi kemi qenë mjaft korrektë, ku shumicën e projektligjeve i kemi votuar, pikërisht për faktin që nuk i kemi parë si betejë politike projektligjet dhe marrëveshjet të cilat e prekin jetën e qytetarëve.

Mirëpo, kur ju nuk i merrni parasysh qëndrimet tona, kërkesat tona që janë plotësisht legjitime, që nuk bien ndesh as me Rregulloren e Kuvendit, që nuk bien ndesh as me ligjet në fuqi, atëherë ju keni vendosur që të mos e përfillni fare opozitën, ta keni një drejtim të këfillë. Në rregull është. Neve nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të pajtohemi. Por, në anën tjetër, ta shfrytëzojmë edhe të drejtën tonë që të përmbahemi prej votimit të këtyre marrëveshjeve. Pra, sot ne do të përmbahemi. Nuk do të marrim pjesë në votim fare, si rezultat e shenjë e një pakënaqësie në raport me devijimin që po i bëhet agjendës parlamentare pa konsensus me opozitën. Faleminderit!

KRYETARI: Tash në emër të Grupit të AAK-së, kryetari i këtij grupi, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Kjo punë është goxha e thjeshtë. Ne jemi deklaruar si grup parlamentar që në çfarëdo rrethane i mbështetim marrëveshjet ndërkombëtare. Megjithatë, po ndodhin disa probleme që kur po dakordohemi aty, kur po vijmë te ti të diskutojmë, e po dakordohemi për disa çështje, atëherë kur po vijmë në votim, çështjet po ndryshojnë.

Ne u morëm vesh, ne folëm, diskutuam katër ligje t'i vendosim t'i votojmë në këtë seancë plenare, duke i pasur 38 pika në rend të ditës, t'i vendosim edhe katra. Shumica i pat numrat dhe deputetët për t'i vendosur 12. I bëni pa pajtimin tonë. Tani, ne e diskutuam si kryetarë të grupeve parlamentare bashkë me LDK-në dhe PDK-në dhe vendosëm që në shenjë proteste, në shenjë mospajtimi me këtë qasje, të mos i votojmë sot këto marrëveshje.

KRYETARI: Kryetarja e Grupit të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Në raport me qëndrimet e opozitës, dua t'i vë në pah disa pasaktësi dhe në vetë kundërshti në atë çka u tha nga shefat e grupeve parlamentare.

Si e para, u deklarua se ne nuk po e përfillim opozitën. Arsyeja që ne jemi sot në seancë të rregullt, në natën e Krishtlindjeve, është për arsye se në Kryesi të Kuvendit, është përfillur kërkesa. Është respektuar rregullorja, por nuk është marrë parasysh kërkesa e opozitës në këtë rast, që me një dakordim politik të martën të caktojmë seancën për të enjten, në mënyrë që të enjten ta kemi ditë të plotë, se e kishim të caktuar Ligjin për inspektime, të vazhdojmë me një seancë tjetër, që ishte kjo, dhe të premtën mund ta kishim eventualisht një gjysmë dite për të përfunduar pikat e mbetura nga dita paraprake. Ndodhi ajo që u respektua mendimi dhe natyrisht Rregullorja e Kuvendit siç po e thoni. Rregullorja e Kuvendit nuk kërkonte, ne nuk bënin ndonjë devijim në dëm të demokracisë ose të punës së këtij Kuvendi, por kërkonim që në vlera universale dhe civilizuese natën e Krishtlindjeve, Kuvendi të mos e kishte një ditë të plotë të punës ditën e premtë. Por u vendos me një konsensus, por gjithashtu fare nuk u vendos në votim nga kryetari i Kuvendit. Sikur të vendosej atë ditë në votim, pozita ishte në numër të plotë, me mundësi të caktimit të seancës. Në rregull!

E dyta, thuhet që ne, e tha një shef i grupit parlamentar se ne kemi pasur ngecje në agjendën legjislative. Ekzakt kërkesa jonë që sot për 12 projektligje që kanë kaluar të gjitha procedurat, amendamentet, komisionet e përhershme, komisionet funksionale, kanë ardhur raportet në seancë, të trajtohen sot, në mënyrë që të kemi bashkërisht si Kuvend një performancë të mirëfilltë për vitin 2021. Por jo, reagimi në veçanti i shefave të grupeve parlamentare, në veçanti i LDK-së ishte, po mendoni që ne do t'ua ndreqim statistikën. Ne si Kuvend po besoj që

vlerësohemi bashkërisht. Është e vërtetë që ka pozitë dhe opozitë. Qeveria i ka proceduar 105 projektligje në Kuvend. Të gjitha ne i kemi obligim t'i procedojmë dhe është mirë të kemi konsensus, se në fund të ditës ato ligje miratohen për qytetarët e Republikës dhe për shumë qeveri të tjera. Nuk është vetëm një qeveri e cila i zbaton ligjet, po duhet që të gjithë dhe natyrisht që do të pasojnë edhe të tjera.

Tjetra, u diskutua për mungesë të mbajtjes së fjalës. Kush e thotë? Besnik Tahiri. Konsistent në tradhti të vazhdueshme të marrëveshjeve. Tri janë, një pas një. E para, diskutimi i buxhetit në lexim të parë. Votën për të gjitha amendamentet përfaqësuesi i AAK-së, në fund nuk e voton projektbuxhetin. E dyta, e diskutojmë, i keni kryer të gjitha procedurat e trajtimit të buxhetit, në të gjitha leximet, në të gjitha komisionet. A e trajtojmë buxhetin në një seancë të ndarë me 17 dhjetor, për arsye se 22 dhjetori mund të jetë një ditë tjetër me punë të komisioneve, thotë po, në Kuvend votojnë jo. E njëjta është për Ligjin për inspektime. Ne disa herë publikisht këtu në Kuvend, jo afër jush Kryetar, po këtu në Kuvend, ka deklaruar se Ligji për inspektime si pjesë e procesit të reformës shtetërore duhet të mbështetet, në Komisionin Funkcional përfaqësuesi i Aleancës del e lëshon diskutimin në komision, rrjedhimisht për një periudhë të shkurtër kohore mbetemi, duke qenë të paqartë mbi qëndrimin e Aleancës për këtë projektligj. Në seancë këtu dje kur u mbajt, nuk ishin për ta votuar. Ne jemi këtu absolutisht për të respektuar të gjithë. Për të bashkëpunuar.

Si grup parlamentar i pozitës jemi të gatshëm t'u qëndrojmë të gjitha kërkesave racionale të cilat kanë të bëjnë në përmirësimin e demokracisë, në përmirësimin e punës së Kuvendit e natyrisht për ne bashkë që të krijojmë një koherencë e cila Kuvendin si institucion e qet më mirë para qytetarëve të Republikës se atë obligim e kemi. Ne jemi pozitë dhe opozitë, por në fund të ditës, sovranit dhe shefat tanë janë qytetarët e Republikës që na e kanë dhënë votën për t'i përfaqësuar këtu. E këtu kur po vini për t'i ndryshuar në moment të fundit, ose në Kryesi të Kuvendit, vetëm pse është propozim i pozitës, atëherë po është mosrespektim i opozitës, jo. Është prezantim i një qëndrimi të partisë në pushtet, e cila mundohet të ndërtojë dialog, mundohet t'i akomodojë natyrisht sipas mundësive dhe racionales kërkesat, por jo kur ju tuajat i ndryshoni vazhdimisht dhe mundoheni neve të na matni me milimetra, e ju tuajat problemet dhe pengesat t'i zgjatni me metra.

Prandaj, kjo që u tha këtu nga kolegët e mi, shefat e grupeve parlamentare nuk qëndron. Qëndrimi i tyre natyrisht është politik, mos t'i votojnë marrëveshjet ndërkombëtare, por unë konsideroj që mbi të gjitha para se t'i dëmtojë këta ose neve, po i dëmton qytetarët e Republikës si përfitues të drejtpërdrejtë nga zbatimi i këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Tash kanë të drejtën e replikës për këto çka i tha kryetarja e Grupit të VV-së. Së pari ia japim të drejtën e kritikës Abelard Tahirit, kryetarit të Grupit të PDK-së.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

E nderuar shefe e grupit parlamentar të mazhorancës!

Nëse vërtet doni ta nxirrni mirë këtë Kuvend, është e rëndësishme që të kemi një konsensus i cili garanton një mbarëvajtje në të mirë të punë së Kuvendit, seancave parlamentare. Pra, ky konsensus, ju nuk jeni të gatshëm për asnjë moment të na e tregoni një raport me opozitën. Prandaj, atë që e përmende në mbledhjen e Kryesisë, ne s'kemi bërë asgjë më shumë as më pak sesa që kemi respektuar Rregulloren. Rregullorja e përcakton qartë që nuk mund të thirret seancë, përveçse nëse është seancë e parakohshme, para 72 orësh. Ne kemi kërkuar të respektohet Rregullorja. Me siguri ka pasur një arsye kur është përcaktuar kjo. Pse? Ju duhet deputetëve kohë. Kur të përcaktohet rendi i ditës, u duhet deputetëve kohë të marrin qëndrime, të ndërtojnë qëndrime në raport me rendin e ditës, aq më shumë kur i ke dyzet pika. E qysh, për një ditë të arrihet të ndërtohet qëndrime për të gjitha këto çështje të rëndësishme? Pra është e pamundur. Ne kemi kërkuar asgjë më shumë dhe nuk mund të dalë në votim diçka e cila bie në kundërshtim me Rregulloren. Pra, përcaktimi i këtij afati kohor prej kur duhet të thirret seanca është i përcaktuar pikërisht si rezultat i nevojës së deputetëve që të kenë kohë t'i trajtojnë këto çështje.

Edhe një herë po e them, unë ju kërkoj që v. 2022 të mos jetë vit i njëjtë i kësaj logjike mbi çfarë e keni udhëhequr mazhorancën në këtë Parlament. Mendoj që konsensusi me opozitën është i rëndësishëm. Kërkesa e Partisë Demokratike ishte thjesht të verifikohet ligjshmëria për një çështje. A kemi të bëjmë me shkeljen e ligjit dhe a kemi të bëjmë me konsumim të veprës penale apo jo? Nëse s'kemi, jemi në rregull. Prandaj, çka ka këtu të mos ketë konsensus? Faleminderit!

KRYETARI: Të njëjtën po e thotë edhe mazhoranca, çka këtu që ju s'pajtoheni me këto?

Një replikë e ka edhe Arben Gashi, kryetar i Grupit të LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit i nderuar kryetar!

Mua po më duket tepër absurde që kryetarja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes ta akuzojë opozitën dhe në këtë rast LDK-në pse ka kërkuar të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit. D.m.th. kjo është përtej absurdit.

Kjo gjuhë, kjo mënyrë e komunikimit me opozitën është e padinjitetshme. Ne kemi përkrahur të gjitha pikat e rendit të ditës që ju si Kryetar i Kuvendit i keni propozuar. Asnjë s'e kemi kundërshtuar. Bile nënkryetarja i ka propozuar dy pika që formalisht më duket hale s'i kanë plotësuar kushtet, për shkak se marrëveshjet ndërkombëtare duhet të jenë në rregull. Por për shkak të sjelljes dhe të komunikimit të kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deklaroj: nëse sot i qitni marrëveshjet ndërkombëtare në votim, ne do të votojmë kundër. Ky është kontributi juaj sot për qytetarët e Kosovës. ne do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Besnik Tahiri e ka një replikë po ashtu.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje le që pa kurrfarë niveli profesional e kolegial del e rren këtu në foltore, por mundohet t'i përmbushë një agjendë të saj, që në fakt nuk di ta bëjë. Nuk di të ndërtojë konsensus Mimoza Kusari. Kemi ardhur te ti Glauk Konjufca, jemi marrë vesh, kemi folur për katër ligje, po nuk u vendosën katër ligje, u vendosën 12 ligje. Si t'i votoj unë ty? Në çfarë forme?

Tjetra temë, po flet për qëndrime të tjera. Është e vërtetë që në Kryesi, edhe grupet e tjera parlamentare kanë folur për t'u mbajtur seanca të enjten, por në fund nënkryetari Shala ka thënë është qysh të vendosin grupet parlamentare. Këtë ta kam thënë ty personalisht. Tash lyp të kemi konsensus prej neve, të lypet mbështetje prej neve, dhe sillesh në formën më të ulët të mundshme si shefe e 61 deputetëve.

Koalicionin në qoshe me Listën serbe e bëre, ndërsa me neve si shefa të grupeve parlamentare na sjell në pikë të mëngjesit agjendën që t'i fusim edhe 12 ligje. A s'ke mund ta çosh një porosi, a s'ke mundur të më shkruash para orës 10, të thuash Besnik dil, se jemi një kat dhe mundohesh të gjuash fajin të thuash mban qëndrime ndryshe. Jo, nuk mbaj. Do ta kesh gjithmonë mbështetjen për ligje ndërkombëtare, për marrëveshjet ndërkombëtare gjithmonë, po jo qysh duash ti.

KRYETARI: Replikën e ka tash Mimoza Kusari, kundër-replikën në fakt.

MIMOZA KUSARI-LILA: Për gjuhën të cilën e përdori z. Tahiri, s'po dua. Jo Abelardi, Besniku. S'po dua ta sjell një standard të ri të keq të komunikimit mes shefave të grupeve parlamentare. Nëse ka pasur të pavërteta në atë që thash, është dashur t'i demantosh e jo të flasësh kot. Për arsye se qe po i tregoj edhe njëherë. Kur shkuam te Kryetari i Kuvendit, nuk u dakorduam për katër projektligje. Ai qe propozim. Askush nuk votoi. As nuk e morëm përsipër ta mbështesim mocionin e Partisë Demokratike, vetëm thamë që po e trajtojmë.

Në të kundërtën e juaj, ne ju mbështetëm në mocionin e juaj. Sa i përket projektligjeve sot që u sollën, unë e kam njoftuar edhe Kryesinë atë ditë. E kam marrë fjalën, kam deklaruar që do të vijmë projektligjet e Komisionit për Ekonomi dhe Shëndetësi. Keni thënë bashkërisht që janë me mocion procedural. Kjo ka qenë e ditur, plus që...

KRYETARI: Tash, veç edhe pak po kalojmë te një diskutim, po ashtu, që e kanë deputetët për këtë çështje. Së pari ia japim fjalën nënkryetares së Kuvendit, Saranda Bogujevci.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryetar!

Jemi një grup i njerëzve këtu që jemi në mbledhje të Kryesisë së bashku dhe e dimë secili mënyrën qysh diskutojmë edhe çka diskutojmë brenda Kryesisë, për çka merremi vesh e për çka nuk merremi vesh.

Pa marrë parasysh që ekzistojmë si pozitë dhe opozitë, në këtë rast, unë mendoj që është komplet e padrejtë, në fakt e gjithë gjuha dhe barra që i gjuhet Mimoza Kusarit. Po. Se e dimë se si i diskutojmë gjërat përbrenda Kryesisë.

Unë mendoj që, po, ka elemente të mosmarrëveshjes në momente të caktuara, ka edhe të marrëveshjes, ama të thuhet që po përdoret një gjuhë apo nuk ka konsideratë për... Të lutem Arben, se unë ty të dëgjova deri më tani, edhe zakonisht e kam princip të dëgjoj.

Po i nderuar, është e vërtetë edhe e di zotëria në fjalë. Mendoj që është e padrejtë të thuhet që nuk është marrë në konsideratë mendimi apo nuk ka pasur konsultime në relacion me opozitën.

Tash, te propozimet që kanë ardhur sot, që janë projektligje në leximin e dytë, që janë shterur debatet, janë diskutuar edhe përbrenda komisioneve, ku edhe vet ju i keni përfaqësuesit tuaj brenda komisioneve, dhe në fund ku është problemi, që përveçse nëse kalojnë këto projektligje që vetëm kanë për t'u votuar, domethënë të gjitha procedurat kanë përfunduar, që në fund të ditës shkojnë në interes të qytetarëve, unë po e shoh ku është problemi që sot vetëm kemi për t'i votuar ato projektligje.

Pse duhet kjo të qitet si kusht, që ju nuk i votoni marrëveshjet ndërkombëtare, që prapë janë në interes të qytetarëve, vetëm pse kanë hyrë disa ligje që vetëm kanë për t'u votuar.

E kuptoj, nëse do të ishte momenti ku neve do të na duhej të diskutonim, të debatonim rreth ligjeve, është leximi i parë, ka shumë çështje që duhet të trajtohen, sinqerisht do ta kuptoja reagim tuaj. Por, në momentin që të gjitha këto kanë kaluar dhe keni qenë pjesë e secilit proces, dhe në fund vetëm kërkohet votimi, për mua nuk ka kuptim. Dhe, në të njëjtën kohë pastaj të qitet si kusht në relacion me marrëveshjet ndërkombëtare apo edhe të thuhet që nuk është në konsultim me opozitën.

Prapë po them, të gjithë keni anëtarë që janë pjesë e komisioneve dhe të gjithë do duhej që si shefa të grupeve parlamentare ta dini që këto kanë kaluar nëpër komisionet përkatës. Po, edhe janë votuar. Domethënë, kanë mbetur vetëm që të vijmë në seancë, të votohen dhe të kalojnë. Është procedurë, asgjë tjetër.

Prapë po them, nëse do të kishin qenë në lexim të parë, do ta kuptoja, por këto kanë përfunduar gjithçka, me diskutime, me debate me të gjitha. Vetëm është leximi i dytë dhe kjo është çështje a votohet sot apo nesër. Kaq.

KRYETARI: Një replikë lidhur me këtë që e tha nënkryetarja Bogujevci, e kanë kërkuar kryetarët e grupeve të PDK-së dhe të LDK-së. Ia japim fjalën fillimisht, Abelard Tahirit.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Ne mund të kemi, nënkryetare, pikëpamje të ndryshme sa i përket a është më e rëndësishme që ka kaluar në lexim të parë apo lexim të dytë. Mirëpo, unë mendoj pikërisht tani kur jemi para një votimi final për ligjin, kur ka amendamente shtesë prej deputetëve, kur ka mos pajtimit prej deputetëve, është tepër e rëndësishme që të shkohet në nguti në një votim të tillë.

Nëse e kemi në leximin e parë edhe mund të pajtohemi, sepse kemi kohë për ndryshim, sepse e kemi periudhën që e përcakton ligji, gjatë propozimeve që ne i bëjmë si deputetë, amendamentet tona, dhe pastaj vendosim se çfarë përkrahim dhe çfarë s'përkrahim. Pra, duke e pasur parasysh që këto ligje, këto projektligje që po e marrin formën e ligjit, që nuk ke më mundësi që të ndryshosh, se s'është në lexim të parë, është në lexim të dytë, mendoj që është tepër e rëndësishme që të hyhet në një proces të tillë. Pra, kjo është ajo që deputetëve u nevojitet kohë, u nevojitet kohë edhe është shumë e drejtë që e ka përcaktuar edhe Rregullorja mënyrën e përcaktimit të seancës.

Pra, nëse do të jetë një ligj edhe dy, hajde mund të kemi mirëkuptim, mirëpo, 12 ligje apo 13 projektligje që e marrin formën e ligjit, pra që janë në lexim final, të hyjnë në një procedurë të shpejtë që ta përmirësosh pak statistikën, është shumë e dëmshme. Është shumë e dëmshme. Përndryshe, çfarë kuptimi ka të mbahet mbledhja e Kryesisë, dhe të jenë 72 orë që të përcaktohet rendi i ditës. Çfarë kuptimi ka? S'do të kishte pasur hiç atëherë forum të Kryesisë, do t'i vendosnim kështu, kur të na e merr mendja.

Prandaj, nënkryetare, kjo është tepër e rëndësishme dhe njëkohësisht mendoj që po bëhet dëm edhe si praktikë që po vendoset në raste të shpeshta për votime të tilla. Pra, më mirë ta ndalim krejt, edhe marrëveshjet edhe mosvotimin e këtyre projektligjeve sesa të bëhet një dëm i tillë, më beso! Faleminderit!

KRYETARI: Për fjalimin e Saranda Bogujevcit ka replikë kryetari i Grupit të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Me gjithë respektin për nënkryetaren, po më vjen keq po, besoj se ju si kryetar dhe nënkryetare e keni marrë materialin që e keni futur në rend të ditës sot.

Unë veç po jua demonstroj fizikisht. Shikojeni sa është, dhe i gjithë ky material duhet të trajtohet sot dhe të mos harroni është të dyja faqet i shkruar, jo veç para, po edhe prapa. Janë rreth 600 faqe që ju po thoni, t'i lexojmë, të marrim qëndrim dhe t'i votojmë sot.

12 ligje që sot marrin formën e ligjit, projektligje që sot nëse i votoni, marrin formën e ligjit. Veç shikojeni sa faqe janë. Deputetët ende s'i kanë marrë, ndoshta u kanë shkuar në formë elektronike. Neve sapo na i dorëzuan në formë fizike, vetëm kryetarëve të grupeve. Pasi hynë në rend dite, as shtatë minuta nuk janë, pasi filluam në këtë diskutimin, na i sollën veç shfaqje të grupeve në formë fizike, dhe po thoni se nuk është kurrëgjë kjo punë, veç duhet të votoni. Vërtet mendoni që veç duhet të votohen këto a po? Veç shikojeni fizikisht sa është. Krejt kjo duhet të lexohet, të merret qëndrim për secilën shkronjë, për secilën pikë, për secilën presje, sepse bëhet ligj në fund.

Nuk marrin deputetët vendim në komisione për grupin as për askënd tjetër, ata e japim mendimin e vet. Secili deputet e ka votën e vet këtu, por nuk është kjo çështja kryesore. Mënyra e të menduarit është gabim. Jemi pajtuar me juve në Kryesi me rendin që e keni propozuar.

Plus ta keni parasysh që për krejt këto ligje sot janë mbledhur komisionet, sot. E kur janë mbledhur? Sot janë mbledhur komisionet. Shumicën e deputetëve i kam pasur nëpër komisione sot, duke ia nisur prej Komisionit për Punë të Brendshme dhe krejt komisionet...

KRYETARI: Në rregull këto që po thuhet, po krejt këto e kanë pasur vendin si diskutime që po i bëni të gjithë, në fjalën kur e ka ngritur mocionin Mimoza Kusari për mocionin e parë.

Tash, a e dini në cilën pikë jemi, të nderuar deputetë? Është marrëveshja Fulbright. Në këtë pikë jemi tash. Tash, mund të diskutoni sa të doni, unë fjalën jua jap sa të doni të gjithëve, por kemi hyrë në procesin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe këtu ju qëndrimet më së miri është që t'i jepni me votën tuaj. Ky është propozimi im.

Në rregull! Edhe Albena Reshitaj e ka kërkuar fjalën për këto marrëveshje.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Kabinetin qeveritar,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Projektligji për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptim ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, për programin e shkëmbit akademik fulbright, është i një rëndësisë të veçantë.

Dua ta falënderoj Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që vazhdon ta përkrahë Kosovën për ngritje të cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje apo memorandumit, është nxitja e bashkëpunimit të institucioneve arsimore e shkencore dhe kërkimore shkencore në Republikën e Kosovës, përmirësimi i kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, edukatorëve dhe studentëve, si dhe promovimi i projekteve të përbashkëta kërkimore.

Ashtu siç u tha, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, në mbledhjen e mbajtur më 14. 12. 2021, e ka përkrahur këtë marrëveshje. Gjatë mbledhjes kritikë e imja ka qenë që kjo marrëveshje, faktikisht mbledhja për këtë marrëveshje ka ardhur shumë shpejt, sot për nesër. Shqetësim që e kam ngrehur edhe te kryesuesi i komisionit.

Për mua një marrëveshje e tillë kaq e rëndësishme është dashur të vinte me kohë dhe normalisht në bazë të Rregullores së Kuvendit, deputetët anëtarë të komisionit dhe unë si nënkryetare e parë e këtij komisioni, të informoheshim me kohë për një marrëveshje të tillë, sepse duke pasur edhe kredi profesionale për të dhënë kontribut në këtë përkrahje të kësaj marrëveshjeje, kam dashur që të kem mundësi dhe hapësirë për ta analizuar.

Dhe, ajo çfarë dua ta shtroj tani, sepse po e shoh që po bëhet shumë politikë me marrëveshjet ndërkombëtare e sidomos me këtë për të cilën i jap vetes të drejtë që të flas, edhe nga opozita, po edhe nga pozita.

Pjesa që ne duhet ta bëjmë si institucione shtetërore të vendit, në këtë rast Ministria e Arsimit, është që të ndajmë buxhet të mjaftueshëm për ta përkrahur këtë marrëveshje. Dhe, pjesa tjetër që duhet të falënderohet dhe të duartrokitet është pjesa e përkrahjes që jepet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për një çështje kaq të rëndësishme siç është arsimit.

Ajo çfarë është dashur të bëhet politikë, të nderuar deputetë, është një shqetësim shumë i madh i hulumtuesve tanë shkencorë. Nëse nuk e dini, dua t'ju informoj që ka vite që hulumtuesit tanë shkencore me ndihmën e mjeteve vetjake mundohen të arrijnë të publikojnë punime shkencore në platforma të indeksuara kredibile, për ta ngritur jo vetëm vlerën e tyre personale shkencore, por edhe vlerën e Republikës së Kosovës në nivelin e kërkimeve shkencore.

Dhe, duke u nisur edhe nga përvoja personale, më 2013 në një hulumtim shkencor në të cilin kam punuar tri vite dhe kam arritur ta publikoj në një platformë kredibile shkencore siç është Web of Science, në atë kohë kemi arritur që ta ngrehim nivelin e shkencës në Kosovë për aq sa kemi pasur mundësi.

Mirëpo, ajo çka unë kisha dashur është që këto marrëveshje dhe nga ana jonë të mundohemi t'i shtyjme përpara që hulumtuesve tanë shkencorë t'u jepen mundësi që t'i shfrytëzojnë këto mjete nga këto memorandume mirëkuptimi që të kenë mundësi të ngrehin vlerën e hulumtimeve tona, duke arritur që t'i publikojmë në revista shkencore kredibile.

Tani, është një platformë shumë e rëndësishme siç është Skopusi, e cila e përcakton përkatësinë shtetërore sipas kodit, standardit të Kombeve të Bashkuara. Pa qenë vend anëtar i OKB-së, nuk mund ta gëzosh atë kod siç është ky ISO. Rrjedhimisht, nuk mund të jemi si Republikë e Kosovës në Skopus.

Disa platforma të tjera e vendosin Kosovës me fusnotë dhe sufiksin UNMIK, ende. Por, kriter i vendosur edhe nga disa platforma të tjera, siç është Elsevier, është i papërcaktueshëm përkundër përpjekjeve tona.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, Hulumtuesit tanë shkencorë ende publikojnë në këto platforma, siç është Skopusi, duke u identifikuar me shtetin serb. Pra, çdo vlerë shkencore që sillet në botë përmes Kosovës, ende i shkon në vlerë shtetit serb.

A duhet shteti serb të reagojë për këtë, apo duhet shteti i Kosovës të reagojë për këtë? A duhet Skopusi të reagojë për ne, apo platformat tjera shkencore të reagojnë për ne? Ne duhet të reagojmë dhe në këtë pikë ne duhet të bëjmë politikë, të dashur deputetë, jo në atë se ne jemi ata të parët të cilët po japim mundësi që të bëhet një marrëveshje e tillë, sepse e kuptuam që prej 2012-tës kemi marrëveshje të tillë.

Apo tjetra, që ne si opozitë dashkemi ta pengojmë një marrëveshje të tillë që as ajo nuk ekziston. Mirëpo, për mua ka shumë rëndësi që ne të fokusohemi që Republikës e Kosovës dhe këtyre shkencëtarëve e hulumtuesve që i kemi t'ua japim mundësinë që të prezantojnë vendin tonë edhe në shkencë, sepse është një fushë, një game e madhe e mundësisë që ta prezantojmë vendin tonë ashtu siç duhet.

Pra, siç kemi arritur ta prezantojmë në sport edhe në art, edhe në shkencë kemi mundësi të prezantohemi si duhet ndërkombëtarisht, por të prezantohemi si Republikë e Kosovës. Jo edhe më tutje shteti serb ta shfrytëzojë Kosovën duke e rritur kredibilitetin shkencor të vendit të vet me punime dhe hulumtime të shkencëtarëve kosovarë dhe me atë se si arrin ata t'i bëjnë, gjithmonë në mënyrë vetjake.

Pse të mos shfrytëzohet një marrëveshje e tillë? Duke iu falënderuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të bëhen hulumtime shkencore edhe jashtë edhe vendit, por edhe këtu, të kemi mundësi të shfrytëzojmë laboratorë kredibile për të bërë punime të tilla.

Unë besoj që kemi hulumtues shkencorë të aftë dhe ta prezantojmë Kosovën ashtu siç duhet dhe ta ngremë nivelin tonë shkencor dhe ta rrisim edhe cilësinë e arsimit në Republikën e Kosovës.

Prandaj, ju lus edhe juve grupeve parlamentare edhe kryetarët e grupeve parlamentare, që të gjeni një ujdi që t'i votojmë këto marrëveshje. Gjithashtu, lus Qeverinë që të mos ketë nguti në këto marrëveshje, sepse po lë për të dëshiruar.

Nëse ftohem si nënkryetare e Komisionit për Arsim, sot për nesër për ta votuar, për ta përkrahur një marrëveshje të tillë për të cilën jam ndër të parat që do të doja ta votoja, të mos kemi hamendje për shkak të ngutive të panevojshme, sepse janë marrëveshje shumë të rëndësishme.

Dhe, po e them edhe njëherë, ju lus që të gjithëve t'i përkrahim këto marrëveshje dhe të mundohemi që punën tonë shkencore ta prezantojmë si vend, si shtet, e të mos varem ende nga Republika e Serbisë e të mos i dërgojmë vlerë shkencore shtetit tjetër, me të cilin edhe ashtu kemi probleme të hapura. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Muja e ka kërkuar fjalën për këtë marrëveshje.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, ajo që e unë e kuptova nga diskutimet është që po thuhet që tri-katër marrëveshje ndërkombëtare po shtyhen sepse përmes mocionit u inkuadruan 12 ligje.

Cilat ligje ishin ato? Ishin tri të Komisionit për Ekonomi të cilat kanë shkuar jashtë rendit të ditës. Vetëm ta përfundoj! Kanë shkuar me unanimitet të plotë, të gjithë deputetët pozitivë edhe opozitë i kanë votuar, dizajnin industrial të gjysmëpërçuesve, sepse janë pako të Bashkimit Evropian.

E dyta, të thuhet pastaj që Ligjet për shëndetësinë e ndërkohë që ne jemi në një periudhë emergjente shëndetësore, nuk janë prioritet, unë mendoj që është e paqëndrueshme. Gjithashtu...

KRYETARI: Zoti Muja, prapë marrëveshjet ndërkombëtare, nëse ka mundësi, sepse jemi te ajo pikë.

ARMEND MUJA: Vetëm te marrëveshjet ndërkombëtare. Te marrëveshjet ndërkombëtare, e dyta që po pret dhe është tepër e rëndësishme, është levimi i mundësive ujore që ka për detyrë ose trajton prioritetin e rikthimit të ujit, ndërtimit të digës në Anomarova.

KRYETARI: Do të vijmë edhe aty, por pak më vonë.

ARMEND MUJA: Edhe njëherë por e nënvizoj rëndësinë që këto marrëveshje ndërkombëtare të votohen sot, i nderuar kryetar, sepse ka vite të tëra që pret ky projekt ndërkombëtar.

Krahas rëndësisë së marrëveshjeve me Fulbright, është po ashtu levimi i mundësive ujore. Për këtë arsye me mirëkuptim kërkoj, sidomos ata që vijnë nga Anamorava, është tepër e rëndësishme si marrëveshje ndërkombëtare.

KRYETARI: Deputeti Fitim Uka e ka fjalën për të diskutuar.

FITIM UKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ratifikimi i memorandumit të mirëkuptimit mes Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por edhe pjesëmarrja e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Horizon Europe, janë infuzione tepër të rëndësishme për arsimin e lartë në Kosovë dhe jo vetëm.

Në mënyra të ndryshme këto programe kanë influencuar edhe shëndetin publik edhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përfshirë projektet e rëndësishme në fushën ekonomisë, të drejtësisë, sferën sociale e politike në Kosovë.

Prandaj, ju them me sinqeritet të plotë që janë mundësi e shkëlqyer për Kosovën dhe votimi në këto dy marrëveshje të paktën, shkon përtej çdo interesi politik e partiak.

Teksa të gjithë pajtohemi që programet e kërkimit shkencor të institucioneve tona të arsimit të lartë, me universitetet ndërkombëtare, sikurse janë edhe ato të shkëmbimit të studentëve edhe të stafit akademik nëpërmjet granteve të mobilitetit, u mundësojnë studentëve tanë dhe profesorëve tanë rezultate me të mira të kërkimit shkencor dhe inovacionit, ne duhet të pajtohemi që deri më tani nuk është bërë mjaftueshëm në këtë drejtim.

Prandaj, është e domosdoshme që fondet e këtilla, si programi Fulbright, si fondet e Horizon Europe, duhet të koordinohen më mirë me veprimet institucionale në arsimin e lartë, në mënyrë që përfitimi të jetë i shumëfishtë dhe i plotë.

Hapat konkret të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar këtë program të jashtëzakonshëm mbështetjeje, do të duhej të kulmonin me punë kërkimore dhe shkencore që mbi të gjitha i adreson disa prej sfidave themelore që i kemi në arsimin e lartë në Kosovë.

E para dhe më e rëndësishmja është pa dyshim, cilësia. Dhe, t'ju them të drejtën, unë kam pritur sot që kolegët e mi nga opozita do të flasin pikërisht për këtë çështje dhe për impaktin që e kanë këto dy marrëveshje në këtë drejtim.

Por, më lejoni që t'ju rikujtoj që sipas rangimit të Webometrics, në kategorinë e transparencës, Universiteti i Prishtinës zë vendin e 1745-të në botë dhe është universiteti i 11-të në rajon për nga cilësia.

Pra, rangimi këtu bëhet duke marrë parasysh numrin e citimeve në Google Scholar, një lloj platforme e cila nuk është edhe aq kredibile, dhe paramendojeni se si do të ishim në rast se platformat, citimet do të merreshin parasysh në platforma kredibile të konfirmuara.

Pra, në këtë drejtim, për mua personalisht është shqetësues rangimi i Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve të tjera publike, e besa edhe institucioneve private të arsimit të lartë. Dhe, i shoh këto dy projekte si një mundësi ideale për të influencuar cilësinë në arsim dhe në veçanti veprimtarinë kërkimore e shkencore të këtyre universiteteve.

Prandaj, nuk e di se kujt i pengojnë dhe nuk e kam të qartë se pse duhet që sot të jemi kundër apo të abstenojmë në një botim të tillë. Përkundër kësaj apo në të njëjtën linjë, do të thosha, me këto të gjetura të webometrics e të platformave të tjera që bëjnë analizën e cilësisë në arsimin e lartë dhe në veprimtarinë kërkimore e shkencore, më duhet të përmend këtu edhe një fakt tjetër shqetësues. Të paktën, sipas organizatës për rritjen e cilësisë në arsim, një hulumtim i vitit 2020, i kemi diku rreth 45% të profesorëve të Universitetit të Prishtinës që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë.

Akoma më keq është situata në universitet e tjera publike, ta zëmë në Universitetin e Gjilanit, 65% e stafit nuk i justifikon titujt akademikë që ka marrë, dhe ky për mua është shqetësim. Besoj që do duhej të ishte shqetësim edhe për kolegët tanë deputetë nga opozita.

Prandaj, unë e kam mirëpritur dhe mirëpres edhe hapa të tjerë, siç është hapi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, që vendosur një rregull të qartë që profilet që kanë marrë phd pa bërë asnjë publikim të vetëm shkencor, kushedi se si e në çfarë mënyre, të mos mund të kenë më mundësinë që të bëhen bartës të programeve të studimit në institucionet arsimit të lartë.

Dhe, e kam edhe një kërkesë tjetër, që ky lloj i vendosjes së kritereve të përcillet me të patjetër edhe me një monitorim të vazhdueshëm dhe të kap edhe nivelin e profesorëve, sepse për mua është totalisht e pakuptimtë që të kemi profesorë që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë, dhe për më tepër dhe në rastin më të keq, të kemi profesorë që e ligjërojnë, ta zëmë, lëndën e metodave të hulumtimit, e në anën tjetër nuk as edhe një publikim të vetëm shkencor të botuar në një revistë kredibile. Kjo s'ka kurrfarë kuptimi.

Në anën tjetër, cilësia në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor në institucionet e arsimit të lartë, nuk është shqetësim vetëm i yni si deputetë e si profesorë, por është edhe shqetësim i studenteve dhe meriton adresim.

Në Kongresin e Aktivizmit Studentor, të organizuar nga ORCA, studentët mes tjerash janë ankuar edhe për përgatitjen e dobët profesionale të stafit akademik. Pra, studentët po kërkojnë rritjen e demokracisë dhe pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje me qëllim të demokratizimit të mëtutjeshëm të universiteteve publike në Kosovë, dhe njëlloj garancie për llogaridhënie. Dhe, kur flasim për hulumtimin shkencor, ne duhet ta pranojmë që e kemi edhe një fakt tjetër shqetësues, duhet ta kuptojmë një herë e mirë që nuk ka mundësi që cilësia në arsim të avancohet përderisa lejohen praktika të tilla, të tilla si plagjiatura, për shembull.

Kur flasim, pra për hulumtimin shkencor duhet ta kemi parasysh që ka plagjiatorë që frekuentojnë universitetet tona publike jo si turistë, as si vizitorë, por si profesorë. Pastaj, çfarë presim prej profesorëve të tillë që janë plagjiatorë? Unë besoj që nismat pozitive të kësaj qeverisjeje do të duhej të shiheshin larg inateve politike e partiake, dhe ta kuptojmë një herë e mirë që reforma merr kuptim vetëm kur përcillet deri në fijen e fundit të litarit të reformave që janë propozuar. Prandaj, përpjekja për ta integruar hulumtimin në mësimdhënie, që është iniciuar prej kësaj qeverisjeje, besoj që nuk e meriton inatin, po e meriton njëlloj përqafimi edhe të opozitës. Pra, njëherë e mirë duhet ta kuptojmë që nuk ka mësimdhënie pa hulumtim, që ka vdekur koha kur profesorët e kanë lexuar një libër e memorizuar mirë atë dhe kanë dalë para studentëve për 10 vjetët e ardhshme dhe e kanë konsideruar të vërtetën si diçka të fjetur. Sot dija është fluide dhe nuk funksionon me profesorë që nuk lexojnë, e aq më tepër me profesorë që nuk kërkojnë e nuk prodhojnë dije të re.

Pra, është koha për pagesën e performansës, për stimuj të ri, për profesorë, departamente, fakultete, universitete, që funksionojnë më mirë, sepse duke e shpërblyer performansën i motivojmë edhe ata që sot kanë mbetur mbrapa. Prandaj, edhe Fulbright, edhe fondet Horizon të Bashkimit Evropian, për të cilat jo rrallë ka pak aplikime dhe pak interesim, do të duhej të ktheheshin në një praktikë të universiteteve tona dhe unë po e shfrytëzoj këtë rast, këtë mundësi që t'i lus kolegët e mi deputetë nga opozita që t'i votojnë këto dy marrëveshje dhe të paktën kësaj radhe të mos kemi këso lloj inatesh personale e politike që e dëmtojnë cilësinë në arsimin e lartë.

KRYETARI: Mirë! Tash, fjalën e ka deputeti Jahja Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, kryetar!

Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të nderuar,

Kur flasim e tema e rendit të ditës momentalisht është çështja e Komisionit Fulbright, prandaj pikërisht në këtë pikë të rendit të ditës dua ta përqendroj diskutimin.

Dhe, menjëherë filloj nga fakti që është një program me të vërtetë prestigjioz për të cilin mendoj që është kënaqësi e veçantë që ka ardhur sot në rendin e ditës. Po them kështu, ngase unë e kam pasur fatin si i ri që t'i shfrytëzoj dy programe amerikane, këtë pikërisht të Fulbright dhe ajo e RX-it, po mos t'i kisha përjetuar këto dyja, domethënë të kaloja nëpërmes të këtyre dy specializimeve apo programeve nuk kisha pas mundësi të bëhem profesor universitar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për këtë arsye, konsideroj që ky program është i domosdoshëm për studiuesit tanë në Kosovë, për studentët tanë, për profesorët tanë, ngase një prej parakushteve kryesore dhe më cilësore është internacionalizimi i universitetit. Po them kështu, ngase shkencat, të paktën shkencat natyrore teknike, teknologjike, kanë karakter sikurse dhe pushka. Ti në qoftë se dëshiron në pushkë ta ngrehësh grepin ngadalë, e të njëjtën krismë e qet. Po bëj të them kështu, se në qoftë se dëshiron ti ta shkruash një libër të shkollës fillore, në qoftë se dëshiron ta shprehësh një koncept shkencor, në qoftë se nuk ke dije adekuate për ta shprehur, përkundër aftësive tua gjuhësore, narrative apo përrallatore, ajo ka për të dalë mbrapsht. Ka për të dalë aq mbrapsht sa që ke për ta dëmtuar një gjeneracion të tërë me ato libra.

Prandaj, vijmë deri te qëndrimi që për t'i dhënë dikujt dritë vetë burimi duhet të shkëlqejë, e burimi shkëlqen në kuptimin shkencor vetëm atëherë kur je shkencëtar ndërkombëtar. Jo vetëm tash, por moti është konsideruar që shkenca është çështje shumë e rëndësishme për ekonominë, më vonë kam dëshirë të paraqitem të flas edhe diçka për çështjen e ngrohjes, apo të energjisë. Në kohën kur kam qenë unë këtu profesor universiteti, atëherë ka qenë një lidhshmëri e madhe e industrisë me shkencën. Ka qenë një lidhshmëri konkrete dhe një bërthamë shkencore në Obiliq atje. Dhe, pikërisht kur kam konkurruar si i ri në programin e Fulbright-it, po ju them atëbotë, ndonëse kam pas punime ndërkombëtare në Gjermani e tjera në botë, një prej punimeve kryesore ka qenë ai, të cilin e kam pas botuar në këtë revistë të Obiliqit, domethënë revistë shkencore. Kanë qenë njerëz kredibilë, siç janë: Aledin Abazi, e kështu të tjerë me radhë, njerëz eminentë, emra të rëndësishëm sot në botën e shkencës ndërkombëtare.

Kurse tash s'kemi kurrfarë investimi, s'kemi kurrfarë lidhshmërie të industrisë, teknologjisë me shkencën. Flasin njerëzit, të cilët janë pa kompetencë, flasin për problemet, të cilat janë ekskluzivisht të karakterit teknologjik, teknik dhe shkencor. Dhe, mu për këtë arsye ne gjenerojmë një katrahurë dhe ky është burimi kryesor i ngrohjes ose mungesës së energjisë. Prandaj, të koncentrohemi për programin e Fulbright-it, temën të cilën e kemi përpara që konsideroj që është aq i rëndësishme, sidomos kur është fjala për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është programi më prestigjioz. Më besoni kudo që e kam dërguar CV-në, një prej

rëndësisë më të mëdha është programi i Fulbright-it, se për të depërtuar atje duhej atëbotë të bëhej një komision qendror në Jugosllavinë e atëhershme.

Domethënë, duhet të bëhet një seleksionim me kredibilitet vetëm kur je student ekstra i shkëlqyeshëm, apo studiues, ti mund ta arrish këtë program. Prandaj, është program aq prestigjioz, prandaj dua të them para qytetarëve, por në radhë të parë para kolegëve këtu që t'i lëmë ne ato hijet tona personale, politike, ndërskamcat, e ato problemet tona që i kemi, që unë s'i kuptoj shumicën prej tyre, por të votojmë, të ecim përpara, sidomos kur është fjala për programin e Fulbright-it, sepse siç thashë është programi më prestigjioz i shtetit, krahas me RX-in, programi më prestigjioz i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Dhe, në qoftë se s'e votojmë atë domethënë dy gjëra vijnë në shprehje, ai që s'e voton sipas mendimit tim është kundër internacionalizimit të universitetit dhe se internacionalizimi është aq i domosdoshëm, për t'u lidhur me mendimin e profesor Ukës, që thotë atëherë nuk kemi njerëz kredibilë. Në qoftë se e vëmë në çdo punëtor shkencor, çdo profesor e vëmë me emrin sot shihet në mënyrë transparente kush çfarë ka punuar. Dhe, menjëherë automatikisht përderisa flet dikush që është e shoh menjëherë në internet dhe shihet automatikisht diagnoza e tij shkencore. Dhe, është fatkeqësi shumë e madhe që diagnozë të tillë kanë negative shumë profesorë, të mos them 80% e profesorëve dhe mësimitdhënësve, të cilët japin mësim në universitetet tona, përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës.

Në anën tjetër, kur është për këtë transparencë, nëpërmjet Fulbright-it ai e kërkon edhe transparencën e punimeve tua, domethënë unë e shoh se në universitetin tonë akoma nuk i kemi doktoratet si transparente. Të ju thënë të vërtetën, te unë kanë doktoruar disa njerëz eminentë shkencëtarë në Universitetin e Prishtinës, por të gjithë ata i kanë doktoratat e publikuara, transparente dhe të digjitalizuara, dhe shihen në mënyrë transparente. Kurse shumë prej doktorëve nuk i kanë domethënë, dhe aty vijmë te konkluzioni që siç përmendi profesor Uka është çështje plagjiaturës.

Me futjen e këtij programi që ka qenë dikur, që bën lidhshmërinë si ky program posaçërisht ka për qëllim lidhshmërinë, implementimin, fjalën "implementim" unë e kam kuptuar në mënyrë adekuate vetëm kur kam përjetuar se si mënyra digjitale e të menduarit implementohet në mënyrë optike. Prandaj, nëpërmjet këtij programi pikërisht insistojnë në implementimin industrial të dijes dhe të mendjes shkencore.

Prandaj, ju lus si kolegë që jemi, si vëllezër, që t'i lëmë huret anash dhe ta votojmë këtë program prestigjioz amerikan, i cili me siguri ju garanton një gjë shumë pozitive studiuesve dhe njerëzve që studiojnë në Universitetin e Prishtinës dhe në universitetet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe i fundit për diskutim lidhur me këtë marrëveshje është deputeti Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm sa për sqarim nga aspekti procedural, programi Fulbright ka ardhur në Parlament më 7 dhjetor dhe pas dy ditësh si komision kemi thirr mbledhje për datën 14 për ta shqyrtuar dhe proceduar për në seancë plenare. Do të thotë, dy ditë pas ardhjes në Parlament, më 9 deri më 14 pastaj ka një periudhë pesëditore, e cila është mjaftueshëm e nevojshme për ta trajtuar projektligjin.

Dhe, një shqetësim që unë doja ta ngre këtu është që të kemi maksimalisht kujdes në operimin me statistika kur është në pyetje gjendja e arsimit të lartë në Kosovë. Unë konsideroj që kur përkthehet një realitet ekzistues me tema statistikore duhet parë me një shikim jashtëzakonisht të kujdesshëm metodologjinë. Unë kam parë edhe statistika më herët sesa 75%, 79%, sot dëgjova dhe 80%, edhe 40 e sa për qind e profesorëve nuk i justifikojnë titujt e tyre nëpër universitete publike, në rastin konkret edhe Universitetin e Prishtinës. Unë i kam parë disa metodologji dhe të ju thënë të drejtën, ato metodologji vuajnë nga çalime të jashtëzakonshme dhe rrjedhimisht rezultati statistikor që e prodhon një metodologji e tillë konsideroj që është më shumë lajthitje dhe që shumë lehtë mund të shndërrohet në mjet propagandimi politik më shumë se sa një deliberim racional i çështjes në Parlament.

Përndryshe, u bashkëngjitëm pa asnjë dilemë të gjitha kërkesave të kolegëve deputetë që këto marrëveshje të votohen sot, ashtu që qytetarët, studiuesit, hulumtuesit, profesorët të mos i vuajnë pasojat e ndonjë animoziteti eventual politik që mund të ekzistojë ndërmjet grupeve parlamentare. Këtij urimi dhe kësaj kërkesë unë i bashkëngjitëm me plot vullnet. Andaj, sinqerisht i kisha bërë thirrje opozitës, me theks të veçantë kolegëve nga LDK, PDK dhe nga AAK që ta ratifikojmë këtë marrëveshje dhe të mos shtyjmë ekzekutimin e këtij programi për vitin 2022. Faleminderit!

KRYETARI: U paraqit në ndërkohë edhe kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri. Ia japim fjalën!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Realisht, ia nisi të më vijë goxha mirë kur i dëgjova deputetët e mazhorancës duke i thurur lavde kësaj marrëveshje. Kjo marrëveshje ka filluar në vitin 2009 prej ministrit të asaj kohe Enver Hoxhaj dhe vërtet është një marrëveshje jashtëzakonisht e mirë.

Deri kur është rinovuar është nënshkruar si marrëveshje në vitin 2016 mes ambasadorit Greg Delavi dhe Qeverisë së Isa Mustafës, e në atë kohë ishte ministër i Arsimit, Arsim Bajrami, merreni procesverbalin e votimit dhe shikojeni. Lëvizja Vetëvendosje, me sa më kujtohet, se kam qenë këshilltar i asaj qeverie, nuk ka marrë pjesë në votim fare, në ratifikimin në vitin 2016. E njëjta është, shumë e rëndësishme. Por, po më vjen mirë që keni filluar që të shihni mirë, pra ai

20-vjeçari që ua keni servuar qytetarëve të krimit e të korrupsionit, tash po dalin marrëveshje të rëndësishme që qenka mirë t'i vazhdojmë dhe qenka mirë t'i votojmë...

KRYETARI: Ne e kemi kuptuar, por juve çka ju gjeti Abelard?!

ABELARD TAHIRI: Epo, kjo është e mira dhe realisht sa më shpejt që e kuptoni realitetin besoj do të jeni më efektivë edhe në çështjen e energjisë elektrike që jemi duke pasur problem.

Prandaj, ne po përpiqemi t'jua hapim sytë, të ju bëjmë më efektivë. Këtu asgjë, asnjë deputet nuk ka asnjë çështje personale. Këto të gjitha janë çështje politike të rëndësishme dhe konsensusi është shumë i rëndësishëm, prandaj kur e ke mundësinë një herë ta lësh anash opozitën, e ke edhe atë mundësi, po na vjen edhe neve mundësia që ta bllokojmë një proces. Prandaj, kjo nuk është e mirë, unë po e di që edhe si hap yni sot nuk është i mirë, por në anën tjetër ne jemi të gjithë ata si opozitë që pavarësisht që jemi me numra më të vegjël, po kërkojmë të ju ndihmojmë, por po është e pamundur.

Pra, nuk ka deputetë në Kuvendin e Kosovës, as qytetarë, as profesorë, qoftë i universitetit privat, qoftë shtetëror, që nuk e dinë rëndësinë e kësaj marrëveshjeje. Pra, prej 2009 ka filluar me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe besoj që mbi 150 bursistë deri tash i kemi pasur në Amerikë si rezultat i këtij fondi të përbashkët të dy qeverive. Prandaj, për të pasur mbarëvajtje të mirë të punëve edhe një herë po ju kërkoj konsensus në tema të rëndësishme me opozitën. Faleminderit!

KRYETARI: Fillimisht, ministrja e ka fjalën, një fjalë përfundimtare ministres për projektligjin.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse po besoj që pas diskutimeve dhe dakordimit për rëndësinë e përmbajtjes së marrëveshjes do të kemi mirëkuptimin e deputetëve për votim dhe e shfrytëzoj edhe këtë mundësi që të ju lus edhe një herë të gjithë deputetëve të të gjitha partive politike, pa marrë parasysh cilin grup e përfaqësojnë, që ta votojnë këtë marrëveshje, sepse sado që edhe aspekti formal procedural është respektuar në tërësi, përmbajtja është shumë e rëndësishme.

Për ata që mund të kenë dilema ose mund të mos e dinë, po e përsëris edhe një herë - përfitues nga kjo marrëveshje janë studentët e Republikës së Kosovës, që do të studiojnë në nivelin master, do të jenë profesorët e rinj dhe profesorët me përvojë që do të studiojnë në programet post-doktoraturë dhe po ashtu edhe institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet tjera që do të përfitojnë nga eksperiencia dhe përvoja e ekspertëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Marrëveshja kësaj radhe ka paraparë edhe dyfishimin e fondeve nga Ministria e Arsimit, që nënkupton dyfish më shumë mundësi për të rinjtë dhe studiuesit tanë dhe ashtu siç u përmend

marrëveshja ka filluar nga viti 2012 dhe është një marrëveshje që është në vazhdimësi. Prandaj, duke pasur parasysh gjithë rëndësinë për të cilën fola për të rinjtë edhe përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, por po ashtu edhe për respektin ndaj marrëdhënieve të shkëlqyeshme me shtetin tonë mik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, unë i ftoj të gjithë deputetët, pa dallim të partive, grupeve parlamentare, që ta votojnë marrëveshjen.

Ju faleminderit paraprakisht për mirëkuptimin që keni ndaj të rinjve dhe ekspertëve të Republikës së Kosovës!

KRYETARI: Pajtohem që miqësia tregohet me votë. Shikoni, e kemi një amendament të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL për këtë marrëveshje. Fillimisht, e votojmë këtë amendament.

Përgatituni për votimin e amendamentit numër 1 të kësaj marrëveshje, të nderuar deputetë, pastaj kalojmë te votimi i marrëveshjes. I kemi të pranishëm 93, a janë apo erdh edhe ndonjë tjetër? 93 deputetë janë të pranishëm. Kemi kuorum! Pra, po e hedhim fillimisht në votim amendamentin numër një të kësaj marrëveshjeje. Komisioni FunkSIONAL e ka propozuar amendamentin.

Kush është për këtë amendament? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konsideroj që nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për votimin e kësaj marrëveshje. 60 vota për i ka marrë marrëveshja, 3 kundër dhe asnjë abstenim. Pra, amendamenti nuk ka pasur mundësi të votohet, kështu që nuk vazhdojmë as me marrëveshjen, sepse duhet të ketë kuorum për këtë çështje.

Kalojmë te marrëveshja tjetër, vetëm le ta prezantojë ministri Liburn Aliu është ngarkuar nga zoti Mehaj dhe pas kësaj po shkojmë në pushim menjëherë. Është:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-097 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse

Të nderuar deputetë,
Komisioni FunkSIONAL për çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Ministri Liburn Aliu është ngarkuar nga ministri Mehaj që ta paraqesë këtë projektligj. Urdhëroni, zoti Aliu!

MINISTRI LIBURN ALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, sot para jush paraqes për miratim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e Forcave SOFA ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes arsyen dhe rëndësinë e miratimit të këtij projektligji. Në kuadër të bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut ka shprehur gatishmërinë dhe janë pajtuar që të finalizohen procedurat për lidhjen e Marrëveshjes për statusin e Forcave SOFA ndërmjet dy qeverive. Kjo marrëveshje është iniciuar vite më parë, por nuk ka arritur asnjëherë të finalizohet. Me vizionin dhe përkushtimin tonë që Forca e Sigurisë së Kosovës të jetë partnere serioze dhe e besueshme e ushtrive të vendeve mike, së bashku me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut kemi arritur t'i finalizojmë të gjitha procedurat e nevojshme dhe ta bëjmë nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje të rëndësishme për shtetin e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Për sqarim, Marrëveshja SOFA e rregullon statusin e ushtrive të vendeve partnere gjatë trajnimeve, ushtrimeve dhe misioneve të jashtë vendit të tyre dhe përcakton se si do të trajtohen pjesëtarët gjatë aktiviteteve të parapara me vendet, me të cilat nënshkruhet një marrëveshje e tillë. Për këtë është me rëndësi që ky projektligj të votohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të hyjë në fuqi në mënyrë që bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën ushtarake, jo vetëm të vazhdojë, por që i njëjti të thellohet dhe më tej.

Andaj, Ministria e Mbrojtjes kërkon shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligjit. Faleminderit për vëmendje!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër Aliu! Tani nga Komisioni për Çështje të Sigurisë, zoti Enver Dugolli e ka fjalën.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në bazë të nenit 60, paragrafi 3, si dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14. 12. 2021, e shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ushtrisë së Republikës së

Maqedonisë së Veriut gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse dhe lidhur me këtë i ka paraqitur Kuvendit këtë:

Rekomandim

Të miratohet ky projektligj pasi i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe njëkohësisht ftojme deputetët që të votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Atëherë, tash e kanë radhën përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Dugolli prapë e keni fjalën në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare!

Gjithashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje shprehim gatishtësinë që do ta votojmë këtë projektligj, këtë marrëveshje shumë të rëndësishme ndërkombëtare e cila njëkohësisht i hapë rrugë një bashkëpunimi edhe më të mirë edhe më të thellë me shtetet fqinje, në këtë radhë me Maqedoninë e Veriut.

Dhe, njëkohësisht plotësojmë edhe disa parakushte që të jemi edhe pjesë e organizatave të ndryshme rajonale, për shkak se votimi i këtij projektligji apo kësaj marrëveshje që njihet edhe si SOFA Agreement është edhe një parakusht i organizatës më të madhe të sigurisë ndërkombëtare, Traktatit të NATO-s dhe ftojme edhe deputetët tjerë që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga grupet tjera parlamentare nuk ka të paraqitur. Tani është radha e paraqitjes së deputetëve. Nga Lëvizja Vetëvendosje, fjalën e ka Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Është me të vërtetë për keqardhje ky qëndrim destruktiv i pjesëtarëve të opozitës në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sidomos kur tërheqin paralele mes rasteve që nuk mund të krahasohen.

Qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje në të kaluarën, vlen të përmendet edhe një herë, në kundërshtim të marrëveshjeve ndërkombëtare në thelb ka pasur keqkeqverisjen dhe pikëpyetjen e legjitimitetit që ato qeverisje kanë pasur në marrjen e vendimeve, të cilat e kanë cenuar sovranitetin e Republikës së Kosovës, integritetin territorial dhe funksionimin e brendshëm. Si rezultat i kësaj, qëndrimi ynë politik ka qenë që ne nuk e mbështesim asnjë marrëveshje, asnjë vendim, deri sa kjo çështje të rregullohet me zgjedhje të reja, ku do të kemi institucione që tashmë i kemi. Pra, qëndrimi ynë ka qenë shumë i qartë.

Cili është arsyeja e tyre në këtë rast për bojkotimin e marrëveshjeve shumë jetike, vitale dhe të rëndësishme për Republikën e Kosovës? Është pikërisht një kritikë e tyre, e cila është marrë

shumë seriozisht nga ne, kur kanë thënë se agenda legislative e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk po plotësohet dhe duke u bazuar në këtë kemi marrë projektligjet, i kemi futur në rend të ditës, që ta plotësojmë këtë kërkesë që ishte pikërisht nga opozita. Dhe, cili është arsyeja e tyre: “Pse po i futni tash, kur nuk kemi kohë t’i shqyrtojmë, dhe si rezultat i kësaj, ne nuk do t’i votojmë as marrëveshjet ndërkombëtare”.

Pra, në njërin anë mundohen të paraqiten konstruktivë, duke thënë se ne jemi këtu për t’ju ndihmuar dhe çfarë bëjnë? Refuzojnë marrëveshjet, ku përfituesit kryesorë do të jenë qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo qasje është destruktive, kjo qasje është joetike, kjo qasje është joparimore. Me këtë nuk po i bëjnë asgjë Lëvizjes Vetëvendosje, me këtë nuk po i bëjnë asgjë Qeverisë së Republikës së Kosovës, me këtë po e dëmtojnë direkt qytetarin e Republikës së Kosovës.

Më vjen mirë që mbledhjet e Kuvendit transmetohen drejtpërsëdrejti dhe qytetarët e këtij vendi kanë mundësi të shohin se kush po punon në interes të tyre dhe më vjen mirë që, më në fund, ne i kemi edhe kushtet teknike për ta parë se kush ka këtu qëndrim parimor. Kjo është për keqardhje dhe nuk mund të arsyetohet në asnjë mënyrë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Po bisedojmë për një pikë të rëndësishme që ka të bëjë me fuqizimin e rolit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe interesimi ynë dhe imi është që marrëveshjet e tilla mendoj që e fuqizojnë edhe karakterin shtetformues, por edhe të Ushtrisë së Kosovës. Sa i përket asaj pjesës së parë, për miratimin apo votimin, ose mosvotimin e marrëveshjes, besoj që u shterua debati. Deputetët nuk kanë nevojë të mbajnë këtu orë edukative arsimore. Këto janë veprime politike dhe ashtu duhet të kuptohen. Krejt çka duhet të merret për bazë dhe të jetë e arsyeshme, është që askush nuk mund të luajë me arrogancën e numrave, kudo dhe kurdo qoftë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe sistemi ynë politik është ndërtuar mbi bazën e konsensusit, po ashtu edhe vetë pavarësia e Kosovës, jo krejt çka ne dëshirojmë, edhe sipas vullnetit ideologjik, politik ose shpirtëror, por mendoj se deputetët duhet ta ruajnë këtë frymë të komunikimit dhe grupet e mëdha parlamentare, edhe kur janë në pozitë, edhe kur janë në opozitë, duhet ta kenë një qasje të njëjtë. Mbi bazën e kësaj ne mund të vendosim dhe, edhe ashtu Kushtetuta na garanton që nuk i nënshtrohemi asnjë lloj detyrimi për votë. Deputetët votojnë me bindje dhe me atë që mendojmë se është e drejtë për interesat e qytetarëve të vendit.

Mendoj që kjo marrëveshje duhet të përkrahet dhe sigurisht se deputetët kur ta kenë numrin e nevojshëm për ratifikimin e marrëveshjeve, besoj që do t'i japin përkrahje për ratifikim të mëtutjeshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka kërkuar deputetja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit, nënkryetare!

Ajo që më nxiti të marr fjalën është pikërisht kjo që tha deputeti Zemaj. Ky është një vendim politik, e qartë, vendim politik që të mos votojmë marrëveshjet, që është për keqardhje, sepse nuk është vendim i argumentuar dhe i bazuar në fakte.

Po bëhet fjalë për tetë ligje, apo më mirë thënë, tetë projektligje, të cilat kanë pasur të bëjnë me sferën e shëndetësisë, që u bënë sot “mollë shërri” këtu dhe këta e nxorën një vendim politik, edhe pse i kishin përfaqësuesit e tyre deputetë në Komisionin për Shëndetësi për projektligjet që janë votuar një javë më herët, të premtën e kaluar, që i kanë kaluar të gjitha procedurat, madje në katër komisionet kryesore, ku po ashtu janë deputetët edhe të pozitës, edhe të opozitës. Kanë ardhur këtu pa asnjë vërejtje dhe pa asnjë amendament. Këto tetë projektligje janë në formën si janë votuar në parim, ndërsa shtatë projektligje të tjera kanë mbetur në komision për t'u amendamentuar.

Prandaj, nuk ka asnjë arsye që sot e nxorën këtë vendim politik për të mos i përkrahur këto marrëveshje kaq të rëndësishme, për çka do të vijë dita kur edhe do t'i votojnë, por do të shtyhen. Marrja e vendimeve kaq të rëndësishme, siç ishte marrëveshja paraprake, kjo tani, dhe me të vërtetë është për keqardhje kur vendimet politike merren pa asnjë bazë, pa asnjë argument të qëndrueshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Atëherë, nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur, gjithashtu nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të votuar. Shkojmë në pauzë deri në orën 3:30.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Vetëm 65 deputetë kanë ardhur deri më tash. Po shihet përgjegjësia shumë e ulët e deputetëve. Secili deputet i ka obligimet e njëjta në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Konsideroj që nuk kemi mundësi, pra nuk janë kushtet për trajtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Vazhdojmë me pikat e tjera.

(Ndërprerje e incizimit)

Së paku, ta kryejmë këtë pjesën e prezantimit të marrëveshjeve. Jemi te pika e gjashtë:

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-096 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Programit - Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e saj në formë të këtij projektligji. E ftoj ministrin e Financave, zotin Hekuran Murati, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Me qëllim të forcimit të menaxhimit të sigurisë së ujit dhe përmirësimin e sigurimit të ujit në Pellgun e Moravës, ne si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve kemi arritur dakordim me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim, si anëtar i Bankës Botërore, për marrëveshjen e titulluar Programi, nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit, apo siç i referohemi shkurtimisht, FLOS.

Marrëveshja financiare ndërkombëtare kap vlerën totale të kredisë prej 25,1 milionë eurosh, me kohëzgjatje prej 30 vjetësh maturitet, ku nga to pesë vjet janë periudhë, ndërsa norma e interesit është fikse prej 1,25% në vit, plus pikët bazë të përshtatjes. Si rezultat, kjo kredi nuk krijon ekspozim shtesë ndaj rrezikut të llojit të normës së interesit. Projekti që financohet përmes kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare financiare është i reflektuar në Buxhetin e shtetit përmes klauzolës për investime dhe vlerësohet se e njëjta nuk rrezikon stabilitetin financiar të vendit.

Marrëveshja ka për qëllim që përmes financimit nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim të ndihmojë në menaxhimin e sigurisë së ujit, e cila është në fushëveprim të Ministrisë për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë, si dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit “Hidromorava”

në Gjilan, që nënkupton se edhe Ministria e Ekonomisë do ta mbikëqyrë projektin. Në këtë kontekst, siguria e ujit përcaktohet si aftësia për të mbrojtur qasjen e qëndrueshme në sasi dhe cilësi të përshtatshme të ujit, zhvillimin socio-ekonomik, përmirësimin e një serë shërbimesh ujore, mbrojtjen e mjedisit dhe ndaj përmbytjeve e thatësisë.

Kjo do të arrihet duke përmirësuar bazën e informacionit për administrimin e burimeve ujore, menaxhimin efektiv të pasurive të ujit, përmirësimin e shërbimeve të ujit për zonat e zgjedhura dhe përmirësimin e planifikimit kombëtar të investimeve në këtë sektor. Po ashtu, përmes këtij financimi do të zgjerohen dhe rregullohen operimi dhe siguria e digave dhe do të adresohen krizat ujore me investime shtesë, duke i finalizuar, ndër të tjera, studimet teknike, mjedisore dhe sociale edhe për hidrosistemin Kikë - Kremenatë.

Rishtazi, po ashtu kemi pranuar edhe zotim nga Ambasada zvicerane për mbështetje të projektit me grante, për të mbuluar studimet teknike, si dhe përkushtimin e Zyrës së BE-së në Kosovë për të mbështetur tutje projektin me fondet IPA lidhur me punimet infrastrukturore.

Pra, ky është një projekt që kishte filluar në Qeverinë Kurti 1 dhe pastaj në mandatin e Qeverisë Hoti, e kishte sjellë në këtë seancë dhe nuk ka marrë mbështetjen, po ashtu as nga grupi ynë parlamentar. Arsyeja asokohe ishte për shkak se nga shuma prej 25 milionë eurosh, rreth gjysma e kredisë parashihej të shkonte në asistencë teknike dhe studime dhe vetëm 12 milionë euro parashihej të shkonin në investime në infrastrukturë.

Me të marrë detyrën si ministër i Financave kam caktuar takim me Bankën Botërore dhe kam kërkuar që të ndryshohet kjo strukturë, ose të gjenden mjete shtesë nga donatorët, në mënyrë që studimet teknike dhe asistencë teknike të financohet nga ta. Dhe, si rezultat i kësaj, siç e thashë edhe në fjalim, pra dallimi me herën e kaluar qëndron se tani, përveç 25 milionë eurove kredi, do të kemi mbështetje edhe nga donatorët deri në 20 milionë euro grante shtesë. Pra, gjithsej shuma totale, përfshirë edhe grantet, në tre vjetët e ardhshme do ta arrijë në 45 milionë euro.

Domethënë, herën e kaluar kishim 25 milionë euro kredi, kurse tani Qeveria zvicerane ka shprehur gatishmërinë dhe presim konfirmimin që të mbështesë, të marrë përsipër një pjesë të financimit të studimeve teknike, kurse pjesa nga komponenti i asistencës teknike, pra me kredi, të zhvendoset tek investimet kapitale dhe po ashtu kemi marrë edhe zotimin nga Komisioni Evropian për të mbështetur edhe me investime kapitale, duke filluar nga viti 2023.

Prandaj, duke marrë parasysh që është një projekt shumë i rëndësishëm dhe, për më tepër, ka edhe financim shtesë nga donatorët deri në shumën 20 milionë euro, e konsideroj si tepër të rëndësishme që përfundimisht të marrë epilog ky projekt dhe ta marrë mbështetjen e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Reshitaj, në mos të ka mbetur fjala prej herës së kaluar, apo dëshironi të flisni për këtë marrëveshjen për ujin? Urdhëro!

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit është njëra ndër marrëveshjet më të rëndësishme në sektorin e ujit në Republikën e Kosovës.

E them këtë, duke u nisur nga fakti që kjo marrëveshje i mundëson Kosovës, ndër shumë leverdi të tjera, mundësinë e krijimit të një master-plani profesional që Kosova nuk e ka pasur që nga vitet e '80-ta dhe çdo investim që është bërë, sado i paktë, në sektorin e ujërave është bazuar në master-planin e viteve të '80-ta, që për mua, edhe si deputete, por edhe si ministre në atë kohë, ka qenë paradoks i llojit të vet, duke pasur parasysh ndryshimet klimatike, duke pasur parasysh nevojat për zhvillim, demografinë që ka ndryshuar ndër vite, zhvillimin urban e shumë faktorë të tjerë që kanë ndikuar në kapacitetet ujore të Republikës së Kosovës.

Tani, përveç atyre që u përmendën nga ministri, si përparësi dhe mundësi që do të ketë Kosova përmes ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, do të doja të veçoja se kjo marrëveshje ka mundësi t'i hapë dyert edhe përkrahjes nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Zvicrës, që gjithmonë na kanë përkrahur në këtë drejtim. Ky projekt, apo më mirë të themi, kjo lloj marrëveshjeje është iniciuar që nga viti 2015 dhe kjo përkrahje ka ekzistuar që atëherë nga Banka Botërore, Komisioni Evropian, Ambasada e Zvicrës dhe të tjerë, mirëpo fillimisht ka qenë në interes që të bëhet rehabilitimi i digave ekzistuese. Pastaj, në vitin 2018, kur unë kam udhëhequr Ministrinë e Mjedisit në Qeverinë Haradinaj, për herë të parë është kërkuar edhe mundësia e përkrahjes për krijimin e digave, ujëmbledhësve apo liqeneve artificiale, në kohën kur kam ndërprerë licencat për hidrocentralet dhe krijimi i digave do të ishte një mundësi shumë e mirë e ujëmbledhësve, që të shihet pastaj mundësia e shfrytëzimit të duhur të ujit në Kosovë.

Dhe, më 2019 nga Banka Botërore janë zotuar mjetet, 45 milionë euro për ndërtimin e digave. Është e vërtetë që unë atë kohë kam kërkuar të krijohet mundësia e përkrahjes financiare nga Banka Botërore, meqë kam kuptuar që Banka Botërore në programin prioritar të saj për vendet në zhvillim ka pasur sektorin e ujërave. Ne e kemi shfrytëzuar këtë mundësi, që të kërkojmë ndihmë financiare për ndërtimin e dy digave, që në atë kohë ka qenë Kikë - Kremenata në Kamenicë dhe diga e Dragaqinës, që më pastaj për shkaqe politike janë ndërruar këto kërkesa, pasi domethënë jemi ndërruar edhe ne si Qeveri. Është mirë të dihet, që kjo nuk ka filluar tani si punë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, apo qeverive të Republikës së Kosovës, mirëpo e konsideroj si dështim ndoshta pse deri tani këto para të zotuara nuk kemi mundur t'i shfrytëzojmë për shkaqe të ndryshme, tashmë të ditura, edhe për shkak të ndryshimeve të qeverive. Nëse ne kemi mundësi brenda kësaj marrëveshjeje të shfrytëzojmë edhe ato mjete, por edhe mjetet e tjera dhe të fillohet konkretisht implementimi, duke u nisur me master-planin, me

pjesën e analizave që e përmendi ministri, e që janë shumë të rëndësishme, mendoj se do të futemi në një fazë historike shumë të rëndësishme në sektorin e ujërave.

Pra, nëse arrijmë që të kemi një master-plan të bazuar në studime të mirëfillta mbi kapacitetet e Kosovës për ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave, atëherë ne po fillojmë një etapë të re në sektorin e ujërave.

Mendoj që mbi të gjitha është me rëndësi të kuptojmë mundin, sakrificën e secilit për ta pasur një mundësi të tillë, që sot Kosova ta ketë një marrëveshje të tillë. Dhe, përtej politikave partiake, konsideroj se është një marrëveshje shumë e rëndësishme. Ne edhe si komision, sepse po i jap vetes të drejtë edhe si anëtare e Komisionit për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim të flas, po u zotohem qytetarëve të Republikës së Kosovës që do ta përcjellim dhe do ta monitorojmë implementimin e kësaj marrëveshjeje pikë për pikë nga institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës. Sepse, interesi i qytetarëve të vendit është që të përfitojnë nga kjo marrëveshje. Dhe, nëse implementohet korrekt, në mënyrë profesionale, atëherë qytetarët e Republikës së Kosovës do të përfitojnë shumëfish nga kjo marrëveshje, duke përmendur edhe mundësinë e ujitjes, që mund të vijë nga ndërtimi i digave në një fazë të radhës.

Pra, edhe një herë, lus të gjithë kolegët deputetë që ta përkrahin një marrëveshje të tillë, sepse nuk është marrëveshje që është iniciuar sot, që po fillon sot, por është marrëveshje që konsideroj se çdo qeveri e ka pasur prioritet dhe e ka shtyrë përpara, por që nuk ka arritur të realizohet deri më sot. Faleminderit!

KRYETARI: E kaluam radhën e komisionit, por mendova që po ashtu znj. Reshitaj ka diçka procedurale.

Tash fjalën ia japim kryetarit të Komisionit për Buxhet fillimisht. Deputeti Armend Muja e ka fjalën.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen që e ka mbajtur më 15. 12. 2021, Projektligji nr. 08/L-096 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit: Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Që ky Projektligj të miratohet konform po ashtu edhe Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare.

Sa i përket, nëse mundem po ashtu edhe në emër të grupit parlamentar?

KRYETARI: Po, lirisht!

ARMEND MUJA: E theksoj që ne e mbështetim fuqimisht këtë marrëveshje dhe në të njëjtën kohë u rekomandojmë edhe deputetëve të tjerë që të njëjtën ta votojmë.

Arsyeshmëria e propozimit qëndron në faktin se miratimi i kësaj marrëveshjeje i shërben Qeverisë së Kosovës e sidomos banorëve të Anamoravës për realizimin e objektivave për menaxhim të sigurisë së ujit, me fokus ndër të tjera, në zbutjen e krizës aktuale dhe thatësisë në atë rajon.

Në bazë të marrëveshjeve, po ashtu edhe studimeve që kemi pasur së bashku me Autoritetin Rregullativ të Ujit, një nga rajonet më të prekura me mungesë të ujit dhe reduktime, është pikërisht ai rajon. Në mesin e 400 mijë qytetarëve të Kosovës që kanë vështirësi në qasje në ujë të pijes, është pikërisht ai rajon. Për këtë arsye, ju kërkoj me mirësjellje të gjithë deputetëve, ne mund t'i kemi nuancat e mendimit të ndryshme, mirëpo ky projekt është jetik për ta zgjidhur dilemën e ujit për Anamoravën, andaj ju kërkoj të gjithëve që ta mbështesin njëzëri.

KRYETARI: Në emër të Grupit të PDK-së, kryetari Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç e dimë ne që kemi qenë edhe deputetë të legjislaturës së kaluar, kjo nuk është një marrëveshje e re. Kjo është një marrëveshje që legjislatura e kaluar ka refuzuar ta ratifikojë. Pra, nëse nuk do të kishim refuzuar atë kohë ta ratifikojmë, ishte harruar ky problem. Pra, ka shkuar më shumë se një vit realisht. Më kujtohet tash ministri i Financave që e prezantoi, atëkohë kryetar i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Transfere e arsyetonte pse nuk duhet të votohet një marrëveshje e tillë. Pra, qytetarët e Gjilanit do të kishin filluar të shihnin ndoshta përmirësime ose implementimin e kësaj shumë më herët. Pra, ne po flasim për marrëveshjen e nënshkruar në korrik nëse s'gaboje nga ish-ministrja e Financave, znj. Bajrami, në Qeverinë e kryeministrit Hoti, dhe ne, siç e ritheksova edhe më herët, do t'i kishim votuar këto marrëveshje në rast se do të kishim një konsensus me pozitën sa u përket disa pikave për të cilat kërkuam realisht mirëkuptimin e tyre.

Mirëpo, meqenëse tash jemi në këtë situatë çfarë jemi, ne do të përmbahemi nga votimi. Mirëpo është me rëndësi të dihet se çka ka ndodhur, që atëkohë në opozitë si kryetar i Komisionit dhe tash ministër, ka ndryshuar qëndrimin në raport me këto marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami. Abdullah Hoti e ka fjalën në emër të Grupit të LDK-së.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Marrëveshja është e dobishme pa asnjë dyshim. Nuk është e re, është marrëveshje që ju e keni negociuar në disa Qeveri, është diskutuar për rëndësinë e furnizimit me ujë, e stabilitetit në këtë sektor. Edhe në Qeverinë e kaluar është nënshkruar në korrik të vitit 2020, ju atëherë keni qenë kryetar i Komisionit për Buxhet dhe e keni kundërshtuar, për faktin, nëse ju citoj drejt: që pak më shumë se 50 për qind e kësaj kredie, apo 25 milionë euro shkon për trajnime, për ngritje të kapaciteteve etj., dhe më pak se 50 për qind shkon për investime kapitale.

Tani unë nuk i jap vetes të drejtë të them a është mirë apo jo, sepse ekspertë të fushës e kanë vlerësuar, e kanë negociuar, është kryesuar prej Ministrisë së Financave ai komision, por në komision ka pasur persona të sektorit përkatës dhe e kanë parë arsyeshmërinë që na duhet një marrëveshje e tillë. Ju atëherë e keni kundërshtuar, dhe ju tash prejse e keni marrë detyrën si ministër i Financave, keni pasur plotësisht të drejtë që ta ktheni prapa këtë marrëveshje dhe ta rinegocioni dhe ta sillni në termat që ju mendoni që duhet të jetë, ose për të qenë konsistentë në ato që keni thënë kur keni qenë në opozitë, sepse atëherë as ne s'i kemi bërë as kur kemi qenë në Qeveri, s'i kemi pasur 80 vota, as ju nuk i keni sot 80 vota, po duhet të bindet opozita për arsyeshmërinë e atij qëndrimi që keni mbajtur.

Nëse mendon që keni gabuar, ju nuk po e thoni, po duke qenë se e keni sjellë të njëjtën marrëveshje, kjo në mënyrë implicite nënkupton që e pranoni që keni mbajtur një pozicion gabim atëherë. Se këto arsyetimet që i thatë në foltore që do të negocioni me donatorë të tjerë, për të sjellë financa shitesë, ajo nuk është e qëndrueshme, sepse ne sot kur votojmë, e votojmë vetëm këtë marrëveshje për 25 milionë euro, që është më shumë se gjysma jo për investime kapitale dhe ka edhe nene ligjore që e përcaktojnë se si duhet të përcaktohet. Pra, këto janë argumentet e grupit tonë parlamentar lidhur me këtë marrëveshje. Ne besojmë që marrëveshja është e mirë. ju nuk keni besuar që është marrëveshja e mirë, sot po e sillni të njëjtën marrëveshje. Po harroni që keni gabuar, dhe ne shkojmë përpara, ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Pas dëmit të cilin ua bën studentëve dhe profesorëve, duke e mohuar një marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas dëmit që ia bën edhe Forcës së Sigurisë, ushtrisë së Kosovës, tash kthetrat e opozitës janë drejtuar nga qytetarët e Gjilanit dhe Anamoravës. Është me të vërtetë për keqardhje që kjo opozitë sot është zgjuar nga gjumi me një dell aq destruktiv. Nuk e di se çka ju ka bërë aq keq.

KRYETARI: Kujdes gjuhën, z. Abrashi!

ARTAN ABRASHI: Aq keq që ju ka bërë Kosova, sa të vini të bëni dëm në këto përmasa. Sido që të jetë, duhet ta theksojmë edhe një herë se po devijohet e vërteta. Arsyeja e mosmbështetjes së këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare në kohën e Qeverisë së kaluar, ka qenë pikërisht mungesa e legjitimitetit që ne e kemi kontestuar në çdo ditë të lume në atë kohë. Dhe kjo mungesë e legjitimitetit është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese kur e ka shpallur Qeverinë e parafolësit të paligjshme dhe jokushtetuese dhe të dyshimtë. Prandaj, të mos i ngatërrojmë temat.

Lëvizja Vetëvendosje nuk ka qenë asnjëherë kundër asnjë marrëveshje ku për interes kanë pasur qytetarin, e veçanërisht zonës së Anamoravës për çka edhe po flasim për këtë projekt. Qëndrimi ynë ka qenë puro pastër politik dhe ka qenë në të drejtën tonë që ta kontestojmë, në këtë rast sponsorizuesin e çfarëdo vendimi që ka ardhur këtu në Kuvend.

Prandaj, duke i ngatërruar këto tema, këta synojnë t'i hedhin hi opinionit publik. Le të vazhdojnë këta me vendime të dëmshme kundër interesit të Kosovës, kundër interesave të qytetarëve. Por, që ta ndëshkojnë një rajon të tërë, Anamoravën, në të cilën janë thirrur aq shumë, me thatësi, me mungesë të ujit, konsideroj që kemi të bëjmë me minimumin e kredibilitetit politik që sot mund ta përfaqësojë një forcë politike në Kuvend. Kjo është shumë për keqardhje. Gjithsesi, Kosova nuk do të jetë peng i kësaj bllokade, të cilën synon ta bëjë opozita. Unë uroj që ky dëll destruktiv në të cilin jeni zgjuar sot, të mbarojë në ditët në vijim dhe se më në fund institucioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës të kthehet në rrugën e mbarë, duke kryer funksionet e veta kushtetuese ligjore, pra që në këtë rast janë miratimi i vendimeve që kanë të bëjnë me lehtësimin e jetës së përditshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Edhe një herë, mbajeni inatin me Lëvizjen Vetëvendosje deri në pikën e fundit. Nuk na bën përshtypje, nuk na ka bërë asnjëherë përshtypje, porse ky inat të manifestohet në dëm të qytetarëve, është absolutisht e papranueshme.

KRYETARI: Një replikë për fjalën e deputetit Abrashi e ka kërkuar zonja. Po e ka të drejtën znj. Hykmete Bajrami që ta ketë diskutimin e vet. Veçse znj. Bajrami duhet ta keni parasysh që nuk e keni pasur radhën në qoftë se doni kështu diskutim. Po, në rregull, po e bëjmë një përjashtim. Duhet t'i dalloni, për arsye se radhën e ka PDK-ja tash nëse është për diskutim. Në rregull, vazhdoni.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Po besoj i kam dhjetë minuta të flasë në kuadër të diskutimit. Fillimisht po i përgjigjem z. Abrashi. Ta quash opozitën e sotme, ta quash LDK-në antiamerikane dhe destruktive, përnjëmend duhet të kesh kujtesë jashtëzakonisht të shkurtër.

Nuk e di a i kujtohet z. Abrashi që ky Kuvend nga Lëvizja Vetëvendosje sa herë është mbushur tym dhe flakë. A ju kujtohet që dy milionë kosovarë, qytetarët të këtij vendi i keni lënë pa viza? Veç pse keni qenë në opozitë, për asgjë tjetër.

KRYETARI: Për tym po, a për flakë s'po më kujtohet.

HYKMETE BAJRAMI: A ju kujtohet që i keni gjuajtur policët, me të cilët sot po krenoheni që i keni shkatërruar 42 banda kriminale. I keni gjuajtur me molotov policët. Vetëm për shkak se keni qenë në opozitë dhe për asgjë tjetër. A ju kujtohet që keni thyer xhama të institucioneve? I keni trembur investitorët e huaj, vetëm pse keni qenë në opozitë. Sot ju e dini pse po refuzojmë ne për t'i votuar marrëveshjet ndërkombëtare. Ne në mëngjes, në grup parlamentar kemi marrë vendim që t'i mbështesim të gjitha, por ishte sjellja juaj destruktive në momentin kur e morët mbështetjen e Listës serbe për t'i futur pikat me mocion, atëherë ne vendosëm që sot të mos i votojmë ato të cilat në mëngjes deshëm që t'i votojmë.

Të kthehemi te pika tani. Ne me të vërtetë nuk jemi duke e bërë opozitën që duhet ta bëjmë. A ju kujtohet juve që e akuzonit secilën qeveri sa herë që ndalje energjia elektrike? Dhe sot ku jemi? Dilni dhe u thoni qytetarëve që të mos ngrohen me rrymë. Nuk është faji ynë. Asnjë faj nuk e kemi sa i përket energjisë elektrike. Këqyrni se fajin e gjeni në mesin tuaj. A ju kujtohet që sa keni qenë në opozitë, keni premtuar se do t'i ulni edhe çmimet? Por sot nuk po i ulni, ato janë ngritur në maksimum.

Por të kthehemi te pika. Zotëri ministër Murati, po ju rikujtojmë edhe njëherë që e keni sjellë marrëveshjen e njëjtë të cilën nuk e keni votuar. Ekzistojnë transkriptet, me siguri janë edhe videot diku. Nuk e keni votuar për shkak të pjesëmarrjes së madhe të asistencës teknike. Dhe sot pikërisht të njëjtën marrëveshje e keni sjellë. Dhe qysh u arsyetuat? Thatë që Agjencia Zhvillimore Zvicerane ka premtuar që do ta mbështesë projektin me asistencë teknike, gjithashtu Komisioni Evropian dhe i përmendët donatorët e tjerë.

I nderuar zotëri,

Marrëveshja mbetet prapë me të njëjtat përqindje. Është prapë po ajo përqindje, mbi 50 për qind asistencë teknike dhe pjesa e mbetur investime kapitale. Pavarësisht sa e mbështet Komisioni Evropian, sa do ta japë mbështetje CDC-ja të cilët e kanë mbështetur sektorin e ujit që njëzet vite, marrëveshja mbetet e njëjtë. Në marrëveshje po të shkruan që mbi 50 për qind është asistencë teknike. E di se në atë marrëveshje është nënshkrimi im. Atëherë keni refuzuar, andaj është shumë e rrugës të dalësh dhe t'u tregosh të gjithëve që nuk është njëjtë sikur kur të jesh në Qeveri edhe sikur kur të jesh në opozitë. Të dalësh t'u tregosh dhe t'u kërkosh falje njerëzve që nuk mund t'i ulni çmimet, nuk mund t'i ndryshoni dhe t'i negocioni marrëveshjet bash qysh doni, se ekzistojnë do ekspertë atje të cilët vendosin se si zhvillohet sektori i ujit, edhe nuk është komplet në diskrecion të Ministrisë së Financave, sepse sigurisht, sikur të kishte qenë ashtu,

besoj që e kishit ndërruar, e kishit sjellë me dhjetë për qind asistencë teknike dhe 90 për qind investime kapitale.

Keni manipuluar shumë, po me të vërtetë me popullizëm i keni fituar votat, por të qeverisni nuk jeni duke mundur të qeverisni me populizëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fillimisht ministrit të drejtën për këto që u ngritën prej deputetëve. Pastaj vazhdojmë me replikë për z. Abrashi.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Çështja është kësajsoj. Në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere kemi pasur po të njëjtin diskutim me deputetin Hoti, e ka ngritur të njëjtën çështje. Kam pasur me vete edhe 'aid' të marrë nga Banka Botërore që e konfirmon këtë që sapo e thashë pra në këtë foltore. Marrëveshja, arsyeja pse nuk kanë ndryshuar komponentat është për shkak se është miratuar si e tillë në Bordin e Bankës Botërore dhe po të kthehej edhe njëherë, vonohet projekti.

Mirëpo në 'aid memoires' që kemi pranuar nga Banka Botërore, pra në nëntor të këtij viti, para një muaji, aty shkruan që pjesa e komponentit tek asistencë teknike e cila do të zëvendësohet nga Qeveria Zvicerane pra si grant, do të mund të bartet me letërkëmbim nga pjesa e komponentës së asistencës teknike të komponenta e investimeve kapitale. D.m.th. s'ka nevojë që të rikalohej edhe njëherë nëpër të gjitha procedurat e brendshme burokratike, por mund të bëhet me një kërkesë të thjeshtë që pjesa e cila e mbulohet nga donatorët dhe asistencë teknike kalon te investimet kapitale. Ka shumë tepër dallim në mes të një kredie apo një investimi 25 milionë euro dhe të kthehen 25 milionë euro dhe të një investimi 45 milionë euro, kur 25 kthehen për kredi, kurse njëzet të tjera janë grant. Ky është dallimi. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, para se të kalojmë se z. Abrashi, të drejtën e ka për një kundër-replikë fillimisht znj. Hykmete Bajrami, pastaj vazhdojmë me të tjerat.

HYKMETE BAJRAMI: Ministër, për besë nuk ishte aspak bindëse. D.m.th. marrëveshjen që e kemi përpara, prapë është marrëveshja e njëjtë. Është e njëjta përqindje e investimeve kapitale, me të njëjtën përqindje të asistencës teknike. Ju mund të vini këtu dhe mund të na flisni tërë ditën se çka keni biseduar me donatorët. Mirëpo, marrëveshjen të cilën ne e kemi sot para vetes, dhe për të cilën ju po kërkonit votat që ta mbështesim, e ne do ta mbështesim, por jo sot, për shkak të sjelljes suaj të mëparshme politike. D.m.th. është e njëjta marrëveshje që ju e keni kundërshtuar. Asgjë nuk ka ndryshuar. Për bisedat e juaja, ne nuk mund t'i përdorim ato si argumente, sepse nuk kemi asnjë memoar, as argumente të tjera dhe asgjë tjetër. D.m.th. e kemi marrëveshjen, të njëjtën marrëveshje të cilën e kemi negociuar dhe e kam nënshkruar unë. Atë e ke sjellë, të njëjtën marrëveshje që e ke kundërshtuar më herët e ke qenë në opozitë. Ky është dallimi. Keni ndryshuar ju, nuk ka ndryshuar marrëveshja.

KRYETARI: E ka të drejtën për replikë lidhur me fjalimin e mëhershëm të znj. Hykmete Bajrami, deputeti Abrashi.

ARTAN ABRASHI: Znj. Bajrami,

Ju thirreni në proamerikanizëm kur keni dashur Ujmanin t'ia falni Serbisë. Ju thirreni në amerikanizëm e proamerikanizëm kur keni dashur ta bëni Zajednicën serbe në Kosovë. Ju thirreni në amerikanizëm a proamerikanizëm, sido që ta quani, kur ju keni humbur territor të Republikës së Kosovës. Jeni thirrur në amerikanizëm kur e keni rrëzuar një Qeveri legjitime në kohë të pandemisë, e jeni bërë gaz i botës. Por nuk po thirreni në amerikanizëm kur fjala është të kalohet një marrëveshje, ku përfitojnë nxënësit, studentët dhe profesorët e Republikës së Kosovës. Po kjo është hipokrizi. E para e punës.

E dyta, Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka lënë Kosovën pa viza, po ju e keni lënë Kosovën pa 8200 hektarë tokë. Kuptojeni këtë gjë! Pra, kur e keni kaluar demarkacionin, atë akt të turpshëm, të cilin historia më e re e Republikës së Kosovës do të ju mbajë mend pikërisht edhe juve. A e keni bërë mend a që nuk e kemi bërë për interesat as të Kosovës po as për interesat e Amerikës? Edhe pyetja është ku janë vizat pra? A e kaluar demarkacionit, ku janë vizat?

Sa i përket çështjes së gazit, keni qenë rrezik ekzistencial për Kosovën. E keni kanosur vendin me instalim të një entiteti autonom serb ku në thelb ka pasur dhe ka synim zhbërjen e Republikës sonë. Në këto situata, Lëvizja Vetëvendosje ashtu siç ka thënë dhe siç ka vepruar, nëse është nevoja, uroj që kurrë jo, përsëri do të veprojë në mbrojtje të interesit nacional, respektivisht Republikës së Kosovës.

Prandaj, mos u mundoni që t'i arsyetoni veprimet e juaja të gabuara, veprime të gabuara historike.

KRYETARI: Znj. Bajrami e ka fjalën për kundër-replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Zoti Abrashi, mbrëmë e kemi festuar, dje në fakt gjatë gjithë ditës 32-vjetorin e themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Mua më vjen keq që duhet të ta përkujtoj, por po të mos ishte Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk besoj që kishe pasur ti shanse të ulesh në Kuvendin e Republikës. Ne nuk kemi nevojë të thirremi në amerikanizëm, ne e bartim vulën e miqësisë me amerikanët. Jeni ju ata të cilët po e keqpërdorni.

Sa i përket gazit dhe dëmeve që i keni bërë këtij vendi, jeni ju ata të cilët po na flisni për zhbërjen e Republikës që nuk e keni njohur deri dje. Deri dje s'e keni njohur Republikën. Nuk e keni njohur flamurin, nuk i keni njohur institucionet. Ju thashë edhe një herë, i keni gjuajtur policët me të cilët sot krenoheni, i keni gjuajtur me gaz e molotov.

Andaj, arsyeja e mosvotimit të marrëveshjeve sot, dihet.

KRYETARI: Deputeti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Kryetar, nëse më lejohet ta përdorni mikrofonin dhe kohën tuaj që t'i them dy tri çështje jashtë kësaj.

Sonte ju e dini që është Nata e Kërshëndellave dhe të bëhen gjithë këto debate në këtë natë nuk është fort mirë. Unë kisha propozuar, meqë është realisht kjo natë, të ndërpriten punimet për sonte dhe njëkohësisht t'u urojmë të gjithë besimtarëve katolikët Kërshëndellat, dhe t'u urojmë edhe atyre, po të gjithë neve, së pari paqe, e lumturi e dashuri e gjithë të mirat. Kjo si propozim, si mocion.

KRYETARI: Zoti Reçica, shumë faleminderit që po m'i kujtoni detyrat të cilat fort mirë i di.

Natyrisht, ne e patëm që sonte me një marrëveshje të punojmë deri kah ora 6 ose 7. Kjo mu duk fort e arsyeshme për sonte, meqenëse Kuvendi i ka agjendat dhe mendoj që po të punonim deri atë kohë, nuk do të cenonim as Krishtlindjet. Natyrisht, që në emër të Kuvendit dhe të gjithë deputetëve të Kosovës ua urojmë besimtarëve katolikë Krishtlindjen. Paçi begati e mbarësi të gjithë, edhe populli ynë, por edhe shtetet mike të Kosovës!

Po besoj që nuk na bënë fare dëm nëse punojmë edhe dy orë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Nëse eventualisht keni ndonjë agjendë ju personalisht më shpejt, ju lirojmë, mirëpo sa i përket Kuvendit, unë mendova që të vazhdojmë edhe dy orë dhe pastaj ma merr mendja që edhe ceremoninë e Krishtlindjes së ditës së sotme mund ta mbërrijë secili deputet në të njëjtën kohë.

Tash Abelard Tahiri. A e ke pasur për replikë, Abelard a po?

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Kam një replikë me deputetin Abrashi. Pra, unë po ia përkujtoj prapë deputetit Abrashi që po flet për një marrëveshje që e ka nënshkruar ajo Qeveri që ky e ka quajtur ilegale. Nëse qëndron në parimet e tij, duhet t'i kërkojë Qeverisë së vet që të tërhiqet prej asaj marrëveshjeje, ta rinegociojë marrëveshjen, sepse sipas tij e ka nënshkruar një qeveri ilegale dhe jo sot të njëjtën të na thonë ejani se po i shpëtoni qytetarët e Anamoravës. Me të njëjtën gjë, ka mundur t'i shpëtojë ky qytetarët e Anamoravës para një viti. Pra, këtu e keni pasur, të njëjtën. Pra, ne e dimë sa mund të devijosh prej një marrëveshje ndërkombëtare. Ato çka na thotë ministri, ato janë krejt rrethana anësore, ti do t'i respektosh, do t'i implementosh një marrëveshje ndërkombëtare që e ka nënshkruar Qeveria Hoti.

E dyta, sa i përket Qeverisë që na i kujtoi shumë e shumë sende, unë po i them veç një fjalë zotit Abrashi. Sot në këto momente kur ne po flasim, më shumë se dyzet për qind e territorit të

Kosovës është pra drita. Është pa energji elektrike. Gjithmonë ka pasur kriza të energjisë elektrike nëpër botë. Edhe para dy vitesh, edhe para tetë vitesh ka pasur, por menaxhim më efikas dhe qeverisje më efikase ka pasur. Sot s'kemi. Prandaj, sot kur ky po flet për qeverisjen e kaluar, po më vjen mirë që po e shohin qytetarët, sepse po mund ta marrë me mend çfarë reagimi ka ndaj tij dhe ndaj mazhorancës. Jo ndaj tij personalisht, po ndaj mazhorancës, kur njerëzit nga tetë orë janë pa energji elektrike. Pra pikërisht sot në regjionin e Anamoravës janë thyer zyrat e KEDS-it, sepse mbi tetë orë s'kanë pasur energji elektrike. Pse? S'ka efikasitet në qeverisje. Qeverisje joefikase. Kemi probleme të mëdha në qeverisje. Shumë probleme të mëdha. Pra, këto do t'i diskutojmë të hënën, mirëpo ne kur të hyjmë në këtë proces, kemi çka të flasim boll. Faleminderit!

KRYETARI: Z. Abrashi një kundër-replikë fillimisht, pastaj vazhdojmë me të tjerët.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit!

Zoti Tahiri, edhe një herë po e them, Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka pasur asnjëherë problem marrëveshjen dhe objektin që e trajton marrëveshja. Lëvizja Vetëvendosje ka pasur problem me sponsorizuesin e marrëveshjes. Në këtë rast, Kuvendi i Republikës së Kosovës atëkohë kishte të bënte me një palë që i mungonte legjitimiteti. Pra, palës i mungonte edhe zotësia për të vepruar. Ju jeni jurist dhe e kuptoni këtë gjë dhe rrjedhimisht çdo gjë na servohej neve në atë kohë, nuk ka pasur asnjë peshë dhe vlerë juridike. Kurse sa i përket çështjes së energjisë elektrike, meqenëse e përmendet, ju si Parti Demokratike e Kosovës, në këtë kohë krize e keni mundësinë që për herë të parë t'i kërkonit falje popullit të Kosovës për shitjen e Distribucionit elektrik për 26 milionë euro, e cila është edhe një nga shkaktarët e krizës për të cilën po flasim.

Në vend se të merreni me mua, merruni me pasojat e veprimeve tuaja, kërkonit falje, është njerëzore tekefundit, porse a ju falë populli, nuk e besoj këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën po ia japim kryetarit të Grupit të AAK-së, Besnik Tahirit.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne jemi duke i trajtuar marrëveshjet ndërkombëtare për të cilat si grupe parlamentare e kemi dhënë një pozicion politik, të cilat sot nuk do t'i votojmë për arsyet që i thamë më herët.

Unë mendoj që në qoftë se duam t'i ratifikojmë pikat tjera, ne mund të shkojmë pikë për pikë edhe në pikën 7, që është një marrëveshje tjetër ndërkombëtare, edhe në pikën 8, po ne si opozitë, sot nuk do t'i votojmë.

Andaj, është humbje kohë dhe unë propozoj që të vazhdohet tutje me tema të tjera, me votimin e drejtorit për Agjencinë Kundër Korrupsion, me votime të tjera për shkak se nuk do t'i votojmë.

Çka po ndodh? Në vend se të flasim për marrëveshjet ndërkombëtare, ne po flasim për tema të cilat nuk janë fushën e diskutimit të pikës së rendit të ditës. Andaj, në qoftë se duam të humbasim kohë në këtë temë, vazhdojmë, në qoftë se ko, vazhdoni në pika të rendit të ditës, për shkak se votat prej opozitës nuk i ke sot. Të martën do t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Tash ia japim fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tash këtu e kemi një gabim ose keqkuptim në objekt, se jemi duke folur për gjëra të ndryshme.

Ajo çka ne si deputet kemi marrë zyrtarisht dhe që e kemi para vetes është e ndryshme prej asaj që po deklaroi ministri. Ne para vetes e kemi një Projektligj për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare për mundësitë e lëvimit të ujit. Një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar, nëse kjo e saktë unë kërkoj falje dhe kërkoj që ministri të del dhe na e sqarojë, nga zonja Hykmete Bajrami, ministre dhe zonja Linda Van Gelde, po ashtu përfaqësuese e organizatës së saj.

Në këtë marrëveshje ka edhe një tabelë, pasqyrat financiar. 12 milionë euro, plus 300 mijë euro dhe në fund thotë, totali 25 milionë euro. Ministri është duke folur diçka tjetër, po thotë një marrëveshje 45 milionë euro, ndryshohen tabelat. Këto janë tabelat fikse. Këto tabela s'mund të ndryshohen në momentin që ratifikohen në Kuvend.

Kjo do të thotë se nuk do të shkojnë këto para për consulting, ku do të shkojnë. Nuk mund të shkojnë kurrkund tjetër përderisa me këtë përshkrim këto ratifikohen në këtë Kuvend. A jemi duke folur për këtë marrëveshje apo po flasim për diçka tjetër.

Ne nuk kemi në marrëveshje të amendamentuar, nuk kemi një amendament për këtë marrëveshje. Nuk po kuptoj çfarë është duke thënë ky ministër. Po i përmend 45 milionë euro. Po thotë që këto para do të shkojnë diku tjetër. Po i thotë Kuvendit, votojeni një marrëveshje e cila është obligim kushtetues të votohet me 2/3, se unë do ta shkeli. Do ta shkeli Kushtetutën dhe marrëveshjen, se do të bëj diçka tjetër. Se ma paska çuar dikush një letër, se unë mund të bëj diçka tjetër. Jo, jo, kur të ratifikohet kurrgjë tjetër përpos kësaj s'mund të bësh. Asgjë tjetër, përpos këtyre tabelave këtu që i ratifikon Kuvendi, asnjë centë s'mund ta lëvizësh.

Nuk mund të lëvizësh kurrgjë. Ose nuk je duke ditur që ta bësh tënde, ose je duke dashur që ta vësh Kuvendin në lajthitje. Nëse ke gabuar herën e kaluar, mund të kuptojmë. Të thuash, kam gabuar, kam pasur qëndrim politik, të votoni nëse mundeni, nëse s'mundeni të mos e votoni, s'kemi çfarë të bëjmë. Por, nuk mund të dalësh dhe ta mashtrosh Kuvendin kështu.

Ne kemi letra. A e kemi propozim ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të nënshkruar nga ministra e Financave, zonja Hykmete Bajrami, apo po ratifikojmë diçka tjetër, sepse në këtë marrëveshje janë tabelat financiare dhe këto tabela financiare janë specifike.

Qysh ndërrohen këto tabela, me çka i ndërron. Në momentin kur ratifikohet qysh e ndërron këtë tabelë. Qysh e ndërron këtë tabelë në momentin kur ratifikohet. Pra, ky është një veprim jashtëzakonisht antiligjor dhe antikushtetues.

Prandaj, të lutem kryetare i Kuvendit që meqenëse ministri po ashtu është i partisë suaj, konsultohuni pak me të se a jemi duke e votuar këtë marrëveshje, a keni propozuar që ta votoni këtë marrëveshje apo diçka tjetër, sepse diçka tjetër është duke u folur këtu.

Po i përmend nja 45 milionë euro, po e përmend një marrëveshje tjetër. Ne kemi tabela specifike të cilat duhet të aprovohen me 2/3, dhe besoj Sekretarin e keni aty si asistent ngjitur, kur aprovohet diçka në Kuvend, as një pikë dhe asnjë presje nuk mund të ndërrohet pa u bërë amendament që të ndryshohet, e sidomos kur bëhet me 2/3, asnjë gjë hiç s'mund të ndryshojë.

Të mos e mashtroni Kuvendin dhe vendin me këto veprime. Ndoshta sot mund të flasësh më lirshëm, se gjysma e vendit nuk janë duke parë se s'ka drita. Del kërko falje, thuaj që kam mashtruar atëherë, edhe e kryejmë këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Murati e ka fjalën, ministri i Financave.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Po besoj që fakti ose shpresa që nuk po shikojnë disa prej qytetarëve, pikërisht prej jush po shfrytëzohet, pra, për të folur gjëra të tilla. Marrëveshja për flouz negociimi është zhvilluar në Qeverinë Kurti 1, nga ministri i asaj kohe Besnik Bislimi. Këtë gjë e di zonja Bajrami.

Pastaj kur ka ardhur si ministre e ka gjetur një marrëveshje pothuajse të gatshme dhe është nënshkruar marrëveshja. Nënshkrimi është i zonjës Bajrami. Domethënë, deri këtu jemi në rregull dhe këtë e thashë edhe në fillim, edhe në hyrje e thashë.

Sa i përket mënyrës se si komunikohet me kreditorin dhe cilat janë mundësitë dhe kushtet për të lëvizur brenda komponentëve apo brenda planit të prokurimit, ato caktohen në marrëveshje. Pikërisht! Dhe, atë po e them. Po besoj që mund t'i konsultosh. Në grupin tuaj parlamentar i ke dy ish-ministra të Financave, të cilët e dinë se për çka po flas. Saktë.

Kështu që, marrëveshja që ratifikohet, siç e thashë, do të shfrytëzohet që mjetet që janë të dedikuara për asistencë teknike aq sa marrim nga donatori, të zëvendësohen dhe të zhvendosen te pjesa e investimeve kapitale.

KRYETARI: Replikë, zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Një e kemi një marrëveshje të shkruar dhe nënshkruar, pjesë e së cilës janë edhe tabelat. Asgjë aty nuk mund të ndryshohet në momentin që ratifikohet në Kuvend, asgjë hiç, as një pikë as një presje edhe nëse është gabim.

Kjo çka po thotë ministri këtu është e tmerrshme, paaftësi totale. Konsultohu me Sekretarin që e ke në krahë, a mund të ndryshohet diçka këtu. Asgjë hiç. Po del dhe po mashtron para Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nuk mund të sillesh kështu, tash je ministër. Ke mashtruar sa ke qenë këtu, thoshe, Qeveria ka bërë marrëveshje, ku mbi 50% i çon për asistencë teknike, Qeveri kriminale, e ka bërë Avdullah Hoti me Hykmete Bajramin, tash del që e paska bërë Besnik Bislimi. A po të kujtohen fjalët e tua. Këtu ke qenë ulur. Unë të kam lutur, votojeni more se është marrëveshje për qytetarët e Anamoravës. Çka është kjo sjellje kështu. Nuk mund të silleni kështu. Dil thuaj që kemi gabuar, dil thuaj që kemi nevojë që të kalojë kjo marrëveshje, në rregull është, por jo të dalësh dhe të thuash, ndryshohet, sepse nuk ndryshohet.

Ratifikohet me 2/3 dhe ajo që ratifikohet me 2/3 në Kuvend, s'ka kush që e ndryshon hiç pa e kthyer në Kuvend. Çka është ky mentalitet kështu? Mentalitet i imponimit. Ju lutem, kjo është sjellje që s'i ka shkuar në mendje kurrkujt deri sot. Qysh mund një ministër të flasë kështu.

Merre zoti kryetar dhe ia mbani një trajnim për marrëveshjet ndërkombëtare dhe respektimin e tyre, se keni qenë edhe ministër i Jashtëm. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën ia japim Bekim Haxhiut fillimisht, pastaj ministri sërish e ka të drejtën që të shpjegohet.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po përpiqem që ta kuptoj edhe esencën e diskutimit tash kur jemi veç specifikisht te një marrëveshje ndërkombëtare, e po mendoj që konsensusi i bashkëpunimit ndërmjet pozitës dhe opozitës sot, u minua nga dëshira e pozitës që t'i imponojë 12 ligje, projektligje që qëllim final e kanë harmonizimin e tyre me Ligjin për kundërvajtje.

A ia vlen ky diskutim, këto përplasje sot edhe minimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për harmonizimin të 12 ligjeve me Ligjin për kundërvajtje. Nëse vërtet e keni vullnetin që t'i kaloni

këto marrëveshje ndërkombëtare, atëherë pse i minuat nga egoja personale. Nuk do duhej që ta bënit.

Konsensusi mes pozitës dhe opozitës, edhe sot dhe sot... Nuk po të kuptoj! Urdhëro! A po dëshiron të flasësh?! Prandaj, kjo çka po kërkoni ju, është minim i marrëveshjeve ndërkombëtare për shkak të egove personale.

Këto të tjerat pastaj, këto përrallat që po i dëgjojmë sot këtu. Nuk kanë nevojë qytetarët që t'i mbyllin sot, se i keni lënë terr. Këto përralla ua keni treguar në të kaluarën, dhe është dashur që t'i mbyllin sytë që t'iu dëgjojnë. Sot s'kanë nevojë që t'i mbyllin sytë, sepse i keni lënë në terr.

KEDS-i nuk është shitur sot, edhe dje ishte i shitur, ishte i privatizuar, dhe kishte rrymë edhe para një viti edhe para dy viteve kishte, i privatizuar ishte KEK-u. Problemi është që ka keqmenaxhim. Thëngjill ka sa të duash, po s'ka ku të prodhohet rryma, sepse e keni dërguar gjeneratorin në remont në pikë të dimrit për të krijuar mundësi përtej importit, për të përfituar nga importi i energjisë, se janë kthyer në Qeveri përkthyesit e UNMIK-ut, dhe atë që e kanë bërë në kohën e UNMIK-ut me gjeneratorë dhe me agregate, po ua kthejnë qytetarëve sërish.

Kjo çka po ndodh sot është pasojë e keqmenaxhimit. Kosova ka rritur kapacitetet e saj edhe në energji, edhe...

KRYETARI: Zoti Haxhiu, te uji jemi, të lutem!

BEKIM HAXHIU: Kjo ka qenë e tejkaluar. Prandaj, i nderuar kryetar, po kërkoj prej jush që mundësisht të bëni një ndërprerje të seancës, merrni kryetarët e grupeve parlamentare le të diskutojnë, le të tërhiqet pozita nga 12 ligjet që i futi me arrogancë në rend të ditës, edhe të kthehemi t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare.

Unë po mendoj që në këtë fundvit, me rëndësishme është që qytetarëve t'ua dhurojmë marrëveshjet ndërkombëtare sesa 12 projektligje për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje që fillimin final e kanë ndëshkimin e qytetarëve dhe të bizneseve. Po mendoj që kjo është më e rëndësishme.

Merri, kryetar i nderuar, kryetarët e grupeve parlamentare, bisedo me ta, le të tërhiqet pozita nga ato 12 projektligje që s'kanë ndonjë relevancë, e të kthehemi t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Mendoj që kjo do të ishte zgjidhja më e mirë dhe kështu do të ishim të gjithë në shërbim të qytetarëve, dhe këtë fundvit ta përfundonim vërtet me një sukses të përbashkët edhe të pozitës edhe të opozitës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj. Mundësisht për ujin, zoti Zemaj nëse ka mundësi se për besë...

ARMEND ZEMAJ: Për ujin. Po mundohemi të sillemi rreth ujit pa gjuajtur ujë. Kryetar, faleminderit shumë! Mendoj që ministri duhet të kërkoj falje tri herë sot. Një herë çka ka thënë, e dyta çka tha sot edhe çka do të thotë nesër. Domethënë, për ta mbuluar krejt këtë që po e bëni edhe mënyrën se si po e bëni.

Veç duhet ta dëshmojmë që ky vend ka memorie institucionale, e nëse dikush është i papërgjegjshëm, i papërgjegjshëm është ai i cili thotë, nga sot ose nga unë fillon historia.

I kisha lutur edhe deputetët e pozitës me numër të madh, pavarësisht ideve edhe gjykimeve të mos ofendojnë deputetët për qëndrimet dhe për veprimet politike. Të mos marrin anë kush me cilin shtet perëndimor është, sepse besoj që vet janë humbës nëse hynë në atë temë.

As nuk mund të gjykojnë, as nuk mund të penalizojnë dhe as nuk mund të kenë qëllime të ndikimit në veprimet tona politike. E thashë edhe pak më herët, ne jemi deputetë dhe nuk i nënshtrohemi asnjë lloj detyrimi, e më së pak të atyre që janë të centralizuar në mendim nga lideri shpirtëror dhe shumë rrallëherë i paraqesin opinionet e veta, por janë false.

Ua shkruan dikush tjetër fjalimet atje në atë komitetin e zonës së tretë operative në Shqipëri edhe vijnë këtu me fjalime duke e ofenduar opozitën edhe deputetët e opozitës. Kështu nuk shkon, nuk bën.

Kjo marrëveshje ka histori. Ishte debatuar shumë më herët, bile ishte debatuar dhe ishte iniciuar në Qeverinë paraprake, para Qeverisë Hoti, ka vazhduar është nënshkruar, është kundërshtuar. Po kërkoni miratimin, por jo ofendime. Këtë s'mund t'ua pranojë askush dhe nuk ua pranon asnjëherë.

Andaj, kërkoni falje nuk është marre, për atë që e keni thënë, për atë që po e thoni sot edhe për atë që do ta thoni nesër në implementimin e saj.

KRYETARI: Edhe i fundit prej diskutuesve për këtë marrëveshjen e ujit është Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: Na e kemi në marrëveshje a po, ju mbani qetësi, unë i uli decibelët nëse doni!

I nderuar kryetar,
Të nderuar deputetë,
Ministra prezentë,
Media s'paska,

Ne si parti, grup parlamentar, po edhe deputetë, i përshëndesim dhe i përkrahim marrëveshjet si ajo për statusin e Forcës që ishte, edhe atë për shkëmbime akademike Fulbright, për studime e të tjera, por edhe këtë për ujërat e cila për mua po lidhte emocionalisht me një regjion të veçantë, me vendlindjen e bashkëvendësit e heroit Agim Ramadani, Rexhep Zeka e shumë të tjerë.

Prandaj, ne të gjitha këto i mbështetim. Kjo marrëveshje po ma kujton një situatë kur deputeti, nëse s'gaboj Lushtaku, ka bërë luftë që ta sigurojë kalimin e një amendamenti për ujin dhe zgjidhjen e çështjes së ujit në Skenderaj, në Drenicë.

Ju zotërinj të opozitës që nga fillimi sot, por edhe që nga 14 shkurti apo dita e dashurisë për pushtetin, po veproni mbi arrogancën e numrave. Keni harruar se kompromis brenda-parlamentar është mjete demokratik për të shtyrë përpara çështje me interes për vendin edhe për qytetarët.

Të mos harroni se në emër të kësaj arrogance i keni hedhur poshtë mbi 80 amendamente e ligje në Ligjin e buxhetit, pikërisht mbi këtë praktikë të gabuar. Ju zotërinj e zonja të LVV-së kurrë të mos e harroni këtë, të gjitha ato amendamente nuk kanë qenë të paarsyeshme.

Kjo është një praktikë e gabuar dhe fyese edhe ndaj qytetarëve edhe ndaj Kosovës, por edhe ndaj votuesve tuaj. Nuk është e mundur që asnjë nga to të 80-tat nuk ka qenë i pranueshëm, aq më tepër disa që kanë pasur më shumë karakter edhe komponentë morale.

Prandaj, ju po tregoni një papjekuri politike, por edhe mungesë vizioni. Andaj, ta lini këtë praktikë që nuk na bën nder, se deputeti dhe zëri i tij është zëri i qytetarëve. Zërat që po i lëshojmë ne në Kuvend nuk janë për deputetë.

Vërtet se qytetarët nuk i dëgjojnë këto grimasa se është e rregulluar teknikisht kjo punë, por duhet të na brejë ndërgjegjja se jemi këtu për qytetarët dhe në shërbim të tyre dhe në të mirën e tyre.

Të lirohemi nga mendësia të bëni punë kuantitative, si arritja e normës për numrin e ligjeve në Kuvend, por fokusohuni në atë se çfarë ato ligje e marrëveshje rregullojnë në jetën e qytetarëve. Mendoj se kjo duhet të jetë motoja që do ta shtynte secilin nga ne drejt një kompromisi që nuk i bllokoi këto ligje, projektligje e çdolloj marrëveshje tjetër që bëhet për të mirën e qytetarëve.

Nëse vazhdojmë kështu, atëherë të më besoni se në ndërrijen tonë secilin prej nesh duhet ta brejë ndërgjegjja për mënyrën se si po funksionojmë.

Unë e kam theksuar një herë se në Republikën e letrave, Ismail Kadare i jep rëndësi hapësirë të madhe thënies: “Për inati sime re, vdektë im bir”. A është turp që të na udhëheqë neve si

përfaqësues të popullit, si zë i atyre qytetarëve që na kanë votuar dhe përfaqësues të shtetit tonë kjo aksiomë kob ndjellëse. Faleminderit!

KRYETARI: Unë po shpresoj që duke ia dhënë fjalën edhe Eliza Hoxhës, më në fund do t'i kthehem ujit, apo jo zonja Hoxha?

ELIZA HOXHA: Te uji do të rri. Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë! Ndoshta që të lidhem me krejt çka u fol dhe çka ndodhi në seancën e sotme. Sinqerisht, edhe kalimi i 12 mocioneve, po flas personalisht vetëm për Ligjin për odat e arkitektëve, për neve është shumë e vështirë, personalisht për mua që kam kërkuar shumë sqarime nga ministri, në leximin e parë, dhe ligji na vjen sot këtu dhe i vjen vetëm shefit të grupit parlamentar, dhe si do të votoj unë, edhe nëse duam të votojmë, pa e parë atë ligj. Çka është ndryshuar në atë ligj, si e para.

Por, po kthehem te uji dhe te brenga që do të duhej ta kishim ne si pozitë dhe opozitë së bashku, mirëpo në fakt ka diçka me hile në këtë sallë.

Nëse uji është i rëndësishëm, nuk është i rëndësishëm veç si marrëveshje ndërkombëtare. Ne e patëm rastin në seancën e kaluar kur kaluam buxhetin, dhe amendamentet u refuzuan pikërisht për çështjen e ujit. Dhe, nëse një amendament për ujin nuk hyn në buxhet, e ka qenë ai projekt në buxhet dikur, dhe sot krekoseni prapë ju se ne po bllokojmë një marrëveshje ndërkombëtare, në fakt po flasim për ujin, goftë marrëveshje ndërkombëtare, e goftë buxhet i Kosovës.

Për mua është brengosëse. Situata e sotme është në fakt reagim ndaj mënyrës së sjelljes së pozitës, në fakt arrogancës së numrave që po vjen në shprehje. Ky Kuvend duhet t'u shërbejë qytetarëve dhe ne këtu jemi për t'i luajtur rolet tona, jo për të bllokuar.

Andaj, nëse mendoni që edhe në buxhet kur keni bllokuar amendamentet e opozitës, dhe sot krekoseni që po bllokojmë marrëveshje ndërkombëtare. Ne sot po distancohemi, thjesht, po rezervohemi vetëm për faktin e mosbashkëpunimit total me opozitën në këso çështje. Kaq desha të them dhe mendoj që nëse flasim për një demokraci, pavarësisht përpjesëtimeve të numrave, mendoj që është shumë e rëndësishme që ta kuptoni që përnjëmend jeni në pozitë, nuk keni nevojë që të flisni dhe ta luani rolin e opozitës, sepse jeni në pozitë, dhe në fund fare ta kuptoni që kompromiset, dialogimi, është kulturë e demokracisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministrin ia japim fjalën edhe pastaj hyjmë në votim.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Pra, vetëm edhe një herë përfundimisht për të hequr çdo dilemë. Megjithëse, i kërkoja deputetit Gashi që të konsultohej me kolegët e vet që kanë qenë ish-ministra të Financave, nuk e bëri një gjë të tillë.

Kjo që po kërkohet, pra, është neni 5 në marrëveshje, ku thuhet që përfaqësuesi i pranuesit, në këtë rast pranuesi është Republika e Kosovës sipas marrëveshjes, është ministri i Financave, i cili mundet që në emër të pranuesit të pajtohet për revidimin e cilitdo provizion apo klauzolë që është e shkruar në anekset scadels të kësaj marrëveshjeje.

Pjesë e anekseve janë edhe ato tabelat që i përmendi zoti Gashi.

Pra, ndryshimi mund të bëhet. Kjo është pajtimin e vet Bankës Botërore, por tjetër gjë është nëse vetëm duam të gjejmë arsyetime. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, mund të hyjmë në procesin e votimit të kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare. I lusim të gjithë deputetët që të kthehen. Uluni ju që jeni në këmbë, ju lutem!

Të nderuar deputetë!

Jemi 87 deputetë për momentin në sallë. Po hyjmë në procesin e votimit të Projektligjit nr. 08/L-096 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, lidhur me financimin e Programit “Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit”.

Kush është për këtë marrëveshje? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konsideroj që për këtë marrëveshje nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të votave, sepse një pjesë e deputetëve nuk kanë votuar.

Pra, i kemi 67 vota për këtë marrëveshje, 4 kundër dhe asnjë abstenim. Si i tillë, nuk ka pasur kuorum për t’u votuar në Kuvendin e Kosovës.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-100 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian, në njëërën anë, dhe Kosovës, në anën tjetër, për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit Horizon Europe - Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim ka kërkuar që Kuvendi ta shqyrtojë Projektligjin nr. 08/L-100 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit Horizon Europe - Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin, dhe që kjo të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të përcaktuara me nenin 56, paragrafi 1, i Rregullores së Kuvendit. Për këtë arsye po ia japim fjalën që ta propozojë këtë, le të themi, mocion, kryetarit të Komisionit Funkcional, deputetit Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Po, është e vërtetë, bëhet fjalë për Horizon Europe, njëri prej programeve më të rëndësishme dhe më të pasura të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit, shkencës dhe në përgjithësi veprimtarisë shkencore, diku rreth 95 miliardë euro dhe kjo është një mundësi për Kosovën që do të duhej të shfrytëzonte medoemos.

Ne e kemi proceduar me kohë si projektligj dhe po shpresojmë që vullneti i artikuluar në komision nga deputetët e pozitës dhe opozitës të shprehet edhe në seancë, ashtu që të bëjmë një procedim sa më të shpejtë, në mënyrë që projektet për të cilat është aplikuar gjatë vitit 2021 dhe të cilat, me gjasë, me shpresë dhe me urimin që do të fitohen të mos shtyhet ekzekutimi i tyre për më tutje. Kështu që u bëj thirrje deputetëve që me një shmangie të procedurës të procedojmë me urgjencën e nevojshme këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, çështja, siç po e shihni, është që nëse duam të trajtojmë në seancë këtë marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare para 30 dhjetorit, duhet t'i shmangim afatet.

Tash po votojmë për shmangie që të mund ta votojmë këtë marrëveshje ndërkombëtare, që të mund ta përfshijmë në proces të votimit. Ju lutem, më njoftoni se sa deputetë jemi të pranishëm! Do të votojmë me 2/3!

Kemi deputetë të mjaftueshëm. 89 deputetë po votojmë tash. Së paku 89 janë të pranishëm, te shohim sa po votojmë. Kërkoj që ta nxjerrim në votim propozimin për shmangie të afateve për trajtimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare, këtë e dëgjuat nga kryetari i komisionit.

Kush është për këtë propozim? Kush është kundër? Kush abstenon?

89 deputetë paskan marrë pjesë në votim, pra të gjithë deputetët kanë votuar. 66 kanë votuar për, 23 kundër, asnjë abstenim. Pra, mund të procedojmë me trajtimin e kësaj marrëveshjeje.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim e ka trajtuar këtë marrëveshje në formë të projektligjit dhe ia ka rekomanduar seancës plenare miratimin e tij bashkë me amendamentin e propozuar. E ftoj ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, që të na e prezantojë këtë projektligj.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore, më 7 dhjetor 2021 kemi lidhur marrëveshje në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Komisionit Evropian për fitimin e statusit të asociuar për Republikën e Kosovës për programin Horizon Europe.

Me këtë marrëveshje Kosova fiton statusin e asociuar në program me të drejta të plota, krahas 17 vendeve të tjera joanëtare të BE-së, ku përfshihen vendet e Ballkanit Perëndimor. Statusi i asociuar do të thotë më shumë mundësi për subjektet juridike dhe individë nga Kosova për pjesëmarrjen në programet kërkimore evropiane. Me këtë rast Kosova bëhet pjesë aktive e hapësirës evropiane të kërkimit, duke përfituar nga pjesëmarrja në një ekosistem të përbashkët panevropian të kërkimit dhe inovacionit. Pa dyshim që ky është një lajm shumë i mirë për gjithë komunitetin shkencor dhe inovativ në vend. Horizon Europe është programi kryesor i Bashkimit Evropian për financimin e punës kërkimore dhe inovacionit me një buxhet të përgjithshëm prej 95,5 miliardë eurosh.

Programi është shtatëvjeçar dhe do të zbatohet në periudhën 2021-2027. Më lejoni t'ju informoj se subjekteve juridike nga Kosova u është lejuar të aplikojnë edhe në thirrje të vitit 2021, ndërsa fituesi do të mund t'i realizojë projektet e tyre pas ratifikimit të marrëveshjes nga ana e Kuvendit të Kosovës, për çka ju lus që të votoni pro kësaj marrëveshjeje.

Sot, pra para jush e keni këtë marrëveshje të rëndësishme për vendin tonë, bashkë me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes. Kushtet e marrëveshjes për Kosovën janë të njëjta sikurse edhe për vendet e tjera me status të asociuar, ndërsa kontributi ynë financiar do të përcaktohet në bazë të bruto produktit vendor dhe performansës së aplikuesve nga Kosova, siç është përcaktuar edhe në aneksin e parë të marrëveshjes.

Vlerësojmë se për dy vjetët e para ky kontribut për ne do të jetë rreth 650 mijë euro, ndërsa urojmë që në të ardhmen të rritet si rezultat i performansës së mirë të ekonomisë sonë dhe të aplikuesve nga Republika e Kosovës. Përmes këtij kontributi ne sigurojmë një financim stabil të punës kërkimore dhe inovacionit në Kosovë, pasi subjektet tona juridike fitojnë një qasje në fonde dhe partneritete evropiane që është parakusht për një produktivitet më të lartë dhe rritje të cilësisë në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes në mbledhjen e 47-të të saj më 7 dhjetor. Ndërkaq, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, ashtu siç e përmendi dhe kryetari Gola, e ka mbështetur unanimisht në mbledhjen e datës 17 dhjetor.

Duke pasur parasysh se është e rëndësishme që fituesit potencialë të mund t'i realizojnë projektet e tyre edhe brenda këtij viti, pra vitit 2021, ju lus, të nderuar deputetë, që të votoni pro projektligjit të propozuar, në mënyrë që kjo marrëveshje Kosovë-BE t'i prodhojë efektet e saj juridike. Faleminderit!

KRYETARI: Tash po ia japim fjalën edhe kryetarit të Komisionit për Arsim, deputetit Ardian Gola, ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

ARDIAN GOLA: Po, kryetar, faleminderit!

Po ashtu, sikurse e thashë, më 17 dhjetor ne kemi mbajtur mbledhjen e rregullt dhe kemi proceduar këtë projektligj. Ka pasur vullnet të përbashkët të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe është votuar kështu konsensualisht, edhe amendamentet, të cilat janë përmendur e të cilat janë Marrëveshje në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, me pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Horizon Europe, Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin, aneksi 1, rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Kosovës në programin Horizon Europe 2021-2027, aneksi dy, lista e programeve, projekteve dhe veprimeve ekuivalente dhe pjesëve të tyre të Kosovës. Aneksi tre, menaxhimi i shëndoshë financiar, mbrojtja e interesave financiare dhe rikuperimi.

Rrjedhimisht, Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport në këtë mbledhje ka shqyrtuar Projektligjin nr. 08/L-100 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet BE-së, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Horizon Europe - Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin. Komisioni ka vlerësuar se me këtë projektligj Kosova do të marrë pjesë si një vend i asociuar dhe do të kontribuojë në të gjitha pjesët e programit Horizon Europe, andaj marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, ky komision i rekomandon Kuvendit miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Për të diskutuar, e nderuar deputete, në emër të Grupit të Vetëvendosjes, a po? Deputetja Arjeta Rexhepi!

ARJETA REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Marrëveshja në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Horizon Europe – Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin themelor, është edhe një partneritet i ri.

Ky partneritet evropian adreson disa nga sfidat më urgjente të Evropës përmes iniciativave të bashkërenduara të kërkimit dhe inovacionit. Duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përparësitë e Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit dhe inovacionit, që kërkojnë masë kritike, vizion afatgjatë dhe rëndësinë e përfshirjes së vendeve të asociuara në ato partneritete. Duke pasur parasysh se kërkimi dhe inovacioni janë dëshmuar si instrumente për bashkëpunimin dhe financimin e projekteve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që mundësojnë qasje të ndërsjellë në përsosmëri, njohuri, inovacion, rrjet dhe burime kërkimore, ka ofruar mundësi të vlefshme për zhvillimin njerëzor, duke shtuar mundësitë e suksesit në gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për sfidat rajonale dhe globale.

Objektivat e zonës së përtërirë evropiane të kërkimit janë që të ndërtojnë një zonë të përbashkët shkencore dhe teknologjike, të krijojë një treg për kërkimin dhe inovacionin, të nxisë dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis universiteteve dhe të bëjnë shkëmbimin e praktikave të mira dhe karrierave atraktive e kërkimore. Duke pasur parasysh që qëllimet e përbashkëta, vlerat dhe lidhjet e forta të palëve në fushën e kërkimit dhe inovacionit dhe, duke e njohur dëshirën e përbashkët të palëve për të zhvilluar, forcuar, stimuluar dhe zgjeruar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e tyre, Kosova është përfituese e shumëfishtë me këtë marrëveshje.

Andaj, me votimin e kësaj marrëveshjeje Kosova do të marrë pjesë si një vend i asociuar dhe do të kontribuojë në të gjitha pjesët e Programit Horizon Europe- Korniza e Programit për kërkimin dhe inovacionin. Duke pasur parasysh të gjitha këto aspekte, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë nismë dhe u bëj thirrje edhe grupeve të tjera parlamentare ta përkrahin këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të PDK-së, Eliza Hoxha e ka fjalën!

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Parimisht, jo vetëm unë, po si grup parlamentar normalisht që kemi pasur në mendje ta votojmë edhe këtë marrëveshje, por që, për shkak të situatës që është krijuar këtu, sot ne e kemi thënë edhe më herët, e prononcoi edhe shefi i grupit parlamentar që në raport me të gjitha marrëveshjet sot do të rrimë të rezervuar, përkundër që personalisht e di impaktin e këtij programi dhe kësaj marrëveshjeje në fushën kërkimore dhe atë të inovacionit në nivel të shoqërisë kosovare.

Prandaj, ky është qëndrimi ynë për sot dhe besoj që seancat në vijim do të kemi një komunikim më ndryshe. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe deputeti Jahja Kokaj është paraqitur për të diskutuar.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Desha të theksoj faktin që inovacioni, shkenca, teknologjia duhet të jenë pjesë e jetës akademike dhe se në mënyrë simbiotike duhet të bashkëveprojnë në qoftë se dëshirojmë të kemi universitete kredibile.

Fatkeqësisht, ne nuk kemi universitete kredibile në Kosovë dhe po e them, fatkeqësisht, ngase kur është një fatkeqësi, atëherë dikush të ketë faj e faji është jetim. Mua ma merr mendja që faji jemi të gjithë njerëzit që janë ndoshta këtu në këtë dhomë, në këtë Parlament, ose të gjithë ata që kanë qenë këtu në këtë Parlament pas luftës. Çdo lëvdatë për kontributet e tjera, kurse sa i përket shkencës, inovacionit dhe teknologjisë, pothuajse asgjë s’u bë, po them “asgjë”, meqë s’ekziston

asnjë bërthamë shkencore, nuk ekziston asnjë qendër ekselente për hulumtime shkencore e nuk ekziston zhvillimi i mendimit shkencor institucional. Çdo lëvdatë njerëzve individual dhe talenteve kosovarë, të rinjtë, të cilët janë të shumtë dhe me potenciale të larta, por një aktivitet institucional që nga paslufta ka munguar dhe akoma mungon.

Në këtë kontest, ju kisha lutur që t'i tejkalojmë këto inate e teke dhe ta votojmë këtë ligj, i cili është shumë me rëndësi, për arsye se në vitet e '70-'80, kur unë isha hulumtues i ri, ne kemi pasur Bashkësinë shkencore, nga e cila fitonim projekte, të cilat në mënyrë komplementare bashkëpunonin dhe bashkëvepronin në mënyrë shpeshherë edhe konkurrenca me Evropën, Amerikën dhe vende të tjera të botës. Po jua kujtoj emrat e profesor Musa Haxhiut, Osman Imamit, Alajdin Abazit, që janë figura të ndritshme, të cilat duhet të jenë në historinë e lavdishme shkencore kombëtare, por që të atillë nuk po gjenerojmë, ngase nuk kemi kurrfarë aktiviteti material. Po ju them që pa laboratorë shkencorë, ju e dini që çmimi Nobel nuk jepet për gjërat teorike ekskluzivisht matematikore, dhe në qoftë se nuk është e verifikuar në mënyrë eksperimentale ekzistenca e tyre, jo vetëm që është e dyshimtë, por edhe nuk pranohen fare.

Në këtë kontest, konsideroj që është e domosdoshme të krijojmë bërthama të këtilla shkencore dhe se nëpërmes këtij programi Horizon Europe është një shans ideal që të fillojmë një aktivitet të mirëfilltë, një aktivitet që të ndërtojmë bërthama shkencore, të cilat në radhë të parë ushtrojnë të rinjtë tanë, domethënë kandidatët tanë, të cilët duan të merren me shkencë, hulumtime se si shkruhen projektet shkencore. Ne flasim për shkrimin, por fatkeqësisht në Kosovë mungon komponenti në universitet tona edhe i mendimit shkencor, mungon komponenti dhe potenciali i të shkruarit shkencor. Për mendimin shkencor, shkrimet shkencore janë një teknikë e veçantë, është një metodologji e veçantë, e ne flasim për metodologji shpeshherë boshe, poshtë e përpjetë, thashë e thëna, por në qoftë se duam të shkruajmë një projekt, i cili është i artikuluar në mënyrë shkencore dhe premtion rezultate shkencore, këtë nuk mund ta bëjnë ekipet tona sot.

Prandaj, diku duhet të nisët gjithmonë dhe kjo nismë ma merr mendja që është e mirëseardhur dhe se votimi juaj nëse është pro, nuk do të shprehte teket partiake, por me të vërtetë ajo që është themi, oksigjen apo ujë për mendjen shkencore të të rinjve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Në radhë për diskutim është deputetja Albena Reshitaj.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Atëherë, edhe si nënkryetare e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Sport dhe Kulturë, është e vërtetë që ne si komision e kemi përkrahur këtë marrëveshje dhe u diskutua nga kolegët, nga fjala e tyre për rëndësinë që ka kjo marrëveshje. E kuptoj në dy bisedat që i bëri profesori Kokaj, sepse profesori Kokaj nisët prej zhvillimit ndoshta të madh, për shkak se çdo shkencëtar i ka pritjet e mëdha të vendit të vet, të shtetit të vet, për të arriturat shkencore.

Gjithashtu, edhe kolegu, Fitimi, që nga zhgënjimi besoj edhe ai e ka thënë, meqë është pjesë e Universitetit të Prishtinës, që i kemi punët ashtu siç i kemi, por unë sërish konsideroj që Kosova dhe Universiteti i Prishtinës ka avancuar, ndonëse në mënyrë solide, nëse mund ta themi dhe viteve të fundit ka filluar edhe me rregullore të reja, me platforma të avancuara, të mundohet me kapacitetet që ka të bëjë ndryshim progresiv aty ku duhet të jemi si vend, edhe universitet publik duhet ta kenë vendin e merituar, ashtu edhe universitetet e tjera në vend.

Unë konsideroj që kemi hapësirë, kemi mundësi, por që duhet punë edhe mendoj që politikëbërja në Kosovë, vendimmarrësit duhet të përkrahin ata që me të vërtetë e meritojnë, që kanë kapacitet, kanë bazë për t'u avancuar, e duke avancuar kuadrot, ndihmojmë edhe në ngritjen e cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës. Kosova ka mundësi, këto marrëveshje ndihmojnë, përkrahin, por është shumë e rëndësishme transparenca gjatë implementimit të tyre, transparenca maksimale dhe të arrihen njerëzit, të përkrahen njerëzit meritore që me të vërtetë kur kthehen, të japin kontributin në vendin e tyre.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që këta individë, të cilët do të arrijnë të përkrahen nga këto mundësi financiare, të mos lihen nga shteti në rrugë, si në të kaluarën disa, për të cilët kam informacione, po të kenë mundësi të inkuadrohen në institucione shtetërore të vendit dhe atë njohuri shkencore që do ta marrin, ato mundësi që do t'i realizojnë, qoftë edhe këtu, përmes programeve të ndryshme, të arrijnë që universitetet e vendit tonë t'i kenë si vlera dhe merita.

Prandaj, sërish po e potencoj, sepse nevojitet sidomos për shkencëtarët e rinj, për profesorët e rinj, motiv sidomos nga kjo sallë ku ne jemi sot, po debatojmë dhe po mundohemi ta përkrahim një marrëveshje të tillë. Motiv, përkrahje, që të ecim shpejt, sepse edhe ashtu jemi shumë prapa. Edhe një herë, nuk mund të jem kundër një marrëveshjeje të tillë, ndonëse jam pjesë e opozitës, sepse nuk do të jetë e ndershme brenda komisionit të votoj pro, e tani këtu të votoj kundër. Prandaj, nuk mund të jem kundër një marrëveshjeje të tillë në këtë moment. Faleminderit!

KRYETARI: I dëgjuat të gjitha diskutimet e deputetëve.

Të nderuar deputetë, kjo marrëveshje e ka një amendament të propozuar. Fillimisht, ju kërkoj që të përgatitemi për votimin e amendamentit numër 1 të kësaj marrëveshjeje.

Sa deputetë jemi? Besoj se ka kuorum, duhet të jenë mbi 80 deputetë të pranishëm. 85 deputetë i kemi në sallë.

Të nderuar deputetë,

Kush voton për amendamentin numër 1 të marrëveshjes? Kush është kundër? Kush abstenon?

Nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm. Kanë votuar vetëm 57 deputetë. 55 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim. Nuk ka arritur të votohet ky amendament. Si rrjedhim, nuk mund të shkojmë as në votimin e marrëveshjes, kështu që kalojmë te pika tjetër.

8. Shqyrtimi i Projektligjit 08/L-105 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa kreative (2021-2027)

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Arsim ka kërkuar nga Kuvendi që shqyrtimi i kësaj marrëveshjeje të bëhet me shmangie nga afatet procedurale. Kështu që, sërish e ftojme kryetarin e Komisionit për Arsim, deputetin Ardian Gola, që ta bëjë këtë propozim për shmangie nga afatet procedurale.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Njëjtë, së bashku me Projektligjin për Horizon Europe, në të njëjtën ditë e kemi pasur në rend dite edhe Projektligjin për Creative Europe dhe ka pasur vullnet të përbashkët politik edhe të pozitës, edhe të opozitës që të procedohet me urgjencë, pasi që ratifikimi i këtyre marrëveshjeve këtë vit do të pasojë proceduralisht ekzekutimin e këtij programi për vitin 2022. Andaj, me qëllim që të realizojmë një objektiv të tillë, kërkojmë po ashtu që të bëjmë një shmangie të procedurës në seancë, në mënyrë që ta ratifikojmë këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar, a jemi mbi 80 deputetë sërish? Nuk është e thënë 80, por duhet ta marrim vesh se sa mbi 60 jemi, meqenëse shmangia nga procedurat bëhet me 2/3-at e të pranishmëve.

Ju lutem, deputetë, nëse mund të uleni nëpër vendet tuaja, në mënyrë që ta dimë saktë sa jemi, meqë do të votojmë tash për shmangien e procedurave. 86 deputetë janë të pranishëm.

Ju lutem, kush është për propozimin e Komisionit Funkcional që të shmangen procedurat për trajtimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare në këtë seancë plenare?

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

70 deputetë kanë votuar, 64 për, 6 kundër, asnjë abstenim. Kalon ky propozim nga Komisioni Funkcional, kështu që mund të hyjmë në shqyrtimin e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare. Për këtë arsye po ia japim sërish fjalën ministrit të Kulturës, Hajrullah Çeku.

MINISTRI HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryetar i nderuar!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantoj për aprovim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa Kreative.

Me këtë rast ju njoftoj se Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 6 dhjetor 2021 në Bruksel ka nënshkruar marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative 2021/2027, i cili është miratuar duke ndjekur të gjitha dispozitat ligjore të përcaktuara me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Ky program paraqet një dritare shtesë për mbështetje të skenës së pavarur kulturore dhe institucioneve publike në Republikën e Kosovës për rritje të krijimtarisë artistike dhe promovim në skenën evropiane. Ky program synon ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturor evropian, si dhe ngritjen e kapaciteteve konkurruese, bashkëpunimit, inovacionit dhe qëndrueshmërisë, përmes mobilitetit në sektorin audio-vizual evropian. Gjithashtu, ky program mëton të promovojë bashkëpunimin dhe veprimet novatore, duke synuar promovimin e një mjedisi të larmishëm, të pavarur dhe pluralist mediatik, duke nxitur kështu lirinë e shprehjes artistike, dialogun ndërkulturor dhe përfshirjen sociale.

Republika e Kosovës, përmes kësaj marrëveshjeje vazhdon pjesëmarrjen në nënprogramin Kultura, ndërsa me miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, do të bëhet pjesëmarrëse edhe në programin, nënprogramin Media, duke krijuar mundësi shtesë për komunitetin që zhvillon veprimtari audio-vizuale në Kosovë.

Kjo marrëveshje do të zbatohet në përputhje me detyrimet e palëve, sipas Konventës së UNESCO-s për vitin 2005 për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore. Krahas aspektit normativ, ne jemi angazhuar edhe në themelimin e diskut Evropë Kreative, Kosovë, Zyra kulturë, që si mandat ka ofrimin e informatave dhe promovimin e programit, asistimin e sektorëve kulturorë dhe kreativë në relacion me programin dhe për mundësitë e ofruara, si dhe çështje të tjera që lidhen me Evropën Kreative.

Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë që ka kjo marrëveshje për sektorët kulturorë dhe kreativë në vendin tonë, kërkoj mirëkuptimin tuaj për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa Kreative. Faleminderit!

KRYETARI: Tash ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Arsim, deputetit Ardian Gola.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Në mbledhjen e fundit që e kemi pasur më 17 dhjetor të këtij viti, është proceduar Projektligji për Evropën Kreative dhe kemi konsideruar që ky projektligj duhet të miratohet dhe së bashku me amendamentin numër 1, me ç'rast neni 3 i projektligjit duhet të ndryshohet, siç vijon:

Pjesë përbërëse të këtij ligji janë:

1. Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian Evropa Kreative 2021/2017,
 - Aneksi 1, rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Kosovës në programin Evropa Kreative 2021/2027;
 - Aneksi 2, menaxhimi i shëndoshë financiar, mbrojtja e interesave financiare dhe rimëkëmbja.

Në këtë mbledhje Komisioni Funkcional ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e BE-së Evropa Kreative. Ka vlerësuar po ashtu se me miratimin e këtij projektligji, Kosova përfiton me pjesëmarrje në këtë program, në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, andaj marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Ardian Gola, në emër të Grupit Parlamentar të VV-së. Urdhëro!

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Për të përforcuar atë që tashmë ministri Çeku e tha, unë po shtoj edhe faktin që si program Evropa Kreative investimet kryesore i ka të orientuara në fuqizimin e diversitetit kulturor dhe linguistik të kësaj hapësire pan-evropiane, pjesë e së cilës jemi edhe ne si Kosovë. Andaj, konsiderojmë që kjo marrëveshje Kosovës do t'ia mundësojë të jetë pjesëmarrëse si vend i asociuar në të gjitha aktivitetet e fushës së kulturës, përfshirë këtu edhe aktivitetin që mbështet krijimin e tryezave të programit, përfshirë fushën ndërsektoriale për vitet 2021 deri në vitin 2017.

Në veçanti, Kosova dhe Bashkimi Evropian marrin përsipër të krijojnë tryezë për Evropën Kreative në përputhje me Rregulloren e Evropës Kreative, duke mbështetur kështu diversitetin kulturor dhe për të nxitur konkurrencën e sektorëve kulturorë dhe kreativë.

Andaj, marrë parasysh peshën e këtij programi dhe mundësitë e shumta që i ofrohen Kosovës si vend i asociuar në këtë program, ne në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje u bëjmë thirrje të gjithë kolegëve deputetë, edhe nga opozita, që të votojnë pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, ashtu që viti 2022 të na gjejë me mundësi të hapura për të ekzekutuar këtë program.

Sa për informatë, 2021-ta tashmë na ka ikur nga mundësitë e aplikimit, andaj bëj ftesë që këtë marrëveshje ta ratifikojmë sot pa humbur kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo marrëveshje e paska një amendament! Ne duhet ta votojmë këtë amendament. Së pari, ta kuptojmë se sa deputetë jemi të pranishëm në sallë. 84 jemi. Pra, janë kushtet për të hyrë në procesin e votimit të këtij amendamenti. Po votojmë pra, për amendamentin numër 1 të

këtij projektligji, që është marrëveshja për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e BE-së Evropa Kreative. 84 deputetë jemi në sallë.

Kush është për amendamentin 1? Kush është kundër? Kush abstenon?

Nuk ka pasur kuorum për votimin e këtij amendamenti, kështu që nuk mund të shkojmë as në votimin e marrëveshjes. 58 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Nuk janë plotësuar kushtet që të trajtohet kjo.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-012 për odat e arkitektëve dhe të inxhinierëve në fushën e ndërtimit

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, së bashku me këto amendamentet që janë propozuar.

Komisioni për Buxhet e ka trajtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se projektligji, bashkë amendamentet, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka thënë se projektligji me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji, bashkë me amendamentet e propozuara, nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenon dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Milazim Salihaj e ke fjalën. Deputeti Salihaj e paraqet dhe e arsyeton raportin e Komisionit Funkcional.

MILAZIM SALIHAIJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, në pajtim me nenet 56, 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21. 12. 2021 e shqyrtoi Projektligjin për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, i propozuar nga Qeveria, si dhe vërejtjet nga komisionet e përhershme dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport lidhur me Projektligjin për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Me këtë ligj themelohet Oda e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, si dy oda të pavarura, që ushtrojnë kompetenca të caktuara publike. Qëllimi i Projektligjit për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit është rregullimi i profesionit të arkitektit dhe inxhinierit në fushën e ndërtimit. Ky ligj rregullon: anëtarësinë, selinë, statusin, rolin dhe fushëveprimin e odave, profesionet, licencimin, përgjegjësitë disiplinore dhe edukimin e vazhdueshëm të arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Në lidhje me Projektligjin për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim formoi grupin punues, me qëllim që të kemi një ligj sa më të mirë në fushën e ndërtimit dhe të kemi përfshirje profesionale. Ishte pjesë e dy tryezave të punës, të organizuara nga profesionistë të fushës, dhe atë: njëra tryezë e punës u mbajt në Fakultetin e Ndërtimtarisë, e organizuar nga Bordi Industrial i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe tryeza e dytë e punës u mbajt në Fakultetin e Arkitekturës.

Gjithashtu, në mes të shqyrtimit të parë dhe të dytë grupi punues organizoi dhe mbajti dëgjimin publik në objektin e Kuvendit të Kosovës më 4 tetor 2021. Në dëgjimin publik morën pjesë të gjithë të interesuarit, si profesionistë të fushës së arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit dhe të gjeodezisë. Pjesëmarrësit e këtij dëgjimi publik nëpërmjet komenteve dhe propozimeve të tyre dhanë një kontribut mjaft të madh për Projektligjin për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, që ky projektligj të jetë sa më i mirë dhe në shërbim të profesionistëve të publikut.

Pas pranimit të komenteve dhe propozimeve të dala nga dëgjimi publik, grupi punues ka vazhduar punën me përfaqësues të ministrisë së linjës, si sponsoruese e këtij projektligji.

Pas shumë takimeve të mbajtura mes grupit punues dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku u shfletua projektligji nen për nen, gjithsej 53 nene, me ç'rast nga kjo punë e përbashkët propozuam dhe harmonizuam 55 amendamente. Pas kësaj projektligji me amendamente është sjellë në komision, ku është shqyrtuar dhe me raportin me amendamente është përcjellë në komisionet e përhershme për procedurë të mëtutjeshme. Pasi është shqyrtuar në komisionet e përhershme Projektligji për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit, është kthyer në komision, ku është shqyrtuar dhe pas shqyrtimit, i njëjti është dërguar në seancë plenare për shqyrtim.

Ndikimi buxhetor: për zbatimin e këtij ligji nuk ka implikime buxhetore shtesë, që do ta ngarkonin buxhetin.

Zbatimin e dispozitave të këtij ligji do ta bëjë autoriteti ligjor, siç është Ministria përkatëse e Infrastrukturës dhe organet përkatëse qendrore dhe lokale.

Nga kjo çfarë u tha për projektligjin komisioni njëzëri i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka tash deputetja Albena Reshitaj.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, kryetar!

Ligji për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve është ligj, që është iniciuar në periudhën kur unë kam qenë ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Tani, nëse ju kujtohet në retrospektivë, ky ligj pati ardhur në Kuvend në lexim të parë, mirëpo pastaj, për shkak të ndërrimit apo rrëzimit të Qeverisë është prolonguar.

Më vjen mirë që tani e kemi në seancë. Këto ndryshime që i kemi bërë si Komision për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Zhvillim dhe Planifikim, shumica janë ndryshime teknike dhe drejtshkrimore. Përmbajtja është pothuajse ajo. Kështu që, sërish po e them, sidomos për qytetarët e vendit, që është e pakuptimtë që unë si në iniciuese e një ligji të tillë, të jem kundër sot, prandaj do të votoj pro. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, në këtë projektligj i kemi të propozuara, siç u tha edhe nga deputeti Salihaj, 55 amendamente.

Sa deputetë jemi në sallë, sepse po hyjmë në procesin e votimit të amendamenteve.

Deputetë, ju lutem, a mund të uleni.

79 deputetë qenkan të pranishëm.

Amendamenti nr. 1. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 2. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 3. Të gjitha të propozuara nga komisioni janë këto. Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Mirë, pra, ju lutem që regjia ta ketë parasysh që 70 deputetë janë në sallë.

Amendamenti nr. 4. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 5. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 6. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 7. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 8. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 9. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 10. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 11. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 12. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 53. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 54. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 55. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Tash, faleminderit shumë! Ju kërkojmë që së bashku ta votojmë Projektligjin me këto amendamente të integruara në projektligj. Ta shohim sa deputetë jemi në sallë.

80 deputetë jemi të pranishëm. Uluni nëpër vendet tuaja, ju lutem. Po votojmë për projektligjin.

Të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje të dorës të votoni për Projektligjin nr. 08/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që me 59 vota për, asnjë kundër dhe 9 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-012 për odat e arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin bashkë me amendamente dhe ka thënë që këto nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka vlerësuar se ai bashkë me amendamente janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Integrim Evropian e ka shqyrtuar projektligjin bashkë me amendamente dhe ka vlerësuar se ai nuk i cenon parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji bashkë me amendamente nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Tash prej komisionit, kush e merr fjalën për ta arsyetuar raportin? Nënkryetarja e këtij komisioni, Jeta Statovci, e ka fjalën.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Siç u cek, qëllimi i këtij projektligji është që të përcaktojë kërkesat, masat dhe procedurat për mbrojtjen ligjore të topografive të produkteve gjysmëpërçuesve dhe zbatimin e të drejtave që rrjedhin nga ky projektligj.

Komisioni e shqyrtoi këtë projektligj sipas procedurës, ku miratoi 12 amendamente. Andaj, në bazë të raportit të vet amendamentues të datës 10. 12. 2021 dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më 22. 12. 2021 vendosi t'i paraqesë Kuvendit këtë rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve.

Andaj, ju ftoj, kolegë deputetë, që ta aprovoni dhe ta mbështesni me votë këtë projektligj të prezantuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash mund të kalojmë te amendamentet, meqenëse Komisioni Funkcional i ka paraqitur 12 sosh.

Sa deputetë jemi që ta dimë se a mund të hyjmë në procesin e votimit të këtyre amendamenteve. Nëse nuk i numërojmë PDK-në, nuk ka kuorum të mjaftueshëm. 60 deputetë janë të pranishëm.

Sa deputetë jemi tash? 67 deputetë jemi të pranishëm në procedurën për votimin e këtyre amendamenteve:

Amendamenti nr. 1. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 2. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 3. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 4. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 5. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 6. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 7. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 8. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 9. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 10. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 11. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti nr. 12. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Tash, ju lutem, të nderuar deputetë, të shkojmë dhe ta votojmë projektligjin bashkë me këto amendamente të integruara.

Të nderuar deputetë, po ju lus që me ngritje të dorës ta votojmë Projektligjin nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konsideroj që me 57 vota për, asnjë kundër dhe 9 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-053 për topografitë e gjysmëpërçuesve.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-055 për dizajnin industrial

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji, bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka vlerësuar që ai bashkë me amendamente nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj së bashku me amendamentet dhe ka vlerësuar se ky projektligj, së bashku me amendamentet, është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Komisioni për Integrim Evropian e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ai bashkë me amendamente nuk i cenon parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit ka vlerësuar se projektligji, bashkë me amendamente, nuk i cenon dhe nuk i prekin të drejtat e komuniteteve.

Me këtë rast, e ftoj sërish nënkryetaren e Komisionit Funkcional, deputeten Jeta Statovci, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pra, qëllimi i këtij projektligji është që të përcaktojë kushtet dhe procedurat për regjistrimin e dizajnit industrial si dhe të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi, masat, procedurat dhe mjetet për zbatimin e të drejtave dhe dizajnit komunitar.

Komisioni e shqyrtoi këtë projektligj sipas procedurës, ku miratoi në tërësi 17 amendamente, andaj në bazë të raportit të vet amendamentues, i cili është i datës 10. 12. 2021 dhe në bazë të

raporteve të komisioneve të përhershme, të cilat janë të dt. 22. 12. 2021, vendosi t'ia paraqesë Kuvendit këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr. 08/L-055 për dizajnin industrial.

Ftoj kolegët deputetë që ta mbështetin projektligjin e prezantuar.

KRYETARI: Duhet ta dimë saktë numrin e deputetëve tash, meqenëse për këtë projektligj, siç e dini, janë propozuar 17 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. Duhet të jemi mbi 60 deputetë të pranishëm, ashtu që të mund të hyjmë në procedurën e votimit.

65 deputetë janë të pranishëm. Kështu që hyjmë në procedurën e votimit të amendamenteve.

Amendamenti nr. 1. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 2. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 3. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 4. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 5. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 6. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 7. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 8. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 9. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 10. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 11. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 12. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 13. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 14. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 15. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 16. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti nr. 17. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Konsiderojmë që janë miratuar të gjitha amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Tash hyjmë në procesin e votimit të ligjit, së bashku me këto amendamente, të integruara. 67 deputetë janë të pranishëm.

Kush është për këtë projektligj? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë, konstatoj që me 58 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-055 për dizajnin industrial.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-059 për patentat

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij, bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin, së bashku me amendamentet, dhe ka vlerësuar që ato janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar projektligjin, së bashku me amendamente, dhe ka vlerësuar që ato nuk i shkelin dhe nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj, e ftoj nënkryetaren e këtij komisioni, deputeten Jeta Statovci, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e këtij komisioni.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar Konjufca!

Qëllimi i këtij projektligji është që të përcaktojë kushtet dhe procedurat për regjistrimin e patentës si dhe të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe, sipas procedurës, ka miratuar gjithsej 29 amendamente. Andaj, në bazë të raportit të vet amendamentues, i cili është i datës 10. 12. 2021 dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më 22. 12. 2021, vendosi t'ia paraqesë Kuvendit këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr.08/L-059 për patentat.

Ftoj kolegët deputetë që ta mbështesin projektligjin në fjalë.

KRYETARI: E dëgjuat raportin e komisionit. 29 amendamente janë propozuar për këtë projektligj. 68 deputetë janë të pranishëm.

Amendamenti numër 1. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti numër 2. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 3. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti numër 4. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 5. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 6. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 7. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 8. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 9. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 10. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 11. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 12. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 13. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 14. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 15. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 16. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 17. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 18. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 19. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 20. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 21. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 22. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 23. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 24. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 25. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 26. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 27. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.
Amendamenti numër 28. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet dhe
Amendamenti numër 29. Kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Tash janë kushtet që të procedojmë me votimin e projektligjit bashkë me këto amendamente të integruara në projektligj. Sa deputetë jemi për momentin, më informoni.

Pra, 10 deputetë të PDK-së i kemi të pranishëm. Pra, 69 deputetë do të hyjnë në procedurë të votimit. Kështu që konsideroj që mund të procedojmë.

Të nderuar deputetë,

Po ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për Projektligjin nr.08/L-059 për patentat.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë,

Mund të konstatojmë që me 57 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr.08/L-059 për patentat.

Kalojmë tash te projektligjet të cilat janë propozuar në shqyrtim të dytë prej Komisionit për Shëndetësi. Jemi në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës së kësaj seance plenare:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia rekomanduar miratimin e tij. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ky projektligj është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet e zbatueshme të Kosovës. Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji, pra, kjo fushë të cilën e ka projektligji nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni për të Drejta dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se ky projektligj nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Prandaj, tash është koha që t'ia japim fjalën kryetares së komisionit, deputetes, zonjës Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj kryetar!

Edhe pse e di që këto 8 projektligje të cilat janë futur në rend të ditës nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale votohen veç e veç, do të kërkoja mundësinë që vetëm një herë ta marr fjalën, sepse edhe arsyetimi është i njëjtë për të gjitha projektligjet.

Prandaj, unë tani do të deklarohej për të 8 projektligjet, pastaj ju mund t'i fusni në procedurë secilin veç e veç që të miratohet.

Në mbledhjen e mbajtur më 17.12.2021, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka shqyrtuar në shqyrtim të dytë të Projektligjit nr. 08/L-37 për ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues.

Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave. Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-39 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent. Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr.08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit...

KRYETARI: Zonja Kollçaku, a mund t'ju lus diçka?!

FATMIRE KOLLÇAKU: Po!

KRYETARI: Ne po i kemi përfshirë këto që po i lexoni, tashmë, në rendin e ditës.

FATMIRE KOLLÇAKU: Po, nuk desha të prononcohen veç e veç. Unë ju luta, por nuk ishit të vëmendshëm.

KRYETARI: Jo, për besë nuk ka mundësi ashtu, nuk mundesh në pako t'i...

FATMIRE KOLLÇAKU: Jo, jo! Do t'i votojmë veç e veç secilin. Shikoni, meqenëse në fillim ishit duke diskutuar. A bën unë të flas?!

KRYETARI: Veç pak, të mos bëni zhurmë deputetë, ju lutem!

FATMIRE KOLLÇAKU: I nderuar, kryetar!

KRYETARI: Po diskutojmë. Ju ashtu-kështu nuk po votoni. Vazhdojmë, po.

FATMIRE KOLLÇAKU: I përmenda të 8 projektligjet. Nuk ishte qëllimi që të votohen në pako, sepse nuk është e mundur. Unë vetëm e kërkoja të drejtën që vetëm njëherë të prononcohem për të 8-at, sepse është i njëjti i arsytim, dhe të mos e marr fjalën për secilin e veç e veç duke e arsyetuar njëjtë.

Të gjitha të 8 projektligjet që janë në rend të ditës nga Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kanë të bëjnë strikt me harmonizimin me Ligjin për kundërvajtje. Kjo edhe është konstatuar nga komisioni që këto projektligje, pra më 17. 12. 2021 kur ne jemi takuar, kemi konstatuar që këto projektligje e kanë përmbushur këtë kërkesë të harmonizimit me Ligjin për kundërvajtje, dhe më 24. 12. 2021 e ka votuar përfundimisht raportin lidhur me këto 8 projektligje.

Unë i përmenda 5, arrita që t'i lexoj, mirëpo nuk mendova që ta marr fjalën për secilin veç e veç me të njëjtin arsytim. Nëse ka nevojë, unë nuk përtoj, por vetëm thjeshtë për të kursyer kohën, sepse bëhet fjalë për të njëjtin arsytim. Pra, kanë të bëjnë vetëm me harmonizim me Ligjin për kundërvajtje dhe nuk kanë implikime buxhetore, qoftë për Ministrinë e Shëndetësisë, qoftë për institucionet e tjera të cilat do ta zbatojnë.

KRYETARI: Më vjen keq, por nëse nuk përtoni, atëherë duhet ta bëni këtë procedurë veç e veç për secilin projektligj. Mirë. E dëgjuat arsyetimin e komisionit, kryetaren Kollçaku në emër të komisionit për Projektligjin për shëndetin riprodhues.

Nuk ka amendamente në këtë projektligj. Të shohim se sa janë nga PDK-ja fillimisht. 10 deputetë janë të pranishëm. Pra, 63 deputetë janë të gatshëm për të votuar.

Të nderuar deputetë,

Tash, po ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për Projektligjin nr.08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-76 për shëndetin riprodhues.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, konstatoj që me 54 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues.

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës është:

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se... Jo s'paska amendamente faktikisht. Vetëm se projektligji nuk ka implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se ky projektligj është në pajtim me Kushtetutën edhe me ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike prej legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Këtë projektligj e ka shqyrtuar edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit, dhe ka vlerësuar se ky projektligj nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Sërish zonja Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit! Atëherë, komisioni ka konstatuar se projektligji e ka përmbush parakushtin për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje dhe më datë 24, e ka miratuar raportin përfundimtar dhe i propozon seancës miratimin e këtij projektligji.

KRYETARI: Mund ta votojmë këtë projektligj. Sa deputetë jemi të pranishëm? Konstatohet që 65 deputetë janë të gatshëm për të hyrë në procedurën e votimit.

Të nderuar deputetë,
Ju lus që me ngritje të dorës të votojmë për këtë projektligj.

Kush është për, projektligjin në fjalë? Kush është kundër? Kush abstenon për këtë projektligj?

Atëherë, konstatohet që me 55 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-038 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-192 për transplantimin e indeve dhe të qelizave.

Pika e pesëmbëdhjetë është:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent

Të nderuar deputetë,
Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet, po ashtu, e paska shqyrtuar dhe ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka vlerësuar se është në pajtim me Kushtetutën e vendit dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ai nuk rregullohet në mënyrë specifike prej legjislacionit të BE-së, kurse Komisioni për Komunitete e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ai nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ia japim fjalën edhe një herë kryetares së komisionit, deputetes Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj!

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, po ashtu, rekomandon që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent, i cili i plotëson parakushtet për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje të miratohet sot.

KRYETARI: E shohim sa jemi të pranishëm. Nuk ka kuorum. I thërrasim të gjithë deputetët që të kthehen në sallë. 60 deputetë janë për momentin. A jemi 62 deputetë tani, ju lutem! Mirë. 62 deputetë i kemi të gatshëm për të hyrë në proces të votimit.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për projektligjin në fjalë. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të konstatoj se me 53 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr.08/L-039 për ndryshimin dhe plotësim e Ligjit nr.05/L-024 për shërbimin mjekësor emergjent.

Pika e radhës:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se ky projektligj është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji në fjalë nuk rregullohet nga ana e legjislacionit të Bashkimit Evropian, kurse Komisioni për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Zonja Kollçaku në emër të komisionit si kryetare.

FATMIRE KOLLÇAKU: Edhe për këtë projektligj ftoj deputetët që ta votojnë, meqenëse komisioni ka votuar rekomandimin që i plotëson parakushtet, dhe i ftoj deputetët edhe një herë që ta miratojnë...

KRYETARI: 64 deputetë janë të pranishëm.

Të nderuar deputetë, po hyjmë në procesin e votimit të Projektligjit për kontrollin e duhanit.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Të nderuar deputetë, me 53 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-040 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 04/L-156 për kontrollin e duhanit.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Edhe Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ai është në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritime Evropiane e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se projektligji në fjalë nuk rregullohet në mënyrë speciale nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se ky projektligj nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Znj. Kollçaku, kryetare e komisionit, e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe po ashtu ka konstatuar se ka përmbushur kushtin kryesor që është harmonizimi me Ligjin për kundërvajtje. Prandaj, e miratoi raportin dhe i rekomandoi seancës që të votohet.

KRYETARI: Po besoj që e kemi kuorumin. 64 deputetë janë të gatshëm të votojnë.

Kush është për projektligjin në fjalë?

Kush është kundër këtij projektligji?

Kush abstenon?

Të nderuar deputetë, 54 vota i ka marrë në favor ky ligj, kundër asnjë, 10 abstenime. Kështu që konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht të gjirit.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka vlerësuar se ai është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin e zbatueshëm në vend.

Komisioni për Integrim Evropian e ka vlerësuar se ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë speciale nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Znj. Kollçaku, nëse mund ta merrni fjalën sërish, si kryetare e komisionit.

FATMIRE KOLLÇAKU: Edhe për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë komisioni ka konstatuar që i njëjti ka përmbushur kushtet për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje. Prandaj, i rekomandohet seancës plenare për miratim.

KRYETARI: Meqenëse nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim, mund ta votojmë këtë projektligj.

62 deputetë janë të gatshëm për procedurë të votimit. Deputetë të nderuar, ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni se kush është për këtë projektligj.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon për këtë projektligj?

Konstatojmë që me 52 vota për, asnjë kundër dhe me 10 abstenime, Kuvendi e miraton Ligjin nr. 08/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka thënë që ky projektligj është në përputhje edhe me Kushtetutën, edhe me ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integritet Evropian ka vlerësuar se ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike nga legjislacioni i BE-së.

Kurse, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se ky projektligj nuk i prek dhe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Edhe një herë znj. Kollçaku, që ta arsyetoni raportin e komisionit.

FATMIRE KOLLÇAKU: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut i ka përmbushur kushtet për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje. Prandaj, ftoj deputetët, në emër të komisionit që ta votojnë ligjin.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E dëgjua vlerësimin e komisionit për raportin e arsyetuar nga kryetarja Kollçaku. Nuk ka kuorum të mjaftueshëm. I thërrasim të gjithë deputetët që nuk janë në sallë për momentin që të kthehen.

64 deputetë janë të gatshëm të votojnë.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konsideroj se 63 deputetë kanë votuar, 54 për, asnjë kundër dhe 9 kanë abstenuar. Kështu që Kuvendi e miratoi Ligjit nr. 08/L-045 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërësit e gjakut.

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe deputetëve u ka rekomanduar miratimin e tij.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se ky projektligj nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion na ka thënë se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e vendit, me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Komisioni për Integritet Evropian ka thënë që ky ligj nuk rregullohet në mënyrë specifike prej legjislacionit të BE-së.

Kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe të Kthimit ka vlerësuar se ky projektligj nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat e komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Kështu që tash e ftoj sërish kryetaren e komisionit, Fatmire Kollçaku, për ta arsyetuar raportin e këtij komisioni.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj, kryetar!

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka konstatuar se projektligji në fjalë ka plotësuar kushtet për harmonizim me Ligjin për kundërvajtje. Prandaj, rekomandojmë që të miratohet në këtë seancë plenare.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E dëgjuat raportin e Komisionit Funkcional. 66 deputetë do të hyjnë në proces të votimit.

Kush është për projektligjin në fjalë?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatoj që me 56 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 08/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin shëndetësor.

Tash, ta vazhdojmë seancën apo? Mirë! Le të jetë pika e 21-të pika e fundit për sonte.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me pikën e 21-të të rendit të ditës:

21. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit nga dy kandidatët e propozuar.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zotin Adnan Rrustemi, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë, ju kisha lutur që të uleni në vendet tuaja, për shkak se ende jemi në seancë. Zoti Rrustemi, e keni fjalën.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe në pajtim me nenin 67 të Rregullores së Kuvendit zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe në mbledhjen e mbajtur më 8 dhjetor vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit për votim të kandidatëve për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit si në vijim:

1. Yll Buleshkaj me 33,7 pikë dhe
2. Visar Krasniqi me 33,5 pikë.

Kuvendi prej dy kandidatëve të propozuar për drejtor të agjencisë do të zgjedhë njërin nga kandidatët. Votimi i kandidatëve për drejtor të agjencisë bëhet me votim të fshehtë. Mandati i drejtorit të agjencisë është pesë vjet.

Më lejoni që në emër të Komisionit intervistues ta arsyetoj raportin.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke vepruar në pajtim me nenin 67 të Rregullores së Kuvendit dhe nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 28. 6. 2021 mori vendim për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e kandidatit për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit, siç përcaktohet në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 22. 10. 2021 miratoi listën e ngushtë të kandidatëve për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe konstatoi se në këtë konkurs konkurruan 25

kandidatë. Katër prej tyre nuk u ftuan në intervistë, për shkak se nuk i plotësuan kushtet formale për intervistim. Komisioni në intervistat e zhvilluara më 30 nëntor dhe 1, 2, 6, 7 dhe 8 dhjetor 2021 intervistoi dhe vlerësoi 20 kandidatë, të cilët aplikuan për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ndërsa një kandidat u tërhoq nga procesi i intervistimit.

Duhet theksuar se në intervistim për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit gjatë tërë procesit monitorues dhe pjesëmarrës kanë qenë ekspertët e projektit britanik, sipas memorandumit të nënshkruar në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ambasadës Britanike, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 08.12.2021 pas procesit të intervistimit dhe vlerësimit radhiti kandidatët sipas rezultateve të poentimit për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ashtu siç përcaktohet me nenin 8 të Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Kandidatët janë:

1. Yll Buleshkaj me 33,7 pikë, dhe
2. Visar Krasniqi me 33,5 pikë.

Komisioni pas përfundimit të procedurës së intervistimit vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë për votim kandidatët e propozuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Një sqarim procedural. Ju njoftoj se në pajtim me nenin 8, paragrafin 5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionit Funkcional, Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të votave zgjedh njërin prej kandidatëve të propozuar për drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Për shkak se kemi procedurë të votimit të fshehtë, duhet të formojmë një komision votues, kështu që ftoj grupet parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komision votues. Nga Lëvizja Vetëvendosje?

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, nënkryetare!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj deputetin Luan Aliu për anëtar të Komisionit zgjedhor.

KRYESUESJA: Nga Partia Demokratike e Kosovës?

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Ne i kishim vërejtjet tona sa i përket këtij procesi dhe, rrjedhimisht nuk do ta propozojmë askënd që të jetë pjesë e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në rregull! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës?

ARBEN GASHI: Nuk pranojmë të kemi përfaqësues.

KRYESUESJA: Në rregull. Nga Lista Serbe? Igor Simiq e ka fjalën. Është për propozim të anëtarëve të Komisionit votues.

IGOR SIMIĆ: Srpska lista predlaže za komisiju gospodina Ljubinka Karadžića.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Enis Kervan, Grupi Multietnik.

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetare!

Ne e propozojmë deputetin Fridon Lala.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, duhet të votojmë për komisionin. Ju kisha lutur që t'i zini vendet tuaja, për shkak se do të votojmë tani.

Ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për formimin e Komisionit votues.

Kush është për?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Ju lus të uleni, për shkak se është e pamundur të numërohen se kush ka votuar.

Edhe një herë, të nderuar deputetë, me ngritje dore të deklaroheni për votim.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë,

Siç kërkova edhe më herët, po bëhet e pamundur ta dimë numrin e deputetëve. Tash e sa herë, në fakt për çka mu desh dy herë t'ju lus të uleni, për të mundur të numërojmë. Kështu që, ju kisha lutur që gjatë kohës kur jemi duke votuar, të uleni. Sepse që e pamundur në fakt të marrim të dhënat.

Të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje dore të deklaroheni për Komisionin votues.

Kush është për?

Kur janë të gjithë ulur, sekretaria mundet shumë lehtë t'i numërojë secilin.

Kush është kundër? Kush abstenon?

Të nderuar deputetë, me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, formohet komisioni.

Lus deputetët që janë zgjedhur si pjesë e Komisionit t'i zënë vendet e tyre.

Atëherë, nëse komisioni është gati, fillojmë me votim. Do të thërras deputetët me emër sipas listës.

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Albana Bytyqi, Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Begjet Pacolli, Bekë Berisha, Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Karameta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili, Dragan Antonijeviq, Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enis Kervan, Enver Dugolli, Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri, Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Glauk Konjufca, Gramoz Agusholli, Hajdar Beqa, Haki Abazi, Haxhi Avdyli, Hisen Berisha, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Isak Shabani, Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Milazim Salihaj, Milijana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rashit Qalaj, Rrezarta Krasniqi, Salih Zyba, Samra Iljaz, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Çeraniq, Visar Korenica, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti, Zoran Mojsiloviq.

Ftoj deputetët që të votojnë, nëse nuk e kanë kryer votimin deri më tani.

Thirrja e fundit për deputetët që nuk kanë votuar deri më tani, që të votojnë dhe pas kësaj e mbyllim votimin.

Ftoj anëtarin e komisionit që t'i lexojë rezultatet. Regjia, ju lutem, mikrofonin te foltorja!

LUAN ALIU: Atëherë, të nderuar deputetë, po vazhdojmë me numërimin e votave. Kanë marrë pjesë gjithsej 66 deputetë.

Vota e parë është për:

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Visar Krasniqi,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Visar Krasniqi,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,

Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
E pavlefshme, sepse ka X,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
Yll Buleshkaj,
E pavlefshme dhe,
Yll Buleshkaj,

KRYESUESJA: Tani, presim rezultatin pas numërimit. Ftoj komisionin që ta paraqesë raportin.

LUAN ALIU: Të nderuar kolegë deputetë,

Rezultati i votimit është si në vijim. Domethënë, për zgjedhjen e drejtorit të Agjencinë Kundër Korrupsion kanë votuar 66 deputetë. 2 janë kundër dhe 2 kanë qenë abstenime, dhe 62 vota kanë qenë për.

Yll Buleshkaj ka marrë 62 vota, Visar Krasniqi i ka marrë 2 vota. Atëherë, më falni! Është fjala për Yll Buleshkaj, dhe nga ky moment zgjidhet drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Atëherë, në bazë të raportit të komisionit, 66 deputetë kanë marrë pjesë në votim, të pavlefshme janë 2 fletëvotime.

1. Yll Buleshkaj ka marrë 62 vota, ndërsa
2. Visar Krasniqi ka marrë 2 vota.

Konstatoj se zoti Yll Buleshkaj zgjidhet drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsion, me mandat pesëvjeçar.

Të nderuar deputetë,
Vazhdimi i kësaj seance do të jetë të martën, më 28 dhjetor, në orën 12:00.

* * *

E martë, më 28 dhjetor 2021

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 24 dhjetor 2021

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, kalojmë tash në pikën e rendit të ditës:

50. Debat parlamentar në lidhje me krizën energjetike në Kosovë

Të nderuar deputetë,

Deputeti Ramush Haradinaj, i mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë e ka parashtruar kërkesën për debat parlamentar lidhur me krizën energjetike në Kosovë.

E ftoj deputetin Ramush Haradinaj që ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar ky debat parlamentar.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Anëtarë të Kabinetit qeverisës,

Kërkesa për këtë debat është e datës 13 dhjetor. Pra, më 13 dhjetor kemi kërkuar një debat parlamentar lidhur me krizën energjetike në Kosovë, për shkak të reduktimeve dhe rikthimi i territorit. Pra, i bie para dy javëve.

Njëkohësisht i kam drejtuar edhe një pyetje parlamentare kryeministrit lidhur me këtë çështje, e që e kam marrë një përgjigje me shkrim. Ndërsa, sot më lejoni, meqenëse janë konsumuar shumë aspekte të temës që po e trajtojmë, më lejoni t'i jap disa vlerësime të miat lidhur me sektorin e energjisë, lidhur me veprimet që është dashur të ndërmerren, po edhe që mund të ndërmerren tash.

Sektori i energjisë ndër vite është viktimë e jostabilitetit politik. Ndërrimi i shpeshtë i politikave të institucioneve ndërkombëtare relevante dhe pamundësi të një ambienti të favorshëm në realizimin e projekteve kapitale në funksion të adresimit të sigurisë së furnizimit. Këto janë disa nga faktorët kryesorë, që e kanë sjellë vendin në këtë gjendje. Njëkohësisht, sot secili mund ta drejtojë gishtin kah secili dhe modeli i amnistisë për mosveprim është bërë model i qeverisjes ndër vite, duke fajësuar tjetrin. Kulmin e ka arritur në Qeverinë aktuale, e cila duke qenë mbi dhjetë vjet opozitë dhe pjesë e institucioneve i ka ditur problemet me të cilat ballafaqohet Kosova në këtë sektor.

Por, u deshën mbi nëntë muaj për ta kuptuar sa emergjente është situata dhe se kërkoheshin ndërmarrja e masave urgjente për të mos përfunduar në reduktime të ashpra të energjisë

elektrike, duke rrezikuar shëndetin dhe mirëqenien sociale të qytetarëve. Dikur, unë si kryeministër, e kam përjetuar këtë që në ditët e para të ushtrimit të këtij funksioni, kur Kosova rrezikohej të ngelej pa qymyr, e rrjedhimisht edhe pa energji elektrike, sepse zhvillimi i minierës dhe mihja e qymyrit ishin bllokuar nga vonesat në shpronësim.

Tre muaj më vonë të qeverisjes, bashkë me ministrat, i kalova në zgjidhjen e problemit dhe jo si Qeveria aktuale, e cila prioritet kishte rehatimin e personave të partisë nëpër borde dhe pozita kyçe nëpër sektorë, e zgjidhja e problemit, i cili që nga prilli i këtij viti, pra në rritjen e çmimeve, po trokiste fuqishëm në derën e konsumatorit, u neglizhua totalisht.

Në këtë periudhë dëgjuam ligjërata të përshkrimit të gjendjes, por nuk dëgjuam as edhe një rresht për dalje nga kjo krizë. Përkundrazi, projekte të rëndësishme që adresonin sigurinë e furnizimit u refuzuan me supozime të paqëndrueshme, të cilat përforcojnë opinionin se kjo Qeveri nuk është viktimë e të tjerëve, por viktimë e pozicioneve të veta, të ndërtuara ndër vite, dhe me supozime të gabueshme populliste e nën klauzolat ideologjike. Me qëllim apo nga mosdija, si rezultat i çmimeve të importit, u la që aktorët e sektorit të energjisë, me këtë rast KOST, KEDS dhe KESKO, ballafaqohen me probleme të mëdha të likuiditetit dhe rrjedhimisht u rrezikua kolapsi i tërë i zinxhirit të transfereve brenda palëve dhe pamundësimi i përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me licencë.

Anëtarët kryesorë të Qeverisë vite më parë refuzonin aktivisht investimet në Kosovën e Re, e cila do të ishte kurrizi i sigurisë së furnizimit me energji, me arsyetimin se çmimi tavan në kontratë 80 euro ishte i lartë. Por, vetëm në dhjetë ditët e fundit futi në sektor si subvencion 45 milionë euro, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar borxhet e akumuluar në gjashtë muajt e fundit, e lëre më që të bëjmë zgjidhje për furnizim në ditët e ardhshme.

Pra, nuk po paguajmë 80 euro për një aset, që do të siguronte siguri të furnizimit dhe transicion të qetë drejt burimeve të ripërtëritshme, por paguajmë herë 400 e herë 500 e deri në 600 tregtarëve të regjionit. Për ata që e përcjellin sektorin e energjisë e dinë shumë mirë, se kush ka monopol në Ballkan në këtë produkt.

Për ta kuptuar më thjesht kjo Qeveri promovoi eksportin e parasë para opsionit të investimit në kapacitete të prodhimit në vend. Sa për reflektim nga e kaluara, kjo Qeveri në tavolinën e vet, pra me të ardhur në pushtet kishte të gatshme procedurat e zhvillimit të ankandeve të draftuara me asistencën teknike të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, pra BERZH. Kishte po ashtu, për revizibilitetin, projeksionet e gazit, por edhe studimin e fizibilitetit në zhvillim e sipër, e bashkë me të edhe 200 milionë euro grant nga MCC dedikuar për investime kapitale në këtë projekt. E kishte të gatshëm planin e veprimit, të zhvilluar me asistim ngushtë të USAID-it, përfshirjen e autoritetit dhe inkasimin e faturave të energjisë në veri. KOST-i i pavarësuar nga blloku me Serbinë dhe tani pjesë e përbashkët e bllokut Shqipëri – Kosovë, i cili mundësonte

inkasimin e mjeteve nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare të kapaciteteve të transmisionit. Shumë projekte tjera, po ashtu në fushën e licencën së energjisë dhe burime të ripërtëritshme, që zhvilluan partneritet të ngushtë me agjencitë zhvillimore dhe donatorët e jashtëm dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Qeveria aktuale nga mosdija, paranojat dhe e ngarkuar ideologjik kundër sektorit privat përdori qasje refuzuese, bllokuese, e në disa raste edhe fyese për organizatat ndërkombëtare të përfshira në zhvillimin e këtyre projekteve. Krejt kjo nën sloganin “nuk na intereson çka është zhvilluar nga e kaluara, ne po e bëjmë strategjinë e energjisë”. Dua t’ia rikujtojmë Qeverisë se strategjia është dokument dinamik dhe se strategji janë zhvilluar edhe në të kaluarën, bashkë me mbështetjen e donatorëve e që sot po i promovon Qeveria.

Por, ajo s’guxon të mbajë peng, pra strategjia, sektorin dhe të jetë arsye për mospunën dhe veprimin e Qeverisë në zgjidhje të çështjeve akute që po kalon sektori në këtë kohë.

Cilat janë veprimet afatshkurtra dhe afatgjata, që mendojmë se urgjentisht duhet ndërmarrë.

Afatshkurtër:

- Të ketë një vlerësim transparent, pra vënia pak veshin kësaj që po ju them, të ketë një vlerësim transparent mbi nevojat financiare për të mbuluar koston e importit përtej çmimit të importit, të aprovuar nga ZRRE, të paktën deri në prill të vitit të ardhshëm. Pra, duhet bërë një llogari e saktë, të dihet se në çfarë obligimesh do të ndodhemi deri në prill.

Më pas, pra si veprim i dytë:

- Të intervenohet në vazhdimësi në ruajtjen, pra duke i pasur të qarta parametrat financiarë edhe koston, të intervenohet në vazhdimësi në ruajtjen e likuiditetit të aktorëve të sektorit energjetik, i përcjellë ngushtë edhe me monitorim të rreptë nga Qeveria dhe Zyra e Rregullatorit, se a janë duke iu përmbajtur këta aktorë (KOST-i, KEK-u, KEDS, KESKO) detyrimeve që i kanë të përcaktuara në licencën e operimit. Rrjedhimisht, edhe të merren masa ndaj atyre aktorëve që dështojnë në kryerjen e obligimeve të përcaktuara në licencë.

Zhvillime afatgjata, ose veprime afatgjata:

- Zhbllokimi i investimeve në sektor nën platformën e zhvillimit të miqsisë të energjisë, pra të hiqen paranojat ndaj sektorit privat, duke e trajtuar atë si pjesë të zgjidhjes dhe kryesorin në mobilizimin e investimeve. Të negociohet pozicioni i Qeverisë së Kosovës në raport me Bashkimin Evropian lidhur me përdorimin e qymyrit si bazë për prodhimin e energjisë elektrike në funksion të sigurisë së furnizimit.

- Të rihapet menjëherë diskutimi me MCC-në, pra të rikthehet projekti i gazsjellësit dhe i diversifikimit të energjisë, dy opsione kanë qenë për një central energjetik me gaz, njëri 250 dhe tjetri 500 MW.

- Të ndërtohet një agjendë, të pajtohet, të dakordohet një agjendë e dekarbonizimit, por jo të nxituar dhe duke rrezikuar sigurinë e furnizimit, por graduale.

Në qoftë se kjo Qeveri është tërhequr nga investimet në qymyr dhe në gaz, si lëndë e parë, kyçe për sigurinë e furnizimit, atëherë është mirë, me kohë të vendosim, të përcaktohem i se cilat do të jenë ato burime të furnizimit të qëndrueshëm, duke pasur parasysh se nga energjia e ripërtëritshme nuk krijohet një stabilitet i furnizimit me energji.

T'ju them të drejtën, dëgjova diskutime shumë dhe e pashë se shumica kanë ardhur këtu për të hequr faj nga vetja. Pra, mundoheshin ta heqin fajin nga vetja. Me pak fjalë, më mirë është kohën që e kemi këtu sot ta shfrytëzojmë për të diskutuar e t'u tregojmë qytetarëve të vendit se si do të jetë situata me reduktimet, sa orë do t'i kenë në ditë dhe sa herë në ditë?

Pra, mos harroni, është një ndërprerje disaorëshe, por nuk është e vetmja brenda 24 orëve. Pra, ndërprerjet po kthehen disa herë brenda 24 orëve. T'u tregojmë atyre se kur ne mendojmë që do të ketë energji të vazhdueshme e të mjaftueshme. T'u tregojmë atyre se në çfarë veprimesh konkrete do të ndërmarrim dhe unë mendoj se duhet çdo ditë t'u shpjegohet qytetarëve e të mos lihen veç me njoftimet se ku ka reduktime. Kjo situatë, ju siguroj, është e ngjashme me kohën e pandemisë, kur ishim 39 e 40 të vdekur në ditë, e s'kishim një zyrtar qeveritar të dilte e të shpjegonte se çka ka ndodhur sot.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E dëgjuat prezantimin nga deputeti Haradinaj. Tash e kemi radhën e grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, kryetari i grupit, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë dua ta falënderoj kryeministrin Rama, kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, për gatishmërinë e tij që në këto ditë të vështira për Republikën e Kosovës në mungesë të energjisë elektrike, sot ka dalë me një iniciativë konkrete dhe me gatishmëri që të ndihmojë qytetarët e Republikës së Kosovës që në prag të festave të mos e ndiejnë mungesën e energjisë elektrike.

Në anën tjetër, është e papranueshme që sot kryeministri i Republikës së Kosovës për temën më të rëndësishme në vend, për atë që më së shumti sot preokupohen qytetarët tanë, të mos jetë prezent në këtë seancë. Mendoj që për kryeministrin tonë nuk duhet të ketë problem, preokupim

dhe përkushtim më të madh në këtë kohë, sesa të merret pikërisht me mungesën e energjisë elektrike, si kryetar i kësaj Qeverie, si njeri i cili pa dyshim që më së shumti bie barra mbi të.

Ne i kemi parë kryeministrat e rajonit të gjithë, si kryeministrin Rama, si kryeministrin Zajev, dhe kur vjen puna te ballafaqimi me këtë sfidë, kanë qenë ata në ballë të këtyre sfidave dhe i kemi parë vazhdimisht duke folur dhe duke marrë iniciativa. Pra, kryeministrin tonë e shohim vetëm në Facebook me disa postime, edhe atë duke u munduar të gjejë fajtorë. E tha edhe më herët kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës që nuk po e bëjmë fajtor për të kaluarën, mirëpo po i kërkojmë përgjegjësi për situatën aktuale në të cilën ndodhemi.

Të nderuar deputetë, jemi i vetmi vend në rajon dhe në Evropë që, pavarësisht krizës së shkaktuar që s'e ka prekur vetëm Kosovën, mirëpo Kosovën e ka prekur vetëm terri. Pra, jemi i vetmi vend që ne i përjetojmë reduktimet, asnjë vend tjetër në rajon nuk i përjeton reduktimet qysh është duke i përjetuar Republika e Kosovës. Pra, në anën tjetër, kur e sheh, Republika e Maqedonisë së Veriut të bazuar prodhimin e energjisë elektrike e ka në termocentrale dhe furnizohet në masë të madhe me thëngjill nga Kosova.

Në një bisedë telefonike që e kam pasur me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë mbrëmë, thotë që 300 mijë tonë thëngjill deri më tani i ka blerë nga Kosova dhe 170 mijë tonë i kanë të kontraktuar. Prandaj, me resurset tona të tjerët po bëjnë zgjidhje, po ne për vete me resurset tona nuk po mund të bëjmë zgjidhje. Pse? Sepse, kemi një Qeveri të paaftë, kemi probleme shumë serioze me ata që na udhëheqin.

Kjo është e papranueshme. Neve po na rrjedhin, pra resurset tona po i drejtojmë në mënyrë shumë të gabuar dhe, në anën tjetër, qytetarët tanë po e vuajnë mungesën e energjisë elektrike në këtë kohë dimri. Kemi shumë familje me asistencë sociale, kemi shumë familje që kanë nevojë ta ndiejnë dorën e shtetit në këto momente të rënda. Kanë nevojë ta ndiejnë dorën e shtetit. Prandaj, unë kërkoj nga kryeministri i Republikës së Kosovës që mos t'i ikën kësaj përgjegjësie. Sot i iku kësaj seance, mirëpo siç duket, edhe nga debati i mëhershëm që ishte në raport me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme sa i përket energjisë elektrike, ne fatkeqësisht nuk pamë asnjë përkushtim të kësaj mazhorancës që ajo të votohet dhe ajo të kalojë.

Kjo është aq joserioze saqë joserioziteti i kësaj Qeverie po reflekton edhe në Kuvend. Ju i keni 51 për qind të votave dhe normalisht do të duhej të mos diskutohej fare, pra shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, ju nuk i keni numrat e mjaftueshëm që ta votoni këtë dokument që e ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës në këtë Parlament. Vërtet është e pafalshme.

Pra, papërgjegjësia po shkon këtu shkallë-shkallë. Po fillon prej ndërmartjeve publike, bordeve që i keni emëruar, po kalon te Qeveria, pastaj po vjen këtu te ne në Parlament. Pra këtu kemi njëfarë degradimi të madh, të papërgjegjësive në këtë vend. Dhe sinqerisht po ju them, nuk po

shoh që po vijnë ditë të mira sa i përket kësaj sfide. Po shoh që do të kemi probleme edhe më shumë. Pra, sot atë që dëgjuam edhe nga dy ministrat prezentë, fatkeqësisht ne krejt çka pamë në këtë dokument që na u ofrua ta votojmë, qe legalizimi i ndërprerjes së energjisë elektrike, po jo zgjidhje edhe më tutje se a do të ndalet reduktimi, pra a do të kemi furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ne pa dyshim që në këtë situatë barrën e mbajnë të gjithë ata. Qe dy dekada jemi munduar të arrijmë të ndërtojmë një termocentral. Më shumë se 15 vite na kanë zgjatur procedurat e Kosovës C e pastaj Kosova e Re e kështu me radhë. Normalisht kemi pasur mospajtime të mëdha si parti politike, si klasë politike, secila i kemi pasur pikëpamjet tona, këndvështrimet tona. Edhe sot e kemi sjellë Kosovën në këtë gjendje. Pra, s'kemi arritur të dakordohemi ne, qe OK, po e financojmë nga buxheti i Kosovës dhe për një politikë më afatgjate, s'kemi arritur të pajtohemi asnjëherë.

Fatkeqësisht sot e tejkaluam atë projekt që realisht nuk u realizua, erdhëm te projekti i dytë që qe projekti i gazit, prapë e refuzuat, që mendoj që ka qenë gabimi më i madh refuzimi i projektit të gazsjellësit. Ka qenë gabimi më i madh i kësaj Qeverie, që do të paguajmë gjeneratë pas gjenerate. Diversifikimi i energjisë do të duhej të ishte prioritet i kësaj Qeverie. Imagjino po të mos e kishim ndërtuar edhe rrjetin e transmisionit të lartë me Republikën e Shqipërisë, që sot e kemi, e quajmë si autostrada energjetike mbi të cilën furnizohemi nga Shqipëria. Në çfarë situatë na kishte sjellë Serbia dje? Prandaj, kjo Qeveri e këtij njëzetvjeçari ka bërë projekte në këtë vend që të lehtësojë Qeveri pas qeverie, ballafaqimin me këto sfida. Mirëpo, ju keni stagnuar komplet dhe nuk është mirë të harxhohet tri orë a katër orë debat e të dilni dhe vetëm të shfajësoheni dhe të fajësoni të tjerët çka kanë bërë, pa dhënë edhe një alternativë të vetme çka do të bësh.

Kriza dhe të ftohtit nuk e pret strategjinë e kësaj Qeverie. Prandaj, nuk po e di a jeni të vetëdijshëm që nuk mund të sillësh konform rrethanave sikurse jemi në njëfarë normaliteti, ka energji elektrike, s'ka mungesë. Pra, ju po flisni për një strategji, ne po ballafaqohemi me terr. Pra, sot nuk mund të thuash këtij problemi do t'i japim zgjidhje me strategjinë time që do ta sjellë. Kjo është e pafalshme. Nuk mundesh, sepse problemin e kemi në derë. Problemi do të vazhdojë të jetë në janar, problemi do të vazhdojë të jetë në shkurt, do të jetë në mars, se s'po duket që do të dalim lehtë prej kësaj krize. Pra reduktimet për aq sa po shoh, prej kësaj Qeverie që s'po jep shpresë që do ta nxjerrë Kosovën prej kësaj gjendje, reduktimet veçse do të shkojnë duke u rritur.

Prandaj, të gjithë këta mekanizma që Qeveria e Republikës i ka në dorë, edhe përmes ndërmarrjeve publike, edhe përmes KOSTT-it, edhe përmes ZRRE-së, edhe përmes KEDS-it e KESCO-s që normalisht janë privatë, mendoj që do të duhej shumë më herë të vihet në këtë ditë të shpallet kjo gjendje e jashtëzakonshme dhe qytetarët të mos e ndjejnë pra mungesën e energjisë elektrike. Ky veprim që kryeministrat e rajonit e kanë bërë pa dy muajsh, do të duhej ta

bënte Albin Kurti në atë kohë që e tha një koleg i imi më herët, i lini 300 punë keq, për të mundur të fitoni pak pushtet lokal.

Prandaj, unë i bëj thirrje që të tregohet më i përgjegjshëm karshi kësaj krize. Më shumë i bie në mend Kryeministrit shqiptar të flasë për krizën energjetike në Kosovë e të zotohet të na ndihmojë se Kryeministri ynë për shtëpinë e vet. Kjo është e pafalshme. Mendoj që edhe sot nuk ka pasur punë më të rëndësishme. Për kureshtje hyra edhe në agjendën e Zyrës së Kryeministrit. Nuk pashë ndonjëfarë pune a angazhimi të Kryeministrit që sot do ta linte për të ardhur në seancë. Nuk pashë diçka as në faqen e tij zyrtare. Mungesa është e pajustificueshme, veç nëse ka udhëtuar diku jashtë vendit dhe nuk na kanë lajmëruar. Andaj, mungesa e tij në këtë seancë që të ballafaqohet me deputetë, me të zgjedhurit e popullit, është e papranueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Vetëvendosjes, fjalën e ka deputeti Armend Muja.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në kuadër të debatit për energji, nënvizon se kjo gjendje që po kalon vendi është rezultat i mungesës së vizionit afatgjatë dhe strategjisë për energjinë. Në të njëjtën kohë, edhe dështimi i Kosovës dhe aktorëve institucionalë për të miratuar planet afatgjatë për bilancin e energjisë.

Situata energjetike në vend është përkeqësuar në saje të rënies së kapacitetit gjenerues të njërit nga blloqet e Kosovës B dhe vështirësive për të blerë energji nga importi, e cila duket që gjatë muajit dhjetor është dhjetëfishuar në çmim.

Ne dëshirojmë të nënvizojmë dhe të mbështesim masat e ndërmarra nga Qeveria Kurti për të siguruar dhe parandaluar shtrenjtimin e energjisë elektrike gjatë verës deri në nëntor. Njëkohësisht mbështesim përpjekjet për rikthim të bllokut B2 në afatin sa më të shkurtër. Ka shenja ditëve të fundit që është duke u stabilizuar edhe çmimi i importit, po në të njëjtën kohë edhe furnizimi, por është evidente që për shkak të vështirësive teknike në rrjetin e shpërndarjes, ka ende qytete ose lokalitete që kanë vështirësi në qasjen në energji elektrike.

Dëshiroj po ashtu të përkrahim fuqishëm dhe të mbështesim hapat, edhe një herë të rikonfirmojmë mbështetjen për vendimin e këtij Kuvendi të marrë në korrik të v. 2021 për auditimin e investimeve kapitale në rrjetin e transmisionit. Mirëpresim planet e ZREE-së për të audituar investimet kapitale dhe në humbje teknike tek rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike KEDS. Njëkohësisht, po ashtu mirëpresim edhe gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit sa i përket auditimit të performansës dhe pasqyrave financiare të KEK-ut.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Një vështirësi po ashtu që hasim, është një ngecje, stagnim i vazhdueshëm sa i përket përpjekjeve për minimizim të humbjeve teknike. Që nga viti 2010, humbjet teknike kanë qenë të parapara në 16.8 për qind, dhe mjerisht ato nuk kanë lëvizur, ose nuk janë zvogëluar, megjithëse ishte premtuar që do të investohen 300 milionë euro në rrjetin e shpërndarjes.

Gjatë diskutimeve me ZRRE, na është thënë që ata kanë evidencë që janë shpenzuar vetëm 100 milion euro. Por, duhet rikujtuar popullit të Kosovës që ato investime janë bartur kryesisht në faturat e energjisë. Në fakt, i ka paguar konsumatori i Kosovës.

Përqendrimi ynë, i nderuar Kryetar, duhet të jetë po ashtu edhe tek, duhet t'ju rikujtoj që në v. 2017, Kosova kishte edhe një krizë të thëngjillit. Ajo çka nuk duhet të anashkalohet, është po ashtu edhe vëmendja sa i përket kapacitetit të prodhimit të thëngjillit, nevoja për të rinovuar kapacitetet ekzistuese të energjisë, nevoja për të menduar në alternativa të tjera të energjisë, sidomos në energji të ripërtrishme, nevoja për minimizim të humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes dhe transmetimit dhe nevoja për të promovuar eficiencën e energjisë, e sidomos alternativat e ngrohjes.

I nderuar kryetar,

Gjithsesi ka ende qytetarë të cilët ballafaqohen me pengesa, të cilat ne i mirëkuptojmë, po në të njëjtën kohë, unë jam goxha i bindur, ne si grup jemi të bindur që këto në bashkëpunim ndërmjet qytetarëve dhe Qeverisë do të arrihet të tejkalohen. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të AAK-së, Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Qytetarë të vendit,

Po shihet që nga deklarimi i Qeverisë Kurti nuk ka shpresë që të kemi përmirësim të energjisë elektrike. Po shihet që ky debat ka qenë i domosdoshëm, që të debatohet edhe për pozitën, por edhe për opozitën.

Thënë sinqerisht, çdo justifikim apo arsye koti nga pozita lidhur me këtë temë, nuk ka vlerë. Sepse, e para jeni në pushtet qysh nga stina e pranverës dhe keni pasur hapësirë në kohë që të bëni përgatitjet për nevojën energjetike të dimrit.

E dyta, vazhdimisht keni mbajtur arrogancën e numrave, kinse jemi fryma e re dhe qeverisja e re dhe fare nuk keni përfillur kritikën dhe shqetësimet e opozitës, që Kosova shpejt do të ketë probleme me energjinë. Madje, vetë e kam thënë edhe në seancë, por edhe disa herë të tjera në

Komisionin për Ekonomi, ku e pranishme ka qenë vetë ministrja Rizvanolli, dhe madje jam kritikuar kur kam thënë që Kosova do të ketë probleme të rënda e serioze këtë dimër me energjinë dhe kam bërë thirrje që të ndërmerren masat.

E treta, jeni Qeveri që keni shumicën parlamentare, e keni Qeverinë, e keni pushtetin, prandaj ju lutem, është në dorën tuaj për të udhëhequr shtetin dhe për të zgjidhur problemet dhe temat që janë shqetësim e që ndikojnë në jetën e qytetarëve. Kjo krizë energjetike po eskalon dhe është për keqardhje që ka nisur paralizimin e funksionimit normal të shtetit apo shoqërisë sonë.

Në këto momente të brishta të shtetit, ngre disa dilema. A mund të më thoni dikush se me cilën formulë dhe si mund të zhvillohet ekonomia e shtetit pa energji elektrike, sepse çdo ditë po kemi ankesa nga ndërmarrjet dhe nga të gjitha bizneset që veprojnë në vend, të cilat kohëve të fundit kanë pasur humbje të mëdha, sepse nuk kanë prodhuar, as nuk kanë shitur. Pra, Kosova po varfërohet dhe dobësohet ekonomikisht. A mund të më thotë dikush se diaspora që janë aorta e shtetit të Kosovës, pasi nuk u ndalën asnjëherë duke na mbajtur gjallë, para e pas lufte, a meritojnë të vijnë në shtëpitë e tyre, të përfundojnë pushimet në dritën e qirinjve dhe të mos kenë as ngrohtësi, po as nxemje të vazhdueshme. A mund të më shpjegojë dikush se cili investitor i Evropës apo edhe i botës do të marrë guximin për të investuar ekonomikisht në shtetin tonë të Kosovë, ku as energji elektrike nuk ekziston si elementi bazik për çdo investitor në botë.

Pra, Kosova u kthye përpara dhjetë vitesh, në kuptimin e imazhit negativ në arenën ndërkombëtare. Po, atëherë flitej si një vend ku nuk mund të investohet, sepse nuk ka as energji elektrike. Pra, në përgjithësi, ky kaos energjetik ka ndikuar që qytetarët të mos kenë energji elektrike sikur para 15 vitesh, që qytetarët të mos kenë ngrohje në shtëpi në këtë dimër. Po ashtu që ekonomitë familjare, bujqit e blegtorët të mos mund të ushtrojnë aktivitetet e tyre.

Të nderuar deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Kjo gjendje fatkeqësisht nuk i është dashur Kosovës, por përgjegjësia tani është mbi supet e Qeverisë Kurti, pasi nuk ndërmorët asgjë dhe aq më keq, refuzuat projekte të mëdha ndërkombëtare për zgjidhjen e energjisë, si në gjendje të opozitës, ashtu edhe të pozitës.

Kur jemi te kjo temë energjetike, para vetes si shtet e shoqëri kemi edhe dy probleme të tjera. E para lidhet me rritjen e çmimit të faturat e energjisë elektrike, ashtu siç keni folur dhe planifikuar që të ndodhë në pranverën e vitit 2022. Unë prapë ju bëj thirrje që të mos e lejoni këtë gjë të ndodhë, sepse ne e dimë që mirëqenia e qytetarëve është e dobët dhe shtrenjtimi i energjisë vetëm sa do ta thellojë mënyrën e keqe të jetesës së tyre. Prandaj, Qeveria duhet të bëjë zgjidhje ngase qytetarët për këtu ju kanë zgjedhur dhe mos vazhdoni t'i zhgënjeni ashtu siç keni bërë deri më tani.

E dyta, lidhet me padrejtësinë ndaj qytetarëve të Kosovës, që ata detyrohen të paguajnë energjinë elektrike më shumë për shkak të papërgjegjshmërisë së komunave veriore të vendit, që nuk po e paguajnë atë. Kjo quhet thjeshtë dhe shqip, vjedhje legale e parasë për shumicën e qytetarëve të vendit. Për më keq, deri para disa ditësh, si total janë ndarë 17,7 milionë euro, dhe deri në fund të vitit 2021, planifikimi ka qenë që të paguhen 27,7 milionë euro për energjinë elektrike në komunat veriore. Ky është dështim i Qeverisë Kurti, e cila ka premtuar dhe ka miratuar rezolutën e Kuvendit që brenda gjashtë muajsh ta gjejë zgjidhjen për çështjen e pagesës së panevojshme të energjisë dhe kaluan nëntë muaj dhe ende s'kemi zgjidhje të problemit. Për këtë, dikush duhet të japë llogari, si para qytetarit, por edhe para nesh si deputetë.

Për fund, ju them punoni e veproni në drejtim të një stabiliteti afatshkurtër e afatgjatë energjetik. Ndaleni praktikën për të paguar borxhet e veriut dhe përmirësimin e instrumenteve qeveritare, mos lejoni të shterohet energjia elektrike. Pra, ju lutem, mos e bëni Kosovën të pajetueshme, ose përndryshe lëshoni rrugë se ne dimë dhe mund të udhëheqim me vendin.

Unë e dëgjova ministren dhe më vjen keq kur thotë ministrja që me të vërtetë ne jemi duke e bërë punën ashtu siç duhet. Ministre, më duket se nuk je në detyrën e duhur se qytetarët boll kanë blerë qebe, boll kanë blerë agregate, mirëpo kot. Edhe pse i kanë shterur xhepat, ju jeni ata që keni premtuar që nuk do të mungojë rryma, por deri më tani nuk kemi parë asnjë veprim dhe tani shoh vetëm vajtim. Lërimi vajtimet, qytetari do rrymë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të LDK-së, fjalën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit i nderuar Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi dëshmitarë të gjithë, pavarësisht se çfarë ka ndodhur, pajtohemi se të gjithë po ballafaqohemi me muaj të tërë e me vështirësi të jetesës që nga paslufta me këtë reduktim të energjisë. Kriza nga pandemia, kriza nga rritja e çmimeve dhe çdo artikulli, reduktimet e tmerrshme të energjisë, kthimi i ndjenjës së pasluftës, si një traumë e kthimit prapa, e jo e ecjes përpara. Rritje e dëshpërimit, zhgënjimit, mungesës së shpresës.

Të nderuar deputetë,

Kriza energjetike ka lënë foshnjat pa ngrohje në këtë acar. Mungesa e rrymës ka vështirësuar jetën e atyre që janë në koma, ku luftojnë me vdekjen në çdo çast. Ka rënduar shërbimet shëndetësore për të sëmurët në përgjithësi, në shtëpi, ambulanca, spitale.

Mungesa e rrymës e ka bërë jetën të papërballueshme për këdo. Ka detyruar shumë mërgimtarë t'i ndërpresin pushim dimërore, e të kthehen sërish në vendet prej nga vijnë, që t'i kalojnë atje pushimet për shkak të kushteve të rënda me energji në Kosovë.

Bizneseve u ka shkaktuar humbje. Ndalja e rrymës ka shtyrë që të blejnë agregate apo gjeneratorë disa qindra euro, e disa biznese tanimë edhe janë mbyllur.

Mezi kanë pritur bizneset tona që të ringjallet në sezonin e dimrit, në festat e fundvitit kur vijnë mërgimtarët, duke i obliguar që të blejnë gjeneratorë e të bëjnë shpenzime të paplanifikuara. Kanë ndodhur edhe mashtrime të tjera dhe qytetarët tanimë janë të thyer dhe të dëshpëruar nga kjo Qeveri.

Jo vetëm që qytetarët kanë pasur reduktime diku me orë të tëra, e diku ka pasur furnizim vetëm një fazë dhe asnjëherë nuk ka ardhur rryma komplet në shtëpitë e tyre dhe kanë pasur vështirësi elementare që të jetojnë.

Të nderuar deputetë,

Arsyetimet e Qeverisë janë të pabaza. Thonë, është krizë kudo, por pyetni njerëzit që i njihni në Maqedoninë e Veriut, në Shqipëri, në Luginën e Preshevës, në Malin e Zi, fare nuk e kanë këtë gjendje sikurse Kosova.

Është propagandë që nuk shitet më, kur jemi të njoftuar me çdo gjë që ndodhë në rajon e në botë.

Gjersa shtet fqinjë kanë blerë energji elektrike muaj më herët, Qeveria Kurti është e vonuar. Ka qëndruar duke numëruar në vend, dhe nuk ka vepruar. Janë tallur me qytetarët e Kosovës, si kryeministri për shembull, me batanije që u përball dhe u bë qesharak nëpër të gjitha mediat sociale.

Ministrja me këshillat që të ndalen video-lojërat dhe që të dy janë bërë për t'u tallur me ta në media dhe te qytetarët tanë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë krizë energjetike, kjo Qeveri ka treguar se nuk di dhe nuk do të qeverisë. Refuzonte kur ishte në opozitë projektin e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re. Kur erdhi në pushtet refuzoi gazin amerikan dhe bënte shaka me disa gypa. Pra, Qeveria dështoi, sepse u vonuar të blinte energji elektrike. Dështoi se nuk i mori seriozisht paralajmërimet para gjashtë muajsh për krizën energjetike dhe çmimet e energjisë elektrike.

Gaboi ngase nuk kishte vizion. Gaboi sepse do duhej herët që të bënte negociata për importim të energjisë. Gaboi sepse e la Kosovën në terr, duke i shkaktuar dëme shumë milionëshe bizneseve

në Kosovë. Dështoi sepse i detyroi shumë mërgimtarë të ikin. Dështoi sepse qytetarët u dëshpëruan në festat e këtij fundviti. Dështoi sepse shumë shkolla mbeten pa rrymë dhe nxënësit u obliguan që të ndërpresin mësimin. Gaboi dhe dështoi gjithkund.

Prandaj, për një dështim të tillë, të paktën do të duhej të jepte llogari edhe për këtë gjendje të krijuar. Pse nuk jepni llogari, sepse në çdo dimër ka pasur rritje të nevojës për import e të blerjes së energjisë elektrike. Pse në vendimin për masat e energjisë nuk përmendet as ndihma e bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilët janë të obliguar që të blejnë gjeneratorë dhe Qeveria duhet t'i rumburësojë.

Pse në vendimin për masat emergjente nuk përmendet detyrimi i KEDS-it për milionat e premtuara për investimet në trafo-stacionet e vjetra. Ne nuk e paguajmë rrymën në veri, por KOSTT-i. E tash, a jeni të vetëdijshëm se si rrezikohet KOSTT-i të largohet nga ENTSO, ku është bërë përpjekje 10-vjeçare që të anëtarësohemi në ENTSO.

Po e përfundoj. Kriza energjetike sado që vjen prej rrethanave globale, ajo është tipike si rezultat i dështimit të Qeverisë së Kosovës, me mënyrën si nuk ka reaguar dhe ka bërë në vonesë dhe ka pasur arrogancë karshi qytetarëve dhe projekteve për energjinë.

Rryma duhet ta çojë në shtëpi këtë Qeveri dhe kjo Qeveri dështoi dhe qytetarët iu besuan, iu vlerësuan, iu votuan dhe kjo Qeveri dështoi tmerrësisht krejt dhe drejt. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Këtë diskutim nuk mund ta kalojmë pa e përmendur të kaluarën dhe vendimet e rëndësishme që janë marrë në këtë Kuvend, sigurisht nga qeveritë e kaluara.

Sepse, kjo situatë është rrjedhojë apo më mirë thënë pasojë e një situatë tjetër, prandaj edhe nuk ka se si të mos përmendet. Madje, thirrësit e këtij debati, besoj se e kujtojnë më mirë se ne kundërpërgjigjen nga deputeti i atëhershëm, e tash kryeministri i sotëm, zoti Albin Kurti, sa i përket privatizimit ani pse kanë kaluar nëntë vite nga ajo seancë plenare.

Lëvizja Vetëvendosje, qoftë me anë të protestave, qoftë këtu në Kuvend nëpërmjet debateve, që nga fillimi ka qenë kundër privatizimit të rrjetit shpërndarës dhe furnizimit me energji elektrike.

Rrjeti dhe tregu i saj janë pasuri e Kosovës. Infrastruktura e shpërndarjes së energjisë është monopol natyror dhe në këtë drejtim, çdo monopol privat në asnjë mënyrë nuk mund të jetë më i

mirë për ekonominë apo për qytetarët, sepse një monopol i tillë e bën absolut kontrollin e tij mbi sektorin e energjisë.

Eficienca e energjisë asnjëherë nuk është trajtuar nga qeveritë e kaluara, por do të trajtohet në Qeverinë Kurti, si potencial me prioritet të zbatimit nëpër sektorët e ekonomisë.

Gjendjen në sektorin e ekonomisë e keni pranuar pa një planifikim të kapaciteteve të reja energjetike dhe pa një vlerësim të numrit të njësive të gjenerimit. Edhe pse ishim të vetëdijshëm, problemet e shumta si mungesa e politikave për mbrojtjen e mjedisit, mungesa e furnizimit të rregullt me energji, mungesa e një strategjie të qëndrueshme e afatgjatë për energjinë, prapë nuk u bë as përpjekja më e vogël për të përmirësuar gjendjen.

Qeveria Kurti është duke u angazhuar për zhvillimin e sektorit të energjisë në funksion të mirëqenies të qytetarëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike. Kjo Qeveri është duke punuar që qytetarët të kenë komoditetin e duhur, e jo që individë të pasurohen. Kjo Qeveri është duke punuar që investitorët e huaj të mos kthehen mbrapshtë siç edhe ka ndodhur në të kaluarën.

Njëri prej praktikantëve të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, ia mohoi diplomon e inxhinierit, tha, le ta kthejë në universitet. Foli të pavërteta, linçime e gënjeshtër. Realisht, ai foli kundër shefit të vet, imitatorit të skajshëm të tij. Fundja, në vet, pikërisht Kurti, e bëri ministër dhe i dha mundësi menaxhimi.

Ju kujtohet ky praktikant imitator i verbër i Kurtit, pati refuzuar të bëhej ministër i Avdullah Hotit, sepse e dinte që ishte qeveri e paligjshme. Kompetencën e fitoi në kohën dhe qeverisjen e Kurtit, madje edhe kryetar i subjektit u bë pikërisht kësaj kompetence. Madje, nuk jam i sigurt se a e bëri Kurti apo partia e tij kryetar.

Të mos e harrojmë edhe një gjë, në shumë vendbanime ka prishje të qëllimshme. Pra, hiqen edhe siguresat qëllimshëm që të zgjatet ndërprerja e rrymës, e energjisë elektrike, në këtë mënyrë që të rritet sa më shumë pakënaqësia ndaj kësaj Qeverie.

Sigurisht, është mirë që ta shohim njëri-tjetrin në sy. Ta shohin veten në pasqyrë dhe po të kishte shtet të së drejtës dhe shtet ligjor, besoj se ata të cilët e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje, e dini se ku do të ishin.

Besian Mustafa përdori njëllëj bullizmi diskursiv ndaj ministres Rizvanolli duke ia bartur dertin se a po e djegim ne si kuadër i ri atë në mesin tonë, por po harron që para disa ditësh, këto kuadrot e reja në Lidhjen Demokratike të Kosovës, siç është ky kryetari i Prishtinës, kur u pyet për ish-kryetarin e LDK-së, tha, a është këngëtar.

Pra, nuk e dinte a është këngëtar apo ishte ish-kryetar i subjektit tuaj. Pra, të mos i bartni dertin kuadrove tona të reja e të vjetra, sepse ne dimë të menaxhojmë me ta, sepse jemi subjekt afirmativ edhe shumë demokratik. Mirëpo, prapë po e them, shikohuni në pasqyrë.

KRYETARI: Në radhë është deputeti i PDK-së, Ardian Kastrati.

ARDIAN KASTRATI: Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryetar dhe ju deputetë,

Se keni qejf të hyni pak në histori. 2000-2002 pesë milionë janë investuar për t'i revitalizuar blloqet. 2002 e tutje ka qenë ai mega i projektit 2100 MW, shoqëria civile e kundërshtonte, Luan Shllaku ka qenë njëri prej bajraktarëve.

Prej 2008 1 mijë MW, prej 2014, 2015 e tutje 600 MW, në fund ju e keni refuzuar edhe Contour Global.

Sot, është situatë shumë e qartë, ka terr, dhe terrin nuk e gjetët mes jush, po e sollët ju terrin, sepse nga 2008 e tutje këtu s'ka pasur reduktime. Ka mundur të ketë ndonjë avari, prishje, por terrin e keni sjellë ju. Nuk e keni gjetur mes jush. Kjo është sigurt.

Por, çfarë bëni tash në këtë situatë? Bizneset janë me gjeneratorë, njerëzit vuajnë nga të ftohtit. Ju kukatni. Jeni bërë Qeveri e kukamave, sikur bebet ue, ue, çka keni bërë 20 vjet, ue, ue 20 vjet. Ndaluni more se është situatë emergjente. Njerëzit kanë nevojë për rrymë, gjeni zgjidhje.

Situatën e keni pasur në dorë dhe keni mundur në verë që ta kontraktoni blerjen e rrymës qysh e kanë bërë këto kombet tona konkurruese, këto qeveritë rreth e rreth, me Maqedoni, me Mal të Zi, me Shqipëri me krejt. Keni dështuar në afat shkurtër, po dështoni në afatmesëm dhe jeni para një zgjidhjeje ose terr ose që qahet ue, ue, ose të rrisni çmimin e rrymës.

Dhe, përveç kësaj, do të thotë dilni dhe ato projektet afatgjate me një hipokrizi të pa konkurrencë, i arsyetoni që jo gazi amerikan nuk vjen asnjë litër, se me litra matke ky Besnik Bislimi, që vërtet është një hipokrit i pa konkurrencë edhe dorën në zemër prej që ka ardhur ky këtu, unë "stupcat" s'po o këqyri më kurrë, edhe i kërkoj falje Vedatit, por po i bën ky shumë konkurrencë.

Sepse, çështja e gazit të lëngshëm amerikan, mënyrën se si e keni arsyetuar ju, është vërtet në mënyrë hipokrite. Hajde-hajde ti këtu, ej ti që fol. Hajde fol këtu, mos fol atje, hajde fol këtu. Hej hajde fol këtu. Boll!

KRYETARI: Vazhdojeni diskutimin i nderuari deputet.

ARDIAN KASTRATI: Tani të çështja e gazit amerikan, nuk ka këtu diskutim se ka gaz të lëngshëm amerikan, është iniciativë rajonale së cilës nuk i jeni përgjigjur ju. Dhe, iniciativa

rajonale është kjo që në Aleksandropulos në qytetin grek është ndërtuar terminali, dhe aty përveç lidhje me TAP, do të vijë në të ardhmen edhe gazi i lëngshëm amerikan, i cili mund të transportohet në rajon pastaj.

Ju keni thënë se nuk lidhemi TAP-in. Madje, ky hipokriti apo ky humorist Besnik Bislimi thoshte se, këtu s'bëhet fjalë për gaz amerikan, por bëhet fjalë për gazin azer dhe rus. Imagjinojeni çfarë hipokrizie. Do të thotë përmes fondit të MCC së mileniumit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i japin fondet për diversifikim të energjisë që të ta sjellin rus përmes Maqedonisë. Pra, i bie diversifikim, por i bie difersifikim i gypave rusë, sepse do gypa i kemi në veri atje, Serbia është komplet në varësi nga energjia ruse, tash edhe një gyp m'ia sjellë kënde.

Por, nëse bëjmë fjalë për gazin azer, çfarë ka aty të keqe kur prej Shandenisdya atje në Azerbajxhan, 3 mijë km gyp deri në jug të Italisë shkon, e krejt Unionin Evropian do ta furnizojë me gaz, çfarë ka të keqe aty që në afatgjatë të mos lidhet edhe Kosova.

Mirë po pajtohem, s'doni me Maqedoninë. Të vetmit jeni ju dhe Qeveria e Serbisë që nuk jeni kyçur në këtë projekt rajonal, i cili ka për qëllim të sjellë gazin e lëngshëm amerikan në vitet e ardhshme, jo nesër, po në vitet ardhshme në rajon.

E keni takimin e kryeministrit Zajeve me nënsekretarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për energji, ku nënshkruan marrëveshje që të kyçet në projektin e terminalit për gazin e lëngshëm amerikan në qytetin Aleksandropulos.

E keni takimin e kryeministrit Edi Rama me ndihmëssekretarin amerikan për resurse, energji dhe zhvillim ekonomik, që të fillohet të ndërtohet terminali i stacionit dhe të rigazifikimit në Porto Romano në Durrës. E keni pastaj para këtij takimi edhe marrëveshjen e Belinda Balukut, ish-ministres me Exxon dhe Excelerate Energy për ta sjellë gazin e lëngshëm amerikan në Shqipëri.

Pastaj e keni edhe një zgjidhje tjetër strategjike që mundur ta shfrytëzoni, po e keni e keni refuzuar gazin e lëngshëm amerikan për arsye që vetëm ju i dini. Ai është gazsjellësi Uniono Adriatic 516 km që do të ndërtohet prej Durrësit deri në Split dhe do të kyçet edhe TAP-in në Fier.

Si realizohet ky projekt. Po, realizohet përmes fondeve të MCC të mileniumit. Unë pajtohem me ministren që nuk janë të gjitha fondet për gaz aty në MCC, por ka edhe fonde të tjera evropiane. Ju e keni projektin e terminalit të gazit të lëngshëm në qytetin Kërk në Kroaci, i cili është ndërtuar, ka përfunduar dhe madje të gjitha kapacitetet e tij u janë shitur arabëve atje, dhe ka bërë një bum ekonomik në Kroaci.

Madje, edhe Qeveria e Serbisë, duke qenë nën shantazhe të Rusisë, Bërnabiqi dhe Vuçiqi ka thënë, po edhe ne jemi të interesuar për këtë gaz, po s'kemi marrë ofertë nga Greqia.

Ju mund të jepni ndonjë arsytim tjetër, siç keni dëshirë kështu të jepni teori të konstipacioneve, ky këtu, edhe të thoni që, po, jo se kjo ka qenë njëfarë lobimi i lobit grek në departamentin e energjisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pastaj këta grekët ta shesin nëpër rajon gazim. Se kështu i kam dëgjuar disa prej jush, kur flisni nëpër korridore.

Po mirë, pse ju s'i keni futur në lojë edhe njohjen e Greqisë me kushtin e marrjes së këtij gazi. Ndërtimin e një terminali, ministresh, këtu afër Prishtinës se nuk kemi nevojë 2 miliardë euro infrastrukturë, le të fillojë me furnizim me Prishtinën. Po për sy të zi nuk ka qenë ai ministri grek, po kë të flasë? Me Gërvallën a?! Ajo e shkreta ka menduar që është ministri i Qipros apo i Mongolisë, se po i ndërron flamurët si kuleçtë e bukës, a po kupton.

Do të thotë, të gjitha këto kanë rënë në ujë dhe në fund e kemi këtë situatë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Bullgaria përmes bulgatrangaz i ka blerë 1/5, se harrova të aksioneve në Aleksadropulos. Maqedonia, po, Shqipëria, po, Kroacia, po, vetëm Republika e Kosovës dhe e Serbisë, jo.

Po a bëhet ky projekt nesër? Jo. Shikojeni rastin e Lituanisë, rastin e Turqisë, rastin e Greqisë, rastin e Bullgarisë, rastin e Kroacisë. Janë projekte afatgjata që kanë filluar që të punojnë që 10-15 vite dhe tash kanë arritur në lartësinë e diversifikimit të burimeve energjetike dhe të sjelljes së gazit të lëngshëm amerikan.

Dhe, për kokën tënde të thatë që flet u pa u ndalur, kur të vjen gazi i lëngshëm amerikan këtu, nuk ke nevojë për ushtarë amerikanë mbi tokë...

Zbardhni dhëmbët tash se ju qeshni edhe kur vdisnit prej COVID-it, injorantë. Pra, nëse kjo do të bëhej...

KRYETARI: Kujdes fjalorin, deputet i nderuar!

ARDIAN KASTRATI: Në plane afatgjate, ne do të kishim një siguri të dyfishtë në Kosovë.

KRYETARI: Të mos i kualifikosh deputetët ashtu.

ARDIAN KASTRATI: Ju mund ta shpjegoni. Ka edhe një mënyrë tjetër, është përmes marrëveshjes së Uashingtonit. Aty thuhet që korporata financiare amerikane për projektet ndërkombëtare do të ofrojë një paketë infrastrukturore, sidomos të bashkëpunimit dypalësh Kosovë-Shqipëri, që i bie, rregulli i këtij tubacioni që të lidhë me TAP në Fier në të ardhmen ose

me atë gazsjellësin Uniono Adriatic, po ju e keni refuzuar këtë marrëveshjen e Uashingtonit, nuk e doni.

Pastaj, Exim... aty në marrëveshje, thuhet: “Do t’i subvencionojë blerjen e gazit të lëngshëm amerikan”, që t’ia rrëzojë argumentet Serbisë dhe Ruisë se gazi i lëngshëm amerikan vjen më i shtrenjtë në treg, sepse duhet të bartet me tankerë, ky Besniku thoshte, duhet të barten me kamionë, shqyr që s’thoshte me kerr të kuajve, deri në rajon.

Këto janë argumentet e Serbisë e të Ruisë, sepse ai gaz në të ardhmen po qe se bëhet përmes këtyre projekteve nuk vjen më shtrenjtë në rajon. Pra, janë argumente që e mbrojnë, në fakt, çmimin e gazit rus në Serbi dhe në rajon, dhe ndikimin e tyre.

Diversifikimi, prandaj, ka qëllim që ta ndalojë ndikimin rus në rajon në të ardhmen. Rasti i Lituanisë na e tregon më së miri. Në rastin e Lituanisë, në momentin kur e kanë ndërtuar terminalin për gazin e lëngshëm amerikan, ia ka zbritur çmimin gazit rus në Lituani për 20%.

Por, tash të kthehemi te situata, afatshkurtër zero dhe afatgjatë zero, situata është terr. Tash keni mbetur në një pozicion të vështirë. Unë ju kuptoj që jeni në pozicion të vështirë, por s’jua kuptoj halucinacionet. Do të thotë, ju duhet të gjeni zgjidhje, zgjidhja nuk gjendet kështu siç flisni ju tërë kohën.

Nuk mundeni më këso pritje false, me shpresa të rreme ta rreni popullin, të thoni, hajt se ju votoni veç për inati të LDK-së, e të PDK-së dhe të AAK-së, e bëhet mirë. Jo! Ata po duan rrymë për të zier edhe për të bërë ushqimin, nuk ka më me këso shpresa të rrejshme. Prandaj, jeni treguar total të paaftë në menaxhimin e kësaj situatë dhe tash, urdhëroni, shtrenjtoni rrymën ose vazhdoni me reduktime. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, më shumë respekt për njëri-tjetrin, edhe deputetët për kolegët e tyre. Për shkak të një problemi teknik, ju lus që edhe një herë të deklaroheni, pra të më njoftoni cilët deputetë lajmërohen për fjalime, për diskutimet e tyre.

Në radhë është Shemsedin Dreshaj, në emër të AAK-së.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Përshëndetje, të gjithëve!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kriza energjetike veç ishte e definuar dhe e pritshme pas ndryshimeve në kontinent dhe paralajmërimit të ekspertëve.

Kosova kërkoi pavarësi energjetike që nga viti 2003, kur për herë të parë u tentua të implementohej Termocentrali C me 2000 MW, i cili u bë publik në vitin 2009, dhe premtoi që në 2015-n do të fillonte nga prodhimi i energjisë. Pastaj, u bë propozimi i dytë për 500 MW, i cili u kritikua, nuk u aprovua dhe krejt këto ishin në bazë të prodhimit të energjisë nga qymyri. Krejt këto iniciativa nuk u realizuan për shkak të rezistencës të disa OJQ-ve dhe opozitës, e cila sot e menaxhon vendin.

Ju kujtoj se Kosova me rezervat e qymyrit është njëra ndër vendet më të pasura në botë. Një burim natyror, të cilin kemi mundur ta përdorim, ta shndërrojmë vendin tonë në një vend të zhvilluar, por tani, si duket, linjitet i ka kaluar koha. Ju citoj: “Në vitin 2014 Banka Botërore ka paraparë që zhvillimi më i shpejtë i Kosovës do të bëhet me shfrytëzimin e linjitetit”. Njëjtë ndodhi edhe me termocentralet me gaz që ishin të planifikuara të ndërtoheshin, për të cilat u fol më herët. Gjendja, mos harroni, edhe më shumë do të përkeqësohet ditët në vijim, për shkak se Kosova A është para dekomisionimit, pra, para shpërbërjes dhe duhet ta largojmë për shkak të kontaminimit të ambientit. Ju përkujtoj se memorandumit i Akademisë serbe ka për mision që Kosova të shpallet shtet jofunksional si në aspektin ekonomik, politik dhe ekzistencial. A ka qenë ky qëllimi që Kosova të mos shfrytëzojë resursin e vetëm të bollshëm, në vlerën që e ka dhe të mbetet një vend i varfër dhe i varur në rajon me energji.

Programi qeverisës që nga prezantimi në Kuvend linte shumëçka për t’u dëshiruar, në secilin segment menaxherial, madje edhe në shtyllat themelore të promovuara si shëndetësia, ekonomia dhe arsimiti. Po ju jemi sot? Shëndetësia është me 57 milionë euro më pak në buxhet. Punëtorët pa ligj për paga. Arsimiti pa vijë buxhetore për hulumtime shkencore, ekonomia me veprime ad hoc, energjetika me gjeneratorë dhe terr. Veçori e qeverisjes së derisotme ka qenë fillimi nga e para, e jo panta rei, pra, të ketë vijimësi për veprimet e mira dhe distancim nga veprimet e këqija. Si duket, në veprimet e derisotme edhe kjo qeveri vazhdon avazin e njëjtë. Votuesi ju votoi për ndryshim dhe atë ‘krejt dhe drejt’, po pyes cili është ndryshimi? Veprimi ad hoc? restriksionet buxhetore, rikthimi i gjeneratorëve dhe i territ, kriteret të dyfishta të vlerësimit? Si e thashë edhe më lart, për situatën e sotme energjetike në vend nuk mund të akuzoheni vetëm ju si qeverisje, kanë përgjegjësi edhe qeveritë paraprake. Por, veprimet tuaja si opozitë në atë kohë ju implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjegjësi lidhur me situatën e sotme energjetike në vend.

Vërtet ishit opozitë dhe atë opozitë e fortë, për mosimplementimin e Termocentralit C, Kosovës së Re, madje edhe këtij të fundit, pra termocentralit me gaz amerikan. Ju përkujtoj se nga viti 2017 deri në vitin 2020, në tremujorin e fundit të çdo viti Kosova mesatarisht ka importuar 549 milionë MW, edhe atë me një trend të rritjes prej vitit 2017 deri në vitin 2020. Nëse ju intereson,

në vitin 2020 janë blerë 759 MW rrymë. Pyetja ime: pse nuk u parapagua rryma në kohën kur çmimi i energjisë elektrike dihej që do të rritej dhe oferta ishte tetë herë më e lirë se sa sot?

Nuk është kurrgjë e re që Kosova çdoherë ka blerë si me krizë, si pa krizë energjetike rrymën në muajt e dimrit. Përse, bile, nuk u përshpejtua procesi i kycjes në Termokos i qytetarëve të Prishtinës, në atë mënyrë që të reduktohet harxhimi i rrymës bile në kryeqytet. Sigurimi i kushteve themelore për jetë normale, si: rrymës, ujit, ngrohjes, kanalizimit, pagës meritore, pensioni dinjitoz, duhet të jenë prioritet i çdo qeverisje që del nga vota e popullit. I proklamuat me të madhe këto, a i keni edhe sot prioritet, ju pyes? Dialogu sindikal, sigurimi i pagës meritore, pensionet e dinjitetshme, kushteve themelore jetësore, mosdistancimi nga shtresat e gjera të popullatës, janë çelësi i një qeverisje të mirë dhe afatgjate. Kërcënimet, represaliet, shkarkimet e emërimet ad hoc janë pjesë e mendësisë totalitare. Ju përkujtoj një thënie nga Bibla: “Të ekzistosh, nuk do të thotë të jetosh”. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Luan Aliu. Halil Thaçi në mikrofonin e Luanit, a po? Mirë!

HALIL THAÇI: Përshëndetje për të gjithë!

Me të vërtetë është për të ardhur keq kur i dëgjon opozitën duke folur për vitet e kaluara, e që vetëm qytetarët e Kosovës dhe të gjithë punëtorët atje në korporatën elektro-energjetike e dinë se çfarë kanë bërë këta që 20 vjet pas luftës me korporatën elektro-energjetike.

U fol viti 2002 - 2004, fatkeqësisht në ato vite ka filluar shpërndarja e KEK-ut. Në ato vite, saktësisht në vitin 2003 është privatizuar sigurimi i KEK-ut, e që po vazhdon të jetë një barrë shumë e rëndë edhe sot për KEK-un. Në vitin 2003 është hapur dera e hajnisë dhe keqpërdorimit në KEK, e dinë të gjithë qytetarët këtë. Nuk mund t’u shitni moral qytetarëve e të thoni se për 9 muaj ditë na latë në terr. Në 2003 ka filluar dëmtimi I KEK-u, ka filluar vjedhja e KEK-u dhe për 17 vjet, 20 vjet me radhë tashmë është vjedhur e është keqpërdorur ky aset shtetëror. Këta deputetë që sot po qajnë me lot krokodili, fort mirë e dinë, sepse i kanë edhe sot e tutje vazhdojnë t’i kenë në menaxhmentin e KEK-ut njerëz të tyre të politikës, të emëruar pa konkurse, por të politikës që edhe sot po e sabotojnë KEK-un. Edhe sot, dhe jam shumë i bindur që Blloku B2 është një sabotazh.

Është një sabotim që iu ka bërë, shumë i bindur jam unë, zotëri, unë të dëgjova çka fole ti, unë jam shumë i bindur për këtë punë dhe do të dalin faktet për këtë punë, sepse fort mirë e tha edhe kolegu yt më herët, se ne kemi qenë të njoftuar 2-3 javë më herët dhe ky është një sabotim që po mundohet t’i bëhet kësaj qeverie, po mundohet t’i bëhet një ministreje të suksesshme dhe po mundohet t’i bëhet një drejtori të suksesshëm, i cili fatkeqësisht ende është i vetëm në menaxhmentin e KEK-ut, një njeri i pakorruptuar dhe që jam shumë i bindur që do ta kthejë në të mirë dhe në të mbarë KEK-un. Mirëpo, a ka punë? Ka punë shumë, sepse për 20 vjet keni

instaluar njerëz aty për të përfituar tenderë. Sot, zotëri, është mosha mesatare e punëtorëve në KEK është 58,5 vjet. Nuk keni pranuar punëtorë vetëm t' i hapni tenderë vetit, firmave tuaja.

Pra, për 20 vjet ju keni keqpërdorur me KEK-un dhe sot për tre muaj ditë një emërim i një drejtori që është bërë në mënyrën më ligjore dhe me një konkurs të mbikëqyrur nga ambasadat ndërkombëtare, ju sot qani me lot krokodili se gjoja se qenka Qeveria jonë fajtoje për këtë punë. Mirëpo, me një kryeministër dhe me një qeveri të tillë, do të ketë sukses edhe KEK-u. Faleminderit!

KRYETARI: Nga PDK-ja fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Po dua të filloj fjalën time me një falënderim për kryeministrin shqiptar, Edi Rama, i cili konsideroj që me vendimin e fundit, me atë për të cilën u deklarua që do t' i dalë Kosovës ndihmë për dy ditë të festave, doli përtej këtyre përplasjeve politike dhe e dëshmoi që do t' i ndihmojë popullit shqiptar. Konsideroj që është një vendim i mirë dhe si deputete, natyrisht dua që ta përkrah e ta mbështes.

Në ndërkohë ne sot kur kemi diskutuar gjatë gjithë ditës me kolegët, në pikën e shumë problemeve të mëdha që i ka Kosova me energji dhe kur është pritur që kryeministri ynë të jetë sot në këtë sallë për t' iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve dhe natyrisht për të ofruar perspektivën e tij lidhur me zgjidhjen që do të bëjë me problemet që i ka Kosova me energji, kryeministri po e shoh që e paska konsideruar më prioritare të jetë pjesë në hapjen e seminarit të dytë shkencor në Fakultetin e Inxhinierisë Kompjuterike. Natyrisht unë vlerësoj një seminar të tillë dhe konsideroj që do t' i ndihmonte shkencës, por në kohën kur Kosova, Parlamenti, Qeveria, qytetarët në veçanti përballen me mungesë të energjisë dhe kur kriza është ende në fillim, kryeministri injoron këtë Kuvend, injoron deputetët dhe injoron për më tepër qytetarët e vendos që të shkojë e të bëhet pjesë e seminareve në takimet e tij hapëse.

Konsideroj që Parlamenti është tribuna e tij ku ai do të duhej të ishte e të fliste për këto probleme. Pra, paralajmërimet se Kosova do të përballlet me krizë të energjisë janë paralajmërimet të para disa muajve, nuk janë aktuale. Pra, edhe ne si Parti Demokratike e Kosovës e kemi thënë kohë më parë, muaj më parë kemi paralajmëruar për krizën që do ta presë vendin dhe të njëjtën gjë ka bërë dhe shoqëria civile. Nuk kam asnjë dilemë se në rast se këto paralajmërimet do të merreshin në konsideratë nga Qeveria, ku do të fillohej të mendohej e të planifikohej më qartë, atëherë kjo krizë do të kalohej edhe më lehtë. Natyrisht që këto paralajmërimet jo vetëm që nuk janë marrë në konsideratë e nuk janë trajtuar drejt nga kjo qeveri,

por janë injoruar dhe janë përqeshur. Pra, sot kur po flasim, po flasim në kohën kur është vetëm fillimi i përballjes me krizën me energji elektrike.

Debati për energjinë, kolegë deputetë, konsideroj se para se gjithash do të duhej që të shihej nga këndvështrimi i përmbushjes së kërkesave që kanë qytetarët e Kosovës, por edhe të bizneseve për të siguruar një furnizim stabil. Kam pasur rast dje t'i vizitoj disa biznese në komunën e Prishtinës, besoni, kolegë deputetë, operojnë në kushte tejet të rënda, me humbje të mëdha dhe me pamundësi që biznesi i tyre në këto rrethana të pandemisë të gjenerojë të hyra, sepse ju e dini, çfarë goditje kanë marrë pjesë e konsiderueshme e bizneseve të mesme e të vogla gjatë periudhës së pandemisë. Pra, vizioni politik i Qeverisë në lidhje me mungesën e energjisë elektrike është ky: Qeveria po thotë ose kurseni rrymën, rrjedhimisht mos u ngrohni e privohuni nga jeta juaj normale, ose në të kundërtën do të paguani më shtrenjtë energjinë elektrike.

Sepse, siç e dini, e kemi një kryeministër të aftë për të krijuar kriza, një kryeministër gjithashtu të paaftë për t'i zgjidhur dhe për t'i menaxhuar ato kriza. Reduktimet e energjisë elektrike kanë shpërfaqur edhe një diskriminim që po u bëhet qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, u tha me të drejtë nga zoti Krasniqi që sot kemi reduktime tepër të gjata në fshatra, 4 orë, 6, deri në 8 orë nëpër zona rurale. Pra, në fshatra, por edhe në lagje të caktuara të komunave të Kosovës. Prandaj, kjo Qeveri përveç që u ofron ose terrin, ose faturat e rritura, gjithashtu ofron edhe diskriminimin që po u bëhet qytetarëve të Kosovës. Pra, kriza energjetike në vendin tonë, e cila erdhi bashkë me këtë qeveri, na tregoi se Vetëvendosja, besa Albin Kurti janë fjalë shumë e punë pak.

Jo shumë kohë më parë, zyrtarë të lartë të partisë në pushtet, në mesin e të cilëve edhe deputetë që sot janë në krye të dikastereve të rëndësishme qeveritare, protestonin rrugëve të Prishtinës kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike. Pra, Kryeministri Kurti me bashkëpartiakët e tij të Vetëvendosjes kanë bërë aq shumë deklarata sa ishin në opozitë, sa që nuk mund t'i numërosh. Ato nuk mund të përmbliidhen me pak fjalë, dhe janë kryesisht deklarata, të cilat i fajësojnë qeveritë e ndryshme se i kanë harruar hallet e qytetarëve të varfër, e nuk po bëjnë asgjë që t'u dalin në ndihmë atyre, por po ua vështirësojnë jetën duke rritur kështu dhe çmimet e energjisë elektrike.

Tash, zoti kryeministër, i cili nuk është këtu edhe ju kolegë të Vetëvendosjes po dua t'ju them se qytetarët nuk mund të mbështeten vetëm kur janë në opozitë, aq më shumë mund të mbështeten tani kur ju keni numra dhe keni mundësi reale që t'i përkrahni ata. Hiç më larg se dje, Kryeministri i Kosovës, duke lënë prapa krahëve të tij dhe në harresë fjalorin e tij opozitar, u tha qytetarëve të Kosovës se nuk ka zgjidhje të mirë, ose reduktime të energjisë ose shtrenjtimit të energjisë. Kjo është një fjali që me pak fjalë tregon se Qeveria e Kosovës i ka braktisur qytetarët e saj dhe nuk do të jetë në gjendje të ofrojë asnjë zgjidhje tjetër të situatës. Pra, qytetarët kanë

vetëm këtë zgjidhje në javët dhe në muajt në vazhdim: ose të përballen me reduktime, ose të përballen me rritje të çmimeve të energjisë.

Duke e parë se si kjo qeveri po përballlet me këtë krizë, qytetarët do të përballen me këto dy problematika: edhe me reduktime të energjisë, edhe me shtrenjtim, edhe me varfërim të tyre, për të cilin Lëvizja Vetëvendosje ishte shumë e zëshme sa ishte në opozitë, pra kjo do të vijë sepse Kryeministri Kurti nuk po u jep përgjigje qytetarëve se si do të përballohet kjo krizë. Këtë zgjidhje, këtë përgjigje nuk e dha sot. Nuk e tha a është për shtrenjtim të energjisë, a është për reduktimet e energjisë, sepse nuk ishte këtu për të thënë qoftë edhe një fjalë të vetme për këtë krizë të madhe, në të cilën vetëm sa është futur Kosova. Pra, Kurti që fajësonte qeveritë e kaluara për çmimin e rrymës, sot nuk u përgjigjet qytetarëve se çka do të bëjnë që të mos shtrenjtohet energjia elektrike për 40%, ashtu siç është paralajmëruar.

Sot Kryeministri i Kosovës nuk po interesohet për hallet e vërteta të qytetarëve të këtij vendi. Ai po mundohet vazhdimisht që t'i injorojë ato. Prandaj, kolegë, nuk e gjeni për tu ballafaquar as në debatet televizive, nuk e gjeni që të ballafaqohet as në këtë seancë plenare, as në tryeza, edhe në ato paraqitje të rralla për mosreagimin e tij, ai përherë dhe vazhdimisht mundohet të fajësojë të tjerët. Pra, kur është në Kosovë, ai qahet para qytetarëve e nuk ndërmerr asgjë, e kur është jashtë Kosovës, ai u flet homologëve të tij se si vendi ynë po përjeton ringjalljen dhe rritjen e pashembullt të ekonomisë që nga paslufta.

Pra, kolegë deputetë, Kosova ka më shumë se 1 dekadë që nuk ka probleme me energjinë elektrike, këtë e thanë edhe kolegët e mi. Ka më shumë se një dekadë që premtimi për furnizim të rregullt me energji elektrike nuk eksiton më në fjalorin e politikanëve dhe më kot u mundua që edhe sot të thuhet se qeverisjet e kaluara qenkan fajtoare. Mund ta pyesim këtë qeveri cila është alternativa dhe qasja e saj në raport me situatën që e kemi sot.

Pra, kriza energjetike është sfida e parë dhe natyrisht është sfida më e madhe e kësaj Qeverie të zotit Kurti dhe shpresoj shumë që do ta kuptoni se qeverisja nuk është vetëm retorikë, e aq më pak nuk është vetëm fajësim i të tjerëve.

Kryeministri Kurti duhet ta dijë që errësirën, reduktimet, që agregatin, që qeben, i ka sjellë qeverisja e tij, nuk i kemi sjellë ne në diskursin tone, e aq më pak nuk i kemi sjellë ne në jetën e qytetarëve, edhe ashtu të rënduar gjatë pandemisë. Pra, justifikimet dhe arsyetimet nuk sjellin as ngrohje, e besa nuk sjellin as drita. Pazotësia e kryeministrit është duke e thelluar edhe më shumë krizën e shumë familjeve dhe bizneseve në Kosovë. Përfundimisht, sot e tëra që mund të bëjë kryeministri është ose të mbulohet me qebe, ose të fajësojë qeveritë e kaluara, ashtu sop po bën përherë.

Por, për një gjë të tillë të jeni të sigurt se Kosovës nuk i duhet një kryeministër, i cili mbulohet me qebe, e aq më pak nuk i duhet një kryeministër i cili nuk merr përgjegjësi dhe nuk udhëheq. Natyrisht, që kryeministrit i mbetet që ta zbusë terrin e rëndë, në të cilin ai e ka futur Kosovën bashkë me qytetarët e saj.

KRYETARI: Nga AAK-ja, kryetari i grupit, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ne diskutuam diku për rreth katër orë në pikën e parë të rendit të ditës, kur Qeveria e prezantoi vendimin për gjendje të jashtëzakonshme, për të cilën ne si grup parlamentar votuam. Pra, ne abstenuam me kërkesë që të inkorporohen edhe disa rekomandime konkrete, mirëpo edhe në atë pjesë që goxha shumë u konsumua si pjesë e debatit, po edhe në këtë pjesë që e kemi thirrur si grup parlamentar, mendojmë pak a shumë ia kemi huqur debatit.

Shikoni, përgjatë katër orëve ne kemi bërë një analizë të të gjitha vendeve të rajonit, e bile edhe në Evropë. Folëm për Francën, folëm për Serbinë, folëm për Shqipërinë, folëm për Maqedoninë, por nuk folëm konkret kurrgjë për vendin tonë. U trajtua në nivele të ndryshme adresa e përgjegjësisë. U fol për KOST-in, për KEK-un, për KEDS-in, për ZRRE-në, për Ministrinë e Ekonomisë e të Financave, në mënyrë që të lidhet adresa e llogaridhënies.

Po ashtu, folëm për disa koncepte ndërkombëtare, thënë të drejtën, as vetë s'i kuptova dhe besoj që as qytetarët e Kosovës s'i kanë kuptuar, për shkak se ato nuk prodhojnë zgjidhje. Pastaj, hymë në histori, e kthym në vëmendje ministrin e parë të energjisë të Kosovës, zotin Ethem Çeku, i cili asgjë në mos pastë bërë, e dimë të gjithë që ka qenë një buldozer të shtyjë përpara Kosovën C. E përmendëm Haki Shatrin, e qe besa analizuam edhe vendimet e vitit 2010 e 2018. U fol edhe për punë të konspiracionit, të siguresave, të rrymës, vjedhjes së rrymës, dëmtimeve të qëllimshme, e kështu me radhë. Bile-bile, u recituan edhe disa poezi e poema për ministrin e kryeministrin, e kështu me radhë, por në fakt, për çka e kemi thirrur ne këtë debat?

Ne jemi në këtë debat të kërkojmë prej Qeverisë qartësi, pra debatin që e kemi sjellë para qytetarëve të Kosovës përmes përfaqësuesve të popullit, është që Qeveria të na japë qartësi në raport me veprimet që do t'i marrë në nivelin afatshkurtër dhe në nivelin afatgjatë. Në nivelin afatgjatë e kemi një strategji, një dokument. Kryeministri Kurti tha që është edhe një dokument duke u përpiluar, në rregull. Mirëpo, çka na intereson? Na interesojnë hapat konkretë, në mënyrë që të kemi një qartësi. Për kënd? Në radhë të parë, për qytetarët e Kosovës.

Të gjithë jemi të vendeve të ndryshme dhe po flasim sinqerisht njëri me tjetrin. E dimë që ne në Prishtinë me të vërtetë shumica prej nesh i ka nga dy orë reduktimin, sikurse e dimë saktësisht, sikurse e dimë që unë jam Besnik Tahiri, që në fshatra dhe qytete të tjera reduktimi është mbi 5-7 orë, e kështu me radhë. Pra, ka reduktim masiv.

E dyta, pse kërkojmë qartësi për veprime konkrete prej Qeverisë, për çka? Sepse, përveç dëmtimit familjar, kemi një dëmtim zinxhior që afekton prodhimin vendor. Pra, secila fabrikë që ka një ndalesë të rrymës dhe e ndez agregatin, menjëherë ka një humbje dhe këtu rashë ndesh kur fola për komoditetin, se këtu nuk ka të bëjë me komoditet, ka të bëjë drejtpërdrejt me humbje, me dëmtim kolateral të një organizate buxhetore private, në këtë rast, fabrikë apo çfarëdo që është.

Pastaj, kur flasim për veprimet konkrete duam të ndërlidhemi pak edhe në aspektin e sigurisë. Qeveria ka kërkuar “shkymni dritat”, një-dy “shkymni dritat”. Po pyetja shtrohet: a jemi në Kuvend këtu? Kush e merr përgjegjësinë në qoftë se ndodh një vjedhje serioze në dokumente, në mbrëmje, kur kamerat e sigurisë nuk e evidentojnë një hajn? A e merr Qeveria e Kosovës, e marrin policët që janë te dera, a e merr kryetari i Kuvendit, a sekretari? Kush e merr atë përgjegjësi në të gjitha institucionet publike? Në këtë kuptim duhet parë këtë pjesën më të gjerë sesa po e trajtojmë me një rekomandim “shkymni dritat”.

Te kërkesa për llogaridhënie, unë mendoj që kërkesa për dorëheqje të ministres, doktor i shkencave që ka studiuar në Angli, kolege jona, për dorëheqje është gabim dhe nuk është e drejtë, për arsye se kjo ka marrë një detyrë, e ka një portfolio, të cilën realisht po mundohet ta kryejë, po mundohet të bëjë diçka. Në qoftë se kërkojmë dorëheqje, duhet të kërkojmë dorëheqje tek organi kolektiv, tek Qeveria, për shkak se Qeveria është ajo që e ka emëruar Bordin, jo ministrja. Qeveria është ajo që e ka emëruar Bordin e ZRRE-së, jo ministrja. Nuk jam avokat i ministres, veç të kuptohemi, por në qoftë se flasim për llogaridhënie, llogaridhënia është tek organi kolektiv, te kryeministri Kurti dhe te mosveprimet që nuk kanë ndodhur tash e tutje.

Ajo që ne kërkojmë prej këtij debati është shumë e thjeshtë. Mos na e bini punën ta shtrijmë dorën e të lypim lëmoshë. Po na bie ta falënderojmë kryeministrin Edi Rama. Më së pari ai kryeministri, Qeveria s’ka marrë asnjë vendim. E ka bërë një postim në Tweeter, ka thënë unë do t’i shikoj të gjitha mundësitë, do të kërkoj nga ministria përkatëse ta vlerësojë, që t’i ndihmojë për Vitin e Ri, dy ditë. Mos na e bini punën ta shtrijmë dorën! Merrni veprimet konkrete në raport me sanimin e gjendjes, mënyrën që doni ta bëni, edhe në qoftë se keni nevojë, energjia nuk është as e një partie, as e një subjekti politik, as e një qeverie, këto shkojnë e vijnë. Është jona, jemi të gatshëm të ndërtojmë një konsensus nacional në këtë temë.

Andaj, si thirrës të këtij debati, kërkojmë që Qeveria të na japë qartësi, të na japë veprime konkrete dhe, mbi të gjitha, të raportojë jo se qysh po nxeht apo si po e siguron rrymën Franca,

Shqipëria, Serbia e Mali i Zi e Maqedonia, po të na tregojë se sa do të jenë reduktimet në qytet, sa do të jenë në fshatra, kur do të sanohen dhe le të na garantojë që të mos ketë rritje të çmimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Jeta Statovci.

JETA STATOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Pa dyshim që kjo nuk është një situatë e izoluar, andaj është e nevojshme dhe e natyrshme që të shikohet në retrospektivë në raport edhe me zhvillimet kronologjike, që e kanë sjellë situatën deri në këtë pikë.

Pra, nëse e shikojmë vetëm se çfarë resurse dhe çfarë potenciali të jashtëzakonshëm energjetik ka Kosova, është një anomali që ende në këtë periudhë ne të kemi situatë të krijuar ndër vite, që të kemi mungesë të një stabiliteti energjetik. Përkundër gjithë potencialit dhe resurseve të jashtëzakonshme, gjendemi në një situatë kur nuk mund të flasim për një stabilitet energjetik.

E kuptojmë saktë që rëndësia e energjisë është përtej rëndësisë së energjisë vetëm si element në ekonomi. Faktikisht, rëndësia e saj del edhe përtej asaj individuale, për arsye se prek edhe shumë degë të tjera të zhvillimit ekonomik. Kështu që, ka edhe efekte multiplikative që prekin edhe dikastere të tjera të jetës, andaj duhet trajtuar dhe duhet të ishte trajtuar ndër vite me shumë kujdes dhe rëndësinë e nevojshme.

U tha që ka rëndësi për sektorët e tjerë. E dimë dhe na është vazhdimisht se paraqet një pengesë të jashtëzakonshme për zhvillimet e mëtutjeshme të bizneseve. Pra, është raportuar në studime të ndryshme se numërohen disa qindra milionë euro humbje për shkak të jostabilitetit energjetik, e shpeshherë është edhe arsyeja që Kosova të mos jetë atraktive për investime të reja nga biznese të caktuara.

Mirëpo, përkundër këtyre kapaciteteve dhe resurseve që i ka, pra nëse shikojmë statistikën, ne shohim që faktikisht ne ende jemi në një situatë që më shumë importojmë se sa eksportojmë. Pra, statistikën tregojnë që diku rreth për tetë muaj Kosovës i paraqitet nevoja që të importojë energji elektrike, kurse katër muaj në tërësi, pra gjatë verës kryesisht, e ka mundësinë që faktikisht të bëjë eksport të energjisë elektrike jashtë Kosovës.

Kurse, në raport me situatën aktuale, besoj se tashmë është evidente që kjo del përtej vetëm situatës aktuale në Kosovë dhe është evidente edhe më gjerë. Besa, të them të drejtën, edhe javëve të kaluara kishim edhe një paralajmërim edhe nga National Greef, pikërisht në Angli, se

për shkak të ngarkesës do të mund të ketë problematikë në raport me furnizimin e nevojshëm të të gjithë qytetarëve dhe ekonomive familjare e fabrikave që funksionojnë në tregun e tyre. Edhe arsytet besoj se janë të qarta, që janë përtej normave ditore të operimit, pra e kuptojmë që rikthimi pas goditjes pandemike që e kishim, goditjes me një krizë shëndetësore, ishte në një zhvillim më të lartë sesa ajo që ishte parashikuar. Dhe, ky kthim prapa kaq i shpejtë dhe dinamik jodomosdoshmërisht arriti të përcillej me furnizimin e nevojshëm me energji.

Element tjetër është gjithashtu edhe ndryshimi i agjendave karshi furnizimeve të sektorit me energji. Pra, nëse shikojmë ndër vite kryesisht në raport me gazin natyror dhe me qymyrin, diku në vitin 1981 furnizimi nga këto dy burime kryesisht ka arritur vlerën 84%, e cila është vlerë po e njëjta edhe vitin e kaluar. Dhe, kjo ka rishikuar, ose ka bërë shtetet të rishikojnë agjendat e tyre kryesisht drejt burimeve alternative, për shkak edhe të afekteve të tyre ambientale.

Mirëpo, ne ndodhemi në një situatë të tillë e besa ende nuk e kemi stabilitetin financiar, mirëpo është e pafalshme të evitojmë faktet për mundësitë e humbura që kemi pasur ndër vite. Kujtojmë një varg temash, që janë vazhdimisht të përsëritura karshi energjisë. Nëse shikojmë transkriptet e vitit 2007 të diskutimeve të bëra po në këtë Kuvend, ne faktikisht e shikojmë një diskutim për një ndërtim të një kapaciteti energjetik me rreth 2100 MW, e cila si justifikim kishte faktin se do të rriste eficiencën, do të bënte sanimin e pasojave të krijuara nga termocentralet elektronike, do të prezantonte teknologji më moderne si dhe do të ishte më miqësor me ambientin.

Pra, ky një diskutim i filluar nga viti 2007, që fillimisht u prezantua si 2100 MW, e pastaj u përcoll edhe me opsione të tjera me rreth 1100 MW. Po ashtu, diskutim i radhës ishte edhe në vitin 2015, ku u fol edhe nga kompani gjermane që të ndërhyjnë në termocentralet tona dhe të bëjnë rehabilitimi i Termocentralit A, së bashku me blloqet e veta. Mirëpo, edhe kjo rastisi në një refuzim të heshtur, e cila besoj se e kujtojmë tani, që kishim të përfshirë edhe aleatë e miq tanë, e jodomosdoshmërisht arriti mbështetjen e nevojshme.

Përkundër investimeve që ishin të nevojshme, ne patëm edhe disa targete të tjera. Targete në raport me burimet e ripërtëritshme, të cilat në bazë të raporteve pritej që do t'i kontribuonin sektorit të energjisë me rreth 25% deri në vitin 2020 – 2021. Kurse, nëse shikojmë vlerat e tanishme, ne shohim që në sistemin tonë faktikisht këto burime të ripërtëritshme i ndihmojnë sektorit me rreth 5%. Pra, të gjitha këto iniciativa me radhë jodomosdoshmërisht arritën që të prodhonin efektin e dëshirueshëm dhe kjo shkaktoi një ngecje të vazhdueshme të sektorit, që sado që të tentohet të bëhet një zgjidhje e shpejtë, është e pamundur për shkak të komplikimeve dhe specifikave që ka ky sektor dhe nevojën për investime në këtë sektor.

Unë besoj se është për t'u lavdëruar të gjitha përpjekjet që në kushte në të cilat gjendet Qeveria, mundohet ta bëjë menaxhimin sa më të saktë dhe sa më korrekt në raport me situatën, në mënyrë që të mirëmbahet situata në raport me furnizimin, gjithashtu edhe me nivelin e çmimeve. Kur

kujtojmë faktin që Kosova për energjinë që paguan është diku rreth katërfish ose pesëfish, më e lirë në krahasim me çmimet referente të vendeve më të zhvilluara brenda Bashkimit Evropian. Mirëpo, kujtojmë që dhe kujtojmë faktin që ne e kemi faktikisht Qeverinë të angazhuar në subvencionimin e importit, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti i institucioneve, gjithashtu të sigurohet edhe stabiliteti në raport me furnizimin.

Kemi veprime karshi kthimit të dividendës, kemi ndarje buxheti me 4-5 milionë, i cili targeton pensionistët dhe familjet në asistencë dhe një varg masash të marra, në mënyrë që të krijojmë një situatë më stabile karshi situatës së krijuar me krizën energjetike. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë. Fjalën në emër të Qeverisë ia japim ministres së Zhvillimit Ekonomik, Artane Rizvanolli.

ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, të nderuar deputetë, për pyetjet dhe komentet!
Dua së pari të jap një sqarim lidhur me vendimin që nuk u votua më herët.

Deputeti Tahiri tha që do ta votonim nëse inkorporohen rekomandimet e tyre. Dua ta qartësoj, siç është thënë edhe në vendim, se këto nuk janë masa ‘perse’. Me vendosjen e masave emergjente themelohet një komitet teknik emergjent, i cili jep rekomandime. Domethënë, vendimet aty nuk janë politike, nuk i vendos unë, ose Qeveria, ose ndonjë entitet tjetër politik, mirëpo vendimet merren në bazë të një komiteti teknik emergjent, i cili përfshin të gjithë aktorët relevantë, duke përfshirë KOST-in, ZRRE-në, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, KESKO-n, KEDS-in dhe KEK-un. Kështu që, nëse kjo ka qenë arsyeja pse nuk e keni votuar, ju lutem, ta rikonsideroni edhe një herë.

Për çështjen e gazit kemi folur aq shumë, besoj që debati është shtjerrë. Po e përsëris edhe një herë, duke qenë se ky debat është për krizën energjetike, që të thuhet: “Pse nuk e keni vendosur ta ndërtoni gazsjellësin dhe termocentralin me gaz”, në kohën kur po përballemi me një krizë botërore, të shkaktuar nga çmimet e gazit, është absolutisht e pakuptimtë. Unë nuk di nëse nuk po e kuptoni këtë me të vërtetë, apo nëse po mendoni që qytetarët do të besojnë në këto përralla, po shpresoj që jo.

Dua të sqaroj disa gjëra. Shumë pyetje ishin. Na tregoni për reduktimet, e të tjera. Do të mundohem ta sqaroj situatën duke i sqaruar së pari rolet e aktorëve të ndryshëm në sektorin e energjisë dhe ne çfarë kemi bërë dhe ku jemi sot. Përgjegjësia për të siguruar energji të mjaftueshme për të mbuluar kërkesën u takon furnizuesve. Në rastin tonë, furnizuesi i ngarkuar me shërbimin publik të furnizimit universal me energji elektrike është KESKO.

Gjatë muajit dhjetor KESKO nuk ka blerë energjinë e mjaftueshme për t’i furnizuar konsumatorët. Si pasojë, për të mos ndalur furnizimin e qytetarëve, Kosova ka tërhequr në

mënyrë të paplanifikuar energji nga shtetet fqinje. Borxhet që KOST duhet të paguajë si pasojë e këtyre veprimeve të KESKO-s, vetëm nga data 6 deri në 20 dhjetor të këtij viti vlerësohet të jenë rreth 26 milionë euro, që është fiks sa është shitur distribucioni, ironikisht.

Pas disa vërejtjeve nga rrjeti evropian i operatorëve të sistemeve të transmissioinit, KOST është detyruar të bëjë shkyçje të këtyre operatorëve, me pasojë direkte në konsumatorët e energjisë. Pa paragjykuar mosaftësinë e një furnizuesi për të siguruar likuiditet të mjaftueshëm për të mbuluar ndryshimin në çmime të importit, ZRRE-ja sipas rregullave në fuqi ka shpallur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave për të parë mundësi të gjenerimit të mjaftueshëm të të ardhurave për të restauruar furnizimin me energji për të konsumatorët.

Për të zbutur ndikimin e çmimeve të importit në tarifa Qeveria ndau 20 milionë euro dhe subvencionoi blerjen direkte të energjisë nga importi përmes korporatës energjetike të Kosovës, KEK. Mirëpo, pavarësisht faktit që Qeveria tashmë ka siguruar fonde të mjaftueshme për të blerë energji për konsumatorët, Kosova vazhdon të devijojë në raport me sistemet fqinje të energjisë për shkak se një nga operatorët, KEDS, vazhdon të mos respektojë rregullat e lojës. Domethënë, pavarësisht që ne e kemi siguruar importin për konsumatorët dhe nuk do të duhej të kishim asnjë reduktim në këtë periudhë, përfundimisht furnizimi pa reduktime është në dorë të KEDS-it, i cili që nga data 20 dhjetor nuk i përmbush detyrimet për të blerë energjinë për të mbuluar humbjet e rrjetit të shpërndarjes, ose nuk e blen tërë energjinë të nevojshme për këtë.

Si rrjedhojë, KOST prapë detyrohet, ose të urdhërojë reduktime, ose të devijojë, ose të mbulojë koston e pambuluar nga KEDS. Gjithashtu, kjo kohë e krizës energjetike na ka treguar si kurrë më parë se sa e rëndësishme është pavarësia operative e vendimmarrëse e secilit operator që mbart funksione publike. Ne kemi arsye të besojmë se mangësitë në shthurjen e funksioneve të furnizuesit dhe operatorit të sistemit shpërndarës, përkatësisht KEDS dhe KESKO, duke lejuar që dy kompani me funksione publike të kontrollohen nga i njëjti aksionar. Gjatë kësaj kohe të krizës ka vendosur në pikëpyetje nëse me të vërtetë të gjithë këta operatorë janë të pavarur në vendimmarrjen operative dhe planifikuese, siç kërkohet me nenet 27 dhe 33 të Ligjit të energjisë elektrike, apo në raste të caktuara këta operatorë vendosin përpara interesit dhe detyrimit publik, interesat e mundshme komerciale që i kanë.

Presim nga ZRRE-ja që të trajtojë këtë çështje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe gjithashtu, ju përkujtoj që arsyeja pse KOST-i dhe KEK-u nuk janë të dyja, nuk e kanë të njëjtin aksionar, Kuvendin apo Qeverinë, por janë të ndara, janë pikërisht për këtë arsye. Ndërsa në rastin e një kompanie të privatizuar private, kemi lejuar që të kemi dy kompani me të njëjtin aksionar dhe duket se shthurja efektivisht nuk ka ndodhur kurrë. Kjo është duke na kushtuar, siç e tregova më herët, në rastin e zbatimit të kësaj ndihme dhe vështirësive që na kanë dalë si pasojë e kësaj, të cilat nuk do t'i përsëris, sepse i thashë në seancën e kaluar.

Si ministre e kam themeluar komitetin emergjent që do të merret me hapat operacionalë të menaxhimit të efekteve të krizës. Pavarësisht se kompetencat e ministrisë si mbikëqyrëse e aseteve gjeneruese të KEK-ut dhe hartuese e politikave afatgjata të sektorit janë të kufizuara në këtë aspekt, personalisht jam njeri që nuk iki nga përgjegjësia, sepse e ndjej që duhet të jem afër qytetarëve dhe e sinqertë me ta në situatën në të cilën jemi, edhe në momente të vështira si këto në të cilat po kalojmë.

Duhet të cek edhe njëherë që ne si Qeveri kemi siguruar fonde të taksapaguesve për të kthyer furnizimin e rregullt me energji dhe qytetarët vazhdojnë të mos kenë furnizim me rregull nganjëherë. Për këtë kërkohet përgjegjësi. Nga kjo foltore u bëj thirrje të gjitha palëve të interesit në sektor që të bëjnë rolin e tyre për tejkalimin e përbashkët të kësaj krize. Në KEK, si Ministri dhe si Qeveri do të punojmë që të evidentojmë problemet teknike në njësi gjeneruese dhe të identifikojmë masa parandaluese për të evituar daljen e papritur nga funksioni të kapaciteteve gjeneruese në të ardhmen.

Nga ana tjetër, u bëj thirrje KOSTT-it dhe ZRRE-së që të jenë në ballë të përgjegjësive të tyre dhe të evidentojnë dhe të saktësojnë të gjitha devijimet dhe shkeljet e rregullave të tregtimit të energjisë që bëhet në Kosovë dhe të marrin masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Juve që qeverisët deri dje e që na e sollët sektorin e energjisë në prag të humnerës, ju ftoj të bëheni pjesë konstruktive e zgjidhjes së problemit, ose së paku të mos i keqinformoni qytetarët në lidhje me shkaktarët e krizës dhe mjetet që i kemi në dispozicion si Qeveri për t'u përballur me krizën përballë situatës në të cilën na sollët.

Në këtë krizë nuk jemi vetëm, por vetëm së bashku mund ta kalojmë këtë. Qeveria tashmë ka ndarë njëzet milionë euro për blerje të energjisë nga importi, ia kemi kthyer dividetën prej njëzet milionë euro KOSTT-it për të pasur likuiditetin e nevojshëm për t'u përballur me krizën. Ne kemi bërë gjithçka të mundshme që të mos kemi reduktime në këtë periudhë, ndërkohë që punojmë për ta bërë shtetin tonë më pak të ndjeshëm ndaj krizave të tilla në të ardhmen. Hapat e menjëhershëm të cilët jemi duke i ndërmarrë janë krijimi i kushteve për të ndërtuar kapacitete të reja të energjisë së ripërtërishme.

Gjatë vitit që vjen, do të vazhdojnë punët e nisura, kornizën ligjore e rregullative për burimet e ripërtrishme të energjisë, lansimin e ankandeve të para për burimet e ripërtërishme të energjisë, rritjen e kapaciteteve të KEK-ut përmes inkuadrimin të 100 MW të energjisë solare, heqjen e barrierave për bizneset që të investojnë në panele solare, duke mundësuar që ato të kenë fatura më të lira të energjisë, duke prodhuar një pjesë të energjisë vetë dhe në këtë mënyrë edhe të bëhen më pak të ekspozuara nga krizat e jashtme siç është kjo e këtyre ditëve. Kjo është një kërkesë e cila vjen nga vetë bizneset dhe për të cilën do të bashkëpunojmë bashkë me ZRRE-në për të punuar në këtë drejtim.

Në strategji të energjisë jemi duke shqyrtuar investimet që sigurojnë qëndrueshmërinë e kapaciteteve tona gjeneruese ekzistuese dhe nga ana tjetër do të promovojmë eficiencën e energjisë, duke investuar në izolim të shtëpive e format e tjera të ngritjes së eficiencës së energjisë, posaçërisht për familjet e varfra të cilat nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë vetë. Edhe përmes ndërhyrjeve fiskale, për të ngjitur eficiencën e energjisë dhe alternativat për ngrohje me ndikim më të ulët ambiental.

Do të vazhdojmë e të punojmë pa ndalur që pasojat e kësaj krize të kalohen sa më lehtë dhe për këtë kërkoj bashkëpunimin e të gjithë juve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Një replikë e ka kërkuar Besnik Tahiri lidhur me fjalën që sapo e pati ministria Rizvanolli.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Më shumë është një sqarim. E para, ne kemi marrë pjesë në votim dhe prapë do të votojmë, por do të abstenojmë, për shkak se nuk e dimë se cilat do të jenë masat konkrete. Ne e kemi parë që keni prezantuar një komitet teknik emergjent, po nuk dimë. Pra, s'mund ta votojmë, për shkak se ne kërkojmë veprime konkrete. Ne do të votojmë, por do të abstenojmë.

E dyta, këtu kam dy ligje, Ligjin për energjinë elektrike dhe e kam Ligjin për energji. Te kapitulli 7, te neni 25, është një përshkrim i saktë se çka duhet të bëjë Qeveria në një situatë krize. Për neve, është totalisht e papranueshme që është vonuar d.m.th. pesë muaj apo gjashtë muaj, apo tre muaj u vonua ky vendim, ose në rastin tonë prej kur e kemi ngritur si çështje para dy muaj e gjysmë dhe nuk kemi ardhur në këtë temë.

Sa i përket kërkesës sonë për të ditur më shumë, më konkretisht, qartësisë që e kërkojmë ne prej jush, është shumë e thjeshtë. Po ta marrë një shembull. P.sh. e ke një lajm në njërin prej portaleve, thotë pjesa te Qershitë e Llapashticës, fshati Sekiraçë dhe Gllamnik kanë mbetur pa rrymë qe 15 orë. Në atë pjesë, që është pjesë e Podujevës, janë diku njëqind biznese të vogla. Kjo është arsyeja pse po kërkojmë qartësi. Nuk po duam ne d.t.th. në këtë debat të nxjerrim elemente që lidhen me akademinë e teorinë e ndryshme, por po duam që konkretisht të shkojmë. Për këtë arsye, ne si grup parlamentar do të marrim pjesë në votim, do të abstenojmë për t'i parë veprimet, se e konsiderojmë si tejet të rëndësishme që Qeveria të marrë një masë emergjente dhe konkrete. Ju faleminderit!

KRYETARI: Po, ministria e ka të drejtën e saj që të përgjigjet në këto që u ngritën nga Besnik Tahiri.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Edhe një herë dua të sqaroj, legjislacioni në fuqi e specifikon se si merren masat dhe kush i merr masat dhe cilat është procedura. Gjithashtu ju

informoj se komiteti teknik në fakt është mbledhur, duke qenë se sipas ligjit, sipas nenit 25 dhe sipas udhëzimit administrativ për këtë çështje, vendimi për masat emergjente hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Kryeministri, d.m.th. në datën e votimit në Qeveri.

Ky komitet është mbledhur, ndërsa kërkohet pastaj aprovim nga Kuvendi brenda shtatë ditësh. Komiteti teknik emergjent është mbledhur ditën e shtunë, të shtunën që kaloi, d.m.th. të nesërmen pasi është votuar propozimi në Qeveri. Llojet e masave të cilat parashihen në udhëzimin administrativ dhe në ligj kanë të bëjnë me masat e ndalimit ose të kufizimit të furnizimit me energji. Detyra shtesë për ndërmarrjet ose kushte specifike të tregtimit. Komiteti teknik nuk e ka parë të nevojshme vendosjen e masave kufizuese në këtë kohë. Rekomandimi i komitetit teknik ka qenë që të gjitha palët, duke përfshirë KEDS-in, të bëjnë nominimet për kërkesën e nevojshme për energji, duke qenë se nuk ka tanimë arsye, duke qenë se Qeveria e ka mbuluar koston për konsumatorët e rregulluar, nuk ka nevojë që të ketë reduktime. Ky ka qenë rekomandimi, nuk ka pasur nevojë për vendim për këtë, sepse kjo veç specifikohet me legjislacionin në fuqi. Kjo nuk është diçka që duhet të përforcohet edhe me një vendim të ministres, i cili rrjedh nga rekomandimet e komitetit.

Sa i përket çështjeve të tjera, kanë qenë edhe disa rekomandime teknike të nivelit më të ulët të them ashtu, si p.sh. masat e efijencës brenda institucioneve publike dhe këto jemi duke i bërë në mënyrë të brendshme, sepse kemi konsideruar se nuk ka nevojë për vendim specifik. (ndërprejje nga regjia)

KRYETARI: Tash fjalën e ka deputeti Jahja Kokaj.

JAHJA KOKAJ: Faleminderit zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të nderuar,

Kolegë deputetë,

Është gjë shumë fisnike që ne të bisedojmë për problemin e energjisë, në kohën kur qytetarët vërtet kanë shumë probleme serioze me energjinë. Prandaj, fakti që ne bisedojmë, ata na shohin, është diçka që ne jo vetëm të solidarizohemi, por bëjmë, shtrydhim trurin, mundohemi që të gjejmë një zgjidhje sa më optimale, sa më fatlume për ta.

Prandaj, në këtë kontekst, unë e shoh edhe diskutimin e tyre fisnik. Por, më lejoni t'ju them se disa diskutime më tepër po më duken jo për të zgjidhur problemin e qytetarëve, jo për të diskutuar për rëndësinë dhe zgjidhjen e këtij problemi, por më tepër për të plasuar sulme, pickime, interesa partiake, të cilat nuk i kontribuojnë as zgjidhjes së energjisë as interesit të qytetarëve. Prandaj, ky është një mendim i imi, mos ma shihni për të madhe, por është një mendim që ndoshta do të kishte qenë mirë të kthehemi në problemin konkret. Problemi konkret kërkon një kronologji të zgjidhjes. Kronologjia është të identifikohet problemi dhe të propozohet

zgjidhja. Tash është fakt i pamohueshëm që për ta filluar ndërtimin e një termocentrali, kërkohen të paktën shtatë vjet që të realizohet. Tashti kur akuzohet dikush që s'ka momentalisht energji që para shtatë vitesh s'ka qenë në Qeveri, po më duket që është arbitrare, jo e logjikshme. Po më duket që është abstrakte, mos ta quaj tendencioze. Prandaj, në këtë kontekst mendoj që të shikojmë faktin që ka qenë dashur, ajo që ka qenë dashur, s'është mirë ndoshta mirë të përmendet, por të përmend faktin që prej pasluftës, ne si prioritet u koncentruam në infrastrukturë dhe dhamë disa miliarda atje në infrastrukturë. Është e mirë infrastruktura, por në këtë kontekst, konsideroj që në kronologjinë apo në hierarkinë e problemeve që duhet të zgjidheshin, ma merr mendja që u zgjodh jo kronologjia adekuate ose hierarkia adekuate.

Mu edhe nga jeta e dini që së pari duhet masa, d.m.th. energjia, pastaj vjen komunikimi. D.m.th. masa e energjia e përcakton jetën e komunikimi vjen pastaj. Prandaj, ma merr mendja që ka qenë dashur që të mendojmë ndërtimin ashtu siç Avni Kurshumliu po e propozonte që ta forcojmë d.m.th. kapacitetet energjetike në Obiliq, që të prodhojmë më tepër se 2300 MW dhe pastaj neve të vazhdojmë me aktivitete të tjera, siç janë arsimi, shëndetësia, ndërsa pastaj vjen qarkullimi e komunikacioni dhe infrastruktura. Ky është mendimi im në qoftë se flasim për diagnozën.

Tashti të kthehem në rastin hë për hë, në rastin konkret. Çfarë duhet të bëjmë? Propozimi im konkret është që në mënyrë urgjente ta aftësojmë Kosovën B, që të rrisim kapacitetet urgjentisht, që të arrijmë të paktën që Kosova B ta tejkalojë 650 MW. Një propozim tjetër që e kam dhënë që është ndoshta i karakterit afatmesëm që të mendojmë për ndërtimin e një fabrike për ndërtimin e paneleve solare. Jam koshient për faktin që ekziston lënda e parë këtu në Kosovë dhe ka ekzistuar një iniciativë gjermane në një legjislaturë të caktuar, por për arsye arbitrare, që nuk dua të futem në karakter të kritikave, ata u larguan. Po të ishte aprovuar ajo, tashti ne do të kishim panelet solare, të cilët do të ishin shumë të lirë.

Unë mendoj që me një aktivitet të tillë, pra energjinë solare, duke e parë edhe faktin se së shpejti akumulatorët do të jenë shumë të lirë, do të jenë me aftësi akumuluese shumë më të madhe, në kohë shumë më afatgjate, atëherë në simbiozë të këtyre çështjeve, pra të prodhimit të energjisë solare, e cila patjetër duhet, unë e kam parë në Zvicër, atje afër Delemont një 'mont soleil' pothuajse disa fshatra ekskluzivisht jetojnë me energji solare. Por, unë u futa atje i pashë ato detaje të atij gjeneratori apo këtij burimi energjetik dhe pashë që rolin kryesor e kishin akumulatorët, i cili fliste ai. Problemi i akumulimit është kryesor në këtë aspekt. Prandaj, po mendoj që meqenëse tash veç nga viti i kaluar është bërë një zbulim kolosal për mënyrën e magazinimit apo mënyrën e akumulimit të energjisë, që tash akumulohet dhe akumulimi bazohet në polarizimin e elektrolitit, atëherë kemi mundësi neve që të realizojmë pra një efikasitet, pra një energji alternative që është shumë e mirë direkt prej protoneve të diellit.

Kur flasim për fotone të diellit, duke mos ju ngarkuar me informacione teknike, të them që pavarësisht se është ditë e mjegullt apo ditë e vrerët apo është ditë me diell, fotonet vazhdimisht

japin energji. Për më tepër, ato që janë ultraviolete kanë energji më të madhe fotonike, d.m.th. energji individuale. Kështu që ne kemi ditë bukur të gjata gjatë vitit dhe se kjo formë, kjo mënyrë alternative ma merr mendja që në afat në kuptimin afatmesëm do të jetë një zgjidhje mos ta quaj ideale, por optimale.

Mandej, të përfundoj për propozimin dhe zgjidhjen. E para është që të aftësojmë kapacitetet që të kalojmë 1200 MW në Kosovën B dhe A, duke e siguruar që të mos kemi ndotje të ambientit, apo ta eliminojmë a zvogëlojmë në minimum CO₂. Por njëkohësisht edhe një lidhe simbiotike ashtu siç e thashë më herët me Shqipërinë dhe se ne huazojmë energjinë gjatë verës, ndërsa ata na huazojnë energjinë, d.m.th. na e kthejnë gjatë dimrit. Gjatë dimrit nivelin e ujërave e kanë të lartë, prandaj hidrocentralet prodhojnë energji me kapacitete të larta, kurse gjatë verës ne mund t'i furnizojmë atëherë kur niveli i ujit bie poshtë. kështu që d.m.th. bëhet një interes simbiotik, jo folklorik, po simbiotik. Në anën tjetër, meqenëse do të vijmë kufizimet, pra do të jetë pragu i eliminimit të CO₂, të bëjmë si dy shtete, atëherë do të kemi mundësi ta tejkalojmë atë prag bashkërisht si një sistem karshi kërkesave për një minimum të emetimit të CO₂.

Prandaj këto janë disa probleme konkrete të cilat ma merr mendja që japin një zgjidhje afatmesme dhe afatgjate. Kurse, për problemet afatgjate i kam edhe disa minuta. Nuk dua t'ju përmendi faktin që ne e kemi diellin dhe mënyra më e mirë është shfrytëzimi i diellit, d.m.th. i energjisë diellore, që edhe pse është 150 km larg nga këtu, ai që shtatë miliard vite na rrezaton dhe se ka mundësi edhe diku shtatë miliard të tjera të cilat nuk janë të rëndësishme për këtë mbledhje, pra për këtë Parlament, por që ne duhet të jemi koshient për faktin që ajo energji është energjia më e pastër dhe se duhet të mendojmë në të gjitha format e mundshme që sa më shpejt, në mënyrë sa më efikase, në mënyrë racionale dhe optimale ta shfrytëzojmë atë energji. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Partia Demokratike, deputetja Floretë Zejnullahu e ka fjalën.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kanë kaluar më shumë se tre muaj kur Partia Demokratike e Kosovës ju ka paralajmëruar për krizën energjetike, por ju e injoruat sepse si Qeveri dhe si subjekt, vuanit nga paranojat dhe nga tendenca për të gjetur armiq e për të mos pranuar asnjë këshillë.

Albin Kurti dhe Vetëvendosje së bashku me partnerët e tyre në qeverisje, Listën Serbe dhe atë Guxo të Vjosa Osmanit, qysh nga fillimi i qeverisjes së tyre kanë neglizhuar secilin problem me të cilin është përballur vendi dhe qytetarët.

Ju nuk e keni marrë seriozisht virusin COVID-19 dhe si pasojë mijëra qytetarë kanë humbur jetën nga vonesa e ardhjes së vaksinës në Kosovë. Ju jeni të njëjtë që keni neglizhuar problemin

me energjinë dhe keni dështuar të ndërmerrni veprime konkrete, të cilat do ta gjenin Kosovën të përgatitur për këtë krizë me të cilën po ballafaqohen qytetarët e vendit. Kjo nuk është thjesht krizë me mungesë të energjisë elektrike, dimensionet e saj të mëdha dhe fajtori dihet, jeni ju Qeveria e Albin Kurtit dhe subjektet politike në koalicion qeverisës.

Përveçse pa energji elektrike efektet multiplikuese të kësaj Qeverie, janë të shumta. Bizneseve, përveç pasojave nga pandemia, tani u është shtuar edhe barra e energjisë. Ato duhet të blejnë agregate dhe derivate me çmimin më të shtrenjtë në rajon për të funksionuar, sepse nga mungesa e rrymës ato duhet të mbyllen. Qytetarët kanë mbetur pa ngrohje si pasojë e mungesës së energjisë elektrike.

E përmendi më herët edhe deputet, kolegu nga AAK-ja, i cili foli për krizën energjetike me të cilën po ballafaqohet Komuna e Podujevës, saktësisht fshatrat Gllamnik, Llapashticë. Zonja ministre, nuk morëm përgjigje nga ju. Këto fshatra përreth 20 orë janë duke u ballafaquar me mungesë të energjisë elektrike, dhe duhet ta keni një përgjigje për këtë, ju të paktën si ministre.

Qendrat e mjekësisë familjare në Kosovë mbesin pa rrymë dhe pa ngrohje, e me këtë edhe qytetarët nuk marrin shërbimet e nevojshme mjekësore dhe mjekëve dhe infermierëve u vështirësohet puna.

Albin Kuti nuk kishte kohë të merrej me problemin e energjisë, sepse ishte në luftë me sindikatat e punëtorëve, të cilët po kërkonin trajtim të dinjitetshëm e ngritje të pagave, ndërkaq kjo Qeveri nuk ua ofron asnjërin, madje ua kanë ndaluar dhe zvogëluar edhe shtesat.

Kriza e madhe energjetike nëpër të cilën Kosova, për fat të keq është mesazh i qartë edhe për investitorët potencialë në Kosovë. Ju jeni duke i larguar ata nga Kosova, lerë më se bëhet fjalë që dikush të vijë dhe të investojë në Kosovë, e as biznesi mashtrues Gjonbalaj, që premtonte mbi 50 milionë euro investime, nuk erdhi dhe nuk të vijë askush, sepse të gjithë e kanë parë dhe po e shohin çdo ditë mashtrimin që vjen nga ju.

Albin Kurti dhe Vetëvendosje në vazhdimësi kanë deklaruar se Kosova nuk është prekur nga kriza energjetike dhe ne kemi kapacitete të mbulojmë shumicën e konsumit vendor. Pra, ju keni treguar një neglizhencë shumë të madhe dhe amatorizëm total, e këtë e keni bërë jo vetëm për arsye të mosdijes, por edhe për shkak të kalkulimeve politike.

Sot, pasojat po i vuan e gjithë Kosova. I vuajnë qytetarët rezidentë të Kosovës, e këto pasoja në kohë festash do t'i jetojnë dhe vuajnë edhe bashkatdhetarët që kanë ardhur për pushime. Edhe ata i keni mashtruar. Por, edhe ata do ta shohin dhe do ta jetojnë mashtrimin tuaj gjatë këtyre ditëve.

Gjendja është edhe më keq, sepse nuk kemi qartësi se deri kur do të zgjasë një situatë e tillë, edhe më pak, cilat janë masat që po ndërmerren për të tejkaluar këtë situatë. Mbase, Albin Kurti dhe Vetëvendosje si masë konkrete e shohin pagesën e një eksperti gjerman, prej 11 840 euro në ditë. 11 840 euro në ditë paguhet ky ekspert ose 248 650 euro për vetëm tri javë. Por, kjo nuk është zgjidhja, ky është thjesht mashtrimi i radhës.

Kjo është fyerje për qytetarët e vendit dhe fyerje për të gjithë punëtorët dhe ekspertët e zotë që ka Kosova. Janë po ata, të cilët e bënë të mundur që Kosova të mos ketë probleme me energjinë elektrike për më shumë se 10 vjet. Tani, kur sipas jush, erdhi dita, në fakt në Kosovë dhe për Kosovën e qytetarët e saj, erdhi vetëm terri.

Sot, çdo ditë po rrezikohet furnizimi i qytetarëve të Kosovës me energji elektrike. Sot, i presim bashkatdhetarët tanë nga diaspora pa rrymë e pa ngrohje. Sot, nuk mjaftojnë arsyetimet e fajësimet. Sot, Qeveria po deklarohej që pret zgjidhje nëse bie shi e borë në Shqipëri.

Nuk mjafton që të presim që të vijë një ekspert një gjerman për të rregulluar turbinën e Bllokut 2 në Kosovën B, nevojiten veprime konkrete, e kjo Qeveri nuk e ka as dijen dhe as kapacitetet që të bëjë më shumë.

Për fat të keq, këta një hall e kanë, të tmerruar nga vota qytetare në zgjedhjet lokale, janë duke tentuar që të shkojnë në zgjedhje nacionale sa më parë, sepse e dinë që çdo ditë e tutje, humbja për ta do të jetë edhe më e madhe.

Sa për t'ua kujtuar, derisa ne debatojmë në terr e në të ftohët, para disa ditësh, Qeveria e Maqedonisë së Veriut nënshkroi një kontratë huamarrje për 28,9 milionë investime në ndërtime e gazsjellësit me Greqinë. Në ndërkohë, Albin Kurti dhe Vetëvendosje me partnerët e tyre, kanë refuzuar projektin amerikan për ndërtimin e gazsjellësit në Kosovë.

Rritja e çmimit të energjisë në kohë të rritjes së përgjithshme të çmimeve pa ofruar alternative për ngrohje, do të ketë ndikim katastrofal në ekonominë familjare të qytetarëve tanë.

Sot, ngrohja nuk është luks, nuk është komoditet vetëm për Zyrën e Kryeministrit, Presidentes dhe ministrave, është nevojë dhe e drejtë elementare për secilin qytetar. Ju jeni dhe do të mbaheni në mend si Qeveri që vetëm keni krijuar konflikte me të gjitha shtresat në vend. Keni krijuar kriza diplomatike dhe ekonomike, dhe nuk keni ofruar asnjë zgjidhje.

Por, tani është koha e fundit që Qeveria të fillojë të bëjë punën e vet. Të ushtrojë përgjegjësitë e saj ligjore. Të mos shpik armiq të paqenë, të largohet nga paranoja dhe të qeverisë. Të mos arsyetohet, por të marrë përgjegjësi dhe të krijojë zgjidhje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ramush Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Kryetar, unë po e lë në fund. A duhet që propozuesi të flasë në fund?

KRYETARI: Po mirë e ke. Lerë në fund, sepse propozuesi e ka fjalën, natyrisht. Kalojmë te deputeti Artan Abrashi.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Meqë jemi në fund, unë pata vetëm të shtoj diçka rreth atyre deklarimeve që i thanë më herët zotit Lumir Abdixhiku dhe zoti Memli Krasniqi, por meqenëse asnjëri nuk është këtu në sallë, unë nuk kam arsye që t'i ngre ato shqetësime.

Vetëm dua të pyes kështu, nuk e di se sa është e lejueshme që një deputet i Kuvendit të Kosovës, edhe pse është lider, të jetë kaq i papërgjegjshëm në punën e tij në Kuvendin e Kosovës.

Në Rregulloren e Punës së Kuvendit, po dua ta di, a ka ndonjë trajtim të veçantë të të qënurit kryetar i partisë? Nëse jo, atëherë a duhet të marrë sanksione Kuvendi ndaj tyre, sepse brenda muajit po vijmë vetëm 10 minuta, po flasim edhe po dalin jashtë.

Brenda një viti, i bie që 120 minuta të punojnë këta. Për 120 minuta këta paguhet 20 mijë euro, 2 orë. Po as shoumeni më i mirë në botë nuk paguhet 20 mijë euro. Pak po më duket e padrejtë zoti kryetar i Kuvendit, që për shkak të papërgjegjësisë së këtyre dy personave, ne të barazohemi me ta.

Unë e tërheq fjalën natyrisht, se s'kam as për kë të flas, veçse njëmend kjo është shumë shqetësuese. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë ka kërkuar për këtë që tha zoti Abrashi, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Nuk mundem pa i reaguat Artanit, edhe pse boll mik e kam. Ne tash e disa muaj ankohe mi për papërgjegjësinë e kryeministrit, për mungesën e tij edhe sot në seancë.

Një njëri që udhëheq shtetin e Kosovës, e udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe a po e shihni se në çfarë shtate kemi ardhur. Mazhoranca ankohet pse dy liderë të partive opozitare nuk janë në Kuvend. Është krejt e parëndësishme kjo puna a janë në Kuvend apo nuk janë në Kuvend, është krejt e parëndësishme.

Pra, është e rëndësishëm që sot në Kuvend të jetë kryeministri Kurti, të ballafaqohet me sfidën. Nuk menaxhohet kriza energjetike me postime në Facebook, qysh është duke u munduar.

Prandaj, sot erdhëm me njëfarë terri informativ, pa e ditur se çfarë ka për të ndodhur me këto reduktime të ashpra, dhe po dalim, po ashtu, në terr informativ. Jemi prej orë 12:00 jemi në debat dhe s'na thatë asgjë.

Edhe një pyetje, a do të vazhdojmë reduktimet a jo? Ju na thoni, po s'e dimë, me gjasë do të vazhdojnë, me gjasë nuk do të vazhdojnë. Pra, paqartësi të mëdha. Nuk është more problemi i Kosovës opozita. Problemi i Kosovës është paaftësia e kësaj Qeverie, paaftësia e këtij kryeministri, paaftësia e këtyre ministrave. E gjithë Evropa, i gjithë rajoni ynë është në krizë energjetike. Nuk është faji i opozitës.

Por, papërgjegjësia të cilën ju e keni duke e treguar, po e thellon edhe më shumë krizën në vend. Po i dëmton edhe më shumë bizneset e vogla dhe të mesme. Po i dëmton ekonomitë familjare. Faleminderit!

KRYETARI: E shqyr që paska ndërruar diçka sivjet, se gjithnjë opozita ka qenë problem në Kosovë. Ia japim fjalën ministrit Hekuran Murati.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm sa për sqarim. Kryeministri Kurti e ka përgjegjësinë dhe përsëkrimin e punës si kryeministër i vendit dhe paguhet për atë punë dhe i kryen po ato detyra.

Sa herë që është e nevojshme ka qenë këtu, është përgjigjur në pyetjet parlamentare. Pra, asnjë kryeministër tjetër nuk ka qenë më i përgjegjshëm sesa kryeministri Kurti. Ndërkaq, sa u përket juve si deputetë, do të duhej që së paku në seanca, e sidomos kryetarët e subjekteve të jenë këtu, për shkak se ata paguhen për të qenë këtu.

Kryeministri Kurti është këtu për të dhënë llogari sa herë që ka nevojë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalimi i ministrit paska qenë i suksesshëm, se shumë replika ka shkaktuar. Ia japim fjalën fillimisht kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, meqë fole i fundit Abelard, pastaj të kthehemi ty.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Tash, në këtë mbrëmje po dalin edhe margaritarë nga ministri i Financave, se kryeministri vjen në seancë sa herë që e vlerëson të rëndësishme.

Sonte me propozimin që vet e ka çuar Qeveria dhe nuk i ka numrat që të kalojë, sepse nuk vjen që të flasë me Kuvendit, kryeministri, e quan të parëndësishme, se më shumë se gjysma e vendit në këtë moment është në terr. Dhe, e quan të parëndësishme që të jetë pjesëmarrës. I gjithë problemi, tash reduktohet, a janë apo s'janë dy deputetë të opozitës në sallë.

Unë po ju garantoj se nëse ju e zgjidhni problemin e energjisë elektrike, pa u bërë 10 minuta të dy kryetarët e partive i keni këtu. Veç na premtoni që do ta zgjidhni problemin e energjisë elektrike.

Kryeministri i përgjigjet Kuvendit. Kur Kuvendi e thërret në debat, vjen këtu edhe bisedon me Kuvendin. Kur kryeministri thërret nëpërmjet deputetëve të tij, seancë të jashtëzakonshme për një vendim të Qeverisë, duhet të jetë në Kuvend që ta arsyetojë vendimin e Qeverisë, dhe jo të thuhet, e ka parë të parëndësishme që kryeministri të jetë në Kuvend.

Paramendojeni se ku ka degjeneruar gjendja mendore e ministrit që thotë, e konsideron të parëndësishme që në këtë seancë të marrë pjesë. E parëndësishme që të marrë pjesë në këtë seancë, kryeministri. Çfarë t'ju them tjetër, kur kryeministri e konsideron të parëndësishme pjesëmarrjen në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Artan, nuk ka replikë për replikat. Jo. Atëherë, mund ta kesh një kundër-replikë. Një kundër-replikë për replikën që e pati me fjalimin tënd, Abelard Tahiri.

ARTAN ABRASHI: Në fakt, në kohë krizash, kryeministri duhet të jetë në krye të detyrës dhe kjo krizë nuk gjen zgjidhje këtu në Kuvend, pikërisht duke diskutuar e debatuar me shkaktarët e kësaj krize.

Kryeministri që dy herë e gjen Kosovën si ndërmarrje në prag të falimentimit, e pikërisht nga këta të cilët janë shkaktarë të kësaj gjendjeje, kërkohet super-produktivitet dhe krejt kjo çka ndodhi në Kuvend nga opozita, është thjesht, një farsë dhe një hipokrizi.

Kryeministri le t'i kryejë detyra e veta, ashtu siç është duke i kryer, por ju na jepni përgjigje, se pse këta që japin ide brilante, markante, këta dy kryetarët tuaj, janë barrë buxhetore, janë abuzuesit më të mëdhenj me buxhetin. Kështu së paku po duket deri tash.

Edhe kryetar, a duhet të merren masa apo jo me Rregulloren të re? Kjo është çështja. Pra, unë po flas për çështjet që kanë të bëjnë me Kuvendin e Kosovës. Për punën e kryeministrit, jeni opozitë dhe ju merreni. Pra, kemi të bëjmë me një papërgjegjësi këtu dhe kjo papërgjegjësi nuk është e tolerueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Gashi, kjo ishte kundër-replika e Artan Abrashit, për Abelardin. Tash, merre me mend Abelardi nuk ka të drejtë, sepse këtu mbyllet qarku, e ti po thua që për kundër-replikën ndaj Abelardit, po e dua fjalën. Urdhëro! E ka përmendur më herët në fjalim e tij.

Dëgjo! Për Zotin na del prej... A e di qysh, po e bëjmë në një mënyrë tjetër që të mos e shkelim bash aq... OK! Ia japim fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në qoftë se kryeministri i vendit e quan të parëndësishme që të merr pjesë në këtë seancë, në qoftë se deputetët e pushtetit sillen në këtë formë me deputetët e opozitës, atëherë ne deklarojmë që largohemi nga seanca deri në pikën e radhës. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Tash, fjalën e ka deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: I nderur Kabinet qeveritar, apo më mirë të them, dy ministra sa keni mbetur prej Kabinetit qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Para dite e kishim seancën e jashtëzakonshme për vendim që e ka marrë Qeveria për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, për gjendjen me energjinë elektrike.

Edhe ky debat i kontribuon kësaj krize dhe po mundohemi që bashkërisht të shtjellojmë se ku janë problemet dhe cilat janë pasojat edhe të keqmenaxhimit të situatës edhe të keqqeverisjes.

Jo vetëm që nëntë muaj që është kjo Qeveri Kurti, por gati që dy vite, pasi që ndërrimi i menaxhmentit të KEK-ut, është nga Qeveria Kurti 1.

Qytetarët me të drejtë e drejtojnë gishtin e kritikës drejt Qeverisë Kurti, sepse kjo Qeveri nuk mund t'i ikë përgjegjësisë në pafundësi. Ata qytetarë që ua kanë besuar qeverisjen e vendit e që janë mbi 50%, sot po ata bashkë me qytetarët e tjerë, ankohen në qeverisjen e zotit Kurti.

Sot, qytetarët janë duke u përballur me terr, me reduktime, me të ftohët, me mungesë të energjisë, për punë dhe mirëqenie.

Njerëzve nga diaspora, të cilëve u jemi mirënjohës çdoherë për ardhjen e tyre në shtëpitë e tyre, janë ata që iu besuan më së shumti, por janë po ata që për një kohë të shkurtër sa e vizitojnë Kosovën përballen me keqqeverisjen dhe keqmenaxhimin. Përballen me terr, përballen me të ftohët, përballen me pasiguri.

Sigurisht, që pushimet e tyre të planifikuara i ndërprejnë, sepse nuk mund të qëndrojnë në këto rrethana.

Ekonomia e Kosovës është në një gjendje të keqe e të jashtëzakonshme. Bizneset janë duke vepruar me humbje dhe në një terren të pasigurt. Siç e thashë edhe më herët, nga Qeveria Kurti

1, është vendosur një menaxhment i ri, dhe si rezultat i çdo keqmeanxhimi të menaxhmentit të KEK-ut, është edhe vet keqqeverisja e Qeverisë Kurti.

Në çdo fillim të vitit, siç e dimë, bëhet bilanci energjetik në bazë të të cilit dihet qartë se si do jetë prodhimi për vitin në të cilin hyjmë e po ashtu, edhe importi. Pra, ka qenë e mundur që pjesa e importit të kontraktohet qysh atëherë, dhe sot nuk do t'i kishim këto probleme.

Pikë tjetër me rëndësi është që para çdo fillimi të sezonit dimëror blloqet servisohe në mënyrë që të ketë siguri për prodhim gjatë dimrit, në këtë rast, Blloku B2, edhe pse ka pasur ta ndalur prodhimin në fillim të nëntorit, nuk është ndalur fare dhe si pasojë e kësaj ka ardhur deri te defekti.

Ndërsa, është hera e parë që nga privatizimi i distribuimit, që Qeveria e subvencion një ndërmarrje private. Kjo ka ndodhur në qeverisjen e Vetëvendosjes dhe zotit Kurti si kryeministër.

Kam një pyetje për Qeverinë. Me çfarë çmimi KEK-u është duke e blerë importin e 1 MW dhe sa ia shet KESCO-s. Meqenëse, jemi mësuar që të mos kemi përgjigje direkte, unë e kam marrë një përgjigje.

Sipas të gjitha informatave, Qeveria apo në këtë rast KEK-u e blen me 300 euro MW dhe e shet me 90 euro. Sado që qytetarët e blejnë rrymën e shtrenjtuar, edhe pse me këto reduktime dhe pse duhet të qëndrojnë në të ftohtë.

Derisa ne jemi duke debatuar për krizën energjetike, disa qytetarë më njoftojnë se nuk ka rrymë edhe në qytetet e tyre, si: në Prishtinë, në Sofali, në Podujevë, Gllamnik, për 11 orë nuk ka rrymë, sikur në fshatin Kllodernicë në Skenderaj, në Fushë-Kosovë e në shumë qytete të tjera që ka dhe vazhdon të ketë reduktime të rrymës. Derisa në veri të Mitrovicës që e paguajnë edhe me shumë, edhe borxh të tyre, nuk ndalet rryma fare. Ndërsa, Vetëvendosja në aspektin strategjik le që i ka kundërshtuar ndërtimin e termocentralit të ri që duhet të kishte bërë zgjidhjen afatgjate të kësaj problematike, por edhe të alternativave të tjera.

Së fundmi e kemi parë se në një investitor potencial për investime strategjike me erë është larguar, i cili kishte planifikuar 111 milionë euro të investojë në Kosovë, ka ikur në veri të Mitrovicës. Fatkeqësisht, qytetarët duhet të shohin këtë keqqeverisje, këtë demagogji, hipokrizi të Qeverisë në të ftohtë e në terr, por për juve e rëndësishme është që e keni Qeverinë, si Vetëvendosje, ujë, rryma, problemet me rritjen e çmimeve, me paga minimale 170 euro dhe me Ligjin e pagave, gjendjen e rëndë shëndetësore, kjo nuk ka rëndësi për ju, sepse vetëm ankoheni në të kaluarën dhe me duart e tyre qytetari ua ka besuar të ardhmen.

KRYETARI: Në radhë është deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat që janë këtu,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Thënë të drejtën, si një deputete jo me shumë përvojë, disa herë kam pasur dilema kur ka pasur debate parlamentare se me çfarë përshtypje dhe çfarë përmbajtje dalim nga një debat dhe sot po e shoh që pas tërë këtyre orëve debat, personalisht nuk po marr mundin të flas në emër të të gjithëve, të dalim nga kjo sallë pa ndonjë përgjigje konkrete.

Pa hapa se si duhet të veprojmë në afat të shkurtër dhe afatmesëm, e këtu brengosëse nuk është vetëm veprimi, por edhe gjuha që përdoret nga vetë Qeveria dhe aktorët deputetë që janë pjesë e pozitës. Nuk zgjidhet problemi duke u krekosur dhe duke akuzuar të kaluarën dhe aktorët që dikur kanë qenë në procese të njëjta. Andaj, përgjigjen duhet ta gjeni në mesin tuaj, nëse ka nevojë për ndihmë dhe ekspertizë, ka njerëz që mund t'ju ndihmojnë dhe për këtë ju kisha lutur që ta merrni shumë seriozisht. Po dua edhe ministrin t'i them që kryeministri sot është dashur të jetë këtu, pavarësisht që ai ka punë në Qeveri, sot në fakt është dashur të jetë këtu, sepse po merret një vendim për gjendje emergjente, po diskutohen ide, alternativa, kritika, çka do qofshin ato, dhe nëse gjendja është kaq alarmante dhe serioze, sinqerisht është dashur të jetë këtu.

Po ashtu, kam nevojë t'i them diçka edhe shefit të Grupit Parlamentar, Besnik Tahiri, me rastin e "lëmoshës", si e quajti ai ndihmën e Shqipërisë apo Kryeministrit Edi Rama. Personalisht jam shumë falënderuese dhe nuk e shoh si një akt politik, më shumë se sa një akt i ndihmës që zakonisht e bëjmë pa menduar dy herë, pavarësisht raporteve politike dhe gjendjeve kush është në qeveri e kush nuk është dhe cilat janë marrëdhëniet partiake midis Kosovës dhe Shqipërisë. Thjesht, ne nuk kemi hezituuar asnjëherë të jemi afër Shqipërisë dhe ky akt është akt i njëjtë, sikurse ne kur kemi qenë për tërmet atje, e njëjta ndodh edhe sot.

Në fakt, ajo që është brengosëse është që ne sot e jetojmë një karma, Qeveria duhet të gjendet në këtë karmën që i kthehet nga një rezistencë konsistente në çdo projekt dhe proces që është dashur të bëhet për energjinë në Kosovë. U fol shumë edhe për termocentralin, edhe për projektin e gazit, hidrocentralet, të cilat vetë aktorët e shoqërisë civile dhe aktorët e Vetëvendosjes dikur kanë lobuar, por që sot prapë bëjnë zhurmë në raport me to, meqenëse kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë edhe në aspektin mjedisor, por që në fakt unë e kam një pyetje shumë të thjeshtë: nëse edhe në strategjinë e 2008, e 2016 dhe në strategjinë e fundit që është deri në vitin 2026 për energjinë, flitet për diversifikim të sektorit të energjisë.

Më thoni ju se si duhet të ringritemi ne nga kjo situatë, s'ka rëndësi pozitë-opozitë, sepse na prek të gjithëve pa dallim, po meqë ju jeni pozitë dhe keni pushtetin, duhet të merrni dhe përgjegjësitë

që ju takojnë, jo vetëm lavde se keni marrë mbi 50% vota, por ta ushtroni atë përgjegjësi dhe të gjeni përgjigje. Si do ta diversifikojmë tregun, nëse ne i themi 'jo' çdo mënyre të prodhimit të energjisë? Qoftë termocentralit, qoftë hidrocentralit, gazit, apo formave të tjera, apo dhe erës që na ikin investitorët nga Kosova, sepse presin me vite për të marrë licencë e shkojnë në Maqedoni dhe marrin brenda muajit licencë dhe dyfishojnë investimin. Kjo duhet të jetë debat për neve sot. Si duhet të ecë përpara Kosova në aspektin e mënyrave të ndryshme të prodhimit të energjisë, të pavarësohet në atë kuptim dhe që të ketë mundësi të jetë pjesë e tregut rajonal, si një aktor i rëndësishëm, kushtimisht ta them i barabartë.

Ne jemi rast unik kur Banka Botërore që nga 2003 e tutje ka investuar me miliona e miliona dollarë për të krijuar mundësi për të analizuar tregun, resurset, për të ngritur kapacitete, për të ndërtuar një termocentral që quhet Kosova C, pikërisht që deri në 2017 për ta larguar nga përdorimi Kosovën A, i cili është ndotësi më i madh, problemi më i madh që kemi ne si Kosovë, edhe për shkak të vjetërsisë dhe për shkak të çështjeve të tjera. Nuk ka ndodhur dhe në 2019 për shkak të dinamikave globale, edhe të agjendës së re të gjelbër, por edhe të një qëllimi të një vendimi që është vënë për dekarbonizimin deri në vitin 2050, Banka Botërore sot i thotë "jo" vetë një investimi me sa e sa vjet në Kosovë, edhe në resurse, edhe në fizibilitetin e çështjes, por edhe në investimet që janë bërë ndër vite. Pse? Sepse është lobuar për t'i thënë "jo" termocentralit. Në momentin që kemi në Poloni një termocentral, i cili është ndërtuar rishtazi dhe do të operojë deri në vitin 2040, me teknologjitë e reja që të shfrytëzohen kapacitetet dhe pastaj të kalohet në energjinë e gjelbër dhe energjinë alternative dhe në eficiencën e energjisë.

Andaj, unë sot sinqerisht kam veç një hall. Ministre e nderuar, më vjen keq që keni mbetur vetëm këtu për ta mbrojtur gjithë këtë çështje, kryeministri nuk është sot këtu, por megjithatë unë kisha pasur dëshirë të kem disa përgjigje, përgjigje se si duhet të dalim nga kriza, se çfarë duhet të bëjmë dhe jo akuza, sepse po ju rikujtoj edhe një here, pavarësisht si ka qenë, nuk është bardh e zi. Ka dokumente strategjike për zhvillim, ka investime, nëse jo të gjitha janë bërë në mënyrën e duhur, urdhëroni, rregullojini çështjen, rregullojeni situatën, investoni dhe nëse keni nevojë për ndihmë, normalisht në këso raste duhet të jemi bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fjalën ministres që të përgjigjet në disa prej çështjeve, të cilat u ngritën nga deputetja Hoxha.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit, deputete Hoxha për pyetjet!

Sa i përket strategjisë, të cilat kanë qenë në të kaluarën, veç mund t'ju përkujtoj që njëra prej tyre ka paraparë që 5 vjet para sotit, në 2016, Kosova A veç ka qenë e dekomisionuar, e kemi pasur një Kosovë të re që prodhonte 7 mijë e 500 gigawatë orë edhe një hidrocentral në Zhur me 400 gigavatë orë.

Këto kanë qenë strategjitë, nuk janë realizuar asnjëherë. Pse nuk janë realizuar? Nuk besoj që unë ose kjo qeveri duhet të japim përgjigje për këtë, mirëpo definitivisht që do të japim përgjigje për atë se çfarë do të bëjmë në strategji. Diversifikimin e përmendët, shumë me të drejtë. Diversifikimi është një ndër qëllimet kryesore të strategjisë. Mund të shtojmë, kemi kapacitete shumë më të larta se sa që i shfrytëzojmë për energji të erës dhe energji solare. Sa i përket energjisë me ujë, veç i kemi të shfrytëzuara kapacitetet dhe atë me një ndikim negativ ambiental, kështu që këtu nuk shohim shumë hapësirë për rritje. Gazi do të konsiderohet, është në një ndër skenarët, të cilët jemi duke e studiuar. Nëse del opsioni më i mirë dhe më i lirë, por edhe më pozitiv për nga ndikimi ambiental, do ta bëjmë gazsjellësin dhe eventualisht edhe termocentralin. Mirëpo, do të shohim edhe ndërkohë se çka po ndodh me çmimet e gazit, duke qenë se momentalisht me trendët që i kemi dhe me një krizë globale e shkaktuar pikërisht nga gazi, nuk është e arsyeshme që në këtë moment të merret një vendim i tillë.

Sa i përket strategjisë, kemi një proces transparent dhe demokratik, ku konsultimet me shoqërinë civile, ekspertët dhe me donatorë kanë filluar, edhe Komisionin Parlamentar për Ekonomi ka qenë i ftuar në qershor të këtij viti. Në fillim të dizajnit të skenarëve janë ftuar dy komisionet parlamentare, për Zhvillim Ekonomik, si dhe ai për Ambientin, por edhe kryetarët e komisioneve të tjera parlamentare. Kanë pasur mundësi të japin komentet e tyre për atë se çfarë duhet të trajtohet apo edhe për preferencat politike për atë se çfarë burimesh duhet të përdoren në të ardhmen. Ky është një proces, i cili është duke vazhduar, në janar do të kemi rezultatet e studimit dhe draftin e strategjisë, ku do të keni mundësi që së paku deputetët që janë të involvuar në këto fusha të kenë mundësinë, nëse dëshironi të ftoheni, mund t'ju ftojme edhe juve specifikisht në diskutimin e strategjisë.

Siç edhe ka thënë Kryeministri Kurti, në ditën kur është votuar, emëruar Qeveria, synimi ynë është që të kemi konsensus jo vetëm politik brenda Parlamentit dhe brenda partive, edhe me partitë opozitare, por edhe konsensus publik për të ardhmen tonë që e zgjedhim, duke qenë se është një vendim, një strategji, e cila e formëson të ardhmen si për nga ana e ambientit, edhe nga ana e energjisë dhe ekonomisë të vendit për gjeneratat e ardhshme. Dhe, për këtë mirëpresim imputet e secilit prej jush dhe jo vetëm prej jush, por edhe të shoqërisë civile, edhe të partnerëve ndërkombëtarë, edhe në përgjithësi të qytetarëve.

Sa u përket hapave të ardhshëm rreth krizës, besoj që e qartësova. Domethënë, hapat e menjëhershëm, është ndarë subvencionit, do të duhej të mos kishim reduktime deri pas Vitit të Ri, së paku, mirëpo kjo në një masë varet nga ajo se sa do t'i kryejë KEDS-i obligimet e veta ligjore në bazë të licencës. Në rast se ka reduktime deri atëherë, do të jenë reduktime shumë të vogla, duke qenë se ajo pjesë është shumë e vogël e cila mbulohet, rreth 10% e totalit të energjisë së importuar dhe sa u përket hapave të menjëhershëm gjatë vitit të ardhshëm, në mënyrë që menjëherë vitin tjetër ne të jemi më të përgatitur për këtë krizë se sa që kemi qenë, edhe kjo nuk do të thotë që nuk kemi bërë diçka për të qenë të përgatitur tani. Kemi punuar në koncept

dokumentin për burime të ripërtëritshme, i cili do të votohet nesër në Qeveri, do të miratohet, shpresoj. Menjëherë, pas kësaj do të fillojmë punën në Ligjin për burime të ripërtëritshme, i cili hap rrugën pastaj edhe për lansimin e ankandeve, mirëpo edhe për përmirësimin e rregullativës ligjore dhe krijimit të mundësive për bizneset që të prodhojnë energjinë e vet përmes paneleve solare. Kjo është një kërkesë, e cila gjithashtu vjen edhe nga bizneset.

Përveç kësaj, kemi një projekt në KEK, i cili do të mundësojë që edhe KEK-u vetë si kompani që e bart barrën kryesore të sistemit elektro-energjetik në Kosovë të mund të diversifikohet dhe të bëhet pjesë e këtij transicioni të gjelbër, e jo të mbetet prapa së bashku me punëtorët e saj. Investimi në efikasitet të energjisë, posaçërisht për familjet e varfra, nxitja e investimeve në efikasitet të energjisë në kuptim të insentivave fiskale për të investuar qoftë në pelet, në format të tjera të ngrohjes që janë më miqësore ndaj ambientit dhe më efikasitet, në poç led dhe pajisje të tjera që janë efikasitet, e të tjera. Të gjitha do të jenë hapa, të cilat do të ndërmerren shumë shpejtë në mënyrë që sa më shpejt varësinë nga importi ta zbusim, kjo nuk është sigurisht diçka që ndodh brenda natës, mirëpo është diçka për të cilën do të fillojmë të punojmë menjëherë.

Në fakt, kemi filluar të punojmë, por duhet një kohë derisa të realizohen. Faleminderit!

KRYETARI: Një replikë për këtë diskutim të ministres e ka kërkuar deputetja Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, ministër, për sqarimet! Unë po shpresoj dhe do ju mbaj për fjale për krejt këto që i thatë, nëse këto do të ndodhin, unë do të gëzohem shumë. Zakonisht puna e një qeverisje të mirë nuk vërehet gjatë mandatit, por pas, por efikasiteti i një qeverie vërehet në kohë krizash. Kjo është shumë e rëndësishme, domethënë mobilizimi, ftesa për bashkëpunim, hapja, jo mbyllja, hapja me të gjithë aktorët që janë relevantë, por edhe me ata që mund t'i cilësoni që janë opozitë e juaja.

Ajo çka po më intereson ta di, pajtohem në idenë e hidrocentraleve që mund të ketë domethënë devijime, kemi folur shumë gjatë mandatin e kaluar, por që në këtë mandat çuditërisht askush nuk i përmend, për ndikimet mjedisore që janë bërë në vende të caktuara. Por, në fakt, ju e përmendët një rregullativë të re për prodhimin e energjisë elektrike që mund ta bëjnë bizneset vetë. Mua më intereson të di sot, kur kemi prodhim të energjisë nga burime të ripërtëritshme, në një rast po e marr shembull, nga energjia me erë prodhohet shumë më shumë se sa që blihet energjia, sepse është e caktuar tarifa dhe, në fakt, mund të ndodhë edhe me bizneset, të cilat nesër do të kenë mundësi ta menaxhojnë veten e tyre në kuptimin e energjisë, por mbetjet kush do t'i marrë? A do të kenë mundësi që ata t'i shesin?

E dyta, ndoshta është mirë hapja, të shikohen mundësi edhe të investimeve që vijnë direkt nga Evropa në aspektin e termikës, sepse nuk mund të flasim për energjinë nëse s'flasim për

termikën. Ju i përmendët familjet e varfra dhe i përmendët pak më herët nëse nuk gaboju institucionet publike, domethënë renovimet, fasadimet e këto të tjera. Mendoj që ka një mënyrë, sepse edhe në emër të fasadimeve shumë nga objektet e trashëgimisë kulturore, duke i veshur me stiropor jashtë në emër të termikës i kemi dëmtuar dhe i kemi shfityruar, andaj mendoj që edhe ministritë përkatëse, dikasteret e tjera përkatëse duhet të jenë në linjë kur flasin për energjinë, për eficiencën, për mbrojtjen e mjedisit vizavi domethënë njëra me tjetrën. Faleminderit!

KRYETARI: I fundit prej deputetëve për të diskutuar në këtë debat parlamentar është deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

E nderuar ministre,

Kolegë deputetë,

Nuk kisha në plan të diskutoj për këtë temë, mirëpo diskutimet e fundit dhe një mesazh që mora nga një punëtor i kompanisë që prodhon energji në Shalë të Bajgorës, më bëri që sot të dal këtu dhe të diskutoj dhe të ngre disa prej shqetësimeve, të cilat janë, e po besoj që ministrja na jep një përgjigje.

Jam i brengosur se kur po ka nevojë që në këtë Kuvend të ketë një konsensus për të zgjidhur, ose për të votuar dhe për të kaluar marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe vendime sikur kjo për shpalljen e gjendjes emergjente, sikur deputetët e pushtetit dhe ministrat qëllimshëm po e minojnë konsensusin në këtë Kuvend. Sikurse po krijohet përshtypja që pushtetit është duke i konvencuar kjo krizë energjetike. Dhe, nëse pushteti dëshiron ta zgjatë këtë situatë pa shpallje të gjendjes emergjente, ku importohet energji dhe kërkohet të zgjatet kjo krizë energjetike pa e krijuar konsensusin e brendshëm, atëherë sigurisht që na lë përshtypje dhe shijen se dikush po përfiton në këtë kohë krize nga importi i energjisë dhe kur krejt ky problem bartet në prezencën ose mosprezencën e dy deputetëve të opozitës, atëherë qëllimi është që të minohet konsensusi dhe të mos ketë një vendimmarrje nga Kuvendi.

Se sa është i rëndësishëm ky problem, pra brengat e të gjithë qytetarëve, sytë dhe veshët e tyre sot janë nga Kuvendi i Kosovës për të gjetur zgjidhje të përbashkët. Dhe, unë mendoj që edhe për importin e energjisë a janë shfrytëzuar të gjitha resurset vendore dhe sa po blihet energji nga jashtë, unë mendoj që kur ka një intencë që të zgjatet kriza, e para e punës do të duhej të fillonte një hetim nga ana e Prokurorisë së Kosovës. Hetimet bazuar në debatet që u zhvilluan këtu, ka shumë prokurorë, të thirren edhe disa deputetë këtu që treguan për shkaktarët që po i ditkan për mungesën e energjisë, qoftë ata që thanë për prishje të qëllimshme, po nëse ka prishje të qëllimshme, është vepër penale. Nëse ka sabotim, prapë është vepër penale dhe deputetët që sot këto çështje i kanë ngritur këtu në Kuvend, do të duhej para prokurorit t'i ofrojnë argumentet,

sepse qytetarët e Kosovës janë në terr, e disa deputetë po e ditkan kush e ka shkaktuar këtë terr, duhet të tregojnë para prokurorit.

E nderuar ministre Rizvanolli,

Sipas punëtorëve të kompanisë që prodhon energji në Shalë të Bajgorës, Selac 1, Selac 2 dhe Selac 3, aktualisht kjo kompani i prodhon 35 MW, të cilët shfrytëzohen për nevoja të energjisë brenda Kosovës. Kapacitetet i ka sot edhe për 35 të tjera, mirëpo nuk po merren nga vartësit e Qeverisë në këtë rast. Pra, edhe 35 janë të gatshme, por nuk po shfrytëzohen, ndonëse janë me çmim 85 euro MW-ti. Çështja është pse nuk po blihet energjia brenda, me 85 euro, e po importohet nga jashtë me çmim astronomik të shtrenjtë.

Sot po të njëjtit punëtorë më shkruajnë se kompani me një kërkesë të Qeverisë brenda tri ditësh është e gatshme të prodhojë 104,5 MW për nevoja të Kosovës me çmimin e garantuar prej 85 euro për MW. Çështja është, a duhet blerë me 85 euro këto prej energjisë së ripërtëritshme, apo duhet importua nga jashtë? Çështja është se duhet ministria përkatëse dhe Qeveria me vartësit e tyre të japin një përgjigje për këtë. Nëse nuk shfrytëzohen kapacitetet vendore të gjitha dhe po importohet me çmim të shtrenjtë, atëherë këtu ka elemente të veprës penale dhe unë besoj që komisioni përkatës parlamentar do ta shqyrtojë.

Qytetarët e Kosovës janë të brengosur dhe çdonjëri prej tyre që është tatimpagues, paguan tatimin dhe e paguan faturën e rrymës. Kjo është përgjegjësia e çdo qytetari në Republikën e Kosovës dhe dëshiron ta marrë shërbimin e energjisë, por përveç kësaj, ndonëse paguajmë tatim, ndonëse paguajmë rrymën, ka vendosur që nga taksat tona të jepen edhe 20 milionë shtesë për energji. Pra, edhe një shpenzim tjetër.

Përveç kësaj, qytetari i Kosovës dhe bizneset duhet të blejnë edhe agregatë. Pra, edhe pse paguajmë tatimin, paguajmë rrymën, edhe 20 milionë janë dhënë për këtë punë, prapë duhet blerë agregatë, sepse ka reduktime. Përveç që duhet blerë edhe agregatin, duhet blerë edhe benzinë për agregatin, se duhet shtuar kësaj fature edhe këtyre shpenzimeve. Kjo është kostoja, po, mund të qeshësh, nuk është problem. Është problem qytetari se si përballet me këto probleme. Ai e di për çka po flas. E njëri prej atyre qytetarëve ka qenë edhe një, edhe disa prej mbështetësve tuaj, që dje ishin në protestë. Deri dje kanë qenë mbështetës tuaj, por sot po protestojnë kundër vendimeve tuaja.

Unë po kërkoj një angazhim. Nuk dua të merrem me analizën se përse ka ardhur deri te kriza, a është dashur marrë vendime për t'i dërguar në remont A-në dhe A-3-shin e A-5-shin verës, kur ka qenë konsumi më i vogël i energjisë, a është dashur me kohë të riparohet B-2-shi, pse ka pasur neglizhencë nga ana e menaxhmentit, a janë marrë në konsideratë vërejtjet dhe sugjerimet e inxhinierëve me përvojë brenda KEK-ut? Pra, nuk po dua të akuzoj për ato çështje, por unë mendoj se këtu ka goxha shumë punë prokurori për t'u marrë prej fillimit deri në fund me këtë

çështje, sepse ka elemente të veprës penale, nëse nuk janë shfrytëzuar resurset e brendshme vendore dhe është importuar me çmim shumë të lartë.

Kërkoj pra, prej juve kolegë deputetë të pushtetit, kur keni nevojë për votat e opozitës për çështje që janë në interes të qytetarëve, nëse dëshironi të zgjidhni krizën, atëherë duhet gjetur konsensusin dhe bashkëpunimin. E te marrëveshjet ndërkombëtare, i minuat për disa ligje që s'kishin ndonjë relevancë, përveç plotësim-ndryshimit në Ligjin për kundërvajtje, i minuat marrëveshjet ndërkombëtare. Ndërsa sot, derisa kryeministri nuk është prezent për këtë problem jetik të qytetarëve, ju e drejtoni gishtin tek udhëheqësit e partive opozitare, me qëllim që ta minoni këtë seancë dhe të vazhdojë kriza këtu, sepse në këtë krizë dikush është duke përfituar, siç ndodh çdo herë që në kohë krizash ka përfitues, e në këtë rast ata duhet kërkuar në Qeveri, sepse këta janë përgjegjësit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Hekuran Murati e ka kërkuar fjalën.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në lidhje me angazhimin e prokurorisë, pajtohem që prokuroria do të duhej t'i fillonte hetimet, fillimisht për ndërmarrjen publike Ibër-Lepenci dhe kontratën që është nënshkruar për shitjen e energjisë nga Ujmani me çmim 38 euro. Duhet ta shohë kush e ka nënshkruar atë kontratë dhe çfarë procesi është zhvilluar në atë kontratë korruptive. Kur ne tash blejmë me çmim marramendës, importojmë, kurse energjinë që e prodhon Ujmani shitet me çmim 38 euro për MW/orë.

Është shumë e çuditshme që vetëm te ne, po besoj, në krejt këtë krizë kontinentale që ka kapluar kontinentin e Evropës, e besa është shtrirë edhe me gjerë shumë shpejt, fajësohet Qeveria veç tek ne. Domethënë, për një krizë globale, te ne fajësohet Qeveria. Është shumë e çuditshme dhe shumë interesante, që një subjekt parlamentar, siç është PDK-ja, thërret konferencë për medie dhe kërkon që të merren hapa për ta shpallur gjendjen emergjente në energji dhe kur vendimi vjen në Kuvend, nuk votojnë. Veç tek ne ndodh që thirrësi i debatit, grupi parlamentar që ka thirrur debatin nuk i ka të gjithë deputetët në sallë. Vetëm tek ne ndodh që një grup parlamentar komplet e lëshon sallën, për shkak se përtojnë të rrinë këtu dhe kërkojnë pretext për të ikur e lëshuar sallën. Veç tek ne ndodh.

Çështja është kështu, po thuhet që në vazhdimësi po kthehemi dhe po ankojemi për 20 vjetët e kaluara. Me dëshirë nuk do ta bënim një gjë të tillë, por e kemi të pamundur kur po dëgjojmë nga opozita shpifje për atë se çka ka ndodhur në të kaluarën. Qytetarët e dinë, por sa për t'ua rikujtuar opozitës, në të kaluarën kemi pasur projekte për energji, ka qenë projekti 2100 MW, termocentral me thëngjill. Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar që një investim i tillë asokohe të bëhet, mirëpo ka pasur një dallim substancial. Dallimi ka qenë se Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar që termocentrali të ndërtohet me para të buxhetit, në mënyrë që ndërmarrja të vazhdojë

të jetë publike. Kurse, qeverisjet aso kohe, çka kanë thënë? Kanë thënë s’kemi para ne për ta ndërtua termocentral, por po ia japim një privati le ta ndërtojë termocentralin, e për atë privat Kosovën A po e dekomisionojmë, kurse Kosovën B po ia falim.

Domethënë, kjo ka qenë marrëveshja që është prezantuar prej qeverisjeve të asokohe. Normalisht, që Lëvizja Vetëvendosje ka qenë kundër kësaj, se ka insistuar që termocentrali të ndërtohet me para të buxhetit, në mënyrë që KEK-u të vazhdojë të mbetet publik dhe jo t’i falet dikujt.

Lëvizja Vetëvendosje ka insistuar që të mos privatizohet KEDS-i, megjithatë është bërë, se na është thënë: “S’kemi para për të investuar në rrjet të distribucionit, po e privatizojmë, sepse privatizuesi do t’i investojë 300 milionë euro”. Ne e kemi kundërshtuar, e ju e keni bërë këtë. Kur erdhi projekti i Bilfingerit, që ishte investim 500 milionë euro nga shteti, në mënyrë që të rriteshin kapacitetet e Termocentralit Kosova A në 800 MW, ne kemi qenë për atë projekt, e kemi mbështetur. Qeverisja e asaj kohe tha: “S’kemi para për këtë, s’kemi para ne si Qeveri ta bëjmë këtë projekt, po e nisim një autostradë të re”. Dy miliardë euro hynë në autostrada, e thanë “projektin për investim në energji po ia lëmë një privati”. E ai privat, Contour Global me normë të kthimit 18,5%.

Domethënë, këto marrëveshje, kjo dialektikë ka qenë. Këto dilema i kemi pasur përpara për t’i zgjidhur dhe, normalisht, ne si Lëvizje Vetëvendosje prapë kemi insistuar. Duhet të ndërtojmë kapacitetet publike, sepse e kemi parë që me resurse kaq të rëndësishme, siç është energjetika, nuk bën të lihen në dorë të subjekteve private, të cilat kryesisht kanë kërkuar që fitimin ta kenë të garantuar, kurse koston dhe rreziqet t’i bartë shteti. Një gjë e tillë ka qenë e paraparë edhe për Contour Globalin, apo jo? Domethënë, të gjitha rreziqet dhe koston ka pasur t’i marrë përsipër shteti, madje edhe duke i garantuar kreditë, kurse fitimin e garantuar e ka pasur privati. Këto kanë qenë marrëveshjet që janë prezantuar. Normalisht, që ne kemi kërkuar, prapë po e ritheksoj, si Lëvizje Vetëvendosje që investimet në kapacitete energjetike të bëhen me buxhet.

Po të ishte bërë siç ka kërkuar Lëvizja Vetëvendosje, sot do të kishim kapacitete të mjaftueshme jo veç për ta mbuluar konsumin vendor, por edhe për eksport dhe me çmimet që janë tani, normalisht që fitimet ose të hyrat nga eksporti do të sillleshin 100-200 milionë euro në muaj. Dhe, me këto para do të kishim mundur të ndërtonim spitale e shkolla, e besa edhe autostrada. Për çka kanë vendosur qeverisjet e kaluara? Nuk e kanë dëgjuar Lëvizjen Vetëvendosje, kanë vendosur dy miliardë euro t’i shtinë në autostrada të shtrenjta.

E këto vijnë te ajo situata, kur ne u thoshim: “Nuk jemi kundër autostradave, por duhet prioritetizuar shpenzimin e buxhetit”. Ju thoshit: “Pse po i kundërshtoni projektet zhvillimore?”, “Autostrada është projekt zhvillimor”, thoshit. “Pse po i kundërshtoni projektet?”, Autostradat të

mira janë. Po, janë shumë të mira kur i ke rregullua disa probleme të tjera, siç është ky me energjinë elektrike.

Tash, u përmendën edhe çështja e Contour Globalit dhe e gazit, si arsytetime që gjoja pse paskemi ardhur në këtë krizë. Kjo është e pavërtetë. Contour Globali, në rastin më të mirë, edhe po të ishte i aftë të siguronte financimin, gjë që ka dështuar vetë, dhe të fillonte ndërtimin, në rastin më të mirë termocentrali do të vihej në funksion në vitin 2025. Projekti i gazit, në rastin më të mirë, pra termocentrali, ose gjenerimi i energjisë elektrike, në rastin më të mirë do ta kishim në vitin 2030. Pra, asnjëra prej këtyre nuk na e zgjidhin problemin që e kemi sot, kur në vazhdimësi po dëgjojmë nga opozita se gjoja këto qenkan arsyet pse ne kemi krizë sot.

Qe 20 vjet po e shohim që këto subjekte që tash janë në opozitë, e që kanë qenë në qeveri 20 vjet të kaluara, nuk kanë pasur asnjë zgjidhje tjetër sa i përket sektorit të energjisë, sepse në vazhdimësi kanë thënë që këtë sektor duhet lënë privatit, nëse mund të gjejnë ndonjë investitor, me normat dhe me fitimin e garantuar, e ne të marrim përsipër rrezikun. Pra, nëse 20 vjet kanë dështuar, unë po ju garantoj se edhe sot, sikur të ishin në qeveri, kurr gjë nuk do të kishte ndryshuar. Do të kishim krizë edhe më të thellë madje-madje, se as ato 20 milionë euro nuk do të kishin qenë, s'do t'i kishte pasur në dispozicion ndonjë qeverisje tjetër e menaxhuar prej juve, qysh i gjetëm ne, për shkak se ato 20 milionë euro, në fakt, bën vaki do të kishin shkuar në ndonjë autostradë të re, të tretë, edhe një miliard do t'i kishit shtirë në autostradë të tretë ju, edhe një miliard të tjera. E dimë këtë, se e keni thënë vetë publikisht, e keni premtuar edhe në fushata zgjedhore. Kështu që, kurr gjë nuk do të kishte dalluar edhe po të ishit ju, përkundrazi, më keq do të ishte situata.

Sa i përket situatës, se përse ka krizë? Edhe këtë duhet sqaruar. Tash, kriza është globale. Çmimi i importit është shtatëfish më i lartë, sesa ka qenë para dy-tre vjetëve, edhe para vitit të kaluar, shtatëfish më i lartë. Nevoja për import, edhe për shkak të mungesës së përkohshme të Bllokut B-2, por edhe për shkak të rritjes së konsumit, është së paku dy-trefish më e lartë, nevoja për import. Domethënë, kemi të bëjmë me një rritje të kostos të shumëfishtë, pra mbi pesëmbëdhjetëfish rritja e kostos totale mujore për import, për të mbuluar importin.

Cila është zgjidhja? Ne kemi ndërmarrë hapat e domosdoshëm dhe të nevojshëm, që në afat të shkurtër, për zgjidhjet në afat të gjatë, foli ministrja, për në afat të shkurtër kemi shtuar likuiditetin në sektorin e energjisë, mbi 40 milionë euro janë shtuar tashmë. Dhe, po shpresojmë që me motin më të mirë dhe me përmirësimin e situatës edhe të reshjeve në Shqipëri, të mund të kemi, sepse si dy shtete, ne jemi komplementare ndaj njëra-tjetrës, edhe ne mund t'i ndihmojmë Shqipërisë, edhe Shqipëria neve. Pra, në momentet kur ne kemi mbiprodhim, mbi atë se sa konsumohet, mund ta deponojmë nëpër liqenet akumuluese të Shqipërisë dhe, pastaj, në kohën kur neve na nevojitet, mund të na e kthejnë. Pra, këtë bashkëpunim mund ta bëjmë, mirëpo kriza

energjetika aktuale i ka zënë të gjitha shtetet në Evropë, edhe Shqipëria ka nevojë për import aktualisht.

Shpresojmë, që shumë shpejt, po besoj është data 20 janar do të kthehet edhe blloku B-2, mirëpo deri atëherë është shumë e rëndësishme dhe besoj që është akt patriotik që secili qytetar të mundohet të kursejë aq sa mundet. Dhe, këtu s'po themi që të mbeten keq apo të mërdhijnë, mirëpo shumë prej tyre që i kanë konvertuar kaldajat në elektrike dhe kanë ngrohje qendrore me dru apo pelet, do të duhej t'i kthenin së paku për këtë kohë në dru, ose pelet. Të gjithë ata që kanë nevojë për energji elektrike dhe që mund ta shtyjnë konsumin në kohën pas mesnate, kur tarifa është e lirë, do të duhej ta bënë këtë, të gjithë duhet ta bëjmë këtë, në mënyrë që ta kalojmë sa më lehtë. Dhe, duhet bashkërisht, por jo duke e akuzuar Qeverinë për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tri replika janë kërkuar për fjalën e ministrit. Së pari, ia japim fjalën kryetarit të grupit të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Kryetar, unë do ta shfrytëzoj kohën time si deputet, sepse do të flas më gjatë sesa dy minuta, kështu që a ta shfrytëzoj tani, apo pas replikave?

KRYETARI: Mirë, po kalojmë te replika e zotit Bekim Haxhiu, pastaj mund ta keni ju fjalimin, i nderuar kryetar i grupit!

BEKIM HAXHIU: I nderuar ministër,

Përpara se të flasësh për përgjithësim, po nisem te çështja e parë që e ngrite dhe që unë e thashë, për çështjen e angazhimit të prokurorit për çështjen e mosshfrytëzimit të të gjitha kapaciteteve e resurseve të brendshme.

Ti je ministër, ministren e Drejtësisë e ke këtë, para se të vish të flasësh me ne, deputetët, hiç s'ke nevojë të na tregosh, kushdo, kudo, çka është i përfshirë, hetojeni, çojeni te gjykatësi, edhe le ta marrë dënimin e merituar kushdo që ka bërë shkelje të tilla, sepse e thatë në fund, që kursimi i energjisë është sot akt patriotik, e nëse ka pasur abuzim me energjinë brenda kësaj periudhe kohore, pra është vepër penale, përfshirë edhe atë që nuk më dhe përgjigjen që kërkova për energjinë e ripërtëritshme në Shalë.

Sipas informacioneve që po i marrim nga ekspertët, sot Kosova ka kapacitet të prodhojë 230 MW energji elektrike nga energjia e ripërtëritshme. A janë duke u shfrytëzuar të gjitha këto kapacitete sot në këtë krizë? Nëse nuk janë, merreni ministren e Drejtësisë, prokurorin, hetojeni, pavarësisht kush është.

Unë nuk po dua të flas për përgjithësime, por kur folët për privatizimin e distribucionit të KEK-ut, mos eja të bisedosh me ne, bisedoje në grup parlamentar, me shefin e grupit parlamentar, me zonjën Mimoza Kusari-Lila, që ka qenë bartëse e këtij privatizimi. Pse po flet me ne? S’kemi qenë, as s’është fushë jona, as nuk e njohim. Bisedoni në mes vete, besoj që e zgjidhni problemin. Faleminderit!

KRYETARI: A po do, ministër, i kryejmë të dy replikat, e pastaj? Eliza Hoxha, po ashtu e ka një replikë.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Thjesht, veç shkurt, sepse unë po pres që nga aktorët e Qeverisë të dëgjojmë më shumë gjëra konkrete, se si do të dalim nga situata dhe veç akuza jemi duke dëgjuar. Në fakt, ne po merremi me pasojën, asnjëherë nuk po kthehemi te problemi që e kemi. Është e vërtetë, ministër, që kriza është globale, por vendimet për jetën tonë janë lokale dhe sfidat që i kemi janë lokale.

Thatë “vetëm tek ne Qeveria akuzohet”, po vetëm tek ne ka reduktime aktualisht. Të gjitha shtetet e tjera kanë marrë masa shumë më herët.

Ju kisha lutur, sinqerisht. Unë e kuptoj që mund të keni edhe nervozë, ose çfarëdo, nëse ne zakonisht kërkojmë llogaridhënie, po këtë e keni bërë edhe ju kur keni qenë në opozitë. S’po them specifikisht ju, se ndoshta atëherë s’keni qenë pjesë e Kuvendit, por gjithsesi po flas si aktor politik.

Prandaj, ju lutem shumë, është çështje shumë me rëndësi dhe kemi nevojë, unë e thashë edhe më herët, ne bëjmë debate parlamentare, shoh vetëm akuza e kundër-akuza, kurrëgjë përmbajtjesore nuk kuptoj kur të dalim prej debatit. E ishte dashur edhe qytetarët ta kuptojnë sot, se si do të jenë hapat tamam. Ministrja u mundua t’i thotë disa, kisha dashur edhe nga ju t’i di dhe thjesht të dalim nga kjo situatë, jo vetëm për këtë dimër, po të kemi një strategji që ekziston. Nuk ka nevojë të bëhet e re, është deri në 2026-tën, mund të përmirësohet, të plotësohet. Nëse ka çështje të reja që janë në skenën globale për shkak të sfidave që i kemi, por që në fakt sot unë mendoj që nuk është me shije që të akuzohet opozita për këtë gjendje. Faleminderit!

KRYETAR: Ia japim fjalën fillimisht ministres, Abelard, për shkak të replikave që kanë qenë dhe pastaj mund ta kesh fjalën. Diskutimi i fundit, e pastaj e thërrasim propozuesin për ta paraqitur mocionin nëse ka.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Sa i përket impiantit me erë në Bajgorë, në Selac, të cilin e përmendët, Ministria e Mjedisit, e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe ZRRE-ja e kanë trajtuar me prioritet licencimin dhe lejen ambientale, për llotin e dytë dhe të

tretë, se i pari ka qenë i licencuar më herët. Kjo është bërë para rreth dy javësh, nëse nuk gaboj, licencimi.

E gjithë energjia, sapo e konfirmova me drejtorin ekzekutiv të KOSTT-it, i cili nuk është në varësi të Qeverisë, përndryshe, por është ndërmarrje publike që i raportin Kuvendit. Ata janë duke e blerë tërë energjinë e prodhuar nga impianti me erë i Selacit, janë duke e blerë gjithë energjinë.

Këto sigurisht janë gjëra që vërtetohen. Nëse është ndryshe, atëherë mund t'i hulumtojmë bashkë, po kjo është informata prej drejtorit të KOSTT-it.

Kjo dikush po përfiton nga kriza dhe Qeveria po do ta zgjatë krizën, veç një gjë mund të them që kjo mund të ketë qenë mënyra qysh keni menduar dhe qeverisur ju, por kjo nuk është mënyra qysh mendojmë dhe qeverisim ne.

A po shfrytëzohen të gjitha kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme? Po, me përjashtim të Ujmanit, i cili e ka një kontratë të jashtëligjshme, për të cilën edhe Ibër-Lepenci është dënuar nga ZRRE-ja dhe Bordi i Ibër-Lepencit e ka dërguar rastin në Polici, ose në Prokurori, nuk jam e sigurt në cilën. Për këtë presim hapa të mëtejme. Duke qenë se e ka një klauzolë të arbitrazhit dhe është konsideruar shumë e shtrenjtë për të dalë nga kjo kontratë, Bordi i ri dhe kryeshefi i ri nuk e kanë anuluar këtë kontratë.

Deputetja Hoxha, së pari një përgjigje për një pyetje të mëhershme, për atë se bizneset që instalojnë panele solare, a do të mund ta shesin, ta kthejnë atë në rrjet apo jo vetëm për nevojat e tyre. Kjo është diçka e cila mbetet të trajtohet në nivel teknik nga ZRRE-ja në radhë të parë, në bashkëpunim edhe me të tjerët.

KRYETARI: A doni edhe një minutë, ministre?

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Mirëpo, sigurisht që së paku për nevojat e veta do të hiqen barrierat administrative dhe teknike për të qenë në gjendje për të prodhuar. Nuk ka nevojë. Thatë që nuk u tha asgjë konkrete, në fakt nuk pajtohem me ju. Unë ju dhashë disa shembuj shumë specifikë se çka jemi duke bërë. Po mirë, tash ministri i Financave, i Punës dhe Transfereve nuk besoj që do të flasë për strategjinë e energjisë, po do të flasë unë.

Nuk ka nevojë strategji të re. Në fakt, ka nevojë për strategji të re. Strategjia e kaluar, e cila do të duhej të ishte valide deri në 2026-ën, ose ndërtuar rreth një projekti të madh të gjenerimit me thëngjill, i cili nuk është i realizueshëm as nuk është i pranueshëm tani në kohën që po jetojmë. Nuk parasheh investime në ifiçencë, të cilat mendoj që duhet të jenë prioritet absolutisht për secilën Qeveri. Prandaj, na duhet një strategji komplet e re. ajo është më shumë një listë

dëshirash, e cila e sheh thëngjillin, gazin, burimet e ripërtëritshme, të gjitha, mirëpo nuk është një strategji e realizueshme.

KRYETARI: Ia japim pra një minutë edhe Bekim Haxhiut edhe kalojmë te Abelard Tahiri.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit ministre për përgjigjen!

Në veçanti për atë që u tha për Selacin. Se a janë duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet a jo, më së miri do të ishte që të shihni numrin e gjeneratorëve që janë në funksion. Më shumë është mirë të besohet a janë duke punuar pra gjeneratorët apo sa janë duke punuar, sesa një raport të KOSTT-it apo dikujt që ka ndoshta marrëdhënie kontraktuale e përfiton nga importi. Pra, më shumë se kjo dhe përtej të gjitha dilemave, unë besoj që do ta zgjidhte prokurori.

Një shqetësim tjetër që është i qytetarëve të asaj pjese, si është e mundur që tri-katër ditët e fundit, edhe dritat e ndriçimit publik në pjesën veriore mbeten ndezur dhe nuk ka asnjë reagim pra për këtë. Nuk dua të flas për çështje tjetër, por vetëm kjo: Pse në pjesën veriore edhe dritat e qytetit gjatë ditës dhe tërë ditën janë ndezur? Me video po na e dërgojnë qytetarët për çdo ditë prej asaj pjese për mosrespektim të kursimit të energjisë.

KRYETARI: Meqenëse i është drejtuar në fjalën e tij paraprake që e kishte Bekim Haxhiu, fjalën e ka kërkuar kryetarja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila. Kjo është replikë për fjalën e tij të plotë që e pati Bekim Haxhiu më parë.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Sa herë që diskutohet për distribucionin dhe privatizimin, emri im pashmangshëm përmendet në këtë Kuvend, nga të gjithë, pa përjashtim. Për dy arsye. Arsyeja e parë ishte se kam qenë pjesë e komitetit qeveritar për privatizimin e distribucionit. E dyta, se në raport me atë proces, është ngritur një aktakuzë. Tash, sikur ky proces të bënte zgjidhjen e situatës aktuale, edhe po e marr, po e mbaj tabelën e qitjes që bëhet mbi emrin tim, si e vetmja që aktualisht është në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga ish-ministrat.

Megjithatë, ajo nuk e bën atë zgjidhje. Arsyeja që sot nuk e kam marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, është se kam dashur që atë ta bëjë dikush i cili ka pasur një qëndrim konsistent në raport me këtë proces.

Dhjetë vite më parë, po që kam qenë pjesë e komitetit qeveritar, por nuk kam qenë bartës. Bartës apo kryesues ka qenë ministri i Zhvillimit Ekonomik, asaj kohe Besim Beqaj. Përderisa unë kam qenë një nga pesë anëtarët e komitetit të privatizimit, ai proces në esencë ka synuar ta përmirësojë furnizimin, siç u tha nga shumë parafolës. A ka arritur ta përmirësojë? Sot ka shumë defekte. Edhe natyrisht që shumë analiza duhet të çojnë në mungesë të performansës së KEDS-it në raport me obligimet që i kanë marrë kontraktuale.

A ka pasur proces kriminal? Jo në nivelin e komitetit qeveritar. Për arsye të thjeshtë, ato takime të cilat i ka shënuar edhe prokuroria, kanë qenë takime në të cilat pjesëmarrës ka qenë: USAID-i, KfW-ja, ambasadat e QUINT-it, KOSTT-i, ZRRE-ja, Zyra e Bashkimit Evropian. Të gjitha institucionet që në një mënyrë ose tjetër kanë pasur interes për situatën.

KRYETARI: Edhe një minutë pra.

MIMOZA KUSARI-LILA: Sa i përket pjesëmarrjes sime aty në kapacitetin e ministres së Tregtisë e Industrisë, ka qenë të përcillet procesi i promovimit dhe i ofrimit të informacioneve të kompanive të interesuara. Megjithatë, ajo çka ndërlidhet në këtë proces në raport me katër hidrocentralet, të cilat të katërtat në total janë 11 MW, d.m.th. tri janë më pak se 2 MW, njëri është 8 MW, ka të bëjë me një informacion i cili ka qenë i paprezantuar më parë. Por, një gabim i cili duhet ta them edhe sot, edhe duhet ta pranojmë publikisht, është se as për së afërmi, rezultati i prituri i asaj kohe nuk është sot. Prandaj, nuk është keq as nga ju e as nga të gjithë asokohe që e keni mbështetur atë proces, të themi se ka qenë gabim.

Ka qenë gabim të privatizohet distribucioni, ka qenë gabim të mos shikohen të gjitha detajet në raport me investimet, e ai gabim është përcjellë në disa qeveri radhazi. Për arsye se në Ministri të Ekonomisë, prej vitit 2013 kur është përmblytur privatizimi ka ekzistuar njësia për mbikëqyrjen e procesit të privatizimit.

Unë personalisht nuk kam qenë ministre në të gjitha qeveritë. Unë kam qenë ministre në Qeveri të Kosovës për dy vite e shtatë muaj. Kaq ka pasur përvoja ime në ekzekutiv. Konsistenca ime ka të bëjë me prezencën politike dhe në dy mandate të mëhershme në opozitë, duke kritikuar dhe duke mos u pajtuar me ata të cilët kanë përfaqësuar partitë me një prej të cilave kam qenë në koalicion në v. 2011 dhe v. 2013. Dhe të më mvishet tash i gjithë procesi, i cili të gjithë e dimë që ka qenë i adresuar, i menaxhuar, i prezantuar, i diskutuar nga të tjerët, për mua vetëm një arsye ka, se vetëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Haxhiu, ia japim një kundër-replikë, por më të gjatë, sepse në përputhje me minutat e znj. Kusari po ashtu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

E nderuar kolege deputete dhe shefe e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes,

As nuk e kisha për qëllim dhe as nuk e kam qëllim të ngre akuza të drejtpërdrejta. Kontesti i diskutimit tim ishte në raport me diskutimin që ministri e tha për privatizimin e distribucionit. Dhe nuk e pranoj si fakt që ministri ta drejtojë gishtin nga dikush që s'ka qenë pjesë e atij procesi.

Pra, unë thashë që kur të flitet për distribucionin, privatizimin e tij, është mirë ta diskutojë brenda grupit parlamentar. Unë besoj që ju keni takime brenda grupit parlamentar dhe çdo pakënaqësi dhe vërejtje të cilat i ka ministri, atëherë ka mundur t'i diskutojë me juve. Edhe këtu ia them ministres si bartëse që e tha sot që ka qenë gabim, do të duhej edhe ne në Qeveri kur kemi qenë prezentë që është gabim privatizimi, ose sot ta mbështetni atë që e keni premtuar në fushatë, pra anulimin e privatizimit të KEDS-it. Kështu keni premtuar në fushatë.

Pra, në një situatë krize pra do të duhej të kishte një vendimmarrje prej këtij Kuvendi, për problematikat të cilat janë evidente. Asnjëherë nuk e fajësova Qeverinë për krizën globale të energjisë. Nuk hyj në atë temë, është krizë globale. Mirëpo, për marrjen e masave me qëllim të menaxhimit më efikas të situatës për të tejkaluar këtë krizë energjetike.

I gjithë diskutimi ishte edhe për arritjen e një konsensusi në këtë Kuvend, për shpalljen e gjendjes emergjente për të zgjidhur problemin dhe brenga ime ishte se nga vetë pushteti pat minim të konsensusit dhe për atë arsye disa prej kolegëve këtu e lëshuan edhe sallën. Pra, edhe po të keni nevojë për votat e opozitës, edhe po të dëshironi ta minoni debatin këtu, edhe nuk jeni të gatshëm të jepni alternativa të tjera.

Pra, nuk ishte qëllimi asnjëherë, në asnjë rrethanë, as t'ju fajësojë dikush, sepse ju jeni në një proces hetimor, e the ti vetë dhe askush s'ju ka shpallur fajtor, e larg meje që unë t'ju shpall fajtor. Asnjëherë, në asnjë rrethanë. Diskutimi ishte vetëm në raport me atë që në mënyrë të përgjithësuar, ministri i kabinetit qeveritar, ministri i Financave, e drejtoi fajësinë këtu, derisa ka aktorë të atij privatizimi brenda grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Tash i fundit për diskutim është kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të lidhem me fjalën e ministrit, atë që e tha se Partia Demokratike ka kërkuar javën e kaluar që pikërisht që të shpallet masa emergjente për furnizim me energji në këto kohë krize, ndërsa sot po refuzoj ta votojë këtë vendim. Po saktë që ne po refuzojmë ta votojmë këtë vendim. Pse? Sepse i gjithë ky vendim është fokusuar në një pikë të vetme, që për ju është tepër e rëndësishme. Pra pika 2.1: vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët.

Pra, ju po kërkonit prej neve që ta përligjim pikërisht pra reduktimin e energjisë elektrike gjatë muajve të ardhshëm. Ky ka qenë qëllimi i krejt kësaj pune, që ne normalisht që e kundërshtojmë. Ne do të punojmë vazhdimisht dhe do të angazhohemi që reduktime në Kosovë të mos ketë. Ky është gabim i madh. Hiqe këtë pikën 2.1 prej vendimit dhe ne jemi në rregull pastaj me pikat e tjera.

Pra, ju po kërkoni prej neve ta votojmë një vendim i cili e përlligj reduktimin, restriktionin e energjisë elektrike për qytetarët e Republikës së Kosovës. normalisht që nuk do ta votojmë. Pra, jemi kundër.

E dyta, sa herë qe gjashtë orë kemi debat për këtë çështje, është interesant ministri i Financave e ka marrë njëfarë roli gjatë tërë debateve parlamentare, qe si qe, vjen flet njëzet vjet, njëzet vjet. Po shumë mirë bre, njëzet vjet Kosova prej zëros ka filluar, as buxhet as asgjë s'kemi pasur. Sot e kemi dy miliard e gjysmë buxhetin. Sot kemi autostradë energjetike që furnizohemi me rrymë me Shqipërinë. 13 vjet nga viti 2008 deri sot, qytetarët e Republikës së Kosovës, me përjashtim të prishjeve e kanë harruar reduktimin, o Hekuran Murati. E kanë harruar reduktimin. Sot ti, qeveria jote e ka kthyer reduktimin si rezultat i mosmenaxhimit të duhur të krizës. Dhe, sot po do ta përlligjim pikërisht ndaljen, restriktionet me këtë vendim. Po normalisht që s'ta votoj.

Pra, qytetarit të Republikës së Kosovës i janë kthyer reduktimet në qeverisjen tënde. Në qeverisjen e Albin Kurtit. Ju po e thoni Kryeministri është në krye të detyrës dhe normalisht vjen kur është e nevojshme. Po nuk është kurrë më e nevojshme sesa të jetë sot në Kuvend. Kjo është republikë parlamentare. Po të ishte republikë qeveritare, nuk e kishe sjellë hiç këtë, e kishe kryer vetë në Qeveri. Po s'mundesh. Duhet ta sjellësh në Parlament.

Kjo është papërgjegjësi e madhe që Kryeministri nuk vjen në Parlament. Pikërisht për ta kaluar këtë vendim që për të është i rëndësishëm, ta menaxhojë krizën më lehtë. Pra, a e shihni papërgjegjësinë e madhe çfarë e keni? Pra, shiheni, veç krahasoje me dy qeveri në rajon, veç me Maqedoninë e Shqipërinë. S'po them më larg të shkojë, as me Slloveni, as me Kroaci, veç me këto të dyja krahasohu, edhe në çfarë niveli jem.

Më flet për Ibër-Lepencin, po pse po rri duarkryq more burrë? Ju jeni aksionar si Qeveri, e keni bërë bordin. Pse nuk merreni? Kush e ka bërë atë kontratë të paligjshme? Kush e ka bërë? Mos i heshtni sendet! Kushdo që e ka bërë, qyshdo që e ka bërë, çdo send që është i paligjshëm, që e dëmton interesin tonë publik, duhet të përfundojë në prokurori. Mos rrini duarkryq! Mos rrini duke folur për të! Vepro! Çoje në prokurori, denoncoji, foli emrat, qiti krejt. Kushdo që e dëmton interesin publik, duhet të dalë dhe duhet ditur.

Pra, është e papranueshme të vihet dhe të flitet për njëzet vjet, për njëzet vjet. Për njëzet vjet janë bërë shumë punë të mira në këtë vend. Po të mos ishin këto autostrada, ne do të ishim njëfarë zorre qorre, një vend i izoluar pa mundur të kalojë askush këndeje, pa mundur as diaspora të të vijë, pa mundur të bëhen as investimet e duhura. Prandaj, sot këto autostrada i kanë dhënë një zhvillim të ri vendit tonë. Kanë ardhur edhe investitorë dhe brende të fuqishme ndërkombëtare që nuk i ke pasur më përpara. Pra, vendi, Kosova ka qenë vend i stabilizuar me furnizim të energjisë elektrike. Këtë prodhim e ke pasur, po menaxhimi ka qenë më i mirë.

Prandaj, unë sinqerisht po ju them, gjashtë orë debat të flitet për strategjinë, të flitet për të ardhmen, është t'u qitet hi syve qytetarëve të Kosovës. Do ta sillni strategjinë për energjinë në Kuvend, do të flasim për atë punë. Nuk është sot debati për strategjinë. Sot është debati për menaxhimin e krizës, sot është debati qysh ta tejkalojmë këtë gjendje, qysh qytetarët mos të mbeten pa energji elektrike. Kjo është krejt esenca e këtij debati. Gjashtë orë ju s'po jeni në gjendje të na thoni. Asgjë s'po jeni në gjendje të na thoni. D.m.th. krejt jeni të fokusuar në akuza, kundërakuzat. Prokuroria në këtë vend ka vepruar gjithë e vazhdon të veprojë prapë. Kështu që mos rrini duarkryq karshi çdo keqpërdorimi që ju e vëreni që ka mundur të ndodhë. Pra, angazhohuni.

Në fund të fundit, ju s'jeni ekspertë të fushë, s'është marre të angazhoni edhe ekspertë të jashtëm, edhe të huaj nëse është nevoja. Nuk është marre, është mirë, sepse na duhen ekspertë të cilët e kanë ekspertizën e duhur të na këshillojnë të dalim prej kësaj situatë. Prapë po e them 300 mijë tonë thëngjill ia shet Maqedonisë, je në proces t'i shesësh, i ke edhe 170 mijë tonë të tjerë, ne këndeje kemi probleme.

Pra, po jemi në njëfarë situatë sinqerisht goxha të rëndë si vend, si qytetarë, dhe nuk po shoh një dritë në fund të tunelit që po ka mundësi të zgjidhet. Pra, po e shohim të kundërtën. Po e shohim që veç po shkojmë duke degraduar. Pra, si po e shoh, fundi i janarit do të na gjejë tepër keq, e me debate edhe më të ashpra, e nuk di a do të na durojnë edhe qytetarët atëherë, edhe juve, edhe neve.

Pra, nuk di si do të jetë situata, sepse sot në këtë kohë kur ende nuk jemi në atë pikun e të ftohtit, ke regjione që me nga tetë orë, me gjashtë orë, me pesë orë nuk kanë energji elektrike. Nuk po shohim që kriza po shkon duke u ofruar të zgjidhet nëpër Evropë, mirëpo duke u rënduar çdoherë e më shumë. Atëherë, vërtet po shkojmë në njëfarë situatë të rëndë dhe ju s'po dini të na jepni kurrfarë përgjigje. S'po mundeni.

Sinqerisht po ju them nuk është marre të angazhoni ekspertë, resurse të tjera nga jashtë. Edhe nga jashtë vendit nëse është e nevojshme, në mënyrë që të këshilloheni të merrni veprimet e duhura dhe mos të thellohet kriza më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministre, a e marrim edhe një replikë të lutem e kemi të fundit. Urdhëro! Ta shikojmë. Besnik Tahiri e ka kërkuar një replikë, por vetëm duhet të na tregojë se kujt i adresohet saktë.

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Agjencia e Lajmeve Reuters ka publikuar një lajm ku thotë: qytetarët e Kosovës kanë filluar t'i ndezin agregatet përderisa kriza energjetike është duke eskaluar. Kjo është çka ju duhet të

merreni... Kjo është, e jo të na tregoni, të debatoni me çështje që i lidhem deri tash, se jemi duke humbur kohë. Që sa jepni përgjigje. Nuk ka lajm më të keq për investime të huaja se kjo.

KRYETARI: Replikave do t'u përgjigjet ministrja e Zhvillimit Ekonomik.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Faleminderit!

Që gjashtë orë apo tetë a s'e di sa janë bërë, jemi duke iu treguar se çka kemi bërë, çka jemi duke bërë dhe çka do të bëjmë, kështu që ky debat u shter tashmë.

Të thuhet, gjithnjë kemi prodhuar kaq edhe kemi pasur furnizim me energji, kjo është shaka. Kur çmimet e importit kanë qenë 60 euro edhe kemi prodhuar kaq, edhe kursimet e importit janë deri në 500, edhe tashti nuk po mundemi të importojmë aq, të thuhet, po atëherë kem pasur energji me këtë prodhim, kështu që mirë kemi qenë, e tash jemi keq, është shaka.

Për vendim. Unë nuk di se si ta shpjegoj më qartë. Vendimi nuk është vendim për marrje të masave për reduktim të energjisë, vendimi është vendim i cili i lejon Qeverisë, në mënyrë të shpejtë të ndërhyjë në rast nevojë. Ju këtë jeni duke e parandaluar.

Në rast, qoftë të subvencionimit, qoftë çfarëdo mase që është e nevojshme, neve na duhet kjo bazë ligjore që të aprovohet prej jush, e ju nuk jeni duke e bërë këtë. Ndërkaq, iu ka shkuar tërë dita duke thënë, jeni vonuar se është dashur ta shpallni dy muaj më herët krizën, atëherë kur s'kemi qenë në krizë. Kjo është shaka.

Sa i përket çështjes së Selacit, thatë, këqyrni a janë duke u rrotulluar ata gjeneratorët. Sipas jush, nëse nuk rrotullohen gjeneratorët, energjia është duke u eksportuar, ndërsa nëse nuk rrotullohen gjeneratorët është duke e blerë KOSTT-i apo?

Nëse nuk rrotohen i bie që nuk është duke prodhuar, nëse nuk është duke prodhuar as nuk është duke eksportuar as nuk është duke u blerë në vend. Prapë kontratat janë diçka të cilat verifikohen edhe kjo nuk ka nevojë që të diskutohet.

Vendimin, nëse doni miratojeni nëse doni mos e miratoni, po arsyetime të tilla jo serioze ju lutem të mos jepni!

KRYETARI: Abelerd Tahiri një minutë, pastaj shkojmë në prezantimin e mocionit.

ABELARD TAHIRI: Joseriozitet më të madh se sa kjo Qeveri nuk kemi parë tash e dy dekada. Të vijë ministra e Energjisë dhe të thotë, ja ku e ke vendimin, nëse do votoje nëse do mos e voto, është sinjerisht mjerim. Nuk është kjo more me dëshirë nëse kështu ose nëse do ashtu, nuk është.

Ministre, duhet të jesh më e përgjegjshme në ushtrimin e detyrës tënde në kohën kur të ka rënë që të ballafaqohesh me një krizë të madhe. Nuk shkon kjo nëse do kështu ose nëse do ashtu.

Ky është një vendim, ti e ke shumicën këtu në Kuvend, i ke 50%. Kjo është dashur të kalojë me mëngjes dhe pa u diskutuar fare, pa u debatuar. Përfundoi debati, i ke numrat, e mbyllë. Pse? Kjo papërgjegjësi oj ministre?! Pra, sinqerisht jeni shumë të papërgjegjshëm.

Hiqe pikën 2.1, ku thotë: vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët, unë ta votoj. Veç reduktimet nuk t'i bën ligji. Kaq!

KRYETARI: E ftojme propozuesin e këtij debati parlamentar që ta propozojë mocionin nëse e kanë gati. Deputeti Ramush Haradinaj e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Nuk kam ndonjë mocion për shkak që e shoh që nuk do të kuptohem drejtë, veçanërisht nga Qeveria dhe nga ata që marrin vendime. E vërteta është se edhe këtë debat kur e kemi ftuar, nuk e kemi bërë këtë për shkak të neve që jemi në sallë ose e dimë që na shohin në televizion ata që na shohin, por e kemi bukur seriozisht edhe problem serioz edhe ne vet kemi familje në terr, edhe na, qysh e keni edhe ju besoj.

Andaj, ftesën për këtë debat para dy jave ka qenë që t'ia bëjmë një alarm Qeverisë që ta kuptojë që do të jetë një çështje të do të përballemi në vazhdimësi.

Unë i falënderoj të gjithë për diskutimet që i patën, dhe thënë të drejtën, nuk jam aq me shpresë. Pra, nuk kam ndonjë shpresë të madhe që po e dimë ku jemi, që po e dimë në çfarë situatë kemi hyrë dhe si do të dalim për kësaj situatë, fatkeqësisht, po e them.

Unë i kam veçuar nga përvoja ime qeverise, nga njohuritë e mia i kam veçuar disa këshilla nëse duan që t'i marrin kolegët e Qeverisë. Së pari, nuk duhet të lejohet që ne të zgjedhim mes reduktimit ose rritje së çmimit. Pra, nuk duhet të lejojmë, nuk duhet të vijë puna që të zgjedhim këtë.

Nëse sasia e energjisë e prodhuar në vend nuk mjafton, atëherë duhet të mobilizohemi që ta sigurojmë sasinë që na mungon, që bie, duhet ta sigurojmë, saktë përpara, një parallogari të kostos së importit deri në periudhën e krizës, për ato 60 ditë që po flasim për vendimin tuaj.

Pra, duhet ta bëjmë një llogari të saktë dhe të sigurojmë buxhet qysh tash dhe jo të dilet në vitin tjetër, për të gjithë operatorët edhe të garantojnë që kanë likuiditet, sepse nëse atyre u ndodhë që ta humbasin likuiditetin ose të ndodhë ndonjë masë disiplinues prej MSOE-së, atëherë do të jetë shumë keq për neve, edhe për neve, por edhe për të gjithë ata që kanë punë me neve realisht.

Pra, është rrezik tash që ta shtrojmë dilemën, a ta rrisim çmimin apo reduktimin. Çmimin s'bon ta rrisim, se jemi duke dhënë para të buxhetit, edhe shkoi kjo e para. Meqë kemi filluar që të japim para të buxhetit, se kemi filluar, i kemi 40 e sa milionë, atëherë bëjeni një llogari dhe e jani në Parlament dhe na tregoni, thoni, kaq na kushton deri në prill, a po ma jepni përkrahjen që të mos e lëmë popullin në terr.

Të më besoni, Aleanca jua jep përkrahjen, se s'kemi kah t'ia mbajmë. Nuk guxojmë të mos jua japim. Nuk guxojmë që t'i lëmë njerëzit në terr. Pra, ju lutem të bëheni të kujdesshëm.

Shikoni! Është, po ashtu, e rëndësishme që ta shfrytëzoni këtë krizë energjetike, ta shfrytëzoni koston e lartë të rrymës, e të filloni ta shtini autoritetin në veri që të paguhet rryma. Pra, e keni, jo një pretekst, por e keni një arsye mjaft të qëndrueshme që t'i jepni një datë të caktuar, ta zëmë, 1 shkurt a, 1 prill a, 1 mars a, edhe të filloni t'ua çoni faturat atyre njerëzve.

Shikoni! Nuk do të munden në pakufi t'i ikin kësaj çështjeje, dhe e keni kohën më të mirë të mundshme që të veproni tash, bazuar në këtë krizë, bazuar në milionat që po i japim.

Dëgjoni! U tha këtu se energjia e ripërtëritshme, alternative. Ju lutem! Gjatë qeverisjes sime, gjatë qeverisjes Haradinaj, përpos që e kemi kthyer prodhimin, kemi dhënë licencën për SOVI LCC. Një investim privat deri në 100 MW me erë është në Shalë të Bajgores dhe është në veri.

E kam përkrahur projektin Kika në Kamenicë. Kemi përkrahur edhe çdo projekt solar potencial. Sado që edhe ju t'i përkrahni këto projekte alternative, prapë nuk do ta kemi furnizimin e qëndrueshëm, se ju e dini më mirë jeni në temë, kapacitetet tona ekzistuese termo, janë të vjetra. Dhe, sa herë që bien në remont, si tash që ka rënë B-ja, ose sa herë tjetër që duhet të bëhen renovime e që keni kërkuar paratë, me çka do t'i kompensoni.

Është pamundur të sigurohet burim i qëndrueshëm energjetik, vetëm prej burimeve alternative ose energjisë, çfarë i kemi ne kushtet në Kosovë për energjinë e ripërtëritshme.

Ekziston një zgjidhje, ju lutem! U përmend Shqipëria. E falënderojmë kryeministrin e Shqipërisë e Shqipërinë për energji që na e jep për Vit të Ri, edhe shpresoj që do të na e japë edhe shpresoj që s'do të jetë në terr për Vit të Ri asnjë familje e Kosovës, po as Shqipërisë.

Atëherë, pse të mos i propozohet Shqipërisë, meqë kemi ardhur këtu në këtë krizë, investim të përbashkët termo, ose në Shqipëri, pra termo në Shqipëri, ose të marrim pjesë në hidro të Shqipërisë, Skavicen.

Pse të mos bëhet kjo? Për faktin se Qeveria jonë ka refuzuar dy projekte deri sot. E ka refuzuar...

KRYETARI: Ia zgjasni një minutë fjalën e tij zotit Haradinaj.

RAMUSH HARADINAJ: Është refuzuar Kosova e Re është refuzuar gazi, atëherë propozojeni ndonjë ide alternative për burime të qëndrueshme më shpejt dhe jo qysh po arsyetoheni nganjëherë 2 mijë e sa...

Ndoshta kolegë, ju kujtoni se qejfin më të madh e kemi veç t'ju zëmë ngushtë dhe vetëm t'ju fajësojmë edhe vetëm t'ju qesim në tabelë të qitjes.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem, deputetë!

RAMUSH HARADINAJ: Të mos harroni, kësaj here gjendja është ajo që është. Pra, të mos harroni, po ju them edhe njëherë, të mos harroni.

Unë shkoj në Gllogjan nganjëherë e më duhet t'i bie nëpër Gjakovë, e kur bie nëpër Gjakovë e shoh në terr. Unë udhëtoj nëpër Kosovë dhe i shoh me vendbanime të tëra në terr, as ndriçim në rrugë s'ka. Është rritur numri i aksidenteve të komunikacionit, janë rritur shumë probleme në Kosovë.

Pse vijnë ato? Kur nuk fle mirë, kur në je në rregull, kur nuk pasur ujë që ta bësh dush, ta pish një kafe. Krejt këto janë pasoja që janë duke i ndodhur këtij vendi. Të mos e neglizhoni gjendjen që e keni në vend, ju lutem!

KRYETARI: Ia zgjasni edhe një minutë zotit Haradinaj. Tash, nuk kemi fort edhe objekt për çka të votojmë. Disa propozime të cilat i formuloi zoti Haradinaj, ato mënyra më e mirë do të ishte që të ishin në formë të shkuar, e pastaj t'iu shpërndareshin deputetëve.

Kjo mund të ndodhë me siguri nëse mblihdemi nesër në orën 10:00 për vazhdimin e kësaj seance, e cila ka edhe shumë pika të tjera, natyrisht.

Pra, janë si në formë të qëndrimeve që i ka shpjeguar AAK-ja, të cilat janë të nevojshme për Qeverinë, që të aplikohen në krizën për të cilën ndodhi ky debat. Pra, vetëm kaq ka sa i përket kësaj.

Nëse pajtoheni mund ta vazhdojmë seancën nesër në orën 11:00? Në orën 11:00. Të mos harroni diçka, sepse është shumë e rëndësishme që të vini nesër se do ta kemi votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat i lamë një seancë para kësaj.

Kështu që, mirupafshim nesër në orën 11:00!

* * *

E mërkurë, 29 dhjetor 2021

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 24 dhjetor 2021

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në seancën, të cilën e kishim nisur më 24 dhjetor, kanë mbetur disa pika të rëndësishme të papërfunduara. Disa prej tyre nuk kanë pasur kuorum, kanë qenë marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare.

Urdhëro, po!

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar,

Po ju drejtohem juve, sot e kemi ftuar një seancë në orën 11:00 dhe në orën 11:00 kemi qenë vetëm tre apo katër deputetë në sallë. Ora është 11:43 minuta dhe ne po fillojmë me 43 minuta vonesë dhe ne, grupi ynë parlamentar, për shkak të marrëveshjeve ndërkombëtare nuk i kemi përdorur dhe nuk kemi shkuar në pushim.

Ju lutem, thirrni seancën, ejani me kohë dhe, në qoftë se nuk vini me kohë, lajmëroni të mos rrimë ne në sallë këtu sikur huta, po të shkojmë edhe ne në zyrat tona. Faleminderit!

KRYETARI: Sa për kryetarin e Kuvendit, seanca ka mundur të fillonte edhe në orën 8:00, kjo e ka përcjellë Kuvendin gjithmonë. Unë e kam provuar këtu, Besnik, edhe ty të të pres gjysmë ore, në këtë Kuvend, gjysmë ore të kam pritur, ta gjej seancën kur të kam pritur. Domethënë unë jam mësuar të vij këtu në Kuvend edhe kur kanë qenë vetëm pesë deputetë.

Por, problemi është që ato pritjet e mia për juve nga 30 edhe 40 minuta nuk m'u kanë dukur efektive. Pra, nuk m'u kanë dukur efektive që e ngrit, le të themi, vigjilencën edhe disiplinën për ardhjen në seancë, se unë vij, nuk është problemi, edhe 10 minuta para 11:00 vij dhe ju pres. Dy herë e kam provuar në këtë Kuvend, nuk ka pasur efekt, kështu që ka mbetur si në të kaluarën që kryetari të vijë kur të bëhet kuorumi. Tash, a është mirë a është keq, e diskutojmë këtë në një debat tjetër kur të thirrni.

Tash jemi 86 deputetë, mund ta fillojmë seancën.

Për diskutim po ia japim fjalën Avni Deharit.

AVNI DEHARI: Rreth propozimit të Besnikut. A e lëmë këtë në të kaluarën, se është e vërtetë se këto parregullsi na kanë përcjellë çdo herë, po që sot e tutje, kur të caktohet koha, të jemi të gjithë, kjo vlen jo vetëm për dikë, po për të gjithë.

KRYETARI: Unë betohem për vete.

AVNI DEHARI: Po!

KRYETARI: Tash të tjerët deklarohuni secili. Pasi po doni të bëni politikë. Politikë me pjesëmarrje, deklarohuni secili a do të vini.

Tash i kemi marrëveshjet ndërkombëtare që t'i votojmë.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet sa i përket Projektligjit nr. 08/L-098 për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e shkëmbimit akademik Fulbright.

Diskutimet kanë përfunduar atë ditë, kemi hyrë në procesin e votimit, nuk ka pasur kuorum. Tash besoj që i kemi kushtet për ta hedhur edhe një herë në votim këtë marrëveshje. Edhe një herë ta dimë numrin e saktë të deputetëve. 87 deputetë janë, është një kuorum i mjaftueshëm për të hyrë në procesin e votimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni, kjo marrëveshje e ka edhe një amendament.

Amendamenti 1.

Fillimisht e qesim në votim amendamentin numër 1 të marrëveshjes.

Deputetë, kush është për amendamentin 1 të kësaj marrëveshjeje?

Kush është kundër? Kush abstenon?

Sërish Kuvendi nuk ka kuorum për marrëveshjet ndërkombëtare. Kanë votuar vetëm 56 deputetë, pjesa tjetër nuk ka votuar.

Nëse mund ta marrim qëndrimin e grupeve politike për marrëveshjet e tjera, nëse paraprakisht e marrim informacionin që i njëjtë do të jetë procesi i votimit, nuk kishim hyrë në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, nëse deputetët nuk votojnë. Siç duket, mund ta kemi rezultatin e njëjtë për marrëveshjet e tjera, kështu që nuk i trajtojmë as ato.

22. Zgjedhja e dy anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 10 i Ligjit numër 06/L 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e dy anëtarëve, prej katër kandidatëve të propozuar si në vijim.

Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës, janë propozuar këta kandidatë:

Milana Deriq, e cila ka marrë 89 pikë dhe kandidatja tjetër, Dragica Jakovleviq, që ka marrë 61 pikë.

Kurse për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës siç përcaktohet në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë propozuar këta kandidatë:

Fahret Velija, me 84 pikë, si dhe Osman Cucoviq, me 69 pikë.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, në këtë rast, që ta arsyetojë raportin me rekomandime, kryetarin e Komisionit për Legjislacion, deputeti Adnan Rrustemi e ka fjalën.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 10 të Ligjit numër 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit për votim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit, si vijon:

Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozohen:

1. Milena Deriq, me 89 pikë, dhe
2. Dragica Jakovleviq, me 61 pikë.

Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi i 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozohen:

1. Fahret Velia, me 84 pikë dhe
2. Osman Cucoviq, me 69 pikë.

Kuvendi prej dy kandidatëve të propozuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të zgjedhë një prej tyre.

Po ashtu, Kuvendi, prej dy kandidatëve të propozuar për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të zgjedhë njërin prej tyre.

Votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor bëhet me votim të fshehtë. Mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është pesë vjet.

Më lejoni që të arsyetoj rekomandimin e Komisionit për Legjislacion në vazhdim.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke vepruar në pajtim me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 10 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 01.10.2021, mori vendim për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohen me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në këtë konkurs konkurruan 12 kandidatë, 7 prej tyre nuk u ftuan në intervistë për shkak se 5 kandidatët nga radhët e shumicës shqiptare dhe një kandidat nga radhët e komunitetit serb nuk ishin gjyqtarë, ashtu si është e përcaktuar me Kushtetutë, ku të paktën një anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës, duhet të jetë gjyqtar.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 26. 11. 2021 konstatoi se nuk ka kandidatura të mjaftueshme për kandidatët nga radhët e shumicës shqiptare, kurse nga radhët e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera janë plotësuar kushtet formale për intervistim.

Për pozitën e anëtarit të Këshillit nga radhët e komunitetit serb kushtet formale për të ftuar në intervistë i plotësuan Milena Deriq dhe Dragica Jakovleviq, kurse për pozitën e anëtarit të Këshillit nga radhët e komuniteteve të tjera kushtet për intervistim i plotësuan Fahret Velija dhe Osman Cucoviq.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2021, pas procesit të intervistimit dhe vlerësimit, radhiti kandidatët sipas rezultateve të poentimit.

Për pozitën e anëtarit, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, janë Milena Deriq, 89 pikë dhe Dragica Jakovleviq, 61 pikë.

Për pozitën e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kandidatët janë: Fahret Velija, 84 pikë dhe Osman Cucoviq, 69 pikë.

Komisioni, pas përfundimit të procedurës së intervistimit, vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë për votim të kandidatëve të propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat arsyetimin e raportit të komisionit, së bashku me rekomandime.

Prej grupeve parlamentare fjalën e ka kryetari i Grupit të PDK-së, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Paraprakisht e pata një propozim, në qoftë se pajtohen edhe grupet e tjera parlamentare. Ne i kemi disa votime këtu në kuti, nëse do të ishte e mundshme, për shkak të racionalizimit edhe të kohës, meqenëse kemi edhe pika të tjera, zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, zgjedhjen e dy drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut "NP KOSTT" dhe zgjedhjen e tre anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media t'i bëjmë e tri kutia dhe t'i marrim fletëvotimet të njëjtën kohë dhe të votojmë në të tri proceset.

Kjo nuk është një praktikë që s'ka ndodhur në të kaluarën në Kuvend. Nëse është e mundshme, mirë, nëse jo, atëherë vazhdojmë kështu. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Tahiri, po më informojnë që teknikisht është goxha e ndërlikuar, po të ishin, për shembull, gjashtë emra apo tetë emra, por kemi të bëjmë me 18 zgjedhje, 18 kandidatë, e të

zgjedhim mes tyre përnjëherësh, është pak e ndërlikuar dhe merr shumë gjatë për vetëm një deputet që t'i kryejë të gjitha procedurat.

Prandaj, besoj që shumë më efektiv do të ishim që t'i ndanim veç e veç, secilin votim sipas pikës që është.

Megjithatë, ta sqarojmë një këshillë procedurale, e cila është e nevojshme gjatë votimit tuaj.

Të nderuar deputetë,

Mbështetur në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafët 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 10 të Ligjit numër 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi i Republikës së Kosovës bëhet sipas paragrafit 3, dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e garantuara për përfaqësues të komunitetit serb në Kosovë dhe, të paktën njëri prej këtyre dyve, dy kandidatëve, duhet të jetë gjyqtar si dhe për nënparagrafin 4, dy anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara të përfaqësuesve të komuniteteve të tjera dhe të paktën njëri prej këtyre dyve po ashtu do të jetë gjyqtar, prej këtyre kandidatëve.

Sipas nenit 10, paragrafi 9, i Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor, po citoj: “Nëse në rrethin e parë kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk e marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë në rundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave”.

